

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXLVIII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 53

LEONARDO M. SAVOIA
(në bashkëpunim me M. Rita MANZINI e Bendetta BALDI)

STUDIME NË GJUHËSINË SHQIPTARE

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXLVIII
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 53

LEONARDO M. SAVOIA
(in cooperation with M. Rita MANZINI and Bendetta BALDI)

STUDIES IN ALBANIAN LINGUISTICS

Approved for publication at the meeting of the Section of Linguistics and Literature,
held on 27th April, 2015, after review by
academician Rexhep Ismajli and academician Idriz Ajeti.

Editor: Academician Eqrem Basha, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXLVIII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 53

LEONARDO M. SAVOIA
(në bashkëpunim me M. Rita MANZINI e Bendetta BALDI)

STUDIME NË GJUHËSINË SHQIPTARE

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
mbajtur më 27 prill 2015, në bazë të recensioneve të
akademik Rexhep Ismajlit dhe akademik Idriz Ajetit.

Redaktor: Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Copyright © ASHAK

PASQYRA E LËNDËS

<i>Variacion dhe përzierje gjuhësore në sistemet arbëreshe: Code-mixing, huazime dhe konvergencë në kushtet e dygjuhësisë.....</i>	9
<i>Mikrovariacioni në morfosintaksën e sintagmës emërore në arbërishte.....</i>	91
<i>Morfo-sintaksa e pjesores dhe e paskajores në të folmen e Shkodrës (me Maria R. Manzini-n).....</i>	153
<i>Ndarja e vetës në sistemet e rasës të gegërishtes (Shkodër) dhe arbërishtes (Greci) (me Maria R. Manzini-n).....</i>	201
<i>Etimologji dhe gjuhë kombëtare. Shënime mbi një aspekt të gjuhësisë së Eqrem Çabejt.....</i>	245
<i>Gjuha në shoqëritë e përziera: identitete dhe variacione gjuhësore. (me Benedetta Baldi-n).....</i>	265

BURIMET:

1. *Variacion dhe përzierja gjuhësore në sistemet arbëreshe: Code-mixing, huazime dhe konvergjencë në kushtet e bilinguizmit* [L. M. Savoia (2012): *Studi sulle varietà arbëreshe*, Università della Calabria Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia, f. 1-63]. Përkthyer nga Majlinda Bregasi.
2. *Mikrovariacioni në morfosintaksën e sintagmës emërore në arbërishte*, [L.M. Savoia (2012), *Studi sulle varietà arbëreshe*, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia, f. 64-109]. Përkthyer nga Majlinda Bregasi.
3. *Morfo-sintaksa e pjesores dhe e paskajores në të folmen e Shkodrës*, [M. R. Manzini, L. Savoia (2003), *Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës, në Studime filologjike*, vol. 2003, f. 93-138, Variant i rishikuar]. Përkthyer nga Genc Lefe.
4. *Ndarja e vetës në sistemet e rasës në gegërishte (Shkodër) dhe arbërishte (Greci)*, [M. Rita Manzini, Leonardo M. Savoia (2014), *Person splits in the case systems of Geg Albanian (Shkodër) and Arbëresh (Greci). Studi Italiani di Linguistica Teorica e Applicata*, 1 - 2014, f. 7-42]. Përkthyer nga Majlinda Bregasi.
5. *Etimologji dhe gjuhë kombëtare. Shënime mbi një aspekt të gjuhësisë së Eqrem Çabejt* [në Thoma Dhima e Vasil Bici (nën kujdesin e), *Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare*, fq. 79-97, Tiranë: Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë]. Përkthyer nga Genc Lefe.
6. *Gjuha në shoqëritë e përziera: identitete dhe variacione gjuhësore*. [Benedetta Baldi, Leonardo M. Savoia (2006), *Perché barbari? Lingua, comunicazione e identità nella società globale*, Roma Bulzoni, f. 67-94]. Përkthyer nga Majlinda Bregasi.

FALËNDERIM

Falenderoj në mënyrë të veçantë Majlinda Bregasin për punën e çmuar për përkthimin e kësaj vepre dhe Genc Lafen për përkthimet e arrira, bërë kohë më parë.

I jam shumë mirënjohës Flora Kolecit për rishikimin e kujdesshëm të teksteve.

Leonardo Savoia

VARIACION DHE PËRZIERJE GJUHËSORE NË SISTEMET ARBËRESHE: CODE-MIXING, HUAZIME DHE KONVERGJENCË NË KUSHTET E DYGJUHËSISË

Komunitetet arbëreshe paraqesin një tërësi dukurish të code-switching, huazimit, konvergjencës dhe të hibridizimit gjuhësor si pasojë e situatës së bilinguizmit mes shqipës dhe dialektit roman, që ka zgjatur për një kohë shumë të gjatë (Camaj 1974, Bibbò 1974, Gambarara 1980, Bolognari 1986). Në këtë kapitull do të shqyrtojmë disa dukuri të përzierjes gjuhësore që lidhen me alternimin mes një varietet arbëresh dhe një varietet roman lokal në bashkësinë e *Gines-tras* (Lucania), *Casalvecchio-s* (Puglia), *Venadi Maida-s* (Calabria). Kjo gjendje, sikurse theksohet në literaturën e (Gumperz e Wilson 1971), reflektohet në proceset e riorganizimit e konvergjencës mes dy gramatikave. Në rastin e komuniteteve arbëreshe, në përgjithësi është arbërishtja ajo që inkorporon veti dhe mjete të morfosintaksës dhe fonologjisë romane, megjithatë janë dokumentuar edhe dukuri të konvergjencës të gramatikës romane mbi atë arbëreshe. Një shembull interesant i gjithë këtij procesi del në dialektin kalabrez që flitet në *Vena*, në të cilin shfaqen tipare, të cilat, një pjesë, rrjedhin nga mekanizmat e riorganizimit gramatikor që kanë të bëjnë me gjuhët e mësuarra dhe, nga pjesa tjetër, janë pikërisht të trashëguara nga arbërishtja.

Leksiku i varieteteve arbëreshe të shqyrtuara përfshin njëgrup bazash leksikore të përbashkëta me varietetin roman+, të cilat kombinohen me morfologjinë fleksive arbëreshe; përveç kësaj shfaqen kushte të leksikalizimit specifik, të ndryshme nga ndërtimet standarde, që veçanërisht përkojnë me sintaksën e fjalisë së varur, të pjesores, të mbiemrit e të sintagmës emërore dhe të morfologjisë së foljes. Ky sis-

temin të rikujton atë çka literatura e quan ‘gjuhë të përzier’, të cilat përdoren në gjendje dygjuhësie e që karakterizohen nga një leksik i përzier dhe nga një morfosintaksë e veçantë që dallon si nga ajo e gjuhës së origjinës, ashtu edhe nga gjuha e kontaktit të folësve. Nga dygjuhësia rrjedhin edhe dukuri të hibridizimit dhe të riorganizimit si në dukuritë fonologjike arbëreshe, ashtu edhe në gjuhët e mësuara romane. Kështu, në arbërishten e *Ginestra-s*, krahas huazimeve të shumta leksikore, shfaqet një organizim fonetik që riprodhon ndjeshmerinë e strukturës së rrokjes dhe diftongizimin në rrokje të hapur të zanoreve tonike, që karakterizon dialektin lukan. Procese të riorganizimit fonologjik prekin edhe varietetet arbëreshe e romane që zotërohen nga folësit e Venës.

Variacioni lidhet në veçanti me procesin e përvetësimit; në këtë kutpim mund të shihet si rezultat i kushteve të bilinguizmit dhe të proceseve të code-switching dhe code-mixing që kanë të bëjnë me të. Dukurive të përzierjes gjuhësore i kushtohet ky kapitull. Kapitulli i dytë, morfosintaksa e sintagmës emërore arbëreshe, analizon disa nga parametrat që karakterizojnë sistemin e rasave dhe të përshtatjes brenda sintagmës emërore në varietetet e *Vena di Maida-s*, *Ginestra-s* dhe *Casalvecchio-s*. Krahasimi i gramatikave hedh dritë mbi një variacion të mekanizmave morfosintaksorë, që vë në pikëpyetje dallimin mes gjuhëve që lidhen si rezultat i procesit normal të të nxënit, në veçanti, në kushtet e dygjuhësisë dialekt roman-dialekt arbëresh, si në rastet e huazimeve mbiemërore apo në sistemin flektiv të mbiemrave. Nga një këndvështrim teorik mund ta shohim variacionin linguistik si reflektim të një leksiku pjesërisht të ndryshëm, më saktësisht, në mënyrën në të cilën elementët leksikorë, përfshirë edhe morfologjinë, realizojnë një hapësirë konceptuale universale. Edhe hapësira fonetike duket se lidhet ngushtë me aftësinë e të folurit dhe variacioni që i intereson përkon me mënyrën me të cilën leksemat zbatojnë mekanizmat prozodike që ato vetë i përmbajnë.

1.1. Përzierja gjuhësore, variacioni dhe aftësia e të folurit.

Multilinguizmi, kontakti gjuhësor, dukuritë e përzierjes dhe pishinizmi gjuhësor kanë shoqëruar funksionimin dhe përdorimin e gjuhëve që nga shpërndarja e species njerëzore në rajone të ndryshme të tokës. Mund të themi se një nga faktorët që kontribuon për variacionin gjuhësor lidhet pikërisht me mekanizmat e dygjuhësisë dhe përzierjes. Më konkretisht, edhe procese si shpërndarja dhe dallimi i gjuhëve indoeuropiane në Europë dhe Azi (Renfrew 1988, Villar 1997) dhe vetë formimi i gjuhëve romane nga latinishtja apo i gjuhëve gjermanike moderne, na shpërndarja gjuhësore dhe te proceset që ndodhen në bazë të tyre. Qasjet e ndryshme mbi evolucionin kognitiv të njeriut, që nga shfaqja e gjuhës e dallimi gjuhësor (Hauser, Chomsky e Fitch 2002, Jackendoff 2002, Pinker e Jackendoff 2005, Nichols 1992, Mayers-Scotton 1992) e forcojnë idenë që gjuhët antike dhe gjuhët që fliten aktualisht varen nga e njëjta bashkësi parimesh dhe parametrash. Ndaj të gjitha gjuhët natyrore shpjegohen mbi bazën e një bashkësie me të njëjtat veti strukturore. Sipas një tipologjie krahasimtare, Nichols (1992) del me rezultatin:

No evidence of anything like speciation has been found in this or any other typological work [...] Languages from typologically very different areas have the same latent structural potential [...] In summary, this survey has uncovered no evidence that human language in general has changed since the earliest stage recoverable by the method used here There is simply diversity, distributed geograph-ically. (Nichols 1992: 277)

Perspektiva mentaliste nga ku del ky kontribut thotë se të gjitha gjuhët pasqyrojnë të njëjtën bashkësi parimesh të cilat përkojnë me të njëjtën bazë kognitive, Gramatika universale (Chomsky 1995). Çdo gjuhë natyrore përkon me një sistem mental të njohjes së të njëjtit tip, që ruan informacione mbi tingujt, kuptimin dhe organizimin strukturor (Chomsky 2000a, b).

Të dhënat mbi kuptimin e fonologjinë që përfaqësohen në elementet leksikore, komputohen në kombinimin sintaksor dhe në to kanë qasje sistemet e ekzekutimit, pra sistemi senso-motor dhe ai i mendimit. Përvetësimi i gjuhës i përcaktuar gjenetikiisht sugjeron që:

[...] the diversity and complexity can be no more than superficial appearance [...] the search for explanatory adequacy requires that language structure must be invariant (Chomsky 2000b:7)

Si rrjedhim, trajtimi i diferencimit gjuhësor paraqet një problem qendror të teorisë gjenerative. Zgjidhja e propozuar për këtë problem ka qenë një koncept parametrik, pra ideja se variacioni varet nga sisteme të ndryshme rregullash, të cilat në çdo gjuhë do të duhej të zbatonin parimet e gramatikës universale (Chomsky 1986, Baker 2003). Sipas kësaj perspektive, një zgjedhje e vetme parametrike, ka pasoja që përfshijnë një bashkësi ndërtimesh sintaksore. Modeli minimalist i zhvilluar nga Chomsky (1995, 2001a, b) e vë në diskutim këtë perceptim të variacionit gjuhësor, duke e lidhur me dallimet leksikore, veçanërisht morfologjike:

It may be that the computational system itself is (virtually) invariant, fixed by innate biological endowment, variation among languages and language types being limited to certain options in the lexicon; quite restricted options (Chomsky 2000b: 79) ...variation may be limited to formal aspects of the language – case of nouns, verbal inflection, and so on. Even here, variation may be slight... But there is evidence that the languages have basically the same inflectional system, differing only in the way formal elements are accessed by the part of the computational procedure that provides instruction to articulatory and perceptual organs. The mental computation seems otherwise identical... (Chomsky 2000b: 120)

Variacioni gjuhësor është pra rezultat i ndërveprimit të një sistemi gramatikor universal dhe të lindur me vetitë semantike të elementëve leksikorë të përvetësuar nga folësi i cilësdo gjuhe. Në fakt, janë

elementët leksikorë ata që regjistrojnë kategoritë morfosintaksore të nevojshme për gjenerimin e fjalive. Veçanërisht variacioni mund të lidhet me mekanizma të caktuara gjatë procesit të përvetësimit. Pasi që vetëm pjesërisht hyn në informacionin e strukturuar të gjuhës ndaj së cilës ekspozohet, fëmija mund të aplikojë zgjedhje të ndryshme nga ato të gramatikës së të rriturve, edhe pse janë njësoj të pranueshme nga Gramatika Universale. Ndaj leksikoni i fazës së përvetësimit dhe ai i L1 do të jenë të paktën pjesërisht të dallueshme në kushtete zakonshme të variacionit gjuhësor (Savoia e Manzini 2007). Përzierja gjuhësore propozon kushte të krahasueshme, në kuptimin që një rol vendimtar luhet nga huazimet dhe nga formimet e reja leksikore, të cilat përdoren nga folësit kur zëvendësojnë leksikun e L1 me format e L2 (Matras 2000). Në veçanti, nëse janë elementet leksikore të një gjuhe ato që regjistrojnë vetitë morfosintaksore të vlefshme për interpretim, mënyra me të cilën huazimet leksikalizojnë kategoritë gramatike dhe semantike do të ketë ndikim mbi komputacionin e fjalisë.

1.2 Aspekte të përzierjes gjuhësore.

Variacioni që lidhet me multikulturalizmin në shumë bashkësi gjuhësore shfaqet te mekanizmat e code-switching, pra në aftësinë e folësve për të kaluar nga një gjuhë në tjetrën e, në mënyrë edhe më vendimtare, në prodhimin e thënieve mikslingue (code-mixing). Mund të pyesim cili është statusi i formave hibride në vetëdijen gjuhësore të një folësi biling, nëse format hibride paraqesin një nivel të veçantë të dygjuhësisë dhe risillen në proceset e code-mixing. Në fakt, literatura mbi përzierjen gjuhësore nxjerr si tipike te të ashtuquajturat gjuhë të përziera gjendjen në të cilën bazat leksikore të një gjuhe kombinohen me sistemin flektiv të një gjuhe tjetër, ajo çka Bakker e Muysken (1994) quajnë ‘language intertwining’. Te Matras dhe Bakker (2003:1) është propozuar një klasifikim i gjuhëve të përziera, të përcaktuara si në vijim:

In the discussion context on Mixed Languages, we are concerned [...] with varieties that emerged in situations of community bilingualism, and whose structures show an etymological split that is not marginal, but dominant [...] Even the minimal definition we have just mentioned does not cover all languages referred to in the literature as ‘mixed’ in a straightforward and unambiguous manner. [...] some varieties that are regarded as MLs did not emerge in a situation of fluent bilingualism. In relation to some others, the issue of languageness may be controversial.

Matras dhe Bakker (2003) te dygjuhësia gjejnë mekanizmin që qëndron në bazë të gjuhëve të përziera, karakteristika fundamentale e të cilave qëndron në faktin që njëra gjuhë furnizon bazat leksikore, morfemat përmbajtjesore, ndërsa tjetra furnizon formativët funksionalë dhe morfologjinë flektive. Marrëdhënia mes gjuhës që furnizon morfologjinë sintaksën dhe gjuhës që furnizon bazat leksikore skematizohet nga Myers-Scotton (1993, 2003:73) në dallimin mes ‘embedded language’ dhe ‘matrix language’, të sintetizuar nga etiketa ‘split languages’ (gjuhë të ndara).

First, to call them “mixed” implies lack of system in their structure. Second, the split between the two main subsystems of language, the grammatical and the lexical, is especially apparent in these languages. (Myers-Scotton 2003: 73)

Nocionin *gjuhë e përzier*, në fakt, është e vështirë ta ndash në mënyrë të qartë nga *code-switching*, nga grammatikat sekondare apo të pixhinizuara, që lidhen me gjendje të dygjuhësisë së theksuar, dhe nga huazimi. Huazimi përfaqëson një nga mekanizmat kryesorë të variacionit që lidhen me *code-switching* dhe me formimin e një gjuhe të përzier. Myers-Scotton (1992) flasin për ‘huazim të thellë’ për të tre-guar kalimin, jo vetëm të leksikut kulturor, por edhe të leksikut bazë, dhe në disa raste edhe të elementëve morfologjikë në kushte të përzierjes së theksuar. Muysken (1996) i kundërvë gjuhët e përziera si ndaj ndërgjuhëve (gjuhë të ndërmjetme), ashtu edhe ndaj atyre pihine, për të theksuar lidhjen e ngushtë që përshkon procesin e for-

mimit të gjuhëve të përziera dhe proceset e code-switching, huazimit dhe përvetësimit të L2. Për dallim nga gjuhët e përziera, sistemi gramatikor i pixinëve e i kreoleve përmban risi dhe parametra morfologjike të posaçme (Bakker 2003). Edhe huazimi në bazën e gjuhëve të përziera do të dallohet nga huazimi normal, pasi që në gjuhët e përziera fjalët do të kombinonin morfologjinë e një gjuhe me bazën leksikore të një tjetre (Bakker 2003).

Përsa i përket code-switching, edhe pse literatura e konsideron code-switching si kusht të nevojshëm e gjithësesi të rëndësishëm për formimin e gjuhëve të përziera, megjithatë disa autorë i lidhin gjuhët e përziera me një proces riorganizimi, i cili shkon përtej një code-switching të thjeshtë (Bakker 2003). Në lidhje me këtë Myers-Scotton (2006: 241) theksojnë se në gjuhët e përziera vetëm njëra nga gjuhët e përfshira në code-switching furnizon kornizën morfosintaksore të fjalisë:

Classic codeswitching includes elements from two (or more) languages varieties in the same clause, but only one of these varieties is the source of the morphosyntactic frame for the clause.

Përveç kësaj, gjuhët e përziera do të krijoreshin nëpërmjet një procesi më të shpejtë të code-switching në kontekste socio-komunikuese, në të cilat përzierja e popullatave që flasin gjuhë të ndryshme është e sistemuar, në radhë të parë në lidhjet e brendshme në familje (Bakker e Muysken 1994, Bakker 2003, Matras e Bakker 2003). Për çdo rast, dygjuhësia dhe mekanizmat e codemixing/switching përgjithësisht rregullohen nga faktorë psikologjikë, demografikë (mosha, gjinia etj), që lidhen me statusin dhe më në fund nga faktorë situacionalë, të regjistrave dhe, natyrisht, nga faktorë pragmatikë që dalin nga ndërtimi dhe nga interpretimi i kuptimit (Baldi e Savoia 2006).

Mbeten, pra, shumë çështje të hapura: për shembull, ekzistenca e llojeve të ndërmjetme të përzierjes, raporti mes dukurive të code-switching e paralelizmave me gjuhët pixinin, varietetet sekondare dhe kreolet. Variacioni që del nga krijimi i varieteteve sekondare/ të të

nxënit, në forma të dygjuhësisë, përzierjes (code-switching dhe code-mixing) dhe huazimeve ka në bazë struktura që të kujtojnë përdorimet “e thjeshtëzuara” të gjuhës (Ferguson 1971), të cilat karakterizohen nga sintasa dhe leksiku i rrëgjuar ose ekspresiv, dhe gjuhët pixhine (Bakker 1994). Në kontekstet kur ndodh kontakti shfaqen varietete pjesërisht të përziera, vetitë morfosintaksore të të cilave, si në rastin që do ta shqyrtojmë, lidhen me ato të varieteteve të të nxënit, të paktën në kuptimin që këto të fundit janë frut i dukurive të hibridizimit mes gjuhës native të folësit dhe gjuhës së komunitetit mikpritës (Whinnom 1971). Për çdo rast, nëse zotërimi i një gjuhe përkon me një sistem të veçantë të njohjes që individi e zhvillon në bazë të një aftësie të veçantë të mendjes së tij, një gjuhë e përzier do të përkojë thjesht me një nga sistemet gramatikore të mundshme që ia lejon ajo aftësi.

Në kuadër të kësaj, varietetet arbëreshe të analizuara dalin si gjuhë me një shtrirje të gjerë të rileksikalizimit roman në kushtet e dygjuhësisë arbërishte-dialekt lokal lukan dhe code-switching, që përfshin, përveç dialektit, edhe italishten vendore. Në arbërishten e *Ginestra-s*, sikurse në atë të *Casalvecchio-s* dhe *Vena-s*, shfaqen si vetitë e gjuhëve të përziera, si janë formimet leksikore me bazë romane dhe eptim arbëresh, ashtu edhe vetitë e gjuhëve sekondare, dhe në përgjithësi të proceseve të përvetësimit të L2. Në veçanti, dukuritë e riorganizimit morfosintaksor që lidhen me eptimin e sintagmës mbiemërore dhe leksikalizimin e kauzativit dhe vetive argumentuese të foljes (shkakorja, pjesorja), dhe disa mekanizma fonologjike, duke e risjellë kontaktin me varietetet romane, na shpjen te riorganizimi gramatikor që del në dritë në proceset e përvetësimit të L1 apo L2.

Bakker dhe Muysken (1994:50) propozojnë që:

The grammatical system (syntax, morphology, phonology) of the intertwined language is often derived from the language known best by the first generation of speakers [...] If an intertwined language is spoken by children of mothers speaking language and fathers speaking lan-

guage Y, the grammatical system will be the one from language X, the language of the mothers.

Kjo skemë përkon me aspekte që spikatin në komunitetin e studiuar, duke parë që, sikurse është e njohur nga literatura socio-linguistike, sjellja konservative, kujdesi ndaj traditës dhe rregullave të grupit, pikërisht nga ana e grave, kombinohet me një hapje më të madhe ndaj kulturave të pranishme nga ana e burrave. Arbërishtja e *Ginestra-s*, *Casalvecchio-se Vena-s* nuk e arrin thujt asnjëherë rileksikalizimin total që karakterizon gjuhët e përziera në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe shfaqen më tepër si gjuhë me një rileksikalizim të zgjeruar roman në kushtet e dygjuhësisë arbërishte - dialekt vendor dhe të code-switching, që përfshin, përveç dialektit, edhe italishten vendore. Për më tepër, për aq sa origjina epërzierjes gjuhësore arbërishte-dialekt mund të gjejë një shpjegim, të paktën pjesërisht, në modelet e autorëve të cituar më sipër, duhet të pranojmë idenë që mund të jenë në lojë më shumë faktorë, si nga ana pragmatike, ashtu edhe ajo psikologjike.

2. Grupe leksikore me origjinë romane në varietetet arbëreshe.

Nëse huazimet janë rezultat i përvetësimit të arbërishtes në kushtet e dygjuhësisë, mund të pyesim nëse shpërndarja e huazimeve në leksik varet nga kufizimet e studiuara në rastin e përvetësimit të L1. Në literaturë është konsoliduar pikëpamja (Gleitman etj. 2005 dhe diskutimi i sjellë aty) se gjatë procesit të përvetësimit përkimi fjalë botë favorizon fjalët të cilat u referohen objekteve dhe ngjarjeve konkrete, të perceptueshme dhe lehtësisht të identifikueshme me anë të eksperiencës, pra fjalë si ‘qen’ dhe ‘hidhem’, në krahasim me ‘besoj’ dhe ‘di’. Mund të pyesim nëse ‘ky nivel bazik i kategorizimit konceptual’ përcakton një rezistencë më të madhe nga pjesa përkuese e fjalorit të secilës nga gjuhët e zotëruara nga një folës apo favorizon hibridizimin. Në literaturë, përveç kësaj, njihet se përvetësimi i huazimeve reflekton një hierarki në bazë të së cilës emrat favorizohen veçanërisht

si huazime të mundshme: *emrat* > *mbiemrat* > *foljet* > *parafjalët* (Appel e Muysken 1987; Myers-Scotton 2006).

Leksiku bazë që shenjon objekte natyrale dhe module të tjera bazike (farefisni, ndarjen e kohës, numrat etj) është ai që përfshin numrin më të vogël të huazimeve. Në të kundërt, bashkësia e emrave që lidhen me artefaktet është veçanërisht e pasur me format hibride, pra me baza leksikore të gatshme për eptimin arbëresh ose roman në varësi të kontekstit, si për shembull në rastet që kemi shënuar në tabelë. Në veçanti, në këto mjedise kognitive huazimi është produktiv në kuptimin që huazimi i rastit është më se i zakonshëm. Krahasimi mes varieteteve tregon se foljet psikologjike ruhen mjaft mirë, foljet që tregojnë gjendjen e gjërave dhe ngjarjeve favorizojnë përhapjen e huazimeve. Gjithësesi folje të zakonshme si ‘mendoj, besoj’ janë huazuar nga dialektet romane, duke konfirmuar kështu rëndësinë e kufizimeve pragmatike.

Kushte të ngjashme karakterizojnë varietetet e analizuara. Format emërore hibride përfshijnë edhe referues që lidhen me pjesët e trupit, në (1a.i.), edhe rereferues që lidhen me entitete natyrore, në (1.a.ii.), si edhe referues që lidhen me artefaktet dhe specifikimet kulturore, në (1.a.iii.). Format foljore të përbashkëta si për leksikun arbëresh ashtu edhe për atë roman, të marra si shembull në (1b), përfshijnë folje psikologjike (besoj, kuptoj, mendoj etj) që tregojnë gjendje, folje që tregojnë aktivitete (që lidhen me botën kulturore) apo ngjarje me karakter telik¹. Të kihet parasysh se [ʎʎ] që gjendet në disa forma arbëreshe të *Ginestra*-s në (1) përkon me [dd] të dialektit roman.

(1) *Ginestra*

a. <i>emra</i>		
<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>	
i. kɔtsə	kɔtsa	‘kokë’
bəkə	beka	‘mjekër/sqep’

¹ Ngjarje telike quhet ajo ngjarje që përmban një qëllim në vete, një objektiv që duhet të arrihet. Ndaj predikati që i referohet asaj ngjarjeje quhet predikat telik (shënim i përkthyesit).

	kanarunnə	kanarunna	‘qafë’
ii.	məlundə	məlundə	‘pjepër’
	skərtsə	skərtsa	‘lëkurë’
	nutsə	nutsa	‘farë’
	kriateurə	kriateura	‘fëmijë’
iii.	vətrinmə	vətrinna	‘xham, vitrinë’
	stiauvukkə	stiauvukka	‘pecetë buke’
	məsələ	məsələ	‘mbulesë tavoline’
	sutaniłłə	sutaniłłə	‘fustan’
	kautsettə	kautsetta	‘çorape’
	martiłłə	martiłłə	‘çekiç, çekan’
	siccə	sicca	‘kovë’
	tielłə	tielłə	‘tigan’
	kucarə	kucara	‘lugë’
	furtfinnə	furtfinna	‘pirun’
	latrunnə	latrunna	‘hajdut’
b.	<i>folje</i>		
	fuməɲ		‘(unë) pi duhan’
	tsumbəɲəɲ		‘(unë) hidhem, kërcej’
	fərnəɲəɲ		‘(unë) pres/ ndalem’
	ðətrəna		‘(unë) tërhiqem’
	turnəɲə		‘(unë) kthehem’
	sparəɲəɲəɲ		‘(unë) kursej’
	fərnəɲəɲ		‘(unë) mbaroj’
	sfriɲəɲɲə		‘(unë) fërgoj, tiganis’
	mbukəɲ		‘(unë) ngroh (gjellën)’
	ɲdɲiɲəɲəɲ		‘(unë) filloj, filloj të përdor’
	ðucəɲəɲ		‘(unë) shikoj, vërej’
	<i>Casalvecchio</i>		
a.	<i>emra</i>		
	<i>njējës</i>	<i>shumës</i>	
i.	kəɲfə	kəɲf(a)	‘kokë’
	bəkə	beka	‘mjekër’
	kanarətsə	kanarətsa	‘qafë’
	putsə	putsa	‘puls’
ii.	məlundə	məlundə	‘pjepër’

	patanə	patana	‘patate’
	skərtʃə	skərtʃa	‘lëkurë (frutash, perimesh)’
	furməkɛlə	furməkɛla	‘milingonë’
	krapite	krapita	‘çjap’
iii.	bukirə	bukira	‘gotë’
	məsələ	məsəla	‘mbulesë tavoline’
	sədʒə	sədʒə	‘karrige’
	skamandiələ	skamandiəla	‘shami’
	martiələ	martiələ	‘çekiç’
	sekə	seka	‘sharrë’
	lastrə	lastra	‘pllakë xhami’
	tsənələ	tʃənala	‘përparësë’
	vanderə	vandera	‘përparësë’
	vritə	vrita	‘xham’
	lənamə		‘dru’
	butiɫlə	butiɫla	‘shishe’
	ləndzuələ	ləndzuəla	‘çarçaf’
	kucarinə	kucarina	‘lugë’
b.	<i>folje</i>		
	tsupəŋ		‘(unë) rrah, vras’
	rəpətsəŋ		‘arnoj’
	sfririjə		‘fërgoj’
	fərməŋ		‘pres/ndalem’
	tʃupəkəŋ		‘çaløj’
	rambəkəkam		‘kacavirem’
	krəðirij		‘besoj’
	kəpirij		‘kuptoj’
	<i>Vena di Maida</i>		
a.	<i>emra</i>		
	<i>njējëshumës</i>		
i.	kanarəts	kanarətse	‘fyt’
ii.	məlun	məlune	‘pjepër’
	hərmikulə	hormikula	‘milingonë’
	əɲɛɫ	əɲɛɫɛ	‘qingj’
iii.	sədʒ	sədʒ	‘karrige’
	stip	stipe	‘dollap, bufe’

martελ	martελε	‘çekiç, çekan’
kat	kate	‘kovë’
hadalic	hadalice	‘përparëse’
lëndzəl	lëndzəje	‘çarçaf’
kucarın	kucarınε	‘lugë’
vitr	vitre	‘xham’
b. <i>folje</i>		
kriðjına		‘unë besoj’
pendzəna		‘mendoj’
kapişjına		‘kuptoj’
ntşjına		‘filloj, nis’
lejına		‘lexoj’
preçəna		‘lutem’
sətahəmə		‘ulem’
mpertikakəm		‘kacavirem’
kardzəna		‘hidhem, kërcej’
sputjına		‘pështyj’
şundjına		‘zgjidh’
ripettsəna		‘arnoj’
frijjına		‘fërgoj’
huməna		‘pi duhan’

Trajtimi morfosintaksor i huazimeve romane emërore dhe foljore pasqyron kushtet e sintaksës arbëreshe. Në veçanti, bazat emërore kombinohen me morfologjinë e klasave emëror edhe ato të shumësit arbëresh si edhe me morfologjinë e përcaktuar si rasë, pra Em (ërore), Kall(ëzore), Gjin(ore)/ Dhan(ore), që për arsye të paraqitjes sa më të qartë ndahet nga baza me një vizë lidhëse. Një grup huazimesh emërore përfaqëson morfologjinë e shumësit *-a*, si në (2a’). Në (2) janë marrë shembujt në (a) emra dhe në (b) folje në formën romane, ndërsa në (a’, b’) janë sjellë huazimet arbëreshe përkatëse.

(2) *Ginestra*

a. furtşeina/ furtşeinə	b. tumbə/	tumba
‘piruni/pirunjtë’	‘hidhem, hidhesh/	hidhet’
a’. furtşinnə / furtşinna	b’. tumbəj/	tumbənnə

‘pirun/pirunj’	‘hidhem/	hidhesh, hidhet’
furtʃinn-a/ furtʃinn-ətə		
‘piruni-Em/pirunjtë-Em/Kall’		

Casalvecchio

a. mələnə/ məlunə	b. kreðə/	kriðə
‘pjeper/pjepri’	‘besoj, beson (ai)/	beson’
a’. məlun / məluna	b’. krəðirij/	krəðirən
‘pjeper/ jepri’	‘besoj/	beson

VII/IIIInj’

məlun-i/ məlun-ətə
‘jepri-Em/pjepri-Em/Kall’

Vena

a. hərmikula/ hərmikuli	b. krijū/	kriði, kriðε
‘milingona/milingonat’	‘besoj/	beson VII/IIIInj’
a’. hərmikul / hərmikula	b’. kriðijna/	kriðin
‘milingonë/ milingona’	‘besoj/	beson VII/IIIInj’
hərmikul-a/ -ətə		
‘milingona-Em/milingonat-Em/Kall’		

Produktiviteti i huazimeve dhe lidhja e tyre me code-switching, të dëshmuara mirë në varietetet e ekzaminuara, konfirmohen nga rastet kur huazimet (eventualisht të rastit) alternohen me një formë etimologjike, sikurse kjo që është ilustruar në (3) për *Venën*.

(3) *Vena di Maida*

rispundijna	prijɛɟəm	krh. rispundu	‘përgjigjem’
ʃundijna	ʒɣliðijna	krh. ʃundu	‘zgjidh’
kaminajna	ikijna	krh. kaminu, ʃkappu	‘iki’

Vendosja në fjali e formave të përziera emërore dhe foljore krijon struktura morfosintaksore që pasqyrojnë vetitë emërore të përshtatjes dhe të rasës së gramatikës arbëreshe. Veçanërisht janë emrat që leksikalizojnë eptimin e rasës përkritazi me kontekste të ndryshme morfosintaksore, si në (4) (ku Pjes(ëz) tregon introduktorin e fjalës ‘të’).

(4) *Ginestra*

mōra kristalir-ənə	
‘mora vitrinën-Kall’	‘mora vitrinën’
mar mōsal-ənə treiz-əsə	
‘marr mbulesën-Kalltryezës-Gjin’	‘marr mbulesën e tryezës’
vətrin-a kristalir-əsə	
‘xhami-Em(ërore) vitrinës-Gjin’	‘xhami i vitrinës’

Casalvecchio

tsupōva kanarōts-in	
‘vrava qafën-Kall’	‘vrava qafën’
bʎeva məlun-ət	
‘bleva pjeprat-Kall’	‘bleva pjeprat’
ndzir skōrtʃ-ənə ta məlun-i	
‘hiq lëkurën-Kallnga pjepri-Nom’	‘hiqe lëkurën e pjeprit’
jəmsedz-ənə	
‘jepma karrigen-Kall’	‘jepma karrigen’

Vena

u ntʃinava	t	ε	lejɲ	
unë fillova	Pjes	e	lexoja’	‘unë fillova ta lexoja’
brēsta stip-in i	ri			
bleva bufenë-Kall	NYJË	re		‘bleva bufenë e re’
həŋgra aɲεʎ-in				
‘həngra qingjin-Kall’				‘həngra qingjin’

Foljet paraqesin një paradigmë të rregullt eptuese, sikurse duket në tabelat (2b’) e (4) (shih 3.3., 3.4.)

2.1. *Huazimet mbiemërore.*

Huazimet mbiemërore romane në përgjithësi karakterizohen nga një eptim më-*u*, pavarësisht nga formativi eptues me të cilin del baza e sistemit emëror, më bashkëtingëllore a më element zanor. Në shumë varietete arbëreshe mbiemrat më –*u* dalin të pandryshueshëm dhe pa nyjën e përparme që del te mbiemrat e leksikut të trashëguar nga shqipja. Kjo situatë shfaqet në *Ginestra* e *Casalvecchio* sikurse është ilustruar në (5). Duhet patur parasysh se eptimi më-*u* është i pra-

nishëm në sistemin eptues me origjinë nga shqipja, sikurse duket në shembujt e sjellë në (5), te të cilat *-u* morfologjizon emëroren, (i) është përbërës i flektimit të rasës kallëzore, (ii) morfologjizon eptimin e klasës emërore të mbiemrit, (iii).

(5) *Ginestra*

ift	grasu	magru	mbunnu	bravu
'është	i/e trashë	i/e dobët	i/e thellë	i/e mirë'
jan	grasu	magru	mbunnu	bravu
'janë	të trashë/a	të dobët/a	të thellë/a	të mirë/a'

krh.	i.	krah-u	'krah-u-Em, krah'u'
	ii.	krah-u-nə	'krahun-Kall, krahun'
	iii.	i rej-u	'NYJË ri.mnj'

Casalvecchio

ift	kruðu	avtu	vaşfu	skavtsu
'është	i/e papjekur	i/e gjatë	i/e shkurtër	i/e zhveshur'
jan	ruðu	avtu	vaşfu	skavtsu
'janë	të papjekur/a	të gjatë/a	të shkurtër/a	të zhveshur/a'
krh.	i.	brëk-u	'pantallonat-Em,	pantallonat'
	ii.	brëk-u-n	'pantallonat-Kall,	pantallonat'

Edhe në *Vena* huazimet mbiemërore nuk e kanë këtë pjesëz, ndërkohë që aty gjejmë dy sisteme të ndryshme eptimi. Një grup mbiemrash, të ilustruar në (6), paraqet eptimin më-*u* në njëjës që alternohet, të paktën si opsion, me eptimin më-*a* në shumës. Huazime të tjera mbiemërore nuk e kanë eptimin më-*u*, për të paraqitur një alternativ të këtij lloji mes njëjësit dhe shumës, si në (6b).

(6) *Vena*

a.	eft	vaşu	kruðu	autu
	'është	i/e shkurtër	i/e papjekur	i/e gjatë'
	jan	vaşa	kruða	auta
	'janë	të shkurtër/a	të papjekur/a	të gjatë/a'
b.	eft	kuntent	surt/	surðə
	'është	i/e lumtur	shurdhë/	shurdhë'

jan	kuntenta	surda
'janë	të lumtur	të shurdhër/a'
krh. i.	ɲeri-u	'njeri-Em, njeriu'
	ii. ɲeri-u-nə	'njeri-Kall, njeriun'

Të vërehet se alternimi mes formës mashkullore njëjës më bashkëtingëllore jo të zëshme dhe femërores njëjës më bashkëtingëllore të zëshme të ilustruar me *surt(ə)*/*surdə* karakterizon edhe mbiemrat me leksik nga origjina e shqipes, si në rastin *ei maθ(ə)* 'i madh mnj' / *ε maðe* 'e madhe fnj.'; në të dy rastet në varësi të kontekstit mund të dalë një zanore fundore.

2.2. Përvetësimi i huazimeve si proces në nivelin e ndërfaqes.

Dukuritë e huazimit dhe të organizimit morfosintaksor që kemi shqyrtuar deri tani përkojnë me statusin e arbërishtes si gjuhë pje-sërisht e përzier, e cila karakterizohet nga një grup formash leksikore romane që kombinohen me eptimin arbëresh. Pamë në fillim se sistemet e ekzekutimit (senso-motorrik dhe i të menduarit), për aq sa janë të jashtme nga aftësia e të folurit në kuptimin e ngushtë të fjalës, i lexojnë ndërfaqet e shprehjeve gjuhësore të gjeneruara nga sintaksa. Mund të mendojmë se dukuritë që lidhen me përvetësimin e gjuhës, me rregullimet e të fulurit dhe me strukturën semantike dhe fonetike në proceset e riorganizimit gjuhësor, që lidhen me dy-gjuhësinë dhe me përzierjen gjuhësore, fiksohen në sistemet e ekzekutimit. Kjo sugjeron që në bazë të dukurive të tilla ka procese të karakterit imperativ (Savoia e Manzini 200, Manzini e Savoia 2007) më tepër sesa të karakterit strukturor, në kuptimin që diferencimi mes sistemeve varet nga mënyra me të cilën janë leksikalizuar vetitë e rëndësishme për komputacionin sintaksor dhe jo nga fakti sikurse hipotezohet nga disa autorë se struktura sintaksore është e paplotë në disa kushte, si në rastin e çrregullimeve të të fulurit apo të përvetësimit të gjuhës.

Fakti që mbiemrat hibridë me bazë romane nuk e marrin pjesë-zën eptuese të paravendosur na sjell parasysh një kontrast të vënë në dukje kohët e fundit nga një drejtim i ri studimor mbi përzgjedhjen e pjesëzave gramatikore nga Schiller dhe Caramazza (2002, 2003), bazuar në interferencën fjalë-figurë krahasuar me pjesëzën e gjinisë. Schiller e Caramazza (2003) vërejnë se dukuritë e interferencës mund të pengojnë përzgjedhjen e përcaktuesit, që bën përzgjedhjen mes formave konkurruese; janë vëzhguar disa efekte të interferencës mbi bazën semantike. Për sa u përket emrave Schiller e Caramazza (2003: 169) dalin me përfundimin se pjesëzat sintaksore (të gjinisë) nuk krijojnë efekte të kongruencës.

The overall pattern of results is interpreted as indicating that grammatical feature selection is an automatic consequence of lexical node selection and therefore not subject to interference from other grammatical features.

Finocchiaro (2002) vëren se nuk është parë ndonjë efekt kongruence në rastin e gjuhëve romane, edhe në gjuhët gjermanike del më tepër si përzgjedhje e formës së përcaktuesit, i cili kërkon informacione morfofonologjike më shumë sesa sintaksore.

Nëse kemi parasysh këtë kuadër eksperimental, do të shohim se eptimi na lidh rregullisht me huazimet mbiemërore, ndërsa formativi eptues i paravendosur, që bën krahasimin mes formave, mungon. Edhe dukuria e ilustruar në (8a) përputhet me këto kushe, duke qenë se formativi eptues i paravendosur neutralizon kontrastin e gjinisë pa varësisht nga gjinia e emrit me të cilin përshtatet. Ky riorganizim duket se konfirmon hipotezën që thotë se përzgjedhja e vetive morfo-sintaksore të një emër varet nga përzgjedhja e nyjës leksikore, duke përjashtuar efektet e kongruencës relevante. Pra huazimet emërore (dhe foljore) kanë hyrë në paradigmat eptuese të rregullta. Kjo vlen edhe për vetitë eptuese të huazimeve mbiemërore, edhe pse të veçanta, dalin megjithatë koherente me sistemin morfologjik të

arbërishtes. Ndërkaq nyja e përparme na del si rezultat i dukurive të redutimit apo të neutralizimit të alternativave konkurruese.

3. Hibridizimi, konvergjenca dhe riorganizimi gramatikor.

Një tipologji e riorganizimit të gramatikës që lidhet me situatat e përzierjes dhe dygjuhësisë përfaqësohet nga dukuritë e konvergjencës (Gumperz e Wilson 1971), ku sistemet e bashkëpranishme kanë një strukturë morfosintaksore paralele në shumë kontekste. Në komunitetet arbëreshe që kemi vëzhguar është *Vena* ajo që përfaqëson një situatë interesante të konvergjencës mes dialektit roman dhe atij arbëresh. Në fakt, nuk është vetëm arbërishtja ajo që përfaqëson dukuri huazimi dhe riorganizimi morfosintaksor që vijnë si shkak i ndikimit që ushtrohet nga dygjuhësia abërishte-dialekt roman, por edhe varieteti kalabrez lokal ka disa karakteristika strukturore, të cilat riprodhojnë sintaksën shqipe.

Një përkim sintaksor makroskopik mes dy varieteteve, pra nënrenditjes modale me anë të ndërtimit pjesës + folje në lidhore, nuk varet nga kontakti i tanishëm mes gjuhës romane dhe shqipes. Ajo përfaqëson një karakteristikë të përgjithshme të gjuhëve ballkanike, si në greqishte, rumanishte dhe shqipe, që gjendet gjithashtu edhe në varietetet e Italisë mesdhetare. Në këto ndërtime të tipit *voglio venire* (dua të vij), *ti dico di dormire* (të them të flej) etj, në të cilat varietetet romane përdorin trajtën infinite të foljes, në dialektet kalabreze, siciliane e salentine folja e nënrenditur lidhet nga një pjesëz e tipit *mu* (*ku* në varietetet salentine), ndërsa në varietetet e shqipes lidhet nga pjesëza *tə*, si në shembujt në (7) (Manzini e Savoia 2005). Pra, përkimi mes dialektit roman të *Vena-s*, që e lidh paskajoren e nënrenditur me anë të pjesëzës *mu* njësoj si dialektet kalabreze lokale dhe të arbërishtes, që përdor në të njëjtën mënyrë pjesëzën *tə*, është origjinare.

Reduktimet sintaksore relevante për këto ndërtime janë analoge në të dyja varietetet, sikurse e dëshmojnë shembujt në (7). Në veçanti,

subjekti i fjalisë së varur mund të vendoset në të djathtë të foljes së varur, si në (7a), ose t'i paraprijë pjesëzës duke u lidhur në një pozicion të topikalizuar, si në (7b), por nuk mund të futet mes introduktorit dhe foljes së varur. Fjalja që vjen pas pjesësës mund të hyjë nën një një element plotësues i tipit *që*, si në (7c); prania e një elementi pyetës përgjithësisht sjell një formë të modalizuar të foljes së varur të llojit *kam-për-paskajor*, si në (7d). Ekzistojnë gjithashtu disa dallime mes gramatikës arbëreshe dhe kalabreze; në gramatikën shqipe në kontekstet negative *tə* zëvendësohet nga mohuesja e specializuar për ndërtimet modale *məs/məh*, që ndryshon nga mohuesja e dëftores *nəng*, si në (7e) (Turano 1995, Manzini e Savoia 1999). Megjithatë në varietetet romane paskajorja mund të dalë edhe në disa ndërtime, eventualisht në alternim me ndërtimin që lidhet nga pjesëzë, si në rastin e kauzativit në (7f); në shqipe nuk ekziston një formë e veçantë për *paskajoren*, në vend të tij del lidhorja në çdo kontekst.

(7) *Vena di Maida*

- | | | |
|----|---|--|
| a. | vɣɣu mu mandzu
dua tə ha
hattsu mu 'ðormenu li hiɣi
bɛɣna tə frənə kria'turatə | 'dua Pjes ha'

'bëj Pjes flenë fëmijët' |
| b. | hattsu li hiɣi mu 'ðormenu
bɛɣna kria'turatə tə frənə | 'bëj fëmijët Pjes flenë' |
| c. | vɔɣɣu (ka) iɣu mu vene prestu
dua (hɛ) ai tə viɣna ndzitu | 'dua (që) ai të vijë shpejt' |
| d. | nɔn tsattɣu ki (aju) mu hattsu
ɣgə di tɣəke tə bɛɣna | 'nuk di çfarë Pjesbëj' |
| e. | aju mu stau tɣttu nɔ mu lu rizbiɣu
zgjuar'ka tə ri cətu pə məs ε zɣɔna | 'ka Pjes ri qetë për mos ta
zgjuar' |
| f. | iɣi ntɣi hannu mandzare la karne
i bəɣnən tə harə miftə | 'i bëjnë Pjes ngrënë mishin'
i bapnən tə harə miftə |

Edhe në këto ndërtime shfaqen pasojat e një riorganizimi strukturor, i cili vjen si shkak i ndikimit të sintaksës romane mbi atë shqipe. Varietetet kalabreze, duke përfshirë edhe atë të *Vena-s*, mund t'u pa-

raprij në ndërtimeve *mu-folje* me parafjalën *pe* ‘për’, si në shembujt (8a). Kjo skemë, që mungon në sistemin e shqipes, rimerret në sistemin e varietetit arbëresh të *Vena-s*, i cili mund të fusë *pe* ‘për’ para ndërtimit që lidhet nga *tə*, si në (8b). Duhet të kihet parasysh se *pe* është pjesë e leksikut etimologjik të shqipes, prandaj konvergjenca i përket përmbajtjes leksikore së *pe*, e cila trashëgon nga dialekti roman veti të përshtatshme si introduktor i fjalive të varura.

(8) *Vena*


- | | | | |
|----|---|----|---|
| a. | mi skōrdai (pɛ) mu lejia
harrovapër Pjes lexova
'harrova të lexova'
li ðiku pɛ mu vene
i them për Pjes vjen
'i them të vijë' | b. | ju harrova (pə) tə lejijn
harrova për Pjes lexova

i θom pə tə nt ^h enətə
i them për Pjes kthehet
'i them të vijë'
ɛ bbəɲa pə tə harə
e bëjpër Pjes ngrënë
'e bëj të hajë' |
|----|---|----|---|

Në literaturë ka propozime të ndryshme që lidhen me statusin e pjesëzave me vlerë lidhëse (shih Graffi 1998). Përfundimi që del nga literatura është se këto pjesëza nuk mund të identifikohen me kategorinë F (leksion) për disa arsye. Vetë folja, në fakt, paraqet morfologji eptuese që mund të jetë e tipit jo modal, si në dialektet romane, apo e tipit modal, si për shembull në shqipe e në greqishte, ku gjendet lidhëria, prandaj, me gjasë, është folja që e leksikalizon F-në. Edhe fakti se pjesëza modale i paraprin klitikëve të objektit vërteton hipotezën se pjesëza përkon me një kategori të ndryshme të fjalisë. Nga ana tjetër pjesëzat lidhëse mund të kontribuojnë si plotësues të tipit *che* (që) roman, si në (7c).

Disa studiues pranojnë se vendi i pjesëzës është mes foljes (F) dhe komplementuesit (Complementizer) (Rivero 1994). Brenda teorisë së përmendur të dominimit C, Roberts dhe Roussou (2003), propozojnë që *mu* është në plotësin më të ulët M, ku paraprihet nga mohuesja *no* dhe nga plotësi *ka* ose *pe* në një pozitë më të lartë. Megjith-

atë analizat e ndryshme pajtohen që pjesëzave të dialekteve kalabreze dhe të varieteteve ballkanike t'u jepet një kuptim modal, si *na* për greqishten dhe *tə* për shqipen, prandaj kombinimi i pjesëzës *mu* me foljen leksikalizon një modalitet të papërcaktuar, jo domosdoshmërisht të shprehur nga morfologjia e foljes. Një zgjidhje më e thjeshtë dhe më bindëse, brenda kuadrit konceptual Chomskian, propozuar nga Manzini e Savoia (2007), e trajton *tə* si një bazë të tipit minimal, e cila përkon me njëjën e përparme, *tə*. Ashtu si në kontekstet në të cilat leksikalizon nyjen e përparme, *tə* vendoset në një pozicion D (*efiniteness/* element përcaktues), me dallimin që në ndërtimet në të cilat lidh fjalinë e nënrenditur, ky është pozicioni D i fjalisë. Falë vetive të saj leksikore *tə* lidh një ndryshore që lidhet me pozicionin D, e cila identifikohet me elementin D të leksikalizuar nga fleksioni i foljes dhe denotimi i së cilës mund të fiksohet nga një element paraprirës që gjendet në fjalinë kryesore. Kjo analizë mund të shtrihet në *mu*, e cila merr veti analoge me operatorin. Konvergenca e dy ndërtimeve shprehet në strukturën në (9), ku vihat në pah përkimi i vetive leksikore të të dy elementeve lidhës *pə mu* e *pə tə*. Në (9), N është pozicioni i kategorive emërore dhe $\sqrt{\quad}$ është rrënja e fjalës.



Sintaksa e varësisë dhe disa përkime të tjera të sintaksës arbëreshe me varietetin roman të *Vena-s*, si ndërtimet progresive dhe sistemi i përplotësuesëve, reflektojnë tipare strukturore me origjinë antike apo të përbashkët që nuk lidhen me dygjuhësinë e folësve të vetëm një komuniteti. Nga ky aspekt, sigurisht që nuk na paraqiten kushte të

konvergencës në kuptimin e plotë të fjalës sesa na shfaqet më tepër një përkim relevant nga këndvështrimi i procesit të përvetësimit gjuhësor dhe i proceve të përzjerjes dhe code-switching, sikurse sugjerohet në rastin për të cilin sapo folëm në (9). Këtu na del mjaft interesante nxjerrja në pah e ekzistencës së përkimeve sistematike të perceptuara nga folësit e të dyja varieteteve.

3.1. Strukturat progresive romane dhe arbëreshe në Vena; sistemi i përplotësuesëve.

Varieteti roman e arbëresh kanë të përbashkët edhe një ndërtim me interpretim progresiv, që formohet me anë të foljes ndihmëse jam dhe një pjese të varur së cilës i prin elementi *ki* roman/ *tʃə* arbëresh. Të dhënat (10) tregojnë paralelizmin e ndërtimit roman të *Vena-s* në (10a) me atë arbëresh të *Vena-s*.

(10) *Vena*

- a. sunu ki 'mantʃanu
 'janë duke ngrënë'
 iʎʎu ε ki mi/ la cama
 'ai po më/e thërret'
- b. jan tʃəhan
 'janë duke ngrënë'
 ai ɐʃt tʃəmə/ ε hir'rɛt
 'ai më/e thërret'

Ky ndërtim shfaqet edhe në dialektet romane të kontaktit dhe në Kalabrinë qendrore në përgjithësi, si në (11a); sikurse tregojnë shembujt në (12b), ndërtimi shfaqet në një mënyrë komplekse në varietete të ndryshme romane e arbëreshe të zonës. Në alternativë me këtë, varietetet romane, përfshirë edhe varietetin e *Vena-se* të *Casalvecchios* e *Ginestra-s*, përfaqësojnë tipin *stare – gerundio* (rri– përcjellore), ngjashëm me standardin, sikurse ilustruhet në (11b).

(11) a. *Iacurso*

sunu ki mi 'camanu	'janë duke më thirrur'
'ëranu ki lu ha'tʃianu	'ishin duke e bërë'

S. Pietro a Maida

suŋŋu ki lu hattsu	'jam duke e bërë'
sunu ki lu hanu	'janë duke e bërë'

b. *Vena*

la staju hatʃendu	'po e bëj atë'
-------------------	----------------

Iacurso

lu stanu camandu	'po e thërrasin'
------------------	------------------

S. Pietro a Maida

lu staju hatʃiəndu	'po e bëja'
--------------------	-------------

Casalvecchio – varieteti roman

mə stannə camənnə	'po më thërrasin'
-------------------	-------------------

Ginestra – varieteti roman

lu stannə fatʃənnə	'po e bëjnë'
--------------------	--------------

Në (12a) janë sjellë të dhënat që lidhen me ndërtimin progresiv që gjendet në përgjithësi në varietetet arbëreshe, ku foljet *jam* ose *rri* në *Ginestra*, lidhen me një fjali të bashkërenditur nëpërmjet lidhëzës *e* 'e' ose me një ndërtim të llojit përplotësues që lidhet nëpërmjet pjesëzës *tə* (Manzini e Savoia 2007), eventualisht kësaj mund t'i paraprijë përplotësuesi *sa* (që), si në të dhënat nga San Benedetto, ose nga *pə* si në të dhënat nga *Chieuti*. Ndërtimi i dytë përkon me një interpretim të mundshëm të pacaktuar i llojit *jam këtu që bëj/ jam këtu për të bërë*.

Ndërtimi i llojit të *Vena-s*, në të cilin *tʃə* lidh gjymyrën e varur, karakterizon edhe varietetet e tjera arbëreshe të Kalabrisë qendrore, si-kurse duket në (12b) dhe shfaqet edhe në varietet me kontekst lingvistik kontakti të ndryshëm, si në *Casalvecchio*, e ilustruar në (12c). Në

fund, në (12d) paraqiten të dhënat që lidhen me kontekstet e rindërtimit me vlerë modale të dëshmuar në të gjitha varietetet arbëreshe, të llojit *ka/do-të-folje e eptuar*. Në shumë varietetet e ndërtimet modale paraqesin dallimet e aspektit e të kohës në morfologji, por jo edhe flektimin e vetës. Në këto ndërtime, në të cilat argumenti i jashtëm i foljes së varur identifikohet me atë të foljes drejtuese, eptimi i foljes së varur regjistron përshtatjen me subjektin, ndërsa folja drejtuese, kam/dua, në shumë varietete ka vetëm një formë pjesërisht flektive. Folja e varur në përgjithësi lidhet nëpërmjet pjesëzës *tə*; për më tepër në dialekte shfaqen sistemime të ndryshme (Manzini e Savoia 2007).

(12)a. *Portocannone*

jam	ε	tə sres	'po të thërras'
'jam e	të	thërras'	
jam	tə	tə sres	'po të thërras'
'jam Pjes	të	thërras'	

Chieuti

iʃa	ε	ε	mirja	'isha duke e marrë'
				'isha e e merrja'
iʃa	pə	tə	mirja	'po e merrja'
				'isha përPjesta marrë'

Ginestra

rija	tə	a	θras	'po e thërras'
				'jam Pjes e thërras'
riɲɲənə	tə	mə	θrasɲənə	'po më thërrasin'
				'janë Pjes më chiamano'

S. Benedetto Ullano

əʃt	ε	m	sər'ɾet	'po më thërret'	
				'është e më thërret'	
əʃt	sa	t	ε	bəɲ	'është për ta bërë'
				'është që Pjes e bën'	

Firmo

jan	ε	ε	diɔvasin	'po e lexojnë'	
				'janë e e lexojnë'	
jan	(sa)	t	ε	bəjin	'janë për ta bërë'
				'janë që Pjes e bëjnë'	

- Civita*
jam ε fʎɔ 'po fle'
'jam e fle'
- b. *S. Nicola dell'Alto*
ujam tʃ ε bier 'po e humbas'
'unë jamqë e humbas'
- Carfizzi*
jɔm tʃə viʃəm 'po vishem'
'jam që vishe-M'
- c. *Casalvecchio*
ujam tʃə kuʃlɔɲ 'unë po flas'
'unë jam që flas'
jan tʃə məθrɛsɲən 'po më thërrasin'
'jam që më thërrasin'
- d. *Portocannone*
ka / dɔ t laxɛm 'duhet/ dua të lahem'
'kam / dua Pjes lahem'
- S. Benedetto Ullano*
ka / dɔ tɛ hapɲ 'duhet/ dua ta hap'
kam / dua Pjes e hap
- Civita*
kam ε bɔɲ 'kam për ta bërë'
'kam e bëj'
ka t ε bɔɲ 'ke për ta bërë'
'kam Pjes e bëj.VIIɲj'
- S. Nicola dell'Alto*
kɛ t fɔj/ fɔtʃ / fiɔɲ 'kam/ ke/ ka për të fjetur'
'kam Pjes fle/ flesh / flejë'
- Casalvecchio*
da a ʎaɲ / ʎatʃ / ʎaɲ / ʎami / ʎani / ʎaɲən 'do ta laj', etj.
'dua ta laj, etj.'
ka t a ʎaɲ / ʎami 'duhet ta laj /duhet ta lajmë'
'kam Pjes ta laj / lajmë'

Duhet të shënojmë se ndërtimet në (11) e (12a,b) hyjnë në një sistem të përplotësuesëve që tregon se ka përkime mes varieteteve kalabreze dhe arbëreshe pavarësisht nga kushtet specifike të kontaktit. Me fjalë të tjera, paralelizmi mes sistemeve të përplotësuesëve lidhet me përkime strukturore antike. Megjithatë është e nevojshme të japim ndonjë detaj që ka të bëjë me çështjen. Varieteti roman i *Venës* si edhe varietetet analoge si ai i Iacustros dhe *S. Pietros në Maida* përfaqësojnë, krahas ndërtimeve plotësuese të llojit të analizuar (9), një sistem përplotësuesish që e ndan elementin deklarues lidhë *ska*, në (13a) nga introduktori i llojit modal në (13a') që në përgjithësi përkon me elementin lidhës *qënë* (13b) dhe me elementin pyetës në (13d). Elementi pyetës i llojit *kush* në këto varietete përdoret *ku*, në (13c) (shih Manzini e Savoia 2005, 2008).

(13) *Iacurso*

- | | | |
|-----|-----------------------------|--|
| a. | mi 'ðisseru ka vene ðomane | 'më thanë që vjen nesër' |
| a'. | neʃ'ʃivi ðoppu ki ttornasti | 'doli pasi që u ktheve' |
| b. | ε kkiru ki mmi cama sempre | 'është ai që më thërret
'gjithmonë' |
| c. | ku vene? | 'kush vjen?' |
| d. | ki ffai? | 'çfarë bën?' |

S. Pietro a Maida

- | | | |
|-----|-----------------------------|--------------------------|
| a. | mi 'ðisseru ka veneðomane | 'më thanë që vjen nesër' |
| a'. | neʃʃivi ðoppu ki idðu vinne | 'doli pasi që ai erdhi' |
| b. | ε kkiððu ki mmi cama | 'është ai që më thërret' |
| c. | ku vene? | 'kush vjen?' |
| d. | ki ffai? | 'çfarë bën?' |

Vena – varieteti roman

- | | | |
|-----|-----------------------------|--------------------------------|
| a. | 'ðitʃenu ka vinne | 'thanë që erdhi/ ka ardhur' |
| a'. | neʃʃivi ðoppu ki venisti tu | 'doli pasi që erdhe ti' |
| b. | ε kkiλλomu ki mi cama | 'është ai burri që më thërret' |
| c. | kine vene? | 'kush vjen?' |
| d. | ki hai? | 'çfarë bën?' |

Një sistemim i këtij tipi shfaqet përgjithësisht në varietetet arbëreshe, si në *Vena* apo *Ginestra* e *Casalvecchio*, të cilat i ndajnë përplo-tësusit *se/ sa/ ke* nga introduktori modal, i cili përkon me elementin pyetës dhe atë atë lidhë *stʃə*, si në (14). Elementi pyetës i tipit *kush* është i diferencuar, si në (14c).

(14) *Vena – varieteti arbëresh*

- | | |
|--------------------------------|--------------------------------|
| a. θɔnə hɛ/ sɛ'viŋnənə | 'thonë që vijnë' |
| a'. dɔla ðɔpu tʃəɛrðɛ ti | 'doli pasi që erdhe ti' |
| b. ai ɛʃt ɲeriu tʃə mə hər'ɾɛt | 'ai është burri që më thërret' |
| c. kuʃ viɛnə? | 'kush vjen?' |
| d. tʃə bɒn? | 'çfarë bën?' |

Carfizzi

- | | |
|------------------------------|-----------------------------|
| a. mə kɔn θɔn sɛ viɛn | 'më kanë thënë që vjen' |
| a'. kɔm dal ðɔpu tʃə ti ɛrðɛ | 'kam dalë pasi që erdhe ti' |
| b. kumiʃa tʃə kɔm biɛtu | 'këmisha që bleva' |
| c. kuʃ viɛn? | 'kush vjen?' |
| d. tʃə ke pər? | 'çfarë ke parë?' |

Civita

- | | |
|--------------------------------|---------------------------------------|
| a. məθa:n sɛ viɛn | 'më thanë që vjen' |
| a'. ɛrθðɔpu tʃə kiʃɛ daɫ | 'erdhi pasi që kishe dalë' |
| b. ɔʃt burri tʃə məθɾɛt sɛmbri | 'është burri që më thërret gjithmonë' |
| c. kuʃ viɛn? | 'kush vjen?' |
| d. tʃə bɔn? | 'çfarë bën?' |

Ginestra

- | | |
|--|-----------------------------------|
| a. məθan sa vin nɛsər | 'më thanë që vjen nesër' |
| a'. ɣɛrtən ðɔpu/ pəʃtainə tʃə u arruva | 'erdhën pasi që unë mbërrita |
| ɣɛrtən mə pərpara tʃə tə arɾɛjənə | 'erdhën para se Pjes mbërritën' |
| b. iʃt a'i tʃə məθɾɛt aŋga dit | 'është ai që më thërret çdo ditë' |
| c. kuʃ iʃi? | 'kush ishte?' |
| d. tʃə dɔ? | 'çfarë do?' |

Casalvecchio

- a. məθan ke vien nesər 'më thanë që vjen nesër'
 a'. dola ðəpu tʃə ti ɣerðə 'kam dalë pasi që erdhe ti'
 b. iʃnə bur tʃə məθret se mbru është një burrë që më thërret
 gjithmonë'
 c. kuʃ vien? 'kush vjen?'
 d. tʃə bən? 'çfarë bën?'

Shpërndarja e ilustruar në (13) e (14) mund të përmbliidhet në (15).

(15)	<i>introduktor deklarues</i>	<i>introduktor modal</i>	<i>përemër lidhor</i>	<i>kuʃ</i>	<i>çfarë</i>
<i>Iacurso</i>	ka	ki	ki	ku	ki
<i>S. Pietro a Maida</i>	ka	ki	ki	ku	ki
<i>varieteti roman i Venas</i>	ka	ki	ki	kinε	ki
<i>arbërishtja e Venas</i>	he/ se	tʃə	tʃə	kuʃ	tʃə
<i>Carfizzi</i>	se	tʃə	tʃə	kuʃ	tʃə
<i>Civita</i>	se	tʃə	tʃə	kuʃ	tʃə
<i>Ginestra</i>	sa	tʃə	tʃə	kuʃ	tʃə
<i>Casalvecchio</i>	ke	tʃə	tʃə	kuʃ	tʃe

Është interesante të theksojmë se në *Casalvecchio* në (14)-(15) introduktori deklarativ *ke* 'që' është një huazim roman; sistemi me-gjithatë e ruan ndarjen mes introduktorit deklarativ dhe introduktorit modal dhe nga përkimi i këtij të fundit me elementin pyetës dhe me introduktorin lidhës. Me fjalë të tjera, elementi roman merr vetitë leksikore të introduktorit origjinar duke i realizuar kushtet që i nevojiten.

Manzimi e Savoia (2005, 2007, 2008) e marrin shpërndarjen e vetive leksikore të për plotësuesve, të nënkuptuara si elemente që lidhin një ndryshore parafjalore. Me fjalë të tjera, llojet e ndryshme të operatorit parafjalor përkojnë me kontekste të ndryshme sintaksore/semantike, në të cilat parafjala relevante është e varur. Në veçanti marrin që *ka* dhe *ki* kanë veti kuantifikuese, respektivisht të shquara dhe të pashquara në krahasim me ndryshoret parafjalore. Në varietetet (13)-(14) i njëjti element, *ki* në dialektet romane e *tʃə* në atë arbëresh merr rolin e pyetësit, lidhës dhe përplotësues i pashquar. Ky përkim mund të lidhet me vetitë e operatorit pyetës që të lidhë një ndryshore

të pashquar. Ndryshorja e pashquar që lidhet nga operatori *ki* përkon me një ndryshore argumentuese në kontekstet pyetëse dhe në ato lidhore, për më tepër, në këto të fundit vlera e tij fiksohet nga koka emërore. Në kontekstet ku lidh një element plotësues *ki* lidh një ndryshore të shprehur me parafjalë.

Duke e zgjeruar këtë shqyrtim te ndërtimet progresive, mund të mendojmë se elementi *ki/ tʃə* lidh një ndryshore argumentuese vetitë referenciale të së cilës fiksohen nga subjekti i fjalisë kryesore. Në këtë mënyrë, futja e elementit pyetës leksikalizon një mekanizëm interpretativ analog me atë që shoqërohet nga pjesëza *tə* në ndërtimet e marra si shembull në (12a) për varietet arbëreshe. Në diskutimet mbi plotësorët në paragrafin 3 pamë se *tə* lidh një ndryshore argumentuese (Manzini e Savoia 2007).

3.2. *Kauzativi.*

Në ndërtimin kauzativ në shumë dialekte arbëreshe folja paraqitet si një formativ foljor i pandryshueshëm që përzgjedh një subjekt shkaktues dhe merr si të varur një folje fleksioni i së cilës përshtatet me subjektin e përzgjedhur (shkaktuesin). Elementi i pandryshueshëm mund të jetë i segmentuar në një morfemë që lidhet etimologjikisht me *bəjn* ‘bëj’ dhe një pjesë flektive që në disa varietete përkon me introduktorin e fjalisë së varur *t(ə)* (Manzini e Savoia 2007, Savoia 1989). Subjekti i fjalisë së varur leksikalizohet nga flektimi i përshtatjes i foljes së varur, sikurse është ilustruar në (16a-c) për *Firmo*-n dhe *Casalvecchio*-n; trajta e shkurtër, që është objekt që leksikalizon argumentin e brendshëm të foljes së varur, vihet në të majtë të foljes së varur, si në (16b). Shembulli në (16c) për *Casalvecchio*-n ilustron kontekstin në të cilin folja e varur është në formë mesore, e leksikalizuar nga tra-jta e shkurtër *u* dhe nga eptimi mesor-pasiv i së kryerës; subjekti i varur është në emërore dhe vepruesi sillet si sintagmë vepruese.

(16) *Firmo*

- a. u bit / binε fjə/ fjəʃ/ fjən
 unë KAUZATIV flejë/ flesh/ flenë
 ‘unë e/ të/ i bëj flejë etj’
 ata bit/ binε fjəmi
 ata KAUZATIV flemë
 ‘ata na bëjnë të flemë’
- b. ata binε u zɟum
 ata KAUZATIV ‘M(ESORE) zgjuam
 ‘ata na bënë të zgjoheshim’

Casalvecchio

- a. u bəta fɬətʃ/ fɬir
 unë KAUZATIV flesh/ flejë
 ‘unë të/ e bëjtë flesh/ flejë’
- b. ai bəta mə θrəsɟin(cirət / ka cirət)
 ai KAUZATIV mi thërrasin të tjerët / nga të tjerët
 ‘ai më thërret (nga të tjerët)’
- c. bəta u tʃax lastra (ka ɟetər)
 KAUZATIV u thye xhami (nga një tjetër)
 ‘bëra të thyej xhamin (nga një tjetër)’

Sikurse e ilustruam në (16c), eptimi mund të dyfishohet nga një SN emërore në pozicion pas foljor ose nga një sintagmë e cila lidhet me anë të parafjalës *ka*, si në (16b, c). Me fjalë të tjera, shfaqet një tipologji e re e renditjes së Rasës e cila leksikalizon sintagmën emërore që fikson referuesin të argumenti EPP i foljes së varur me anë të një vepruesi të rastit. Kjo strukturë na shpie të kauzativi roman, i cili e trajton subjektin e varur si kundrinor.

Nga rezultati del se eptimi i foljes së varur mbart vetitë denotuese që përshtaten me kundrinorin. Varietete të tjera si *Piana* në (17) dhe *Vena* në (18), ashtu sikurse shqipja standarde, bëjnë përshtatjen e foljes drejtuese me kauzatorin. Dialekti i Pianës paraqet, ashtu si varietetet arbëreshe në përgjithësi (Manzini e Savoia 2007, Savoia 1989), një rirrenditje të Rasës në fjalinë e varur, në të cilën subjekti është në kallëzore për t’iu përshtatur foljes së varur.

(17) *Piana degli Albanesi*

buɲ tə fləɲ dial-in
 bëj Pjes flejë fëmijën(Kall).
 ‘bëj të flejë fëmijën’

Arbërishtja e *Venas* paraqet disa variacione në krahasim me dialektin e *Pianas* në (17). Si kauzativi ashtu edhe folja e varur eptohen duke iu përshtatur subjektit kauzativ dhe kundrinorit; folja e varur lidhet nëpërmjet pjesëzave (*pə*) *tə* (shih §§ 3 e 3.1). Si në *Piana*, folja mund të leksikalizohet nga rasa kallëzore kur është tranzitive, si në (18a) e (18b). Në *Vena* subjekti i foljes së varur mund të marrë një pozicion menjëherë pas të; përndryshe kauzativi mund të leksikalizohet nga një emërore, si në (18a’) and (18b’). Trajatat e shkurtra të cilat përkrijnë me argumentete foljes së varur, ndryshe nga kundrinori, janë të ndërshtëna në foljen e varur, ndërsa trajta e shkurtër, e cila përkon me subjektin e varur, leksikalizohet në foljen kauzative, sikurse tregohet në (18a’), (18b’).

(18) *Vena di Maida*

- a. u bərə (ɲeri-unə) pə tə ikənə (ɲeri-unə)
 ‘unë bëra njeriun-Kall për Pjes ikur (njeriun-Kall)’
 a’. bëɲɲa (pə) tə harə diaɫ-i
 ‘bëj për Pjes hajë djali-Em’
 a’’. mə bëɲɲənə (pə) t ɛ ʃɔxə
 ‘më bëjnë për Pjes e shoh’
 b. u bərə (‘buʃtr-itə) tə piçəkrumiʃtinə (‘buʃtr-itə)
 ‘unë bëra qenit-Dhan (ore) Pjes pijë qumështin-Kall qenit-Dhan’
 b’. bëɲɲa (buʃtr-i) tə pirə krumiʃtinə (‘buʃtr-i)
 bëj qeni-Em Pjes pijë qumështin-Kall qeni-Em
 b’’. ɛ bëɲɲənə (pə) t ɛ ʃɔrə
 ‘e bëjnë për Pjes ta shohë’
 ‘e bëjnë ta shohë’

Sipas Manzini-t e Savoia-s (2005, 2007) mund të pohojmë se në ndërtimin kauzativ folja drejtuese merr si të varur një kundrinor të fjalisë, pozicioni i subjektit i të cilit (argumenti EPP) përkon me një ndryshore të hapur. Në veçanti, ideja te Manzini e Savoia (2007) është

se në ndërtime si ato të *Pianas* e *Venas*, do të jetë elementi *tə* që do të lidhë një ndryshore të asociuar me pozicionin D subjekt i fjalisë së varur. Ndryshorja e lidhur nga *tə* identifikohet me elementin D të leksikalizuar nga flektimi i foljes, denotimi i të cilit fiksohet nga një element emërore prezent në fjali, pra argumenti i shkaktuar, pavarësisht nga fakti që leksikalizohet si emërore në (18a', b') ose si kallëzore/dhanore.

Në rastin e varieteteve arbëreshe në të cilat kauzativi nuk flektohet, si në *Firmo* e *Casalvecchio* në (16), kauzativi mund të analizohet si një përbërës i një elementi flektiv, i cili lidh vetë ndryshoren. Kjo analizë rrjedh nga fakti se forma verbale kauzative në shumë varietete përfshin pjesëzën *tə*, e cila lidh fjalitë e varura (shih. pf. 3, 3.1). Ndërtimet kauzative arbëreshe tregojnë qartë serenditja e rasës dhe përshtatja janë dukuri interpretuese. Manzini e Savoia (2007) i përqasin këto ndërtime me ato të llojit modal dhe aspektual, të cilat janë të pranishme në varietetet arbëreshe ku ndodh njësoj, që fleksioni i përshtatjes të shfaqet vetëm të folja e varur. Për dallim nga këto, kauzativi nuk ka veti kontrolluese.

Ndërtimi kauzativ i dialektit të *Ginestra-s* kombinon një rivendosje të rasave me foljen drejtuese jo të eptuar (Savoia 1989). Morfologjia e foljes së varur mund t'i referohet argumentit të vetë EPP si në shqipen standarde dhe në shumë varietete arbëreshe, si në (16)-(18), apo kauzatorit. Subjekti i foljeve jokalimtare është në rasën kallëzore, ndërsa subjekti i foljeve kalimtare është në dhanore, edhe pse nuk mungojnë shembuj me subjekt të varur në emërore. Në këtë kuptim arbërishtja e *Ginestra-s* duket se paraqet një sistem rasor origjinar. Përveç kësaj, sikurse duket në (19a), në disa kontekste kauzatori përshtatet me foljen e varur, duke rikrijuar në këtë mënyrë kushtet romane të paktën në kuptimin që përshtatja e predikatit të përbërë *folje kauzativ-folje e varur* ta ketë parasysh subjektin kauzator. Një pikë e rëndësishme është për dallim nga varietetet e tjera kauzativi i *Ginestra-s* paraqet një ndarje të vetës në bazë të të cilit

përshtatja e VIIIsh mbizotëron ndaj atyre të I/IIshnj. Përveç kësaj një subjekt i varur i vetës I/IIsh është detyrimisht i leksikalizuar nga një klitik objekt, si në (19a,b,c), ndërsa një subjekt i varur i VIIIshnj leksikalizohet nëpërmjet fleksionit, si në (19d).

(19) *Ginestra*

- | | | | | | |
|----|-------------------------------------|----------|---------------|------------------|---------------|
| a. | ve:t | bəta | mə/ | tə | fɔʎənə |
| | ai | KAUZATIV | mua/ | tə | flasë.VIIIInj |
| | 'ai më bën të flas' | | | | |
| b. | yu | bit | a | θraspənə | ato |
| | unë | KAUZATIV | e | thërrasin.VIIIsh | ato |
| | 'unë bëj të thërrasin ato/ nga ato' | | | | |
| c. | yu | bitə | ta | zʎɛðətʃə | |
| | unë | KAUZATIV | ta | lexosh.VIIInj | |
| | 'unë të bëj ta lexosh' | | | | |
| d. | neira | bəta | fɔʎənə | | |
| | ne | KAUZATIV | flasë.VIIIInj | | |
| | 'ne e bëjmë të flasë' | | | | |

Në arbërishten e *Ginestra-s* (ashtu si në varietetet e tjera arbëreshe) ndryshorja-subjekt e varur del si e kontrolluar, të paktën në rasi të caktuara. Veçanërisht ndarja në veta kërkon kontrastin mes elementeve që lidhen me diskursin dhe elementeve që lidhen me ngjarjen. Në veçanti VIII, vetitë referenciale të së cilës fiksohen në raport me ngjarjen e denotuar të fjalisë, fikson përshtatjen e foljes së varur sipas preferencës së vetës I/II, të leksikalizuara nga klitikët e objektit. Përfundimi është që VI/II interpretohen pavarësisht nga vetitë flektive të foljes së varur, por direkt nga raporti që kanë me universin e diskursit. Duke krahasuar VI e VII vërejmë se kjo e fundit tendencialisht renditet te VIII, ndaj VI duket se spikat pragmatikisht më tepër në fjalitë deklarative.

3.3. Pjesorja dhe përzgjedhja e ndihmëses në arbërishtën e *Vena-s*.

Morfosintaksa e arbërishtes dhe ajo e varieteteve romane të *Vena-s* kanë të përbashkët skemën e përzgjedhjes së ndihmëses që

parasheh ‘kam’ në të gjitha ndërtimet (veprore/ joveprore, jokallëzore) me përjashtim të perifrazës pasive/statike që ndërtohet me ‘jam’. Fli-tet sërish për një paralelizëm të pavarur nga kontakti e nga dukuritë e huazimit, duke parë se shpërndarja jam/kam në ndërtimet kryesore karakterizon pjesën më të madhe të varieteteve arbëreshe dhe të varieteteve kalabreze të zonës qendrore (Manzini e Savoia 2005, 2007), si jepet shembull në (20i) për varietetet romane dhe në (20ii) për ato arbëreshe të *Civita-s*, *Ginestra-s* e *Casalvecchio-s*.

Të dhënat në (20) vënë në pah faktin se si në varietetet arbëreshe ashtu edhe në ato kalabreze dalin normalisht ndërtimet me ndihmësen ‘kam’ në të pakryerën, ndërsa e kryera realizohet nga një formë verbale me morfologji specifike. Në realitet në shumë varietete arbëreshe ndërtimet me ndihmësen ‘kam’, eventualisht me vlerë modale, nuk përjashtohen (Manzini e Savoia 2007, Altimari 1991, 1994). Në këto ndërtime pjesoret paraqesin një fleksion të përshtatur vetëm në kontekstet statike të tipit në (20i, iia); ndërkohë që në varietetet arbëreshe pranohet edhe forma jo e eptuar e pjesores, sikurse tregohet në (20ii, a). Kontekstet vepore dhe mesore paraqesin një formë jo të përshtatur, e cila në varietetet romane përkon me -u, si në (20i, iib):

- (20) i. *Vena – varieteti roman*
- | | | |
|----|------------------------------|-------------------------------|
| a. | sta kamisa ε ripettsata | ‘kjo këmishë është e arnuar’ |
| b. | sta kamisa l avia ripettsatu | ‘këtë këmishë e kisha arnuar’ |
| | m avia settatu | ‘isha ulur’ |
| | savia vruşatu kiłła karta | ‘ishte djegur ajo letër’ |
| | avianu venutu | ‘kishin ardhur’ |
- Iacurso*
- | | | |
|----|-----------------------------|---------------------------|
| a. | sti kammisi furu ripettsati | ‘këto këmisha qenë qepur’ |
| b. | le avianu ripettsatu | ‘i kishin arnuar’ |
| | avia ðormutu | ‘kishte fjetur’ |
| | s avianu assettatu | ‘ishin ulur’ |
| | s avianu lavatu | ‘ishin lare’ |
| | avianu venutu | ‘kishin ardhur’ |

- ii. *Civita*
- a. ktə kmiʃjantə ʎaitura/ ʎaitur (ka ai)
 ‘kəto kēmisha janë NYJË lara (nga ai)’
- b. ε kiʃa pa:r ‘e kisha parë’
 ai kiʃ daʎ ‘ai kishte dalë’
 u kiʃinʎaitur ‘ishin larë’
 M kishin larë’
 ukiʃazjuar ‘isha zgjuar’
 M kishazgjuar’
- Ginestra*
- a. kjəkəmiʃ kʎεʃtreurə/ iʃtreumi (nga vɛ:t)
 ‘kjo kēmishë uhekuros / NYJË hekuros (nga ai)’
- b. i kiʃi ʎa:r ‘i kishte larë’
 kiʃa fʎejturə ‘kisha fjetur’
 kiʃa daʎurə ‘kisha dalë’
 ju kiʃi ʎaggurə ‘ishte lagur’
 ‘M kishte lagur’
- Casalvecchio*
- a. ktə kəmiʃ kʎɛtən ʎar ha aʃji
 ‘kəto kēmisha u lanë nga ai’
- b. a kiʃja ʎar ‘e kisha larë’
 kiʃja daʎərə ‘kisha dalë’
 ukiʃja ʎaxərə ‘isha larë’
 ‘M kisha larë’
 kiʃjafjetərə ‘kisha fjetur’

I marrim sërish pikat kryesore se si bëhet përzgjedhja e ndihmësës në varietetet shqipe të Manzini e Savoia (2012). Kjo analizë identifikon ndërtimet me pjesore që realizohen nga një ndihmëse në ndërtime dy frazore në të cilat si ndihmësja ashtu edhe pjesorja ruajnë strukturat e veta argumentuese (Manzini e Savoia 2005, 2007). Bashkimi eventual që karakterizon këto kontekste, pra fakti që interpretimi i këtyre ndërtimeve sjell vetëm një ngjarje apo gjendje, mund të shihet si një pasojë e vetive sintaksore në fjalinë kryesore, veçanërisht fakti se ‘subjekti’, pra argumenti EPP (Chomsky 1995), i fjalisë kryesore të jetë një ndryshore. Nga ana tjetër, pjesorja ka një strukturë të brendshme në të cilën flektimi i përshtatjes (klasa emërore) lidhet me argu-

mentin e brendshëm, si në (24a). Për dallim nga format e foljes, në të cilat flektimi i referohet subjektit. Manzini e Savoia e lidhin përzgjedhjen e ndihmëses në gjuhët romane dhe shqipe me vetitë e leksikalizuara nga *kam* dhe *jam*. Veçanërisht *jam* karakterizohet si një predikat që nuk merr role argumentuese, ndërsa *kam* është folje transitive që lidhet me një strukturë normale transitive, e cila ia jep rolin tematik argumentit të vetë EPP.

Në ndërtimet shqipe e romane në (20i, ii, b) ‘*kam*’ përzgjedh një fjali pjesore në të cilën pozicionet argumentuese janë përmbushur, në kuptimin që denotimi i argumenteve është fiksuar nga elementët emërorë/eptimet të pranishëm në ndërtim; veçanërisht në këto ndërtime referimi me argumentin EPP të pjesores identifikohet me atë të subjektit të foljes drejtuese, sikurse ndodh te foljet me kontroll. Në të kundërt, folja ‘*jam*’ në (20i, ii, a) përzgjedh një fjali pjesore, në të cilën D/EPP e varur është një ndryshore; kur ndryshorja EPP e pjesores merr një interpretim gjenerik ose referuesi i saj fiksohet nëpërmjet futjes së një kundrinori veprues, përftohet interpretimi pasiv. Kombinimi me ‘*jam*’ lidhet me interpretimet pasive dhe të gjendjes, në të cilat bashkimi i ndërtimeve të mundshme i të dy fjalive sjell identifikimin e subjektit të foljes ‘*jam*’ me argumentin N të pjesores. Këto kontekste janë të gatshme si për një interpretim në të kryerën, ashtu edhe për një interpretim statik, bazuar pra mbi një semantikë kompozicionale të llojit që gjejmë te kombinimi këpujë-mbiemër, i cili na del më i parapëlqyeri. Interpretimi statik tregon se referimi kohor është ai që leksikalizohet nga folja drejtuese. Në kontekstet me interpretim statik, si ato në (201, 11,a) duken relevante vetitë e ndërthurura aspektuale të pjesores. Sikurse e pamë, interpretimet statike, në të cilat pra interpretimi i *jam-pjesore* është kompozicional, marrin po njësoj edhe një interpretim pasiv.

Në varietetet arbëreshe të *Vena-s* ky sistem ndihmës përfshin edhe disa dukuri të riorganizimit morfosintaksor që lidhen me morfologjinë e pjesores. Në veçanti gramatika e *Vena-s* ka përvetësuar një

sufiks pjesor *-t-* me origjinë romane, i cili ka një shpërndarje të veçantë për kontekstet pasive/statike. Eptimi i tipit roman – *V(okale) T(ematik)-t-* na del me origjinë romane në alternativë me eptimin e shqipes *-VT-r-*. Format e pjesores të ndërtuara nga eptimi *-VT-t-* reduktohen vetëm në interpretimin statik, duke përfshirë edhe pasivin, ilustruar në (21a), ndërsa flektimi *-VT-r-* është e vetmja formë e lejueshme në kontekstet me ‘kam’ tranzitive, mesorejoveprore dhe pyetëse, në (21b). Të dhënat tona sugjerojnë se përveçse foljet me pjesore *-VT-t-* i përjashtojnë pjesoret me *-VT-r-* nga kontekstet statike (këpujore e pasive), edhe pse kjo mundësi nuk duket aq jo gramatikore, sikurse e tregon shembulli *kiλε i fundirturə ηga ai* ‘është zgjidhur nga ai’ in (21c). Me fjalë të tjera, brenda këtij grupi leksikor dalin të specializuar jo vetëm *-VT-t-*, por edhe *-VT-r-*, e cila përdoret vetëm në ndërtimet me ‘kam’.

Format me eptim roman paraqesin shumësin më *-a* dhe nuk e kanë nyjën e paravendosur, duke u sjellë pra si huazime mbiemërore të diskutuara në pf. 2.1. Pjesoret në *-VT-r-* nuk eptohen dhe nuk e marrin nyjën e përparme në ndërtimet veprore a mesore, pra në kombinim me ndihmësen *kam*, ndërkohë e marrin nyjën e përparme dhe fleksionin *-a* të shumësit në ndërtimet me *jam* të llojit statik (këpujor e pasiv). Në glosat në (21), M(esëm) shënon elementin *ju* që sjell interpretimin mesor-joveprore në të kryerën e në të kryerën e thjeshtë në shqipe.

(21) *Vena*

a.	<i>kjə kumiʃ</i>	<i>aʃt / ki¹λε</i>	<i>ripets-a t</i>	(<i>ηga ai</i>)
	‘ <i>kjo këmishë</i>	<i>është / ishte</i>	<i>arnuar</i>	(<i>nga ai</i>)’
	<i>kitə kumiʃ</i>	<i>jan / ki¹λɛn</i>	<i>ripɛtts-a-t-a</i>	
	‘ <i>këto këmisha</i>	<i>janë / ishin</i>	<i>arnuar</i>	
	<i>ɛʃt / ki¹λε</i>	<i>ʃund-u-tə</i>	(<i>ηga ai</i>)	
	‘ <i>është / ishte</i>	<i>shkrirë</i>	<i>nga ai</i>	
	<i>jan / ki¹λɛn</i>	<i>ʃund-u-t-a</i>	(<i>ηga a¹i</i>)	
	‘ <i>janë / ishin</i>	<i>shkrirë</i>	<i>nga ai</i>	
	<i>iʃ sɛt-a-tə</i>	<i>/</i>	<i>jiʒə</i>	<i>sɛt-a-t-a</i>

	'ishte	ulur	/		ishin	ulur'	
	ɲgə	ki'λɛ	krið-u-t				(ɲga məsi'ɲə)
	'nuk	ish	besuar				(nga askush)'
b.	ɛ	kɛʃ	ripetts-a-rə				
	'e	kisha	arnuar'				
	ɛ	kɛʃ	ʃund-i-rə/ ʃund-ir-t-u-rə				
	'e	kisha	shkrirë'				
	ju	kɛʃə	sət-a-rə				
	'M	isha	ulur'				'isha ulur'
	ju	kizə	sət-a-rə				
	'M	ishin	ulur'				'ishin ulur'
	ju	kizə /	kizə ʃund-i-rə				
	'M	ishte/	ishin ulur'				'ishte/ ishin ulur'
	ɛ	kɛʃ	krið-i-rə				
	'e	kisha	besuar'				
c.	kiλɛ	i	ʃundirt-u-rə				ɲga ai
	'ishte	NYJË	shkrirë				nga ai'
	ki	kiλɛi	ʒgλið-u-rə				(ɲga ai)
	'kjo	ishte	NYJË shkrirë				nga ai'
	izə	tə	tʃ-a-r-a				
	'ishin	NYJË	thyer'				
	kjo	kumiʃɛʃt /	kiλɛɛ λ-a-rə/ λ-a-ʃt-u-rə				(ɲga ajo)
	'kjo	këmishë	është/ishte NYJË larë				(nga ajo)'
	kitə	kumiʃki'λɛn	tə λ-a-r-a				(ɲga ajo)
	'këto	këmisha	ishin NYJË larë				(nga ai)'

Manzini e Savoia (2007,2012) analizojnë një parametër pjesërisht të ngjashëm në arbërishten e *Portocannone-s*, ku 'the passive voice' regjistrohët nga një morfologji specifike *-x-*, e cila shfaqet si në të kryerën, ashtu edhe në pjesore. Në ndërtimet me pjesore aktive pjesorja merr morfologjinë *-ur*, si në (22b), ndërsa në format aktive pjesorja merr morfologjinë joaktive *-x-*, e cila ndiqet nga eptimi i pjesores *-ur*, si në (22a).

(22) *Portocannone*

a.	atə	kifən	u	la-	x-	ur
	'ata	kishin	M	la-	M-	Pjes'
b.	atə	kifən	ɛ	laitur		
	'ata	kishin	atë	larë'		

Kushtet në *Vena* janë pak më ndryshe në (21a), duke qenë se parametri ka të bëjë vetëm me pjesoren dhe pjesorja e llojit *-VT-t-* përdoret vetëm në interpretimin statik/pasiv.

Duhet të theksojmë se pjesorja më-*t*(*ə*) me kuptim mbiemëror del e pavarur në shqipe (Demiraj 1986, 2002), në disa grupe foljore. Këto forma, për dalim nga pjesoret *-VT-t-* të shqyrtuara në (21a), marrin një nyje të përparme dhe eptimin e klasës emërore/shumës përgjithësisht të lidhur me mbiemrat, pikërisht si pjesoret *-VT-r-* në (21c), që, sikurse e kemi parë, në këto kontekste statike kanë morfologji mbiemërore. Në (23a) janë sjellë shembuj që lidhen me format më-*t* të *Vena-s*, *Casalvecchio-s* e *Carfizzi-t*, ku përfshihen ndërtime statike dhe pësore. Në (23b) janë sjellë pjesoret më-*r* në kontekste statike dhe pasive, ku shfaqin si forma me përshtatje, ashtu edhe pa përshtatje. Format pa përshtatje janë të vetmet që dalin në kontekstet kalimtare/mesore në (23c).

Pjesoret më-*t* pra nuk dalin asnjëherë në kontekstet kalimtare dhe mesore, që kanë kuptim të ngjarjes, sikurse tregon shpërndarja e dëshmuar në *Vena*, *Ginestra*, *Carfizzi*. Në *Casalvecchio* pjesoret më-*t* kanë një shpërndarje të ngjashme me atë të pjesoreve më-*r*, që dalin si në kontekstet kalimtare në (23c), ashtu edhe në kontekstet pasive në (23a). Në këto kontekste përfshihet një formë e pjesores jo me përshtatje, për dallim nga format statike në (23a), që megjithatë, ashtu si në përgjithësi në varietetet arbëreshe, e pranojnë formën jo me përshtatje të pjesores. Varieteti i *Ginestra-s* na jep si shembull edhe një lloj tjetër të pjesores, të lidhur me eptimin mbiemëror, pra të kufizuar në kontekstet statike/pasive, sikurse tregohet në (23a') për *Ginestran*.

(23) *Vena*

a.	ki'kɛ	i	ʎag-t		
	'ishte	NYJË	lagur'		
	jan /	ki'kɛn	tə	ʎag-t-a	(n̄ga ai)
	'janë /	ishin	NYJË	lagur	nga ai'
	ai	ki'kɛ	i	zjua-t	(n̄ga ai)

	'ai	ishte	NYJË	zgjuar	nga ai'
b.	kiλε	i	'λag-u-rə		(nga ai)
	'ishte	NYJË	lagur		(nga ai)'
	ai	kiλε i	zɟua-rə		(nga ai)
	'ai	ishte	NYJË	zgjuar	nga ai'
c.	ε	kεɟ	'λagg-u-rə		
	'e	kisha	lagur'		
	ai	ju	kiɟ	'λagg-u-rə	
	'ai	M	ishte	lagur	'ai ishte lagur'
	ε	kεɟ	zɟua-rə		
	'e	kisha	zgjuar'		
	ju	kiɟə	zɟua-rə		
	'M	ishte	zgjuar'		'ai ishte zgjuar'

Carfizzi

a.	ɔ	ε	lag-t		
	'është	NYJË	lagur'		
	ka cən	ε	lag-t	ka ai	
	'ka qenë	NYJË	lagur	nga ai'	'është lagur nga ai'
a'.	ɔɟt	ε	lag-t /	ε lagg-u(-r)	
	'është	NYJË	lagur		'është lagur'
b.	ka cən	ε	lagg-u(-r)	ka ai	
	'ka qenë	NYJË	lagur	nga ai'	'është lagur nga ai'
	ɔɟt	ε	lagg-u(-r)		
	'është	NYJË	lagur'		
c.	ε	kəm	lagg-u(-r)		
	'e	kam	lagur'		

Ginestra

a.	kɟəkəmiɟ	iɟt / kλε	i	λaggə-ti	(nga vɛ:t)
	'kjo kēmishë	është / ishte	NYJË	lagur	(nga ai)'
	kɟəkəmiɟ	kλε	i	ɟtru-m-i	(nga vɛ:t)
	'kjo kēmishë	ishte	NYJË	hekurosur	(nga ai)'
	atə	iɟən	tə	uɟtreum-a/tə puɟtreur-a	
	'ata	ishin	NYJË	mbuluar-sh'	
b.	atə	ishin	puɟtreur		
	'ata	ishin		mbuluar'	
	kɟəkəmiɟ kλε	λagg-u-rə /	i	λagg-u-r-i	(nga vɛ:t)
	'kjo kēmishë	ishte larë /	NYJË	larë	(nga ai)'
c.	kɟə kəmiɟ	ju	kiɟi	λagg-u-rə	
	'kjo kēmishë	M	ishte	lagur'	

a kifa λagg-u-rə
 ‘e kisha lagur’

Casalvecchio

- a. kjo iſt a λag-t-a
 ‘kjo është NYJË lagur-fnj’
 kjoκλeti λag-t / ηgrɔx-t (ka ajo)
 ‘kjo ishte lagur/ngrohur (nga ajo)’
- b. kjo tries iſt mbuλuor / a mbuλuor
 ‘kjo tryezë është mbuluar / NYJË mbulesa’
 ato kriatura janm buλuor / tə mbuλuora (ka ajo)
 ‘ata fëmijë janë mbuluar / NYJË mbuluar-sh (nga ajo)’
- c. a kifa λag-t/ ηgrɔx-t
 ‘e kisha lagur / ngrohur’
 a kif mbuλuor
 ‘e kishte mbuluar’

Të dhënat nga *Carfizzi* në (23a’) japin një parametër më të hollësishtëm krahasuar me të dhënat e *Vena-s e Ginestra-s* në (23), po ashtu edhe me ato të *Civita-s* në (20ii). Në fakt në arbërishten e *Carfizzit* mesorja-jo veprare leksikalizohet nga ndërtimi ‘jam’-pjesore dhe jo nga ndërtimi që del përgjithësisht në varietetet arbëreshe i llojit *u-‘kam’-pjesore*, si në shembullin në *Vena* në (21b) e *Civita* në (20ii.b) (Manzimi e Savoia 2007). Në ndërtimin mesor-jovepror të *Carfizzi-t* është e pranueshme forma *-t*.


Parametri i *Carfizzi-t* na shpie në një shqyrtim më të kujdesshëm të formimeve me pjesore (21)-(23). Sikurse theksojnë Manzini e Savoia (2012) varietetet arbëreshe mund ta dallojnë interpretimin statik nga ai i së kryerës duke kryer dy leksikalizime të pjesores, pra një formë me eptimin mbiemëror në rastin e parë dhe një formë jo të eptuar në rastin e dytë. Ky kontrast del i qartë nëse krahasojmë dy ndërtimet kalimtare në (21b) me ndërtimet statike në (21a, c). Në *Vena* pra sikurse edhe në varietetet e tjera të shqipës, pasivi perifrastik sjell megjithatë një formë të eptuar të pjesores dhe një interpretim të llojit statik (në mënyrë të ngjashme me perifrastat pasive të greqishtes të diskutuara te Anagnostopoulou 2003). *Vena* na sjell një tjetër ndarje, ku një grup verbal ka pjesore të veçanta për këto kontekste, si në (21a). Për dallim nga pjesoret e zakonshme të eptuara me nyjën e

paravendosur, pjesoret e këtij grupi nuk e marrin atë nyjë. Në të vërtetë të dy llojet e pjesoreve mund të sillen në dy struktura identike, që na shpien te përkimi mes strukturës flektive të pjesores romane dhe strukturës flektive shqipe (Manzini e Savoia, 2005, 2007). Në ndërtimet në (24) zanorja tematike romane njësoj me zgjerimin e *-u-* së shqipes zë një pozicion N menjëherë në zonën e rrënjës, sufiksat *-t-* në (24a) dhe *-r-* në (24b) identifikohen nga elementi flektiv në kuptimin e së kryerës/ rezultative (pjesore) në F(lektim), ndërsa eptimi i mundshëm i klasës emërore specifikon argumentin e brendshëm të pjesores në N, duke e dyfishuar zanoren tematike.


Reduktimi i pjesores në *-VT-t-* në *Vena* mund të vijë thjesht nga fakti se kjo pjesore nuk e ka një alternuese të pa eptuar, pra që nuk e ka flektimin e klasës emërore/ shumës. Pamë se pjesorja që del në kontekstet me '*kam*' paraqet një formë që nuk i mbart vetitë e përshtatjes lidhur me subjektin (kontekstet medio-reflexive) ose me objektin (kontekstet kalimtare). Paradigma e pjesores më *-u-r-* parasheh këtë formë, e cila në fakt del edhe në bazat romane, si në (24c). Në të kundërt, format me *-VT-t-* kanë një paradigëmë që megjithatë leksikalizon vetitë e klasës natyrore/numri si pjesoret romane.

(24) *Vena*


a.



b.



c.



Fakti se të dyja llojet e pjesores mund të leksikalizojnë interpretimin statik vërtetohet nga analiza e Manzini-t e Savoia-s (2012), ku nuk ka një lidhje mes interpretimit statik dhe vetive eptuese. Jo rastësisht në shumë varietete arbëreshe forma joflektive e pjesores mund të dalë në ndërtime statike/pasive, sikurse është ilustruar në shembujt në *Civita* në (2011.a.).

Në të kundërt, ndërtimi me *jam* në *Carfizzi*, në (22a') na sjell një parametër tjetër të variacionit të gramatikat arbëreshe, në të cilën kuptimi medio-fleksiv i së kryerës sillet nga një pjesore e eptuar. Mund të mendojmë se është bashkimi i mundshëm në bazë të interpretimit të të kryerës. Në një varietet si ky *jam* hyn në kontekstet në të cilat subjekti i fjalisë kryesore identifikohet me argumentin e brendshëm të pjesores, pra edhe me një interpretim mesor-jovepror.

3.4. Konvergenca në paradigmen e së kryerës.

Foljet me temë më zanore të thjeshtë, *-a-*, *-e-*, *-i-*, e formojnë të kryerën duke ndërshtënë një morfemë fleksive *-ft-* o *-st*², së cilës i korrespondon morfema *-st-* / *-ft-* e varietetit roman. Sikurse duket në

² Edhe pse hipoteza relative më e kënaqshme e origjinës së morfemës *-st-* / *-ft-* është ajo e huazimit, nuk mund të përjashtohet që pikënisja e kësaj konvergjence mund të na shpjegë të morfologjia e së kryerës *-jt-* që dëshmohet në shumë varietete arbëreshe, në të cilat gjysmëkonsonantja **j* ka si ekuivalente një frikative palatale. Në të vërtetë, në dialektin e *Vena-s* **j* origjinare në kontekste të shurdhimit, si për shembull në pozitën në fund të fjalës, përkon me një nyjëtim frikativ, si në *atiç(ə)*, edhe pse me artikulum palatal më shumë sesa alveopalatal si ai i *f*. Edhe pse në origjinën e këtyre formave mund të kishte dalë kjo ngjashmëri fonetike, me rëndësi është që sot ka një përkim mes formativit arbëresh dhe atij roman dhe ky përkim gjendet në bazën e përvetësimit gjuhësor të fëmija.

(25), arbërishtja në (a) merr formativin *-ft / -st-* në të gjitha vetat, ndërsa paradigma romane në (b) e paraqet formativin *-st-/ -ft-* vetëm në vetën e dytë shumës. Përveç kësaj arbërishtja paraqet në vetën Ish dhe IIsh një formë alternative me formativin *-v-*, dhe në VIIIshnj një alternuese me eptimin m *-u*. Kjo e fundit përkon me formën romane. Duhet të vërehet që kjo paradigme nuk përdoret vetëm te bazat foljore të huazuara nga varieteti roman, sikurse *ripetts-a-ja* ‘qep’, e *krið-i-ja* ‘besoj’, por edhe te bazat leksikore origjinare, si *λ-a-ja* ‘laj’ in (a’).

Bazat më diftongje, në (25), dhe më bashkëtingëllore në (25d) nuk kanë eptim të veçantë për të kryerën. Në bazat më diftongje në shumës flektimi kombinohet drejtpërdrejt me bazat foljore, specifikë kjo e së kryerës. Foljet më bashkëtingëllore nga ana tjetër e marrin flektimin e vetës në të kryerën drejtpërdrejt mbi bazën leksikore, si në (25d). Të dhënat krahasuese në (25e) paraqesin paradigmen e së kryerës në një varietet të kontaktit roman; sikurse shihet forma dhe shpërndarja e elementeve eptuese përkojnë me atë të sistemit roman të *Vena-s*.

(25) Vena – varieteti arbëresh	Vena – varieteti roman
a. ripetts-a-st-a/ ripetts-a-v-a	b. ripetts-a-i ‘arnova’, etj.
ripetts-a-st-ε/ ripetts-a-v-ε	ripetts-a-st-i
ripetts-a-st-i/ ripetts-a-u	ripetts-a-u
ripetts-a-st-əmə	ripetts-a-mε
ripetts-a-st-ətə	ripetts-a-st-ivu
ripetts-a-st-ərə	ripetts-a-ru
krh. ripetts-a-ja ‘arnoj’	ripetts-u
krið-i-st-a/ krið-i-v-a	krið-i-vi ‘besova’, etj.
krið-i-st-ε/ krið-i-v-ε	krið-i-st-i
krið-i-st-i/ krið-i-u	krið-i-u
krið-i-st-əmə	krið-i-mε
krið-i-st-ətə	krið-i-st-ivu
krið-i-st-ərə	krið-i-ru
krh. krij-u, krið-i‘besoj, beson’	krið-i-ja ‘besoj’
a’. λ-a-st-a ‘lava’, etj.	
λ-a-st-ε	
λ-a-st-i / λ-a-u	
λ-a-st-əmə	

	ʎ-a-st-ətə		
	ʎ-a-st-ərə		
c.	piʃtr-ɔ-v-a	'mbulova, etj.'	
	piʃtr-ɔ-v-ε		
	piʃtr-ɔ-i		
	piʃtr-ua-mə		
	piʃtr-ua-tə		
	piʃtr-ua-n		
d.	ceʃ-a	'qesha, etj.'	
	ceʃ-ε		
	ceʃ-i		
	ceʃ-ə-mə		
	ceʃ-ə-tə		
	ceʃ-ə-rə		
e.	<i>Iacurso, S. Pietro a Maida</i>		
	krið-i-v-i	'besova', etj.	m assett-a-i 'u ula', etj.
	krið-i-st-i		t assett-a-st-i
	krið-i-u		s assett-a-u
	krið-i-mmi		n assett-a-mmi
	krið-i-st-i-vu		v assett-a-st-ivu
	krið-i-ru		s assett-a-ru


Manzini e Savoia (2005) e identifikojnë zanoren tematike (VT) që kombinohet me bazat foljore me një element që lidhet me pozicionin N të fjalës që përkon me argumentin e brendshëm të përzgjedhur nga rrënja; eptimet që sjellin veti aspektuale/modale të veçanta identifikohen me pozicionet e llojit flektiv (F). Përfundimisht, flektimi i përshtatjes emërore lidhet me pozicionin D, që përkon me kategorinë e subjektit të fjalisë, që në fakt këto flektime e leksikalizojnë.

Duke i rimarrë pikat kyçe të kësaj analize mbi flektimin foljor, shohim se struktura e brendshme e formave në (25) vë në pah një sistem flektiv të përbashkët të gramatikës arbëreshe dhe asaj romane. Në veçanti formantët që vihen në përdorim leksikalizojnë të njëjtat kategori në të dyja gramikat. Në (26a) përbërësit rrënjë-VT, ku VT lidhet me N, vihet në përdorim elementi *-ft-*, ose *-v-* në klasa të tjera foljore, që leksikalizon eptimin e aspektit; në fund flektimi i përshtatjes emërore hyn në D. Formime si kriðu në (26b) nuk kanë eptim të


veçantë për aspektin/mënyrën; është eptimi i përshtatjes ai që e regjistron të kryerën. Në fund, (26d) paraqet strukturën e formave të së kryerës, në të cilat baza foljore kombinohet drejtpërdrejt me eptimin e përshtatjes emërore; edhe në këtë rast, janë këto të fundit që, duke pasur formë të specializuar, japin informacionin e së kryerës. Sikurse shihet, të gjitha strukturat janë të pranishme në sistemin foljor arbëresh e roman dhe paraqesin përkimin mes morfologjisë romane (R) dhe asaj arbëreshë (A).

(26) *Vena*

a.



b.



Krahasimi në (25e) tregon që varieteti roman i *Vena-s* ka paradigma të njëjta me ato të varieteteve romane me të cilat janë në kontakt. Është normale të mendosh se është ky sistem roman në bazën e konvergjencës me sistemin arbëresh, për aq sa folësit e kanë përvetësuar atë. Me fjalë të tjera, është njohuria dygjuhësore e folësve që i ushqen përkimet sistematike, sikurse këto që kemi shqyrtuar.

Është me interes të shikohet se bazat romane të llojit në (25a) gjenden edhe në varietete të tjera arbëreshe. Në shumë varietete baza leksikore e këtyre huazimeve ngrihet mbi trajtën infinite foljore të gju-

hëve latine, të cilit i shtohen formantët arbëreshë, si në (27a) në *Carfizzi* e *Casalvecchio*. Është me interes të shihet që formanti -t- që del në format e së kryerës, si edhe ato në pjesore, dëshmohet qartë si formant i së kryerës në paradigmen e bazave foljore të leksikut origjinar arbëresh, sikurse ilustron në (27b). Me fjalë të tjera, formimet e llojit (26a) paraqesin raste me përzierje të brendshme të fjalës, në të cilat një bazë romane kombinohet me morfologjinë eptuese arbëreshe (diskutimi në 4.1, 4.2), sikurse tregohet në strukturën në (27c).


(27) *Carfizzi*

a.	krið-i-r-t-a	'besova', etj.	u set-a-r-t-a	'u ula', etj.
	krið-i-r-t-e		u set-a-r-t-e	
	krið-i-r-t-i		u set-a-r-t	
	krið-i-r-t-um		u set-a-r-t-um	
	krið-i-r-t-it		u set-a-r-t-it	
	krið-i-r-t-in		u set-a-r-t-in	
	krh. krið-i-r-i	'(unë) besoj'	jom set-a-r-tu	'jam ulur'
b.	l-a-t-a	'lava', etj.		
	l-a-t-e			
	l-a-t-i			
	l-a-t-um			
	l-a-t-it			
	l-a-t-in			

Casalvecchio

a.	krəð-i-r-t-a	'besova', etj.
	krəð-i-r-t-a	
	krəð-i-r-t-i	
	krəð-i-r-t-əm	
	krəð-i-r-t	
	krəð-i-r-t-ən	
	krh. krəð-i-r-ijn	'(unë) besoj'
	a kiʃa krə'ðirtərə	'e kisha besuar'
b.	mbuʎo-v-a	
	mbuʎo-v-a	
	mbuʎuo-t-i	
	mbuʎuo-j-t-əm	
	mbuʎuo-j-t	
	mbuʎuo-j-t-ən	

c. *Casalvecchio*



3.5. *Kundrinorët emërorë.*

Në varietetet e shqipes kundrinori emërore lidhet nëpërmjet një përcaktuesi të përshtatur me emrin kokë, i ndjekur nga sintagma emërore me eptim të gjinore. Në varietetet arbëreshe dalin, të paktën si alternativa strukturore, ndërtime që rikrijojnë kushtet romane, në të cilat sintagma emërore kundrinorit lidhet nga një parafjalë dhe ka formë emërore. Sikurse tregojnë të dhënat në (28), po të njëjtat varietete paraqesin, krahas ndërtimeve që lidhen me parafjalë në (28a), edhe ato të tipit etimologjik me gjinoren, në (28b).

(28) *Ginestra*

- | | | | |
|----|----------|-----|-------|
| a. | jə bukir | ðə | vitrə |
| | një gotë | nga | qelqi |

Casalvecchio

- | | | | | |
|----|----------|------|----------|------------------|
| a. | jə bukir | ðə | ɣujə | |
| | një gotë | nga | uji | |
| | ʎɛʃ-i | ðə | dɛʎɛ | |
| | lesh-Em | nga | dele | 'leshi i deles' |
| | mɨʃ-t | ðə | ʎɔp-a | |
| | mish-Em | nga | lop-Em | 'mishi i lopës' |
| | jəɣaʃt | ðə | cɛn-i | |
| | një asht | nga | qen-Em | 'një asht qeni' |
| b. | bri-t | tə | ʎɔp-s | |
| | bri-sh | NYJË | lop-Gjin | 'brirët e lopës' |

Vena

- | | | | | |
|----|------------|-----|---------|---------------------|
| a. | sɛdʒ-a | ŋga | kambr-a | |
| | karrige-Em | nga | dhom-Em | 'karrigia e dhomës' |
| | tə biçətə | ɛ | saçə | |

	NYJË bij-sh	NYJË	saj-Gjin	‘të bijtë e saj’
	bijfti	i	ʒɛʎ-it	
	bisht-Em	NYJË	gjel-Gjin	‘bishti i gjelit’
b.	tə biçətə	nga	aʒə	
	NYJË bij-sh	nga	aʒə	‘të bijtë e saj’
	bijfti	nga	ʒɛʎ-i	
	bisht-Emnga	gjel-Em		‘bishti i gjelit’

Në këto ndërtime, parafjala mund të jetë një huazim nga dialekti roman, si *ðə* në *Casalvecchio*, ose mund të jetë një nga parafjalët e leksikut origjinar, si për shembull *nga* në *Vena*. Në rastin e dytë vetitë e saj leksikore janë ripërcaktuar. Elementi *nga* del normalisht në kontekstet lokative (vendore), ku ka kuptim ‘nga, afër’ dhe leksikalizon vepruesin në kontekstet pasive. Në (28b) merr veti semantike të lidhura ngushtë me përfshirjen në një grup.

3.6. Klitiku i kallëzores në varietetin roman të *Vena-s*.

Sistemi i klitikëve të kundrinorëve të vetës në varietetin kalabrez të *Vena-s* na jep një nga aspektet që e dallojnë sistemin eptues të shqipës nga ai roman, pra dallimin e trajtës së shkurtër të V3nj femërore të kallëzores nga ajo e gjinisë mashkullore. Sistemi i shqipës (Demiraj 2002, Solano 1972, Manzini e Savoia 2007) del vetëm me një formë ε të klitikut objekt të V3shnj, që dallohet nga ai i kallëzores shumës/dhanore. Të njëjtët formativë dalin edhe si artikuj të paravendosur dhe si flektim emërore/mbiemëror, saktësisht si në flektimet romane, që dalin te klitikët, nyjat dhe emrat/mbiemrat. Sistemi i dialekteve kalabreze të kontaktit, sikurse të gjitha sistemet romane, veçojnë një formë kallëzore *lu* mashkullore njëjës nga forma *la* femërore njëjës, ndërkohë që në shumës në alternim me *ɲtʃi* në dhanore përkojnë me formën *li*, sikurse ilustron në (29) për varietetin e *S. Pietros* në Maida.

(29) *S. Pietro a Maida*

ičču lu/ la/ li cama	'ai e/i thërret'
l avia camatu	'e/i kishte thirrur'
ičču li/ ntʃi ðuna kistu	'ai i jep këtë'
ičču ntʃi lu ðuna	'ai ia jep'
nda viju nu paru	'e shoh një palë'
<i>Iacurso</i>	
lu/ la / li 'viðenu	'e/i shohin'
l a'via camatu	'e/i kishin thirrur'
li ðuna kistu	'i jep këtë'

Paradigma e klitikut të *Vena-s* ka vetëm dy forma të klitikut objekt, pra formën *li* shumë dhe vetëm formën *la* për njëjës, e cila neutralizon dallimin e klasës emërore tipike të varietetit roman; dhanorja leksikalizohet nga lokativi (vendorja) (*n*)*ntʃi* si në shumë varietete të kësaj zone (Manzini e Savoia 2005, 2007, 2008). Në kontekstet predikative *la* përshtatet si me klasën emërore -u, ashtu edhe me klasën emërore -a. Kjo gjendje ilustron në (30), ku janë vënë përballë ndërtimet romane në (a) dhe ato arbëreshe në (b).

(30) *Vena – varieteti roman**Vena – arbëresh*

a. la lavai	b. ελafta
'e lava'	'e lava'
la piʃʃai ccu vaʃʃu/ ccu vaʃʃa	emōra mē i maθ/ mēæ maðe
'e mora më të vogël'	'e mora më të madh/ madhe'
li piʃʃai ccu vaʃʃi	i mōra mē tē mbiðej
'i mora më të vegjël/ vogla'	'i mora më të mdhenj/ mëdha'
ntʃi la detsi	j-a ðe
'ja dhashë'	'ja dhashë'

Riorganizimi i sistemit të eptimit roman vë në dukje përkimin e ngushtë mes eptimit të shqipes dhe atij roman. Në veçanti *ε / i* arbëreshe mund të analizohen si formativë të klasës emërore pikërisht sikurse -u/-a/-i të varieteteve romane (diskutimi në kapitullin pasues), edhe pse kushtet e shpërndarjes sipërfaqësisht janë të ndryshme. Vetitë leksikore të regjistruara nga të dyja sistemet dalin uniforme, aq sa

gramatika romane mund të aplikojë në sistemin e saj të klitikëve paradigmën arbëreshe. Përzgjedhja e flektimit *-a*, që lidhet në përgjithësi me klasën emërore femërore, duket të lidhet me veti të ekuivalente nëε. formativ iε del si nyje e paravendosur i përshtatur me femëroret dhe me eptimin e femërores njëjës (në distribucion komplementar me fleksionin e shquar *-a*) në disa grupe emërore, si në rastin e *δελε* ‘dele’ / *δελα* ‘delja’, *ματςε* ‘mace’ / *ματςα* ‘macja’. Në veçanti me emrat e farefisnisë femërore nyja e paravendosur *ε* kombinohet me flektimin e shquar të femërores *-a*, si në *ε* *κυσίριρα* ‘kushërira’. Me fjalë të tjera, parametri arbëresh është riprodhuar në dialektin roman mbi bazën e të njëjtit grup reduktimesh leksikore.

Një pikë e fundme për t’u shqyrtuar i përket faktit se riorganizimi që pamë nuk aplikohet te sistemi i nyjave, edhe pse ka një përkim edhe formal mes klitikëve dhe nyjave në dialektet e zonave. Sistemi i nyjave të varietetit roman të *Vena-s* në fakt është *lu, la, li*, ndaj nëse dukuria do të ishte thjeshtë reduktim, do të duhej t’u përkiste edhe nyjave. Në të vërtetë dukuria qëndron në organizimin e veçantë të flektimit që sistemi roman e bën duke pasur si model arbërishten.

3.7. Aspekte të fonologjisë në varietetin roman të Vena-s dhe huazimet.

Zanoret në varietetin roman të *Vena-s* paraqesin një sistem me tri shkallë të hapjes [*i ε a o u*] e njëjta gjë dëshmohet edhe në varietetet kalabreze qendro mesdhetare; shpërndarja e këtyre elementeve përkon me atë të varietetit të kontaktit (Savoia 2005) me një dallim të rëndësishëm në krahasim me këto të fundit, pasi që sistemi fonologjik i varietetit roman të *Vena-s* nuk e parasheh meta-foninë (Savoia e Maiden 1997). Në varietetet romane të kontaktit në fakt [*εo*] tonike përjashtohen nga kontekstet në të cilat [*i u*] janë bërthama të rrokjes vijuese atone. Në këto kontekste dalin diftongjet [*iə uə*] që paraqesin alternueset metafonetike të [*εo*]. Ky alternim është thjeshtësuar në (31) në varietetin e *Iacursos*:

(31) *Iacurso*

[kur'teɤa] 'thika' - [kur'tiɤɤu] 'thikë'

[mar'teɤa] 'çekanë' - [mar'tiɤɤu] 'çekan'

[aɲ'ɲiɤɤu] 'qingj' - [aɲ'ɲiɤɤi] 'qingja'

[kra'piɤttu] 'cjap'

['pɛðɛ] 'këmbë' - ['piɤði] 'këmbë'

['liɤju] 'lexoj' - ['leɤjɛ] 'lexon'

['priɤɤu] 'lutem'

['vɛcca] 'e vjetër' - ['viɤccu] / ['viɤcci] 'i vjetër/ të vjetër- të vjetra'

['rɔta] 'rrota' - ['ruɤti] 'rrote'

[lan'tsuɤlu] 'çarçaf' - [lan'tsɔla] 'çarçafë'

['uɤccu] / ['uɤcci] 'sy/ sy'

Mund ta trajtojmë diftongun metafonetik si rezultatit e një kërkese të tipit prozodik që kanë gramatikat me metafoini, në bazë të së cilës një zanore atone legjitimohet nga vetitë fonologjike të zanores tonike që ka përpara. Në rastin e varieteteve kalabreze që kemi shqyrtuar, me diftongizim në korrespondencë me [i u] vijuese, kjo kërkese përmbushet nëpërmjet dekompozimit të përmbajtjes fonologjike të zanoreve gjysmë të ulta /ɛɔ/, përfshirë vetitë timbrore [-e prapme] ([I]) / [+e prapme] ([U]) dhe vetitë e shkallës së hapjes [e ulët] ([A]). Në kontekstet metafonetike përmbajtja fonologjike e bërthamës tonike shpërndahet në dy pozicione silabike, ndaj [I]/ [U] lidhen nga një pozicion prozodik që dallon nga ai i [A]. Për aq sa janë realizuar në pozicione autonome, [I]/ [U] kanë një status prozodik të mjaftueshëm për të legjitimuar zanoret fundore [i u], që përkojnë me vetën një veti të timbrit, sikurse është ilustruar në (32) për vargun *uv ... i*. Me fjalë të tjera, është përmbajtja e bërthamës dominuese kokë që ka një përmbajtje fonologjike dhe një status prozodik të përshtatshëm për të legjitimuar zanoret fundore të tipit [i u]. Në (32) etiketa N tregon 'Nucleus/berthamën', R 'Rimën', F 'Fillimin', x tregojnë pozicionet prozodike të vargut, bërthama tonike shënohet me N (Kaye, Lowenstamm e Vergnaud 1990, Harrsi 1994).

(32) *Iacurso*

F	R	F	R	
	N		N	
	\			
p	x	x	ð	x
	[I]	[A]		[I]

['piɐði] 'këmbë'

Dialekti roman i *Vena-s* e përjashton absolutisht këtë kufizim, ku vokalet gjysmë të ulta [ɛɔ] dalin edhe në kontekste ku paraprijnë [i u], si në (33a). Me fjalë të tjera, në *Vena*, në mungesë të një kërkese si ajo që kërkon diftongizim në (32), përmbajtja fonologjike e zanoreve gjysmë të ulta lidhet me vetëm një pozicion vokalik, si në (33c), pa varësisht nga zanoret që e ndjekin. Të njëjtat rezultate karakterizojnë edhe huazimet korresponduese në (33b), duke sugjeruar se huazimet leksikore, të analizuar në 2 janë të lidhura ngushtë me njohjen dygjuhësore (varietet kalabrez lokal/varietet arbëresh) i folësve. Me fjalë të tjera baza leksikore e huazimeve është e përmbashkët për të dyja grammatikat.

- (33) a. *Vena – varieteti roman*
 ['pɛðɛ] / ['pɛði] 'këmbë / këmbë'
 [lɛju] '(unë) lexoj'
 [pɛɣu] '(unë) lutem'
 [mar'tɛʎʎu] / [mar'tɛʎʎi] 'çekan/ i'
 [a'ɲɛʎu] 'qिंगj'
 [kapɛtu] 'cjap'
 ['vɛccu] / ['vɛcca] / ['vɛcci] 'i/e/të vjetër/a'
 ['dɔrmu] / ['dɔrmi] / ['dɔrmɛ] 'fle'
 ['rɔta] / ['rɔti] 'rrota/ rrota'
 [lɛn'tsɔlu] / [lɛn'tsɔla] 'çarçaf/ ë'
- b. [mar'tɛʎ-i] 'çekani'
 [a'ɲɛʎ-i] 'qिंगji'
 [ka'pɛt-i] 'cjapi'
 [lɛ'jiɲna] 'lexoj'
 [pɛɣaɲna] 'lutem'
 [lɛn'dzɔl-i] 'çarçafi'

c.

<i>Vena</i>			
F	R	F	R
	N		N
p	x	ð	x
	[A, I]	[I]	

[ˈpɛði] ‘këmbë’

Shpërndarja e përgjithshme e zanoreve gjysmë të ulta që karakterizon sistemin fonologjik të varietetit roman të *Vena-s* përkon pra me kushtet e sistemit fonologjik arbëresh, që i merr zanoret gjysmë të ulta edhe përpara [i u], si në (34).

- (34) *Vena – varieteti arbëresh*
 [ˈcɛʃa] / [ˈcɛʃɛ] / [ˈcɛʃi] ‘qesha/qeshe/qeshi’
 [ˈdɛrk-u] ‘derri’
 [piʃˈtrɔva] / [piʃˈtrɔvɛ] / [piʃˈtrɔi] ‘mbulova/ve/u’
 [piʃˈtrɔ-ju] ‘mbulohu’
 [ˈɲɔha] / [ˈɲɔhɛ] / [ˈɲɔhu] ‘njoha/e/u’
 [ˈzɔg-u] ‘zog’

Inventari konsonantik i varieteteve romane nuk përfshin mbrapavajtjen, e pranishme, edhe pse me realizime fonetike të diferencuara, në varietetet e kontaktit. Të dhënat leksikore kanë, në vend të prapavajtjes, lateralen palatale [ʎʎ], si në (35a). (35b) sjell huazimet përkuese në arbërishte, që karakterizohen nga i njëjti konsonantizëm.

- (35) *Vena*
 a. [kurˈtɛʎʎu] / [kurˈtɛʎʎi] ‘thikë/a’
 [ˈiʎʎu] ‘ai’
 [marˈtɛʎʎu] / [marˈtɛʎʎi] ‘çekan’
 b. [marˈtɛʎ-i] ‘çekani’

Sërish, huazimi arbëresh ekuivalent inkorporon rezultatin [ʎʎ] të varietetit roman që flitet nga folësit bilingë, duke konfirmuar kështu hipotezën që huazimi përkon me një dispozitiv të code-mixing mes dy gramatikave më shumë se me një procedurë të nxjerrjes nga sisteme të jashtme. Kjo vlen edhe për rezultatin [h] intervokalik që në varietetet

e kontaktit përkon me *f etimologjike. Në varietetin e *Vena-s* në (36a) gjejmë këtë rezultat, që mbetet i regjistruar në huazimet arbëreshe, në (36b). Disa baza të leksikut të shqipes origjinare e paraqesin njësoj [h] në vend të *f, si në (36c). Duhet të mendojmë pra që procesi i dobësimit të /f/ aplikohet edhe në nivelin e përbërësit të Formës Fonetike (shih, pf. 4) të gramatikës arbëreshe.

(36) *Vena*

- a. [had'dalɛ] 'përparëse'
 ['hɛɛ] 'vrer'
 ['himini] 'gra'
 ['hɔku] 'zjarr'
 ['hɔrɛ] 'jashtë'
 [hɔr'mikula] 'milingonë'
 ['humu] '(unë) pi duhan'
 ['buha] 'thithlopë'
- b. [hada'lic-i] 'përparëse'
 [hɔr'mikul-a] 'milingona'
 [hu'maɲa] '(unë) pi duhan'
 ['buh-a] 'thithlopa'
- c. [i 'hɔrtə] 'i fortë'
 ['cah-a] 'qafa'

Në varietetet e kontaktit [h] intervokalike gjendet në shpërndarje komplementare me altrernuesen [f] në pozicion postkonsonantik dhe alternuesja [ff] në kontekst të dyfishimit fonosintaktik, si në (37). Kjo sugjeron që mbartja leksikore e këtyre formave përmban një paraqitje bazike me /f/ nistore.

(37) a. *Iacurso*

li hijjuɛli	su ffiɲjuɛli
'vajzat'	'janë vajza'

S. Pietro a Maida

sunnu himmini	tri ffimmini
'janë gra'	'tri gra'

b. *Vena*

sunnu himmini	tri himmini
'janë gra'	'tri gra'

Gramatika romane e *Vena-s* nuk i përfshin alternueset që lidhen me kontekstin fonosintaktik. Mund të mendojmë se mbartjet leksikore janë magazinuar në leksik me [h] nistore, pikërisht si në huazimet e përdorura nga gramatika arbëreshe.

3.8. Diftongimi i bërthamës tonike në arbërishten e *Ginestra-s*.

Varieteti i *Ginestra-s* paraqet një organizim fonologjik i cili riprodhon ndjeshmërinë e strukturës silabike dhe diftongizimin në rrokjen e hapur të zanoreve tonike, që karakterizon dialektet lukane të afërta me varietetin lukan që flitet nga vetë arbëreshët. Në varietetet lukane diftongizimi i bërthamës tonike del në rrokje të hapur me këmbë dyshe në pozicion fundor tonik të thënies (Savoia 1987, 1993); në kontekstet e rrokjes së mbyllur dhe në pozicion e tretë fundor del një lloj vokalik më i hapur dhe më qendror. Shembujt në (38) krahasojnë rrokje tonike të hapura në pozicion parafundor në (i) me forma të theksuara në pozitën e tretë fundor në (ii) dhe forma paroksitone në pozicion të brendshëm në (iii). Në dialektet lukane diftongu realizohet vetëm në kontekstin (i), sikurse ilustruhet në (38b); në arbërishten e *Ginestra-s* diftongu ka një shpërndarje të ndryshme, mbi të cilën do të kthehemi sërish, dhe në veçanti realizohet si në (i) ashtu edhe në (ii), sikurse ilustruhet në (38a).


(38) *Ginestra*

a.	i.dɛirə	dorë
	u peita	unë piva
	t a beimi	ta biem
	u turneua	u tërhoq
	əm-a meua	ma jep mua
	a/ u ðəbɛura	e/ u humba

	kaleuiti	zbriti
ii.	dëirənə	dorën
	kriateurətə	fëmijët
iii.	u pita tsa ujə	unë piva pak ujë
	t a bimi dəpu	ta biem më vonë
	u turnua prapətə	u tërhoq mbrapa
	əm-a mua martiλλənə	ma jep mua çekanin
	ðəbərə uðən	humba rrugën
	kalçiti diçi	zbriti dielli
b.	i.sə deitçə	thuhet
	nən lu tçinə	nuk e mban
	nu mələunə	një pjepër
	lu məuvə	e lëviz
	lu steutə	e fik
ii.	mə lu ditçənə	ma thonë
	lu stutənə	e fikin
iii.	nən lu tenə cu	nuk e mban më
	nu mələnə fradzətə	një pjepër i kalbur
	lu məvəyeçə	e lëviz unë
	stutə lu fukə	fike zjarrin

Kushtet strukturore që drejtojnë vokalizmin roman të *Ginestra-s* dhe në përgjithësi atë të varieteteve lukane janë paraqitur në (39). Nëse ia kushtojmë peshën prozodike të një njësie, që shënohet me ‘μ’ (mora), bashkëtingëllores në pozicionin bisht që ndjek bërthamën tonike, do të shohim se diftongu realizohet vetëm kur bërthama tonike ndiqet nga vetëm një ‘μ’ (mora), si në (39a). Në strukturat e rrokjes së mbyllur në (39b) dhe në ato proparaoksitone në (39c), du bërthama tonike ndiqet nga dy njësi peshe, diftongu nuk realizohet.

(39) *Ginestra*




Të dhënat në (38a, i-iii) tregojnë se në arbërishte diftongizimi i bërthamës tonike del në pozicion tonik fundor të thënies, në pozicionin fundor të fjalës dhe në rrokje të hapur. Në rastin e dytë, reduktimi te karakteri binar i kënbës nuk është veprues, sikurse tregohet te diftongu në shembujt (ii). Në të kundërt ndodh një reduktim, jo i pranishëm te dialektet romane, ku është një sonante e ngjitur me bërthamën tonike e cila shkakton diftongizimin. Në të vërtetë, sistemi prozodik i *Ginestra-s* nuk ka reduktime prozodike që lidhen me karakterin e fortë të bërthamës tonike: për shembull ndodh realizimi i zanoreve të dobëta pavarësisht nga pozicioni i tyre në sekuencë (Savoia 1994). Mund ta lidhim pra reduktimin në kontekstet e diftongizimit me faktin që diftongizimi interpretohet në lidhje me vetitë fonologjike të bashkëtingëllores që vjen pas. Reduktimet prozodike duket

të jenë më të kufizuara dhe reduktojnë mundësitë në të cilat konteksti i përcaktuar nga bashkëtingëllorja favorizon diftongun.

Fakti që diftongu del në kontekstin e sonanteve të tipit gjysmë vokalik a mono vibrant mund të lidhet me përmbajtjen e ngushtë fonologjike të këtyre segmenteve. Me fjalë të tjera, këto sonante nuk janë të afta për të kontrolluar përmbajtjen fonologjike të bërthamës; rezultati del që bërthama tonike ka autonomi prozodike në kontekstin fundor të fjalës. Autonomia prozodike e bërthamës realizohet në formën e një përmbajtjeje fonologjike veçanërisht të pasur, me të cilën përkojnë edhe veti me forcë prozodike, që lidhen me theksin dhe me pozitën tonike kryesore të fjalisë, sikurse tregohet në (40).

(40) *Ginestra*



Të vërehet që (40) paraqet strukturën prozodike të fjalës (Fj) të futur në këmbë (K) e cila mban theksin kryesor; përmbajtja e [r] është paraqitur me vetëm një veti [dhëmbore].

4. Fjalë dhe thënie të përziera.

Bashkegzistenca e mundësisë së dyfishtë strukturore në rastin e formave në (1)-(3) na bën të dyshojmë se këto mund të jenë huazime në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra, sipas Bokamba (1988), elemente të një gjuhe L_x të hyra në mënyrë të qëndrueshme në leksikun e një gjuhe të ndryshme L_y edhe për folësit jo bilingë. Në realitet, në një komunitet si ai i *Ginestra-s* të gjithë folësit njohin të paktën arbirshen dhe dialektin e vendor lukan, ndaj statusi i këtyre elementeve leksikore me fleksion të dyfishtë na shpie te përzierja e brendshme e fjalës.

Kushtëzimet që drejtojnë kombinimet e mundshme të elementeve të gjuhëve të ndryshme brenda një kuadri teorik adekuat paraqesin argumentin kryesor të studimeve mbi komutacionin e brendshëm të fjalisë. Poplack (1980) duke analizuar code-switching në spanjisht-anglisht në një komunitet portorikan në New York e lidh code-mixing me kushtëzime të natyrës strukturore që paraqesin vetëm disa mundësi kombinatorore mes elementeve të gjuhëve të ndryshme duke përjashtuar të tjerat.

Poplack (1980: 585-586) propozon këto dy kushtëzime (41):

(41) a. *The equivalence constraint: Codeswitches will tend to occur at points in discourse where juxtaposition of L1 and L2 elements does not violate a syntactic rule of either language, i.e. at points around which the surface structures of two languages map onto each other.*

b. *The free morpheme constraint: Codes may be switched after any constituent in discourse provided that constituent is not a bound morpheme.*

(41a) lejon komutacionin e brendshëm vetëm aty ku strukturat sipërfaqore të dy gjuhëve kanë të njëjtin rend të fjalëve, duke përjashtuar për shembull kombinimin e një përemri të dobët (trajtë e shkurtër) në spanjishte me një folje në anglishte, si në (42a), pikërisht pasi

anglishtja nuk e ka këtë lloj sekuece, sikurse tregohet në shembujt që janë sjellë për krahasim në (42b):

- (42) a. *told le, le told (MacSwan 2000: 38)
 b. I told him... vs. (Yo) le dije...
 ‘(unë) i thashë...’

Kushtëzimi (41b) përjashton komutacionin mes morfemave të brendshme të fjalës, si në (43)

- (43) *eat-iendo’ (Poplack 1980: 586)
 ‘duke ngrënë’

Kushtëzimet e sjella nga Poplack (1980) ndjekin intuitën sipas së cilës komutazioni nuk mund t’i prekë strukturat themelore të sintaksës e të morfologjisë së një gjuhe. Diskutimi në studimet e MacSwan-it (1999, 2000, 2005b) tregon pamjaftueshmërinë e disa kushtëzimeve të tjera të propozuara, si ajo ku elementet leksikore me lidhje drejtuese mes tyre, si lidhja mes një foljeje e një objekti, parafjale e objekti, pjesëze eptuese dhe emri etj, duhet t’i përkasin së njëjtës gjuhë, e përgënjeshtuar nga shumë raste të dëshmuara në literaturë.


Shembujt në (44) në *Vena* tregojnë që materiali leksikor roman mund të hyjë në brendësi të fjalisë me sintaksë arbëreshe, duke e bërë të mundur code-switching kanonik të fjalisë. Sikurse ilustrojnë fjalitë në (44) materiali leksikor roman mund të hyjë edhe në kontekstet që e vënë në dyshim kushtëzimin në (41a). Në radhë të parë, sikurse ilustrohet në (44a), format romane si *nu misə* nuk e përmbushin kërkesën e morfologjisë së Rasës të sintaksës arbëreshe. Sintagmat *emër-Nyjë- mbiemër* në (44b,c) e kundërshtojnë (44a) ku emri roman kombinohet me nyjën e paravendosur të shqipës pasi që varietetet romane nuk ka në një rend me elemente eptuese parambiemërore që lidhen me emrin.

- (44) *Vena di Maida*
 a. ka nu misə tʃə ŋgə vjen
 ka një muaj që nuk vjen

b.	aft	na lutʃε	ε	maðe
	është	një dritë	NYJË.fnj	madhe.fnj
c.	ka	na vutʃε	ε	hørte
	ka	një zë	NYJË.fnj	fortë.fnj

4.1. Modeli morfologjik i MacSwan; Morfologjia Shpërndarëse.

Në qasjen minimaliste code-mixing i propozuar nga MacSwan (1999, 2000, 2005a, 2005b) i vetmi kushtëzim i përzierjes në brendësi të fjalisë përjashton kombinimet që vihen në kundërshtim me kërkesat e gramatikave: ‘Nothing constrains code switching apart from the requirements of the mixed grammars’ (MacSwan 2005a:4). Pika teorike që na intereson i përket mundësisë së kombinimit të morfemave të një gjuhe me morfema të gjuhës tjetër brenda kokave leksikore, pra kateg-oritë e nivelit X^0 . Në qasjen minimaliste code-mixing i propozuar nga MacSwan (1999, 2000, 2005a, Modeli i njohjes dygjuhësore i propozuar nga MacSwan (1999, 2005a, 2005b), i skematizuar në (45) e përjashton këtë mundësi.



PF = Phonetic Form, LF = Logical Form

Në (45) krijimi i thënieve të përziera vjen nga një leksik që përfshin leksikon e dy gjuhëve (ose më shumë), mbi të cilin kanë vepruar rregulla të strukturës morfologjike (MS). Folësi përzgjedh bashkësinë e elementeve (Numërimin) që futen në strukturën e fjalisë mbi të cilën veprojnë rregullat e lëvizjes; struktura e prodhuar nga komputacioni i nënshtrohet dy përbërësve interpretues të formës

fonetike (PF) dhe të formës logjike (LF). Në veçanti PF ka rolin e përkthyesit në fonologji të pjesëve morfosintaksore. Fakti që PF vepron me rregulla të drejtuara i përjashton fjalët e përziera me bazë leksikore nga një gjuhë dhe eptim morfologjik nga një tjetër:


Codeswitching is formally the UNION of two (lexically-encoded) grammars, where the numeration may draw elements from the union of two (or more) lexicons. Each lexical item imposes certain requirements on the derivation in term of the encoded features, [...] the relevance of inflectional morphology to the phonological component further suggests that changing phonological systems in the context of such phonological material would disrupt the mapping to PF, and hence is also disallowed [...] Codeswitching will not occur in contexts involving phonological derivations, [...] inflectional material from one language will not be coded by the phonology of another language, and [...] codeswitching will not occur internally within an X^0 . (MacSwan 2005a: 5, 6)

Fjalitë e përziera do të vinin nga ndërhyrja e elementëve leksikorë të formuar tashmë dhe nuk do të mund ta preknin nivelin e brendshëm të fjalës. Këto kushte janë formuluar në *PF Disjunction Theorem* (MacSwan 2005a: 5-6) në (46), që e sjell kushtezimin e morfemës së lirë në (41b) nga vetitë e komponentit fonologjik. Ky i fundit, për aq sa përmban rregulla të drejtuara në mënyrë të ndryshme për secilën gjuhë, e përjashton mundësinë e bashkimit të materialeve morfologjike të gjuhëve të ndryshme:

(46) *PF Disjunction Theorem*

- i. The PF component consists of rules/constraints which must be (partially) ordered/ranked with each other, and these orders vary cross-linguistically
- ii. Codeswitching entails the union of at least two (lexically-encoded) grammars
- iii. Ordering relations are not preserved under union
- iv. Therefore, codeswitching within a PF component is not possible

Modeli i MacSwan (1999, 2005a, 2005b) parasheh pra që format leksikore hibride me të cilat jemi marrë duhet të identifikohen me huazime në kuptimin e ngushtë të fjalës, që ndodhen tashmë në të dy leksikët e folësit dy gjuhës. MacSwan (1999, 2005a,b) e mbështet këtë zgjidhje në modelin *Distributed Morphology* (*Morfologji Shpërndarëse*). *Morfologjia Shpërndarëse* (Halle e Marantz 1993, 1994, Marantz 1997, Embick 2000, Harris e Halle 2005) parasheh një model specifik të paraqitjes (Morphological Structure, MS) në të cilin ndodh futja e elementeve të Fjalorit, pra kombinimi i pjesëzave fonologjike me rendin e pjesëzave morfosintaksore që lidhen me nyjat fundore të derivimit sintaksor, në nivelin e strukturës sipërfaqësore të sintaksës. Sikurse është skematizuar në (47).



Në (47) SStregohet se niveli që arrihet nga derivimi sintaksor i fjalisë vjen pas aplikimit të rregullave të lëvizjes në strukturën bazë (DS); LF paraqet interpretimin semantik të fjalisë. Ndërfutja e elementeve të Fjalorit ndodh në nivel të përbërësit MS, pasi kanë vepruar rregullat që shtojnë, lëvizin apo varfërojnë rendin e pjesëzave të nyjave fundore. Halle e Marantz (1993: 114) përmbledhin:

MS is a syntactic representation that nevertheless serves as part of the phonology, where “phonology” is broadly conceived as the interpretive component that realizes syntactic representations phonologically.

Ndërfutja leksikore aplikohet në fund të derivimit morfosintaksor (Late Insertion), pasi që rregullat e ridrejtimit kanë vepruar mbi pjesëzat në nyjat fundore, duke krijuar paraqitje të nën specifikuara nëpërmjet operacioneve që shtojnë, spostojnë, bashkojnë dhe

zërthejnë nyjat fundore. Në bazë të këtyre operacioneve shtrirja lineare e morfemave nuk shfaqet izomorlike me nyjat fundore të prodhuara nga niveli i strukturës –S. Në këtë kuadër teorik del një dallim i qartë mes elementëve radikalë dhe atyre funksionalë. Në veçanti elementët funksionalë janë të ndarë nga elementët leksikorë, për aq sa të parët mund të futen në një grup të mbyllur me veti të GU, sikurse nënvizon Embick (2000:187):

A further background assumption concerns the distinction between the functional and lexical vocabularies of a language. I will assume that functional categories merely instantiate sets of abstract syntactico-semantic features.

Një pasojë e këtij veprimi është që pasi që janë lidhjet e segmenteve që mund të lëvizin, zërthehen, shkurtohen, dukuritë që lidhen me linearizimin, mungesa e izomorfizmit mes nivelit të strukturës –S dhe nivelit PF kanë të bëjnë vetëm me elementët funksionalë. Janë këta të fundit që regjistrojnë së pari variacionin, pra morfologjitë e ndryshme që lidhen me segmente identike (Embick 2000, Embick e Noyer 2001, Harris e Halle 2005).

4.2. Një propozim i ndryshëm në kuadër të modelit minimalist.

Në realitet gjendja e përshkruar nga të dhënat e disponueshme, përfshirë edhe ato në pf. 2-3.8, ndryshon nga ajo që është paraparë nga një aplikim letrar i (41a,b) e (46), sikurse është evidente nga të dhënat e diskutuara te Bokamba (1988), Muysken (1996, 2000), për të cilët tërheqja e ‘morfemës së lirë’ duket shumë e fuqishme. Në fakt është dëshmuar mjaft mirë në studime komutacioni i brendshëm i fjalës, si në rastin e formave mikse franceze/varietet bantu Lingala e Kinshasa (Zaire) te Bokamba (1988), ilustruar në (48):

- (48) na-mi-demand-àkà... (Bokamba 1988: 38)
 ‘mrekullohem/ pyetem...’
 na- mi- demand-àkà...
 ‘unë-vetvetore- pyes-e tashme’

Në (48) baza leksikore frënge ‘demand’ kombinohet me morfemën që bën përshtatjen me subjektin të V1sh na-, me morfemën vetvetore mi- dhe me morfemën e së tashmes –àkà të Lingalishtes. Edhe MacSwan diskuton formacionet analoge, si ato në (49)

- (49) Juan está iteando su pozole (MacSwan 2005a: 7)
 Juan po ha eat-Përcjellore pozolin e tij
 ‘Juan po ha pozolin’

Megjithatë mendoj se ky lloj formacioni tregon se baza leksikore është fonologjikisht e integruar në gjuhën e morfemës fleksive. Pra, duhet të trajtohen si huazime, edhe pse të rastit. Të dhënat e shqyrtuara në pg. 2, 2.1, 3.3, 3.4, përshtaten plotësisht me këtë lloj formacioni, duke kombinuar një bazë leksikore romane me morfologjinë fleksive arbëreshe. Pra, duke iu kthyer propozimeve të MacSwan, duhet të pranojmë se në rastet si në (1)-(6), (21), (25)-(27), një kopje e secilës bazë leksikore i përket leksikut arbëresh ku përfaqëson një element të dallueshëm nga ekuivalentja e saj romane, dhe vetëm rastësisht është e ngjashme me të. Në një formë të tillë do të ketë hyrë morfologjia flektive ekuivalente.

Për më tepër, kërkimet mbi këtë pikë dalin mjaft kundërvënëse. Autorë të tjerë si Appel e Muysken (1987), Bokamba (1988), Myers-Scotton (2006) nuk e vënë një kufi të prerë mes code-switching dhe huazimeve, dallimi mes tyre del më tepër si një çështje gradimi. Jake, Myers-Scotton, Gross (2005), duke iu përgjigjur kritikave të MacSwan (2005a), vërejnë praninë e gjerë të fjalëve të përziera (mikse) të llojit me formë bazë leksikore angleze dhe morfologji swahili m-tu-evaluate ‘do të na vlerësosh’. Ata vijjnë në përfundimin që argumentimi me të cilin MacSwan (2005a,b) identifikon formacione të ngjashme me huazimet, duke përjashtuar mundësinë e code-switching të brendshëm të fjalës, është i dobët, pasi shfrytëzon veti morfosintaktike jo relevante.

Edhe të dhënat që lidhen me përzierjen te folësit dygjuhës me patologji neurolinguistike (Fabbro 1999, Perelman 1984) dokumentojnë karakterin produktiv të përzierjes brenda fjalës, ku një bazë leksikore e L_x kombinohet me morfema fleksive të L_y . Fabbro (1999) duke iu referuar Perelman-it (1984) vëren që llojet e code-mixing që dalin më shpesh te bilingët afazikë hyjnë te dukuritë e përzierjes të dëshmuara te folësit dygjuhës normalë. Bëhet fjalë në veçanti për: *Word mixing* (përzierje fjalësh brenda fjalisë), *Root and suffix mixing* (përzierje e brendshme e fjalës), futje e fjalëve të një gjuhe tjetër brenda ndërtimeve sintaksore të një gjuhe tjetër dhe aplikim i fonologjisë së një gjuhe te fjalët e një gjuhe tjetër.

Ideja e këtyre autorëve është se dukuritë e përzierjes kanë të bëjnë me kalimin nga paraqitja konceptuale paralinguistike e gjuhës në atë tërësisht linguistike (Fabbro 1999: 156), për aq sa u pa në pg. 2.2 falë faktit që dalimi mes sistemeve varet nga mënyra me të cilën janë leksikalizuar vetitë relevante për komputacionin sintaksor. Në rastin e përzierjes veprojnë kufizime që te folësit normalë, ashtu si te folësit patologjik, bllokojnë pranimin e elementeve apo vetive leksikore të një gjuhe të zëvendësuara nga elemente apo nga fjalë ekivalente të një gjuhe tjetër. Këto përfundime sjellin një hipotezë të ndryshme nga ajo e MacSwan-it (2000a, 2000b), e cila sugjeron se gjuhët e bashkë pranishme te një folës nuk kanë sisteme përfaqësimi të dallueshme, por vetëm një sistem përfaqësimi, i cili 'ka më shumë fonema, morfema, mbartje leksikore dhe rregulla sintaksore' (Paradis 1993: 282).

Zgjidhja e MacSwan-it, se rregullat që konvertojnë informacionin morfologjik në përfaqësimet fonologjike i përkasin komponentit PF del problematike si nga pikëpamja teorike, ashtu edhe nga ajo empirike. Së pari, ai flet për një ndarje mes interpretimit të pjesëve flektive dhe leksikalizimit të tyre, për të cilën Manzini e Savoia (2007) vënë në dukje papërshtatshmërinë. Ky konceptim nënkupton se paska kategori morfosintaksore të përcaktuara si të pavarura nga elementet

leksikore. Prania e rregullave të ristabilizimit në Morfologjinë e Shpërndarjes ka një efekt të mëtutjeshëm për ndarjen e leksikut funksional nga ai jofunksional, pra nga elementet që kanë një përmbajtje predikative si emrat, mbiemrat, foljet.

Në të vërtetë kemi parë se përkimi mes materialit leksikor arbëresh dhe materialit leksikor roman u përket edhe parametrave të llojit flektiv. Në shembujt (25)-(27) kemi vënë në dukje përputhjen e elementeve flektivë të klasave emërore arbëreshe dhe romane në format e së kryerës, si *-u* e VIIIshnj në *Vena*, dhe daljen e elementëve flektivëtë së kryerës me origjinë romane në format e së kryerës arbëreshe, si *-st/ft-e Vena-s*, dhe formimi më-*ir-Casalvecchio*. Në raste të tilla pra janë elementet flektivë që kanë një rol interpretues analog në formimet arbëreshe dhe romane. Këto dukuri i vënë në dyshim modelet, si ai që mbështetet nga MacSwan, të cilët bazohen në ndarjen mes elementeve leksikorë dhe atyre funksionalë. Sikurse e kemi parë, MacSwan e motivon këtë ndarje duke u nisur nga hipoteza se elementët funksionalë hyjnë te nyjat fundore të paraqitjes sintaksore vetëm në fund të derivimit, nëpërmjet rregullave të komponentit fonologjik (shih. (45), (46)). Rastet e shqyrtuara në të cilat elementët flektivë me origjinë romane kombinohen me elementët flektivë arbëreshe sugjerojnë se modeli morfo-sintaksor i MacSwan-it nuk është i përshtatshëm. Do të duhej të mendohet se edhe elementët flektivë përsëriten dy herë, në fjalorin roman dhe atë arbëresh, edhe pse derivimi gjeneron nyja fundore që kanë të njëjtat pjesë sintaksore, si në rastin e sufiksit të së kryerës-*st-/ft-* në *Vena* në (25) apo të formimit të paskajores-*ir-* në (27).

Përveç kësaj diskutimi në 3 tregon se përzierja nuk mbaron vetëm me dukuritë e huazimit e të code-switching brenda fjalës, por mund të prekë edhe aspekte të komputacionit morfosintaksor dhe të fonologjisë. Këto të dhëna tregojnë se *PF Disjunction Theorem* në (46) dhe skema e njohjes dygjuhësore në (45) imponojnë kufizime mjaft të forta. Në radhë të parë kemi parë se të njëjtat kufizime fonologjike mund të zbatohen te të dy përbërësit PF_x e PF_y , duke e dobë-

suar hipotezën e një ndarjeje të prerë mes këtyre dy niveleve. Kemi vërejtur se kalimi i elementëve leksikorë nga një gjuhë në tjetrën përdor mekanizma apo kufizime fonologjike nga të dy sistmet. Në veçanti, huazimet me origjinë romane sjellin në arbërishten e *Vena-s* vetitë fonologjike që regjistrohen në varietetin roman konvergjent (pf. 3.7). Rastet e konvergencës të shqyrtuara në 3.5 për sistemin klitik në varietetin roman të *Vena-s* mbështesin idenë se gramatikat paskan grupe leksikore të përbashkëta, duke përfshirë aty edhe grupe të kategorive funksionale. E njëjta gjë vlen për lloje të ndryshme ndërtimeve plotësuese të analizuara në 3-3.2, të cilat luajnë me elemente funksionale dhe veti fleksive që janë të përbashkëta për të dyja gramatikat. Jo rastësisht përfundimi i Gumperz dhe Wilson (1971) mbi dukuritë e konvergencës të shqyrtuara prej tyre është:

What seems to have happened in these informal varieties is a gradual adaptation of grammatical differences to the point that only morphophonemic differences (differences of lexical shape) remain (Gumperz e Wilson 1971: 155).

Një pikë interesante është se elementet leksikorë/funksionalë që kanë të bëjnë me konvergencën mes gramatikave shpesh, si në rastin e sufiksit të pjesores të diskutuar në pf. 2, marrin veti të tjera interpretative, të cilat janë të papranishme si në sitemin nga i cili ato vijnë, ashtu edhe në sistemin ku mbërrijnë. Me fjalë të tjera, konvergjenca sjell megjithatë riorganizim të gramatikës, duke shfrytëzuar dukuri që lidhen me përvetësimin gjuhësor.

Në këtë përfundim të sjellin edhe modelet e lidhjes gjuhësore të sugjeruara nga studimet afaziologjike e neurolinguistike që mbajnë një raport direkt mes flektimit dhe përbërjes konceptuale-semantike. Në veçanti, propozimet më të reja të Shapiro, Shelton e Caramazza (2000) e di Shapiro e Caramazza (2003) mbështesin një model të procesimit leksikor i cili përmban një nivel të përfaqësimit semantik-konceptual dhe një të përfaqësimit fonologjik/ortografik. Flektimi është rezultat i rregullave sintaksore që marrin informacione kategorikale që lidhen

me vetitë thelbësore (kategoria leksikore, gjinia) dhe jothelbësore, pra që varen nga konteksti sintaksor (numri, rasa):

Let us assume that when the speech system is required to produce an inflected form, at least the extrinsic grammatical properties of an inflectional morpheme (often common to a set of allomorphs) are selected by some externally derived information relating to sentence structure or semantic content. As soon as a lexeme is selected, it becomes necessary for the various allomorphs specified by this information and choose the one form that is appropriate for inflection of the lexeme. We suggest that this discrimination process is triggered by the selection of grammatical class information, which may be said to control or "coordinate" inflection. (Shapiro, Shelton e Caramazza 2000: 679)


Ky mekanizëm i analizës ndahet nga modelet e analizimit leksikor të pranuar në përgjithësi, të cilat parashohin një nivel ku elementi leksikor (lema) lidhet me vetitë e tij sintaksore, në një nivel ndërmjetësues mes nivelit të përfaqësimit semantiko-konceptual dhe nivelit fonologjik/ortografik. Modeli (*Independent network model of lexical access*), i skematizuar në (50), propozuar nga Caramazza (1997) e Miozzo e Caramazza (1997) sheh të jetë vetëm një njëjle leksikore që përkon me përmbajtjen semantike-konceptuale dhe që elementet leksikore lidhen me vetitë morfosintaksore dhe me ato fonologjike/ortografike në procesin e prodhimit/njohjes leksikore. Sikurse nënvizon Caramazza (1997) karakteristika kryesore e modelit e paraqitur në (50) është se niveli semantiko-leksikor është direkt i lidhur me atë fonologjik/ ortografik, pa një nivel ndërmjetësues që lidhet me lemat abstrakte të pajisura me informacione morfosintaksore. Sikurse thekson Caramazza (1997) një model i këtij lloji del i përshtatshëm për t'u marrë me llojet e problemeve mbi lidhjen te elementët leksikorë:

The fact that there is a direct link between the lexical-semantic and the lexeme levels provides a natural explanation for the occurrence of semantic errors only in writing or in speaking; the fact that syntactic features are represented autonomously allows a natural explanation

for the occurrence of selective deficits of grammatical classes in only one modality of output. (Caramazza 1997: 203)

Me fjalë të tjera, aktivizimi i morfologjisë varet nga informacioni semantiko-konceptual dhe lidhet me aktivizimin e përfaqësimit fonologjik/ortografik. Caramazza (1997:203) sugjeron që përfaqësimet semantiko-leksikore, sintaksore e të veçanta për modalitetin relativ me një fjalë, janë magazinuar në mënyrë të pavarur në përbërës të ndarë dhe aktivizimi i leksemave përzgjedhësendodh në pjesët gramatikore tashmë të thjeshtuara nga aktivizimi duke filluar nga përbërësi leksikor-semantik. Një model si ai në (50) nuk përjaston ndërveprimin mes informacionit morfosintaksor dhe përfaqësimit fonologjik, për aq sa kjo e fundit duhet të ketë parasysh alomorfinë, por sjell një raport direkt mes informacionit semantik dhe morfo-logjisë, në kuptimin që elementet morfologjike përfaqësojnë veti semantiko-konceptuale direkt të rëndësishme për formimin e fjalës. Në veçantifutja e elementëve flektivë kontrollohet nga një mekanizëm që ka parasysh vetitë semantike dhe të kontekstit fonologjik.

(50)




(Caramazza e Miozzo 1997: 339)

Si përfundim, mund të mendojmë se futja e materialit flektiv u përgjigjet kufizimeve të dhëna në (50), ndërkaq kjo përkon me vetitë semantike të nivelit leksikor-semantik.

Sipas Manzini e Savoia (2007) raporti mes elementeve leksikore dhe strukturave sintaksore mund të përmblihdhet në një kuadër teorik më të thjeshtë në të cilin strukturat gjuhësore janë të projektuara nga elementët leksikorë pa ndonjë manipulim të mëtutjeshëm dhe rregullat që realizojnë flektimin i përkasin përbërësit sintaksor. Supozojmë pra se në një gramatikë bilinge bazat leksikore identike mes dialektit roman dhe arbërishtes janë të pranishme vetëm një herë në gramatikën e folësit dhe futja e një baze leksikore që i përket L_x nuk e përjashton kombinimin mes morfemave flektive të L_y . I vetmi kufizim i vlefshëm mbetet ai i interpretimit të formës, në bazë të së cilës formës mix-lingue duhet t'i përkasë një interpretim adekuat për kontekstin morfo-sintaksor në të cilin ajo futet. Ky përfundim është koherent me një kuadër ngushtësisht minimalist në të cilin vetitë sintaksore janë të projektuara nga elementët leksikorë dhe nuk janë elementët leksikorë ata që kënaqin vetitë sintaksore të gjeneruara në mënyrë të pavarur.

Veçanërisht, në rastin e gramatikave të përziera sikurse ato që kemi shqyrtuar, huazimet leksikore të përfshira në një gjuhë (në këtë rast në arbërishte) mund të mendohen sikur i përkasin të njëjtit fjalor të gjuhës së kontaktit (dialektit lokal) ndërsa ndarja mes dy sistemeve përqendrohet mbi parametrat morfosintaksore që janë në bazë të komputacioneve sintaksore të ndara. Në të vërtetë, diskutimi në pf. 3 tregoi se përkimet janë më të hollësishme dhe prekin si leksikun, përfshirë edhe sistemet flektive, ashtu edhe vetitë strukturore, si morfologjia e foljes dhe e emrit, të vlefshme për komputacionin sintaksor. Strukturat në (51) ilustrojnë strukturën e një emri, në (i) dhe të një foljeje, në (ii), me baza leksikore romane dhe fleksion roman/arbëresh.



Vetitë morfosintaksore të vareteteve arbëreshe të analizuara, të cilat i kemi lidhur me përzierjen dhe me proceset e hibridizimit, mund të shihen si rezultat i proceseve të riorganizimit leksikor dhe morfologjik lidhur me dygjuhësinë dhe përvetësimin e gjuhës. Një përfundim i ngjashëm mund të zgjerohet edhe te përbërësi fonologjik, në kuptimin që, sikurse e kemi parë, prania e elementëve të përbashkëta leksikore ka sjellë reduktime prozodike të reja.

5. Disa mendime përmbyllëse.

Dukuritë e studiuara dhe analizat e parashtruara na shpjen te disa propozime të fundit të përmbledhjes së paradigmës teorike (Manzini e Savoia 2007, Culicover e Jackendoff 2005, 2006, Jackendoff 2002). Në veçanti, diskutimi lidhur me modelin e MacSwan-it (1999, 2005a, 2000b) në pf. 4 bazohet mbi një konceptim të raportit mes vetive leksikore dhe interpretimit që risheh në mënyrë substanciale qasjet gjenerative tradicionale. Perspektiva teorike e Manzini e Savoia (2005, 2007), e vazhduar në këtë punë, merr një interpretim më të ngushtë të kuadrit minimalist, që përjashton lëvizjen dhe kategoritë abstrakte, dhe bazohet mbi një model të paraqitjes së lidhjeve sintaksore.

Në një optikë të ngjashme lidhen kritikrat që Culicover e Jackendoff (2005, 2006) ia bëjnë kuadrit tradicional të gramatikës gjenerative kur merret me përkthimin direkt të vetive interpretuese në terma të kategorive dhe parametrave sintaksorë ('Interface Uniformity'). Këta autorë theksojnë si gjenden mjaft të dhëna në mbështetje të hipotezës që sintaksa nuk e përfshin semantikën dhe që kuptimi është:

the product of an autonomous combinatorial capacity independent of and richer than syntax', 'largely coextensive with thought' (Culicover e Jackendoff 2006: 416).

Ky përfundim në veçanti bën eliminimin e kategorive funksionale abstrakte nga komputacioni sintaksor, roli i vetëm i të cilit është pikërisht transferimi në sintaksë i pjesëve të interpretimit. Jackendoff (2002) përveç kësaj mbështet homogjenitetin e leksikut funksional dhe të atij jofunksional:

[...] the correct conception is taken to be the one traditionally associated to the non-functional lexicon: there is a conceptual and grammatical space to be lexicalized and variation results from the different partition of that space. This approach, as applied to the functional lexicon, leads to the truly new results: elimination of categories that do not play any role in organizing the parametric space etc.

Vetitë semantike të elementëve leksikorë janë ballafaqimet reale për interpretimin:

[...] the function of lexical items is to serve as interface rules, and the lexicon as a whole is to be regarded as part of interface components. (Jackendoff 2002: 131)

Duke përjashtuar analizën e elementeve abstrakte si pjesëzat apo kategoritë boshe që shërbejnë vetëm për të krijuar derivimin sintaksor, Manzini e Savoia (2005, 2007) arrijnë të një model i cili nuk parasheh ndarjen mes kategorive funksionale dhe elementëve të tjerë leksikorë. Komputacioni sintaksor ndërtohet pra në bazë të vetive semantike të regjistruara nga elementët leksikorë dhe nuk i projekton domoshmërisht të gjithë përbërësit e asaj qëne e quajmë kuptimi i fjalisë. Ku kuadër teorik ka sjellë një rishikim kritik tëdisa çështjeve themelore të modelit të MacSwan-it në pf. 4, që, sikurse e pamë, riprodhon një model të gramatikës bazuar mbi ndarjen mes kategorive funksio-

nale dhe atyre leksikore, që përkojnë me përbërës dhe derivime të veçanta.

Idea e zhvilluar në këto faqe është që variacioni linguistik rrjedh nga rindarjet e ndryshme të hapësirës konceptuale (përcaktuar nga Gramatika Universale) që regjistrohen nga elementët leksikorë. Variacioni pra varet në një analizë të fundit nga vetitë leksikore të elementëve. Huazimet dhe sjellja e tyre morfosintaksore na shpjen sërish te kjo perspektivë, në kuptimin që huazimet dhe në përgjithësi dukuritë e përzierjes përkojnë me mënyra të leksikalizimit të hapësirës konceptuale më shumë sesa me reduktimin te idiosinkracitë tëndonjë grupi të veçantë thëniesh (*lingua esterna*) në situata të kontaktit. Huazimi dhe përzierja nuk përkojnë pra me një transpozim mekanik të strukturave morfosintaksore dhe leksikore, por kanë të bëjnë me mekanizma kognitivë të përgjithshëm që lidhen me ndërveprimin mes sistemeve të të menduarit dhe atij senso-motorik dhe vetive komputacionale. Në këtë kuadër hyjnë edhe huazimi dhe riorganizimi fonologjik, të analizuara në pg. 3.7 e 3.8, që përfaqësojnë rezultatin e përvetësimit të vetive dhe proceseve që përbërësi fonologjik përvetëson nga sistemi senso-motorik.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Altimari, F. (1991), *Alcune osservazioni sul passato presuntivo nell'arbëresh*, në A. Landi e P. Del Puente (nën kujdesin e), *La lingua albanese nell'Italia meridionale. Studi e prospettive*, Università degli Studi di Salerno: 53-65.
- Altimari, F. (1994) *La distribuzione del passato "presuntivo" nell'albanese d'Italia*, në F. Altimari e L. M. Savoia (nën kujdesin e), *I dialetti italo-albanesi*, Roma, Bulzoni: 211-221.
- Appel R., P. Muysken (1987), *Language contact and bilingualism*, London, Arnold.
- Baker M. (2003), *Gli atomi del linguaggio*, Milano, Hoepli.
- Bakker P. (1994), *Pidgins*, në J. Arends, P. Muysken, N. Smith (nën kujdesin e), *Pidgins and creoles. An Introduction*, Amsterdam, Benjamins: 25-39.
- Bakker P. (2003), *Mixed languages as autonomous systems*, në Y. Matras, P. Bakker (nën kujdesin e), *The mixed language debate*, Berlino, Mouton De Gruyter: 107-150.
- Bakker P. e P. Muysken (1994), *Mixed languages and language intertwining*, në J. Arends, P. Muysken, N. Smith (nën kujdesin e), *Pidgins and creoles. An Introduction*, Amsterdam, Benjamins: 41-52.
- Baldi B. e L. M. Savoia (2006), *Perché barbari? Lingua, comunicazione e identità nella società globale*, Roma, Bulzoni.
- Bibbò A. (1974), *Romanzo e albanese nei dialettofoni di Casalvecchio (FG), Chieuti (FG), Greci (AV)*, në *Bilinguismo e diglossia in Italia*, CNR-Centro di Studio per la Dialettologia Italiana, Pisa, Pacini: 15-22.
- Bokamba E. G. (1988), *Code-mixing, language variation, and linguistic theory*, në *Lingua* 76: 21-62
- Bolognari M. (1986), *Profili antropologici*, në F. Altimari, M. Bolognari, P. Carrozza 1986, *L'esilio della parola*, Pisa, ETS: 33-113.
- Camaj M. (1974), *Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell'Italia meridionale*, në *Bilinguismo e diglossia in Italia*, CNR-Centro di Studio per la Dialettologia Italiana, Pisa, Pacini: 5-13.
- Caramazza A. (1997), *How many levels of processing are there in lexical access?*, në *Cognitive neuropsychology* 14.1: 177-208.
- Caramazza A. e M. Miozzo (1997), *The relation between syntactic and phonological knowledge in lexical access: evidence from 'the-tip-of-the-tongue' phenomenon*, në *Cognition* 64: 309-343.
- Chomsky N. (1986), *Knowledge of Language. Its nature, Origin, and Use*, New York, Praeger.

- Chomsky N. (1995), *The Minimalist Program*, Cambridge Mass., The MIT Press.
- Chomsky N. (2000a), *Minimalist inquiries: The framework*, në R. Martin, D. Michaels, J. Uriagereka (nën kujdesin e) *Step by Step*, Cambridge, Mass., The MIT Press.
- Chomsky N. (2000b), *New Horizons in the Study of Language and Mind*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Chomsky N. (2001a), *Derivation by phase*, në M. Kenstowicz (nën kujdesin e) *Ken Hale: A life in language*, Cambridge, Mass., The MIT Press: 1-52
- Chomsky N. (2001b), *Su natura e linguaggio*, Università degli studi di Siena.
- Culicover P. e R. Jackendoff (2005), *Simpler Syntax*. Oxford, Oxford University Press.
- Culicover P. e R. Jackendoff, (2006), *The simple syntax hypothesis*, në *Trends In Cognitive Sciences* 10, 9: 414-418.
- Demiraj Sh. (1986), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 8 nëntori, Tirana.
- Demiraj Sh. (2002), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e shkencave e shqipërisë, Tiranë.
- Embick D. (2000), *Features, Syntax, and Categories in the Latin Perfect*, në *Linguistic Inquiry* 31, 2: 185-230.
- Embick D. e R. Noyer (2001), *Movement operations after syntax*, në *Linguistic Inquiry* 32, 4: 555-595.
- Fabbro F. (1999), *The neurolinguistics of bilingualism, An introduction*, Hove, Psychology Press,
- Ferguson Ch. A. (1971), *Absence of copula and the notion of simplicity: a study of normal speech, baby talk, foreigner talk, and pidgins*, në D. Hymes (nën kujdesin e), *Pidginization and creolization of languages*, Cambridge, Cambridge University Press: 141-150.
- Finocchiaro G. (2002), *Variabili semantiche, grammaticali e fonologiche nel processo di produzione dei clittici accusativi*, në *Quaderni del Laboratorio di Linguistica* 3: 273-284.
- Gambarara D. (1980), *Parlare albanese nell'Italia unita*, në *Zjarri* 27: 49-67.
- Gleitman L. R., C. Kimberly, R. Nappa, A. Papafragou e J. C. Trueswell (2005), *Hard Words*, në *Language Learning and Development*, 1.1: 23-64.
- Graffi G. (1998), *Sulla struttura di un balcanismo sintattico*, në G. Bernini, P. Cuzzolin, P. Mulinello (nën kujdesin e), *Ars linguistica*, Roma, Bulzoni: 247-262.
- Gumperz J. J. e R. Wilson (1971), *Convergence and creolization. A case from the*

- Indo-Aryan/Dravidian Border in India*, në D. Hymes (nën kujdesin e), *Pidginization and creolization of languages*, Cambridge, Cambridge University Press: 151-167.
- Halle M. e Marantz A. (1993), *Distributed morphology and the pieces of inflection*, në K. Hale, S. J. Keyser (nën kujdesin e), *The view from Building 20*, Cambridge Mass., The MIT Press.
- Halle M. e Marantz A. (1994), *Some Key Features of Distributed Morphology*, në A. Carnie, H. Harley, T. Bures (nën kujdesin e), *Papers on Phonology and Morphology*, në *MIT Working Papers in Linguistics* 21: 275-288.
- Harris J. (1994), *English Sound Structure*, Oxford, Blackwell.
- Harris J. e M. Halle (2005), *Unexpected Plural Inflections in Spanish: Reduplication and Metathesis*, në *Linguistic Inquiry* 36, 2: 195-222.
- Hauser M. D. e N. Chomsky, W. T. Fitch (2002), *The faculty of language: what is it, who has it and how did it evolve?*, në *Science* 298: 1569-1579.
- Jake J. e C. Myers-Scotton, S. Gross (2002), *Making a minimalist approach to code-switching work: adding the matrix language*, në *Bilingualism: Language and Cognition* 5, 1: 69-91.
- Jake J. e C. Myers-Scotton, S. Gross (2005), *A response to MacSwan (2005): Keeping the Matrix Language*, në *Bilingualism: Language and Cognition* 8, 3: 271-276.
- Jakendoff R. (2002), *Foundations of language*, Oxford, Oxford University Press.
- Kaye J. e J. Lowenstamm e J.-R. Vergnaud (1990), *Constituent structure and government in phonology*, në *Phonology* 7:293-231.
- MacSwan J. (1999), *A minimalist approach to intrasentential code switching*, New York, Garland Press.
- MacSwan J. (2000), *The architecture of the bilingual language faculty: evidence from intrasentential code switching*, në *Bilingualism: language and cognition* 3, 1: 37-54.
- MacSwan J. (2005a), *Codeswitching and generative grammar: A critique of the MLF model and some remarks on "modified minimalism"*, në *Bilingualism: language and cognition* 8, 1: 1-22.
- MacSwan J. (2005b), *Précis of a Minimalist Approach to intrasentential Code Switching*, në *Italian Journal of Linguistics. Rivista di Linguistica* 17, 1: 55-92.
- Manzini, M. R. e L. M. Savoia (2004), *The nature of the agreement inflections of the verb*, në *MIT Working Papers in Linguistics* 47: 149-178
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2005), *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi generativa*, 3 voll., Alessandria, Edizioni dell'Orso.

- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2007), *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian dialects*, London, Routledge.
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2008), *Worknotes on Romance morphosyntax - Apunti di morfosintassi romanza*, Alessandria, Edizioni dell'Orso.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2012). *Non-active voice in Albanian: Implications for the theory of movement*, në Leonardo M. Savoia, *Studi sulle varietà arbëreshe*, Rende (CS): Università della Calabria: 111-149.
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2011), *(Bio)linguistic variation: have/ be alternations in the present perfect*, në A. M. Di Sciullo (nën kujdesin e), *Biolinguistics*, Oxford University, Press: 222-265.
- Marantz A. (1997), *No escape from syntax: Don't try morphological analysis in the privacy of your own lexicon*, në A. Dimitriadis, L. Siegel, et al. (nën kujdesin e), *University of Pennsylvania Working Papers in Linguistics*, 4.2: 201, 225.
- Matras Y. (2000), *Mixed languages: a functional-communicative approach*, në *Bilingualism: Language and Cognition* 3, 2: 79-99.
- Matras Y. e P. Bakker (2003), *The study of mixed languages*, në Y. Matras, P. Bakker (nën kujdesin e), *The mixed language debate*, Berlino, Mouton De Gruyter: 1-20.
- Milroy L. e P. Muysken (1995), *Introduction: code-switching and bilingualism research*, në L. Milroy, P. Muyske (eds), *One speaker, two languages: Cross-disciplinary perspectives on code-switching*, Cambridge, Cambridge University Press: 1-14.
- Muysken P. (1996), *Media Lengua*, në S. G. Thomason (nën kujdesin e), *Contact Languages. A wider perspective*, Amsterdam, Benjamins: 365-426.
- Muysken P. (2000), *Bilingual speech*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Myers-Scotton C. (1992), *Codeswitching as a mechanism of deep borrowing, language shift, and language death*, në M. Brenzinger (nën kujdesin e), *Language death in East Africa*, Berlino, Mouton De Gruyter: 31-58.
- Myers-Scotton C. (2003), *What lies beneath: Split (mixed) languages as contact phenomena*, në Y. Matras, P. Bakker (nën kujdesin e), *The mixed language debate*, Berlino, Mouton De Gruyter: 73-106.
- Myers-Scotton C. (2006), *Multiple voices. An introduction to bilingualism*, Oxford, Blackwell.
- Nichols J. (1992), *Linguistic diversity in space and time*, Chicago, The University of Chicago Press.
- Perecman E. (1984), *Spontaneous translation and language mixing in a ploglot aphasic*, në *Brain and Language* 23: 43-53.

- Pinker S. e R. Jackendoff (2005), *The faculty of language: What's special about it?*, në *Cognition*, 95, 2: 201-236.
- Poplack S. (1980), 'Sometimes I'll start a sentence in Spanish y termino en Español': towards a typology of code switching, në *Linguistics* 18: 581-618.
- Renfrew C. (1989), *Archeologia e linguaggio*, Roma-Bari, Laterza.
- Rizzi L. (1997), *The fine structure of the left periphery*, në L. Haegeman (nën kujdesin e) *Elements of grammar*, Dordrecht, Kluwer, 281-337.
- Roberts I. e Roussou A. (2003), *Syntactic Change*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Romaine S. (1995), *Bilingualism*, Oxford, Blackwell.
- Savoia L.M. (1987), *Teoria generativa, modelli fonologici e dialettologia. La propagazione di /u/ in una varietà lucana*, në *Rivista Italiana di Dialettologia*, 11: 185-263.
- Savoia L.M. (1989), *Alcune caratteristiche del causativo arbëresh*, në *Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del 2° Congresso Internazionale*, Comune di Piana degli Albanesi: 363-420.
- Savoia L.M. (1993), *Condizioni fonologiche e morfosintattiche della coincidenza fra flessione media e attiva nei dialetti arbëreshë di Barile e di Ginestra*, në *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze*, 4: 133-162
- Savoia L. M. (1994), *Parametrical variation in prosodic licensing: evidence from Italo-Albanian dialects*, në *Rivista di Grammatica generativa*, 20: 105-141.
- Savoia, L.M. (2005), *Armonizzazioni vocaliche in alcune varietà romanze*, në M. Biffi, O. Calabrese e L. Salibra (nën kujdesin e), *Italia linguistica: discorsi di scritto e di parlato. Nuovi studi di linguistica italiana in onore di Giovanni Nencioni*, Siena, Protagon: 217-233.
- Savoia L. M. e M. Maiden (1997), *Metaphony*, në M. Maiden e M. Parry (nën kujdesin e), *The Dialects of Italy*, London, Routledge: 15-25
- Savoia L. M. e M. R. Manzini (2000), *Variazione linguistica, disturbi del linguaggio e Grammatica Universalenë* *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze* 10: 13-30.
- Savoia L. M. e M. R. Manzini (2007), *Variazione sintattica nel costrutto ausiliare arbëresh. La variazione come problema teorico*, në C. Consani, P. Desideri (nën kujdesin e), *Minoranze linguistiche. Prospettive, strumenti, territori*, Roma, Carocci: 85-102
- Shapiro K. e J. Shelton, A. Caramazza (2000), *Grammatical class in lexical production and morphological processing: evidence from a case of fluent aphasia*, në *Cognitive neuropsychology*, 17.8: 665-682.

- Shapiro K. e A. Caramazza (2003), *The representation of grammatical categories in the brain*, në *Trends in cognitive sciences*, 7.5: 201-206.
- Schiller N.O. e A. Caramazza, (2002), *The selection of grammatical features in word production: the case of plural nouns in German*, në *Brain and Language*, 81: 342-357.
- Schiller N.O. e A. Caramazza, (2003), *Grammatical feature selection in noun phrase production: Evidence from German and Dutch*, në *Journal of Memory and Language*, 48: 169-194.
- Turano G. (1995), *Dipendenze sintattiche in albanese*, Padova, Unipress.
- Villar F. (1997), *Gli indoeuropei e le origini dell'Europa: lingua e storia*, Bologna, Il Mulino.
- Whinnom K. (1971), *Linguistic hybridization and the 'special case' of pidgins and creoles*, në D. Hymes (nën kujdesin e), *Pidginization and creolization of languages*, Cambridge, Cambridge University Press: 91-115.

MIKROVARIACIONI NË MORFOSINTAKSËN E SINTAGMËS EMËRORE NË ARBËRISHTE

Kjo pjesë analizon disa parametra që karakterizojnë sistemin e rasës dhe të përshtatjes të sintagmës emërore në varietetet: *Vena di Maida*, *Ginestra* e *Casalvecchio*. Nga ky krahasim na del një variacion i thellë të mekanizmat morfosintaksorë, që lidhet në mënyrë të veçantë me procesin e përvetësimit të gjuhës në kushtet e dygjuhësisë. Sikurse e pamë në kap. 1, kontakti dhe dygjuhësiadilaekt roman-shqipe furnizojnë dhe janë në bazë të dukurive të variacionit që prekin përbërës të ndryshëm të gramatikës arbëreshe. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë variacionin që del në rastet e huazimeve mbiemërore dhe në sistemin eptimor të mbiemrit. Hipoteza e diskutuar në kap.1 supozon që variacioni gjuhësor të jetë një pasqyrim i organizimeve leksikore pjesërisht të ndryshme, më saktësisht përkon me mënyra të ndryshme me të cilat elementët leksikorë, përfshirë edhe morfologjinë, realizojnë një hapësirë konceptuale universale (Manzini e Savoia 2007); diskutimi të Baldi e Savoia 2008). Edhe hapësira fonetike del e lidhur ngushtë me aftësinë e të folurit dhe variacioni që i përket përkon me mënyrën me të cilën elementët leksikorë vënë në veprim mekanizmat prozodikë që ato i përmbajnë.

Sipas kësaj perspektive, elementët leksikorë të një gjuhe sjellin kategori konceptuale mbi të cilat ndërtohet komputacioni sintaksor, duke përcaktuar kështu variacionin, sikurse është teorizuar tashmë nga Chomsky (2000: 120):

The I-language consists of a computational procedure and a lexicon. The lexicon is a collection of items, each a complex of properties (ca-

lled “features”), such as the property “bilabial stop” or “arti-fact” ... There is reason to believe that the computational system is invariant, virtually. There is some variation at the parts closely related to perception and articulation; ... That aside, language variation appears to reside in the lexicon. One aspect is “Saussurean arbitrariness,” the arbitrary link between concepts and sounds... The linkage of concept and sound can be acquired on minimal evidence, so variation here is not surprising. However the possible sounds are narrowly constrained, and the concepts may be virtually fixed... Beyond such factors, variation may be limited to formal aspects of the language – case of nouns, verbal inflection, and so on.

Variacioni pra nuk është arbitrar, por pasqyron limitet që caktohen nga aftësia jonë e të folurit, veçanërisht nga sistemi konceptual dhe nga sistemi fonologjik.

Më saktësisht, qasja e aplikuar këtu ndjek propozimet e Manzini e Savoia (2007), të cilat i rishikojnë disa pika të paradigms chomskiane, të cilat na tërheqin vëmendjen te disa çështje konceptuale të Jackendoff (2002), Culicover e Jackendoff (2005, 2006) (diskutimi në kap.1). Një çështje themelore, që del nga fragmenti i Chomsky-t i sjellë më sipër, ka të bëjë me ndarjen mes leksikut funksional dhe leksikut jofunksional që konfiguror shumë nga parametrat formalë të gramatikës gjenerative, përfshirë edhe mënyrën e të konceptuarit të derivimit sintaksor. Në qasjet tradicionale gjenerative komputacioni sintaksor vepron mbi një bashkësi të pandryshueshme kategorish funksionale edhe pse jo të leksikalizuara në mënyrë të dukshme. Të zënë e një niveli me vetitë semantike abstrakte jep mundësinë e inkorporimit në gramatikë, në formën e kategorive jo të realizuara sipërfaqësisht, aspekte themelore të procesit interpretues. Manzini e Savoia (2007) vënë në dukje pamjaftueshmëritë që e bëjnë të papërshtatshme këtë qasje nga këndvështrimi teorik duke tërhequr vëmendjen te dukuritë normale të mikrovariacionit gjuhësor, dhe, në veçanti, kritikojnë hipotezën që kategoritë funksionale të kenë një status të ndryshëm nga kategoritë e tjera leksikore. Modeli i propozuar nga ata pranon që kategoritë leksikore të vlefshme për sintaksën e një gjuhe për-

kojnë me ato që realizohen në mënyrë të dukshme nga leksiku, duke përjashtuar kështu një nivel analize që përmban kategori jo të leksikalizuara. Në këtë kornizë kaq të ngushtë, variacioni varet nga ata përbërës konceptualë që leksiku i bën të pranueshëm për sintaksën. Mekanizmi i përvetësimit gjuhësor paraqet pra zinxhirin që lidh vetitë gjuhësore universale me variacionin leksikor.


Varietetet arbëreshe në *Ginestra*, *Casalvecchio* e *Vena* karakterizohen nga një përzierje e fortë me dialektin roman, sikurse është theksuar në paragrafët e mëparshëm. Në veçanti, morfologjia e hua-zimeve mbiemërore e ilustruar në (5) në pf. 1.3.1. nuk është e vetmja dukuri e riorganizimit strukturor që prek sintagmën emërore. Sikurse do ta shohim, ka veti të tjera të mbiemrit, më pak të dukshme, por jo më pak të rëndësishme, që duket se vijnë nga kontakti me gramatikën romane. Përveç kësaj, tërësia e dukurive që lidhen me mbiemrin përkon me një situatë mikrovariacioni mes gramatikave, e rëndësishme nga këndvështrimi deskriptiv dhe teorik.

Shpjegimi i sjelljes së mbiemrave kërkon një analizë të përshtatshme të sintagmës emërore. Do të përqendrohemi te organizimi morfosintaksor i emrit dhe i mbiemrit, mbi dukuritë e përshtatjes së rasës që karakterizojnë varietetin arbëresh të shqyrtuar, duke mbajtur parasysh se në përgjithësi varietetet arbëreshe, përfshirë edhe standardin, paraqesin sisteme të ngjashme.

1. Struktura e sintagmës emërore

Modeli teorik i propozuar nga Manzini e Savoia (2004, 2005, 2007) në kornizën e teorisë gjenerative pranon se është e njëjta bashkësi kategorish që qëndron në bazë të strukturave sintaksore (fjalía, sintagma) dhe të strukturës së brendshme të elementëve leksikorë. Sipas këtij modeli, elementët predikativë në sintaksë, si folja dhe emri, projektojnë një sërë pozicionesh argumentale $D(\text{eterminer}) = (Determinant)$, $Q(\text{uantifier}) = (Kuantifikues)$, $P(\text{erson}) = (Vetë)$,

N(oun) = (*Emër/ argument i brendshëm*), duke krijuar një strukturë si në (1), ku I(nflection) = (*Fleksioni*), zë pozicionin kryesor të projektimit të frazës apo të sintagmës emërore dhe elementi leksikor (folje apo emër/ mbiemër) leksikalizon veçoritë funksionale të frazës apo të sintagmës emërore. Pozicionet D, Q, P, N përcaktojnë hapësirën e tij (të projektimit).




Në (1) F përkon me pozicionin që lidhet me ngjarjen/gjendjen e gjërave që sillen nga folja apo nga emri/mbiemri, kategoria D përkon me vetitë referenciale që përcaktojnë subjektin e fjalisë ose barazvlerësen e tij në sintagmën emërore, që mund të identifikohet për shembull me përcaktuesin në gjuhën romane. D është pra një pozicion që lidhet si me vetitë e shquarsisë (subjekt i shquar, njëj shquese, flektim i shquar etj), si edhe me vetitë kuantifikuese (subjekte të pashquara, kuantifikues, flektim i pashquar/shumës etj). Kategoritë P, Q e N leksikalizojnë vetitë referenciale që përcaktojnë argumentin e brendshëm të predikatit (argumentin e brendshëm të foljes, të vetmin argument të emrave/mbiemrave). Mund ta mendojmë rendin hierarkik në (1) si një mënyrë për të paraqitur prurjen e elementëve, në kuptimin që, për shembull, vetitë referenciale/kuantifikuese të subjektit e marrin predikatin (folje e objekt) duke e kuantifikuar mbi ngjarjen dhe mbi argumentin e brendshëm.

Përveç pozicionit të shënuar me F, janë të gatshme edhe pozicione të tjera për futjen e elementëve leksikorë, që në fjali përkrijnë

me pozicione interpretuese që lidhen me modalitetin, Fokusin etj, (Rizzi, 1997), çdo njëra prej të cilave projekton të gjithë zhinxhirin e pozicioneve emërore. Edhe në rastin e emrit/mbiemrit duhet të hipotetizojmë, përveç pozicionit që lidhet me statusin e gjërave të denotuar nga emri/ mbiemri, edhe pozicione qëllimore/modale që përkojnë me kuantifikimin e ngjarjes/gjendjes së gjërave, të treguar skematikisht në (1) nën etiketën $C_{I(\text{ntension})}$ (Complementizer/ Introdutori ilokutiv /modal). Analogjikisht, duhet të mendojmë që F zë një domen të ulët, të projektuar mbi elementin leksikor.

Manzini e Savoia (2004, 2005, 2007) e aplikojnë këtë analizë në varietetet romane. Në bazë të kësaj në një sintagmë emërore si *la macchina* ‘makina’ in (2), formativi flektiv zë një pozicion D, ndërsa emri leksikalizon pozicionin F të sintagmës. Emri, nga ana e tij, është i analizueshëm në një strukturë në të cilën baza leksikore, që tregohet me $\sqrt{\quad}$ (rrënjë), e cila shpreh përmbajtjen predikative, kombinohet me fleksionin e gjinisë dhe numrit, pra me *-a* të *macchina*, që në varietetet romane mund të analizohet si një element i klasës emërore që bashkëvepron për të fiksuar referuesin e emrit. Sikurse tregohet në (2), flektimi tregohet me kategorinë N e lidhet me argumentin e brendshëm të emrit. Emri *macchina* projekton pozicionet e tjera të nyjës romane. Manzini e Savoia (2005) dalin në përfundimin se rendi interpretativ sugjeron që pozicioni i për-shtatshëm i futjes së nyjës romane është ai i pozicionit C_1 për aq sa lidhet me vetitë kuantifikuese, sikurse ilustruot në (2).



Qasja klasike gjenerative e shpjegon përshtatjen' si rezultat të kontrollit të pjesëzave të gjinisë, numrit (dhe rasës), që e bën të nevoj-

shme lëvizjen, të paktën në Formën Logjike, për të kënaqur këtë kërkesë. Në të kundërt, sipas Manzini-t e Savoia-s (2005, 2007), duket më interesante dhe më bindëse të merret përshtatja, në rast të veçantë mes elementëve të ndryshme brenda sintagmës emërore, pra në (2) nyja dhe flektimi, si veti relevante të përbashkëta. Sipas kësaj perspektive, përshtatja paraqet kushtin paraprak për identifikimin e pozicioneve D/N të sintagmës, të cilat interpretohen duke iu referuar të njëjtit individ, atij që përbën të vetmin argument të emrit.

Analiza në (2) nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike edhe për emrin në shqipe. Në të vërtetë, edhe në sistemin emëror të shqipes klasa leksikore e emrave të fafesisë del me nyja të përparme, ashtu sikurse një lloj fleksioni me veti të klasës emërore të përfrueshme me ato të gjuhës romane. Megjithatë, pika thelbësore është se, për dallim nga sistemi roman, në varietetet e shqipes shfaqet një sistem flektimi i emëror, i cili i regjistron vetitë e rasës dhe të shquarsisë që në gjuhët romane shprehet me përcaktues dhe me përemra klitikë (që në fakt identifikohen në serinë *l-*).

1.1. Paradigmat emërore në varietetet e shqipes

Në varietetet e shqipes, përfshirë edhe standardin, emrat kanë një paradigmë të shquarsisë e një të pashquarsisë. Forma e pashquar e emrit nuk paraqet flektim të rasës emërore dhe kallëzore, ndërsa në shumë varietete paraqet një fleksion të veçantë të rasave të zhdrejta (Solano 1972, Camaj 1984; Giusti e Turano 2007). Në veçanti, te emërorja dhe kallëzorja flektimi emëror kombinon vetitë e rasës dhe të shquarsisë. Në kombinim me një përcaktues, një përemër dëftor apo një nyjë joshquese, ndërtohet forma e pashquar e emrit, që, përveç se te Rasa e zhdrejtë, nuk e regjistron rasën që në fakt regjistrohet te përemri dëftor. Prandaj vetitë e rasës emërore/ kallëzore dhe të shquarsisë paraqiten te emri ose te përcaktuesi, por jo mbi të dy. Përshtatja mes emrit dhe përcaktuesit ruan veçanërisht në këto kontekste vetitë e klasës emërore (gjinia) dhe të shumësit. Kjo shpërndarje

është ilustruar në (3) për njëjësin dhe në (4) për shumësin; nga ilustrimi është përjashtuar rrjedhorja, pjesërisht i ruajtur në modifikimin emërore në disa varietete arbëreshe (Giusti e Turano 2007). Të dhënat janë ndarë në bazë të konteksteve në të cilat janë realizuar sintagmat emërore: *e pashquar-emër* në (a), *dëftor-emër* in (b), *emër i shquar* në (c). (d) përfshin shembuj eptimi të emrave neutralë, emra të masës. (i) përkon me sintagmën emërore subjekt të *erθ/ erðə(rə)* ‘erdhi/ erdhën’, (ii) përkon me sintagmën emërore objekt të *pε* ‘pashë’, (iii) përkon me sintagmën emërore dhanore të *ðe* ‘thashë’.

Analizojmë sistemin e varieteteve të marra në shqyrtim. Paradigma e pashquar nuk parasheh eptim të specializuar të emërores dhe të kallëzores. Në kontekste të subjektit dhe objektit në (3i,ii) emri paraqet formën bazë që përfshin, në disa grupe leksikore, eptimin e klasës emërore (femërore), si *-ein matʃ-ε* ‘mace’ në *Vena*, ose *-a* in *matʃ-a* në *Casalvecchio*. Në kontekstet dhanore njëjës në (3iii) në varietetin e *Vena-s* në mashkullore del *-i/u-çə*, ndërsa në femërore alternohet mes formës bazike në kombinim me dëftorin në (3iii.a) dhe formës me eptim të specializuar *-(ε)-jε* në kombinim me kuantifikuesin e pashquar në (3iii.b). Në këto kontekste në varietetin e *Ginestra-s* emri del gjithmonë në trajtën e pashquar.

Paradigma e shquar përfshin eptime që kombinojnë interpretimin e rasës, interpretimin e shquar dhe referimin e klasës emërore. Në veçanti, emërorja njëjës është morfologjizuar nga flektimi i specializuar *-i/-u* për mashkulloren dhe *-a* për femëroren, si në (3i.a); *-u* është përzgjedhur nga një bazë leksikore që mbaron me velare ose me zanore. Në *Vena* kallëzorja njëjës në (3ii.a) është leksikalizuar nga flektimi *-i/u-n(ə)* e *-ə-n(ə)* respektivisht për mashkulloren dhe për femëroren. Dhanorja njëjës në (3iii.a) është leksikalizuar nga flektimi *-i/u-t(ə)* për mashkulloren dhe *-ə-s(ə)* për femëroren. Në *Casalvecchio* kallëzorja merr *-i-n* në mashkullore njëjës, *-ə-n* në femërore njëjës; dhanorja/ gjinorja paraqet *-i-t* al mashkullore njëjës, *-(ə)-s* al femërore njëjës. Në *Ginestra* kallëzorja merr *-ə-n(ə)* në mashkullore dhe në

femërore njëjës; dha-norja/ gjinorja del me -ə-n(ə) mashkullore njëjës, -ə-s(ə) në femërore njëjës.

(3) Ginestra

- i. Emërore njëjës: kontekstet γerði - Subjekt 'erdhi Subjekt'
- a. jə burə / jə vaizə
një burrë / një vajzë
- b. ai burə / ajo vaizə
ai burrë / ajo vajzë
- c. bur-i / vaiz-a
burri / vajza
- ii. Kallëzore njëjës: kontekstet pɛjə - Objekt 'pashë Objekt'
- a. jə burə / jə vaizə
një burrë / një vajzë
- b. atə bur / atə vaiz
atë burrë / atë vajzë
- c. bur-ə-nə / vaiz-ə-nə
burrin / vajzën
- iii. Dhanore njëjës: kontekstet ja ðejə - Dhanore 'ia dhashë Objektit'
- a. jəi-ti burə / jəi-ti vaizə
një burri / një vajze
- b. atei-ti burə / asa-jə vajzə
atij burri / asaj vajze
- c. bur-ə-tə / vajz-ə-sə / matʃ-ə-sə
burrit / vajzës / maces

Casalvecchio

- i. Emërore njëjës: kontekstet γerði - Subjekti 'erdhi Subjekti'
- a. jə burr / jə vaiz / jə cən / jə matʃ-a
një burrë / një vajzë / një qen / një mace
- b. ai burr / ajo vaiz / ai cən / ajo matʃ-a
ai burrë / ajo vajzë / ai qen / ajo mace
- c. burr-i / vaiz-a / cən-i / matʃ-ja
burri / vajza / qeni / macja
- d. kjo miʃt iʃt a ziəra
ky mish është Nyjë zier
- ii. Kallëzore njëjës: kontekstet pɛva - Objekt 'pashë Objekt'
- a. jə burr / jə vaiz / jə cən / jə matʃ-a
një burrë / një vajzë / një qen / një mace
- b. atə burr / atə vaiz / atə cən / atə matʃ-a
atë burrë / atë vajzë / atë qen / atë mace
- c. burr-i-n / vaiz-ə-n / cən-i-n / matʃ-a-n
burrin / vajzën / qenin / macen
- d. həŋgra miʃt
həŋgra mishin

iii. Dhanore njëjës: kontekstet ja ðeva - Dhanore 'ia dhashë Objektiv'

- a. a nə burr / a nə vaiz / a nə cən / a nə matf-a
 një burri / një vajze / një qeni / një maceje
- b. atij burr-i / asaj vais / atij cən-i / asaj matf-a
 atij burri / asaj vajze / atij qeni / asaj maceje
- c. burr-i-t / vais / cən-i-t / matf-ə-s / maestr-a-s
 burrit / vajzës / qenit / maces / mësueses

Vena

i. Emërore njëjës: kontekstet erθ -Subjekt 'erdhi Subjekt'

- a. nə vazdə / nə diaç / nənə'ri / nə maistrə / nə matf-ε
 një vajzë / një djalë / një burrë / një mësuese / një mace
- b. ajo vazdə / ai diaç / ai nē'ri / ajo maistrə / ajo matf- ε
 ajo vajzë / ai djalë / ai burrë / ajo mësuese / ajo mace
- c. vazd-a / diaç-i / nē'ri-u / maistr-a / matf-a
 vajza / djali / burri / mësuesja / macja
- d. mə pri'cən miçə-tə
 më pëlqen mishi

ii. Kallëzore njëjës: kontekstet pε - Objekt 'pashë Objekt'

- a. nə vazdə / nə diaç / nənə'ri / nə maistrə / nə matf-ε
 një vajzë / un djalë / një burrë / një mësuese / një mace
- b. pε at diaçə / at vazdə / atənə'ri / at(ə) maistrə / at matf-ε
 atë djalë / atë vajzë / atë burrë / atë mësuese / atë mace
- c. vazd-ə-nə / diaç-i-nə / nē'ri-u-nə / maistr-ə-nə / matf-ε-nə
 vajzën / djalin / burrin / mësuesen / macen
- d. a'i ha nə tçəp miçə / miçə-tə
 ai ha një copë mish / mishi

iii. Rasë e zhdrejtë njëjës: kontekst ja ðε - Dhanore 'ia dhashë Objekt'

- a. niçə vazd-ε-jε / niçə diaç-i-çə / niçənə'ri-u-çə / niçə maistr-ε-jε
 një vajze / një djali / një burri / një mësueseje
 niçə matf-ε-jε 'një maceje'
- b. asaçə vazdə / atiçə diaç-i-çə / atiçənə'ri-u-çə / asaçə maistrə
 asaj vajze / atij djali / atij burri / asaj mësueseje
 asaçə matf-ε 'asaj maceje'
- c. vazd-ə-sə / diaç-i-t / nē'ri-u-tə / maistr-ə-sə / matf-ε-sə
 vajzës / djalit / burrit / mësueses / maces

Të dhënat në (4) u përkasin formave shumë. Një flektim i specializuar i shumësit –a del në shumë grupe emërore, sikurse është ilustruar këtu nga *vazd-a* 'vajza', *kriatur-a* 'fëmijë', *maistr-a* 'mësuese' në *Vena*, *bur-a* 'burra' në *Ginestra e Casavecchio*, etj. Disa grupe përveç kësaj paraqesin forma bazike të specializuara për shumësin, si në rastin e shumësit *jerəsə* 'njerëz' krahas njëjësit *je'ri* 'njeri' në

(3)-(4) në *Vena*, shumësi *vaʃʃəra* ‘vajza’ krahas njëjësit *vaiʒə* ‘vajza’ në *Ginestra* e *Casalvecchio*, etj. Emërorja e shquar dhe kallëzorja i shquar shumësi janë leksikalizuar nga i njëjti formativ (ə)-t(ə), që leksikalizon edhe format e shquara të emrave neutralë.

Në *Casalvecchio* rasa e zhdrejtë e shquar merr *-va-t*, si në (4iii.c.); flektimi *-va* del, edhe pse në mënyrë të ndryshme, në forma të pashquara, në (4iii.a.). Në *Vena* rasa e zhdrejtë e pashquar merr si option flektimin e specializuar *-vetë* cilit i shton në format e shquara elementin *-tə*, si në (4iii.). Në *Ginestra* interpretimi i rasës së zhdrejtë nuk lidhet me flektime të specializuara, as në kontekstet me dëftori/i pashquar, në të cilat emri del në një formë shumësi të pashquar, as në ato me emra të shquar, si në (4iii.c.). Në rastin e fundit emri paraqet flektimin normal *-ə-t(ə)* të shumësit të shquar, analogjikisht pra me format në (4i.c.) e (4.ii.c.).

(4)Ginestra

i. Emërore shumësi: kontekstet *ɣertənə-Subjekt* ‘erdhën Subjekt’

- a. di bur-a / di vaʃ-ur-a
dy burra / dy vajza
- b. atə bur-a / atə vaʃ-ur-a
ata burra / ato vajza
- c. bur-ə-tə / vaʃ-ər-tə
burrat / vajzat

ii. Kallëzore shumësi: kontekstet *pəjə-Subjekt* ‘pashë Objekt’

- a. kac bur-a / di vaʃ-ur-a / ʃum diʎm-ər-a
kaq burra / dy vajza / shumë djem
- b. atə bur-a / atə vaʃ-ər-a / atə diʎm-ər-a
ata burra / ato vajza / ata djem
- c. bur-ə-tə / vaʃ-ur-tə / diʎm-ər-tə / cən-ə-tə
burrat / vajzat / djemtë / qentë

iii. Dhanore shumësi: kontekstet ja *ðejə* - Dhanore ‘ua dhashë Objekt’

- a. a kac bur-a / a di vaʃ-ur-a / a ʃum dilm-r-a
kaq burrave / dy vajzave / shumë djemve
- b. atir-v-r-a bur-a / atir-v-r-a diʎm-r-a / atir-v-r-a vaʃʃ-ur-a
atyre burrave / atyre djemve / tyre vajzave
- c. bur-ə-tə / vaʃʃur-ə-tə / diʎm-ər-ə-tə / cən-ə-tə
burrave / vajzave / djemve / qenve

Casalvecchio

i. Emërore shumësi: kontekstet *ɣerðən-* Subjekt ‘erdhën Subjekt’

- a. *ɣac burr-a* / *ɣac vaʃʃ-ər-a* / *ɣac cən* / *ɣac matʃ-a*
kaq burra / *kaq vajza* / *kaq qen* / *kaq mace*
- b. *atɔ burr-a* / *atɔ vaʃʃ-ər-a* / *atɔ cən* / *atɔ matʃ-a*
ata burra / *ata vajza* / *ata qen* / *ata mace*
- c. *bur-a-t* / *vaʃʃ-ər-a-t* / *cən-t* / *matʃ-a-t*
burrat / *vajzat* / *qentë* / *macet*
- ii. Kallëzore shumë: kontekstet *pɛva-Objekt* 'pashë Objekt'
- a. *ɣac burr-a* / *ɣac vaʃʃ-ər-a* / *ɣac cən* / *ɣac matʃ-a*
kaq burra / *kaq vajza* / *kaq qen* / *kaq mace*
- b. *atɔ burr-a* / *atɔ vaʃʃ-ər-a* / *atɔ cən* / *atɔ matʃ-a*
ata burra / *ata vajza* / *ata qen* / *ata mace*
- c. *bur-a-t* / *vaʃʃ-ər-a-t* / *cən-t* / *matʃ-a-t*
burrat / *vajzat* / *qentë* / *macet*
- iii. Dhanore shumë: kontekstet ja *ðeva-Dhanore* 'ua dhashë Objekt'
- a. *a ɣac burr-a* / *a ɣac vaʃʃ-ər-a* / *a ɣac cən* / *a ɣac matʃ-a*
kaq burrave / *kaq vajzave* / *kaq qenve* / *kaq maceve*
- a. *ɣac kriʃter-va* / *a ɣac cən-va*
kaq vetave / *kaq qenve*
- b. *ati-v-r-a burr-a* / *ati-v-r-a vaʃʃ-ər-a* / *ati-v-r-a cən* / *ati-v-r-a matʃ-a*
atyre burrave / *atyre vajzave* / *atyre qenve* / *atyre maceve*
- c. *bur-va-t* / *vaʃʃ-ər-a-va-t* / *cən-va-t* / *kriatur-va-t* / *matʃ-ə-va-t*
burrave / *vajzave* / *qenve* / *personave* / *maceve*

Vena

- i. Emërore shumë: kontekstet *ɛrðə(rə)* -Subjekt 'erdhën Subjekt'
- a. *tʃəðɔ vazda* / *tʃəðɔ kriatura* / *tʃəðɔ ɲɛrəsə* / *tʃəðɔ maiʃtra* / *di matʃɛ*
disa vajza / *disa fëmijë* / *disa burra* / *disa mësuese* / *dy mace*
- b. *atɔ vazda* / *atɔ kriatura* / *atɔ ɲɛrəsə* / *atɔ maiʃtra* / *atɔ matʃɛ*
ato vajza / *ata fëmijë* / *ata burra* / *ato mësuese* / *ato mace*
- c. *vazda-tə* / *kriatura-tə* / *ɲɛrəsə-tə* / *maiʃtra-tə* / *matʃɛ-tə*
vajzat / *fëmijët* / *burrat* / *mësueset* / *macet*
- ii. Kallëzore shumë: kontekstet *pɛ* - Objekt 'pashë Objekt'
- a. *tʃəðɔ vazda* / *tʃəðɔ kriatura* / *tʃəðɔ ɲɛrəsə* / *tʃəðɔ maiʃtra* / *di matʃɛ*
disa vajza / *disa fëmijë* / *disa burra* / *disa mësuese* / *dy mace*
- b. *atɔ vazda* / *atɔ kriatura* / *atɔ ɲɛrəsə* / *atɔ maiʃtra*
ato vajza / *ata fëmijë* / *ata burra* / *ato mësuese*
- c. *vazda-tə* / *kriatura-tə* / *ɲɛrəsə-tə* / *maiʃtra-tə* / *matʃɛ-tə*
vajzat / *fëmijët* / *burrat* / *mësueset* / *macet*
- iii. Dhanore shumë: kontekstet ja *ðɛ* -Dhanore 'ua dhashë Objekt'
- a. *tʃəðɔ-ve vazda(-ve)* / *tʃəðɔ-ve kriatura(-ve)* / *tʃəðɔ-ve ɲɛrəsə* / *tʃəðɔ-ve maiʃtra-ve*
disa vajzave / *disa fëmijëve* / *disa burrave* / *disa mësueseve* / *di-ve matʃɛ-ve* 'dy maceve'
- b. *atire vazda(-ve)* / *atire kriatura(-ve)* / *atire ɲɛrəsə* / *atire maiʃtra-ve*
atyre vajzave / *atyre fëmijëve* / *atyre burrave* / *atyre mësueseve* / *atire matʃɛ-ve* 'atyre maceve'
- c. *vazda-ve* / *kriatura-ve* / *ɲɛrəsə-ve* / *maiʃtra-ve* / *matʃɛ-ve*
vajzave / *fëmijëve* / *burrave* / *mësueseve* / *maceve*

Një tjetër pikë e vënë në dukje në të dhënat në (3)-(4) ka të bëjë me formën e përcaktuesëve. Përemri dëftor paraqet forma të specializuara për numrin, gjininë e për rasën. Pra, për shembull, paradigma e ‘atij’ është *a'i*-Em.mnj, *atv*-Kall.sg, *atiçə*-Dhan.mnj kundrejt *a'jə*-Em.fnj, *atv*-Kall.sg, *asaçə*-Dhan.fnj, *a'tə*-Em/Kall.sh, *atirɛ*-Dhan.sh në *Vena*, *a'i*-Em.mnj, *atə*-Kall.sg, *ateiti*-Dhan.mnj kundrejt *a'jə*-Em.fnj, *atə*-Kall.sg, *asajə*-Dhan.fnj, *a'tə*-Em/Kall.sh, *atirva*-Dhan.sh në *Ginestra*. Për sa u përket kuantifikuesve të pashquar, shohim se *ɲə* alternohet me *ɲiçə*-Dhan dhe *tʃədɔ* ‘disa, lett. *çfarë do (ti)/do (ai)*’ me *tʃədɔ-vɛ*-Dhan në *Vena*.

Emrat e farefnisisë paraqesin kushte morfosintaksore të veçanta, si pozicioni para emrit i pronorit dhe mundësia e futjes së nyjës së përparme në kombinim me eptimin e shquar që, sikurse do ta shohim më detajisht në fq. 1.2., ndodh edhe me mbiemrat, si në (s). Në veçanti, shembujt në (5) tregojnë alternimin mes dy klasave të formativëve të paravendosur, prandaj në kontekstet emërore në (5) janë futur *i*, *ɛ/a*, ndërsa në kontekstet kallëzore në (5b) dhe për rasën e zhdrejtë (dhanore) në (5c) është futur *tə*. Shembujt ilustronjë përveç kësaj edhe kombinimin e emrit të farefnisisë me mbiemrin, i paraprirë nga nyja dhe nga kuantifikuesi. Rendi që rrjedh prej kësaj është *nyjë-emër.fleks-(Q)-nyjë-mbiemër.fleks*. Në (5) janë sjellë kontekste në të cilat emrit të farefnisisë i paraprin pronori ose kuantifikuesi i pashquar; në këto raste del trajta e pashquar e emrit të farefnisisë. Mungesa e eptimit të shquar në kontekstet pronore mund të shpjegohet duke pranuar se lidhja e emrit të farefnisisë me pronorin mjafton për ta stabilizuar denotimin e sintagmës emërore, duke përjashtuar realizimin e nyjës. Duke vijuar Manzini e Savoia (2005), mund të mendojmë se në këto raste emrat që futen te klasa e emrave të farefnisisë hyjnë nën domenin C, që lidhet me vetitë e fiksimit të denotimit (pg. 1.1. e 1.1.2.), duke u bazuar te vëzhgimi që brenda këtij domeni zakonisht leksikalizohet elementi D që fikson referimin e emrit, vendosja e emrit në C mjafton për të fiksuar referimin, duke përjashtuar leksikalizimin e pavarur të D.

(5) *Ginestra*

- a. γ erði i kuſərej- u ((mə) i maði)
erdhi Nyjë kushëri-Em.mnj ((më) Nyjë madh.mnj)
- b. pejë tə kuſərej-ə-nə (a maðə)
pashë Nyjë kushëririn/ën ə-Kall (Nyjë madhe)
pejë tə vihr-ə-nə
pashë Nyjë vjehrrin-Kall
- c. ja ðejə tə vihr-ə-tə
ia dhashë Nyjë vjehrrit-Dhan

Casalvecchio

- a. γ erði i kuſərir-i ((mə) i maði)
erdhi Nyjë kushëri-Em.mnj ((më) Nyjë madh-mnj)
- b. pe tə kuſirir- i- n (mə i maði.mnj)
pashë Nyjë kushëririn-mnj-Kall më Nyjë madh.mnj
- c. ja ðeva təkuſərir-i-tə ((mə) i maði)
ia dhashë Nyjë kushërit- mnj- Dat(më) Nyjë madh-mnj

Vena

- a. erθ i vla- u
erdhi Nyjë vëllau-Em.mnj
erθ i kuſirir-i ((mə) i maθə)
erdhi Nyjë kushëri-Em.mnj ((më) Nyjë madh-mnj)
erθ ε kuſirir-a ((mə) ε maðε)
erdhi Nyjë kushërira-Em ((më) Nyjë madhe-fnj)
- b. pe tə vla- u-nə
pashë Nyjë vëllanë- mnj-Kall
pe tə kuſirir- i- nə mə i maθə
pashë Nyjë kushëririn- mnj-Kall më Nyjë madh.mnj
pe tə kuſirir- ə- nə mə ε maðε
pashë Nyjë kushërirën- fnj-Kall më Nyjë madhe.fnj
- c. ja ðε tə kuſirir- ə- sə
ia dhashë Nyjë kushërirës-fnj-Dhan
- d. *Ginestra*

γ erði i m kuſərir/ ajo kuſərejə
erdhi Nyjë im kushëri/ ajo kushërira
pejë të ma kuſərejə/ nə / atə kuſərejə
pashë Nyjë ime kushëriraë / një/ atë/ atë kushëri/(r)ë

Casalvecchio

γ erði i m kuſərir/ nə u'la
erdhi Nyjë im kushëri / një vëlla
peva tə m kuſərir

pashë Nyjë tim kushëri
 kjɔ iʃt tə tə m kuʃərir
 ky është Nyjë Nyjë im kushëri

Vena
 nə vla 'një vëlla'
 nə/ im kuʃi'ri 'një / im kushëri'
 ɛrθ nə/ ime kuʃirire
 erdhi një/ime kushërirë
 pɛ nə kuʃirire
 pashënjë kushërirë
 ja ðɛ ni-çə kuʃir-ɛ-jɛ / asa-çə kuʃirire
 ia dhashë një-Dhan kushërire-fnj-Dhan/asaj.fnj-Dhan kushërire.fnj

1.2. *Struktura e sintagmës emërore: emri dhe flektimi*

Shpërndarja e vetive të klasës emërore, të shumësit dhe të rasës brenda sintagmës emërore dhe lloji i përshtatjes që realizohet aty na shtyjnë të thellohem në analizën e propozuar për gjuhët romane nga Manzini e Savoia (2004, 2005, 2007) në mënyrë që të kuptojmë vetitë interpretuese të flektimit arbëresh. Me këtë qëllim, vetitë morfosintaksore të emrave të farefisnisë na shërbejnë si një pikënisje mjaft e nevojshme. Ato kombinojnë dy vetitë sintaksore themelore të sistemit emërore të shqipes, pra nyjën e përparme me flektimin e rasës dhe të shquarsisë. Përkimi formal e konceptual i nyjave të përparme dhe i formativëve të flektimit sugjerojnë që kemi të bëjmë me të njëjtët elementë leksikorë, të cilët vendosen në brendësi të fjalës ose në një pozicion të brendshëm të sintagmës emërore, sipas konteksteve. Nëse aplikojmë strukturën në (1)-(2) të shpërndarja e ilustruar nga të dhënat në (5) shohim se në fakt nyja e përparme vendoset në një nga pozicionet argumentuese të sintagmës emërore, ndërsa flektimi leksikalizon një pozicion brenda emrit.

Përsa i përket konceptit të rasës, analiza e paraqitur këtu e rimerr konceptimin e propozuar nga Manzini e Savoia (2005, 2008). Brenda kësaj kornize teorike rasa nuk është parë si një primitiv i sintaksës, por

përkon me morfologjizimin e vetive të ngjarjes (argument i brendshëm) ose me ato denotuese (veta, kuantifikimi, shpërndarja, etj) nëpërmjet formativëve që lidhen normalisht me vetitë e klasës emërore ose kuantifikuese. Një sistemim i tillë e karakterizon emëroren si denotim të argumentit D të zinxhirit, duke e kundërvënë atë me kallëzoren, që konceptohet si argument i brendshëm N, i identifikuar me terma të klasës emërore ose, në shumës, me terma kuantifikues mbi individë/objekte të ngjarjes. Rasa e zhdrejtë (dhanore/gjinore) mund të identifikohet si një lloj i veçantë i kuantifikimit i cili lidh një argument me një grup në të cilin përfshihet (gjinorja) ose me një shpërndarës (dhanorja; Manzini e Savoia 2005, 2007, 2008). Pra, rasa mund të riinterpretohet sipas përmbajtjes referuese që ka të bëjë me kategoritë emërore D, Q, N; në një analizë të fundit, duke iu rikthyer diskutimit në (1), kjo do të thotë se vetitë e rasës janë të ngjashme me vetitë e mbartura nga specifikime referuese të ndryshme. Në veçanti, brenda një emri apo sintagme emërore vetitë D marrin nën vete edhe vetitë N apo Q, që, nga ana e tyre, përmbajnë bazën predikative.


Në varietetet arbëreshe, duke përjashtuar rasën e zhdrejtë të pashquar, rasa regjistrohet në kombinim me shquarësinë, për të cilën flektimi që përfaqëson interpretimin emërore, kallëzore ose dhanore/gjinore përfshin referimin e shquar. Përveç kësaj, sikurse e kemi parë në paragrafin e mëparshëm, prania e përcaktuesit dhe prania e flektimit të rasës/shquarsisë të emri gjenden në shpërndarje plotësuese. Në këtë pikë e marrim formën e shquar *i kusjiriri* ‘kushëri’ të *Venas*, si një formë që kërkon një nyjë të përparme që e dyfishon morfologjinë flektive. Duke ndjekur të paktën si hipotezë të parë trajtimin e propozuar në përgjithësi nga studimet (Dimitrova-Vulchanova e Giusti 1998, Turano 2002, 2003, Manzini e Savoia 2007), duket e natyrshme të lidhet formativi *i* me pozicionin D paraemërore, ku leksikalizon vetitë e shquarësisë të sintagmës emërore, si në (6a); formativi *-i* si fleksion i brendshëm i emrit leksikalizon vetitë referenciale të shquara, me të cilat përkon interpretimi emërore. Ideja e propozuar këtu është që në gjuhët si shqipja, të cilat i regjistrojnë vetitë e rasës nëpërmjet

flektimit, morfologjia flektive leksikalizon kategori (veti referenciale) të ndryshme sipas interpretimit të rasës. Veçanërisht të vjen natyrale të pranosh se interpretimi emërore përkon me vetitë D, pra me ato që lidhen me argumentin EPP të një predikati.


Forma kallëzore e shquar, si *tə kuʃiririnə* ‘kushëririn-Kall’ in (6b), analizohet si një leksikalizim i specializuar për kategorinë N e cila identifikon argumentin e brendshëm të ngjarjes verbale dhe të vetmin argument të emrit. Elementi *-i-* mund të lidhet me një pozicion N, i dyfishuar nga pozicioni N, i cili e pranon flektimin e specializuar të kallëzores-*nə*. Nyja *tə* është në domenin D të sintagmës emërore. Të vërehet se, nga që e kanë të mundshëm leksikalizimin e të njëjtit pozicion D paraemërore, elementët *i*, *ε/a* dallojnë nga elementi *tə* përsa i përket aspektit të vetive leksikore. Në fakt, elementët *i*, *ε/a* analizohen si formativë të klasës emërore, të pajisur pra me përmbajtje semantike, edhe pse të reduktuar, ndërsa *tə* mund të analizohet si një kuantifikues, një ndryshore e vërtetë, referimi i së cilës fiksohet nga përshtatja me emrin apo mbiemrin, ose edhe deitakisht, pra në raport me universin e diskursit. Për fund, në (6c) flektimi dhanore/gjinore lidhet me pozicionin Q brenda emrit, që fikson nga ana kuantifikuese referimin me të vetmin argument të bazës leksikore. Kemi sugjeruar në fakt se interpretimi dhanore/gjinore përkon me një lloj të veçantë kuantifikimi, i cili bën lidhjen mes një argumenti dhe një grupi në të cilin përfshihet.

(6) *Vena*


a.



b.




c.



Qasjet klasike gjenerative e shpjegojnë rendin *Emër-nyjë e prapavendosur* si derivat të lëvizjes së emrit nga pozicioni i tij bazik në një pozicion më të lartë të sintagmës emërore, për shembull pozicioni D, ku kombinohet me nyjën në enklizë. Dimitrova-Vulchanova e Giusti (1998), pohojnë se nyja është gjeneruar drejtpërdrejt në N dhe që N ngjitet në pozicion Focus i sintagmës emërore, nga ku kontrollon pozicionin D të nyjës në nivelin LF (ose në alternativë nëpërmjet lëvizjes së emrit në D). Ky mekanizëm do të kujdesej edhe për shpërndarjen plotësuese mes nyjës së prapavendosur dhe përcaktuesëve të sintagmës emërore (shiko në (3)-(4), ndaj futja e një elementi shquarësie në një pozicion të lartë do të ishte e mjaftueshme për të kënaqur kërkesën e kontrollit të pjesëzave të shquarësisë në D, duke përjashtuar një prani të mëtutjeshme mbi pozicionet në të djathtë të saj. Analiza e Turanos (2003) identifikon nyjën e prapavendosur me një formativ të shquarësisë të gjeneruar në D dhe shpjegon sufiksizimin e saj me emrin si rezultat i inkorporimit të sufiksit me emrin si pasojë e lëvizjes së N-së në D.


Trajtimi teorik i propozuar nga Manzini e Savoia (2005, 2007) i përjashton kategoritë abstrakte, përfshirë edhe gjurmët dhe lëvizjen që lidhet me to, duke i quajtur të papraktikueshme të dyja këto trajtime. Nga ana tjetër, analiza e bazuar mbi lëvizjen nuk shpjegon për cilën arsye emri do të duhej të lëvizte në N; në këtë kuptim, nuk na del bindës as zgjidhja e sugjeruar nga Dimitrova-Vulchanova e Giusti (1998) për të cilën do të duhej të ishte një pozicion Focus që do ta ushqente atë që është rendi normal N-Nyjë. Përveç kësaj, për dallim nga qasja klasike gjenerative, ku përshtatja është parë si rezultat i kontrollit të pjesëzave të gjinisë, numrit dhe rasës, sipas lëvizjes të paktën në Formën Logjike, kemi parë se një trajtim më i përshtatshëm e identifikon përshtatjen me vetitë e përbashkëta referencialisht relevante (Manzini e Savoia 2005, 2007). Në rastin në shqyrtim elementët e ndryshëm brenda sintagmës emërore si formativi flektiv i paravendur dhe flektimi referojnë te i njëjti individ.

Në analizën në (6) kemi pranuar tashmë se formativët e rasës dhe të shquarsisë janë karakterizuar si flektime të emrit, që do të mund të futet në pozicionin normal F kokë e brendshme e sintagmës emërore. Flektimi i shumësit ose i klasës emërore që del në disa klasa emërore, sikurse është ilustruar në (3)-(4), nuk lidhet me interpretimin e rasës, por fikson veti kuantifikuese apo referuese të emrit, si në gjuhët romane, që nuk e kanë markimin e rasës. Kemi parë se në varietetet e shqipes flektimi i shumësit (dhe i klasës emërore) kombinohet me flektimin e shquar $-t(\theta)$ lidhur me interpretimin e emërores/kallëzores, sikurse në *kriatura-tə* ‘fëmijët’, *dεΛε-tə* ‘delet’ në *Vena*, *bura-t* ‘burrat’ në *Casalvecchio*, etj. Mundemi pra ta trajtojmë këtë lloj të formativëve flektivë si morfologji e lidhur me pozicionin N (argument i brendshëm) brenda emrit, si në rastin e varieteteve romane në (2). Formativi $-tə$ leksikalizon D, kur sjell interpretimin emërore ose e dyfishon N, kur lidhet me interpretimin kallëzore, si në (7).

(7) *Vena*

Ambivalenca e *-tə* te emërorja e kallëzorja mund të shpjegohet duke i dhënë këtij formativi veti të ngjashme me ato të një operatori që sjell një ndryshore, referimi i të cilit është fiksuar nga përshtatja me elementët e tjerë referencialë të sintagmës, ose në mënyrë deitike, në raport me universin e diskursit. Ky karakterizim shpjegon edhe faktin se *-tə* lidhet, jo vetëm me shumësin, por edhe me interpretimin emërore/kallëzore të neutralëve, sikurse tregohet në (3d). Në të vërtetë, ambivalenca e *-tə* vërteton idenë që prezantimi ynë më mirë i regjistron vetitë interpretuese sesa vetitë e brendshme të elementit *-tə*. Me fjalë të tjera, mund të mendojmë se *tə* leksikalizon vetitë kuantifikuese *Q* të gatshme si për interpretimin e subjektit, ashtu edhe për atë të objektit; ky përfundim mbështet idenë e sugjeruar në diskutimin mbi strukturën në (1) që kategoritë sintaksore *D*, *N*, *Q*, përkojnë me përmbajtjet referenciale dhe që rendi hierarkik në të cilin janë vendosur përkon me domenin e mbartjes. Pajisja e *-tə*me veti kuantifikuese konfirmohet nga fakti se i njëjti element leksikalizon referimin gjinore/ dhanore, sikurse është diskutuar në pg. 1.1.3., dhe justifikon identifikimin e vetë me nyjën e paravendosur *-tə* (dhe në përgjithësi me formativin *-tə*që lidh fjali të varura, sikurse hipotezojnë Manzini e Savoia 2007; pf. 1.4. Le të shqyrtojmë kontekstet në (3a,b)-(4a,b) në të cilat rasia emërore/kallëzore është regjistruar nga dëftori dhe nga kuantifikuesi i pashquar, ndërsa emri paraqet formën e pashquar që përkon me bazën leksikore eventualisht inkluzive të flektimit të klasës emërore dhe të shumësit, por megjithatë e privuar nga fleksioni i rasës. Si rrjedhim, në këto kontekste përshtatja *dëftor / kuantifikues – emër* është reduktuar në veti të klasës emërore ose të shumësit.


Pranojmë në radhë të parë se dëftori /i/ pashquar vendoset në D dhe emri vendoset në pozicionin F. Zinxhirëve *atə burə* ‘ai-Kall burrë’ e *atə bura* ‘ata-Em/ Kall burra’ në *Ginestra* në (3)-(4), mund t’u caktohen respektivisht strukturat në (8a) e (8b); të vërehet se *-a* paraqet flektimin e shumësit përshtatur me formën e shumësit të dëftorit *atə* ‘ata’. Do ta përmbyllim duke pohuar se në shqipe leksikalizimi i dëftorit/ kuantifikatorit në D është i mjaftueshëm për të leksikalizuar vetitë e rasës dhe të llojit referencial (shquarsi /joshquarsi) të domenit të elementit emërore. Më saktësisht, D fikson referimin dhe interpretimin e rasës së argumentit obligator të bazës predikative *bur* në (8a,b), prandaj përshtatja mes dëftorit /kuantifikuesit dhe emrit mjafton për ta fiksuar interpretimin. Në rastin (8b) flektimi i klasës emërore regjistron interpretimin e shumësit si një veti të argumentit N të bazës emërore që nga ana e saj përkon me (një grup të) vetitë interpretuese të leksikalizuara në D.



Paraqitjet në (6)-(8) na vënë përpara disa çështjeve që lidhen me pozicionin e përcaktuesit të nyjës së përparme dhe me statusin e flektimit të rasës/shquarsisë. Përsa i përket nyjës së përparme mund të pyesim nëse pika e saj e vendosjes përkon me atë të përcaktuesit të varieteteve romane, që tregohet në (2). Analiza që do bëjmë këtu, ku do të sjellim dëshmi të tjera, është se pozicioni i nyjës së përparme është më i ulët se ai i nyjës romane dhe në përgjithësi i përcaktuesëve të ndryshëm, përfshirë dëftorin dhe të pashquarën në shqipe. Kjo zgjidh-

je motivohet në veçanti nga fakti se kuantifikuesit i paraprijnë nyjës së përparme në zinxhirin mbiemëror (të shihet diskutimi në pg. 2); përveç kësaj, nyja e përparme nuk i regjistron të gjitha vetitë që në shqipe kanë të bëjnë me shquarsinë, në veçanti me vetitë e rasës, duke u lidhur në gjysmë të rrugës, bije fjala, mes një përcaktuesi në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe një klase emërore.

Te emrat e farefisnisë me nyje të përparme vendosja e një kuantifikuesi përputhet normalisht me praninë e nyjës së përparme. Gjejmë pra *nə kushirire* ‘një kushërirë’, *sum kushiriç* ‘shumë kushërinj’ në *Vena*, me përjashtim të sekuencave të llojit **nə ε...*, **tə sum...ə* **sum tə...* Në rastin e numërorëve jepen sekuencat e tipit *tipotə katra kushiriçətə* ‘katër kushërinjtë’, që ruajnë rendin themelor në të cilin *təi* paraprin numërorit, i përshtatur në shumës, dhe emrit në shumës të shquar. Si përfundim, duke rimarrë strukturën në (2), pranojmë se nyja e përparme vendoset në një pozicion D të ulët, pra atë që gjendet në domenin e vendosjes së elementit leksikor, që përkon me specifikimin e vetive të ngjarjes, sikurse tregohet në (9a). Përcaktuesit vendosen në një pozicion D të lartë, brenda nyjes C_1 ku kuantifikojnë pozicionet argumentuese të projektuara nga elementi leksikor, duke ua fiksuar denotimin, si në (9b); prania e një determinuesi në D përjashton, përveç flektimit të rasës/ shquarsisë së emrit, si në (8), edhe nyjën e përparme (shih të dhënat në (5d)). Me fjalë të tjera, përcaktuesit kanë veti kuantifikuese mbi gjendjen e gjërave që sillen nga emri që nyjat e përparme nuk duket që ta kenë; si rrjedhim kuantifikimi i leksikalizuar nga një përcaktues përputhet me atë të një nyjeje të përparme ndaj e përfshin në vete duke e përjashtuar ndërfitjen.



Në dritën e këtyre reflektimeve, shqyrtojmë sërish statusin e flektimit të rasës/ shquarsisë së emrit. Fakti që një flektim i tillë është në shpërndarje plotësuese me përcaktuesit e saj sugjeron që flektimi i rasës /shquarsi së dhe determinuesit kanë të njëjtin status interpretues. Sikurse e kemi sugjeruar edhe më parë në diskutimin më lart, mund të mendojmë që flektimi i rasës /shquarsisë të jetë i lidhur me një përmbajtje interpretuese të llojit kuantifikues dhe denotues të të njëjtit tip të atij që futet nga përcaktuesit. Në rastin e kallëzores dhe të rasës dhanore ky status i veçantë i formativëve të rasës/ shquarsisë manifestohet në faktin që ata kombinohen me përbërësin *rrënjë - flektim i klasës emërore*; pra kuantifikojnë në bazë të formacioneve që përmbledhin elemente denotues, si klasa emërore dhe shumësi, si në (6b,c), duke u sjellë kështu si determinues të vërtetë. Në emëroren njëjës mjafton një formativ i klasës emërore-*a/-i/-u* për të leksikalizuar referimin e shquar. Kjo mundësi konfirmohet nga fakti se edhe përcaktuesit kanë forma emërore jo gjithmonë të specializuara. Dëftori e dallon emëroren e kallëzoren njëjës, ndërsa në shumës ka vetëm një formë *a'tɔ/ ktɔ* 'ata/ato' / 'këta/këto'; e pashquara si njëjës dhe shumës

nuk e dallon asnjëherë kallëzoren nga emërorja. Flektimi i thjeshtë denotues është pra i mjaftueshëm për të leksikalizuar vetitë e emërores.

Kjo analizë mund të shpjegojë shpërndarjen plotësuese mes pranisë së një përcaktuesi dhe morfologjizimit të vetive të shquarsisë /rasës nga ana e flektimit të emrit, përfshirë nyjën e përparme të emrat e farefnisës si (9a, 9b). Në fakt prania e një formativi që lidhet me interpretimin e shquar apo me kuantifikimin e pashquar mjafton për të leksikalizuar vetitë referenciale të të gjithë sintagmës emërore: në të vërtetë, mund të mendojmë se secili element (dëftor, kuantifikues i pashquar, fleksion i shquar i emrit) leksikalizon veti denotuese të specializuara, jo automatikisht të përputhshme me ato të leksikalizuara nga secili prej formativëve të tjerë. Vetitë e rasës, të cilat i kemi karakterizuar si veti referenciale, për aq sa nuk janë të ndara nga ato të shquarsisë, pësojnë të njëjtën shpërndarje me këto të fundit.

Mund të kërkojmë t'i formalizojmë këto kushte, duke pranuar se struktura e brendshme e fjalës përmban në vetvete jo vetëm të njëjtat kategori të fjalisë e të sintagmës, sikurse u propozua në (1), por edhe domene të ndryshme të pemës strukturore të projektimit në përputhje me vetitë që sillen nga elementët referencialë / kuantifikues. Me fjalë të tjera, mund t'i interpretojmë paraqitjet në (6) si struktura në të cilat projektme të ndryshme që lidhen me flektimin e rasës leksikalizojnë rasën dhanore në (6c) marrin në mbartjen e tyre flektimin e klasës emërore në N të domenit të rrënjës leksikore, duke realizuar ato që interpretohen si veti të rasës. Jemi duke sugjeruar që formativët e rasës /shquarsisë (në kombinim me nyjën e përparme të kontekstit të emrave të farefnisës) kanë të njëjtin status me përcaktuesit e vërtetë, ata sillen si operues të kuantitetit që fiksojnë mbi një individ referimin e vetive të mbartura nga emri.

Kemi vërejtur se forma e pashquar e emrit paraqet flektimin përkatës për rasën e zhdrejtë. Formativët dhanore / gjinore, që lidhen me pozicionin e brendshëm Q të emrit sikurse sugjerohet në (6c), kombinohen me flektimin e dëftorit /të pashquar në D, sikurse tregohet në


(10). Fakti që flektimi i rasës mund të dyfishohet te përcaktuesi dhe te emri vërteton idenë që sapo e diskutuam se shpërndarja plotësuese mes përcaktuesit dhe flektimit emërore ka të bëjë veçanërisht me vetitë kuantifikuese që lidhen me fiksimin e referimit.

Në të vërtetë, disa varietete si ai i *Ginestra-s* nuk e kanë flektimin e rasës te emri në kontekstet me determinues /të pashquar, ndërsa varietetet e tjera, sikurse ai i *Vena-s*, që e marrin flektimin e zhdrejtë në kontekstet me trajtë të pashquar, mund ta përjashtojnë duke marrë dëftorin. Në veçanti (3iii,b,c) në *Vena* tregon se në njëjës kontekstet e pashquara *jiçə vazdeje* / *jiçə diaʎiçə* vihen në kontrast me kontekstet e shquara *asaçə vazdə* / *atiçə diaʎiçə* ku flektimi i zhdrejtë është përjashtuar nga emrat femërorë. Kjo na kujton se formativët e ndryshëm flektivë kanë veti leksikore pakëz më të ndryshme, që vijnë pikërisht nga sjellja e tyre. Për shembull mund të mendojmë se ndërsa *-çə* e mashkullores është një morfemë Q, *-jε* e femërores është një morfemë e klasës emërore, sikurse sugjerohet në (10a), më shumë se e llojit Q, prandaj nuk përputhet me statusin referencial të vetive të shquarsisë që sillen nga dëftori. Analiza në (10) mund të zgjerohet edhe te fleksioni i zhdrejtë që lidhet me kontekstet me përcaktues të llojit që paraqitet në *Casalvecchio* në (3iii.a.), si në *cən-i* ‘geni-Dhan/ Gjini’. Mund ta identifikojmë pra *-i* si një element të klasës emërore që përkon me atë që del në kallëzore, si në (10b).


Në shumës, në *Vena* fleksioni *-ve* del fakultativ në kontekstet me dëftor/ i pashquar. Në këtë rast duket relevant fakti se *-ve* është edhe flektim i zhdrejtë i shquar, sikurse del në shembujt në (4iii,a). Me fjalë të tjera *-ve* është në gjendje të marrë vetitë e shquarsisë të sintagmës. Pakëz më ndryshe është gjendja në *Casalvecchio*, ku flektimi i zhdrejtë në shumës është (në mënyrë fakultative) *-va-* në kontekstet e pashquara, ndërsa në formën e shquar të emrit *-va-* kombinohet me elementin *-t(ə)*. Të vërehet se *-va-* mund ta përjashtojë flektimin në shumës, si te *bur-va-t* ‘burrave’, *kriatur-va-t* ‘fëmiëve’ etj. Si në rastin në *Vena*, *-va-* merr pra gjithë serinë e vetive referenciale të

emrit. Mund të mendojmë se elementi *va/vε* është një formativ kompleks i emrit në të cilin *-v-* leksikalizon vetitë kuantifikuese që lidhen me interpretimin e rasës dhe elementi *a/ε* përfaqëson flektimin emërore /shumës, si në (10c).


(10) a. *Vena*



b. *Casalvecchio*



c. *Casalvecchio*




Në strukturën në (10) elementi *-t* futet në Q. Kjo zgjidhje mbështetet nga fakti se ka varietete si ai i *Ginestra-s*, që nuk kanë flektime të specializuara për dhanore/gjinore shumës, që leksikalizohet nëpërmjet flektimit të thjeshtë *-t(ə)* (shumës/gjinore njëjës), si në rastin *bur-ə-tə* në (4iii.c.). Pra mund të mendojmë se elementi *-t(ə)-* bazuar te vetitë e tij kuantifikuese është i gatshëm për leksikalizimin e referuesit gjinore /dhanore.

Të dhënat në *Casalvecchio* në (3iii.) dhe *Ginestra* e *Casalvecchio* në (4iii.) tregojnë se ndërtimi dhanore në të cilin emri paraprihet nga një përcaktues i pashquar lidhet nga elementi *a*. Kemi kështu forma si *a pə burr* 'një burri', *a çac burr-a* 'kaq burrave' në *Casalvecchio*, *a kac bur-a* në *Ginestra*; në të dyja rastet është i

dukshëm paralelizmi me formimet në të cilët është i pranishëm një përcaktues i shquar, si në *ati-v-r-a burr-a* ‘atyre burrave’ në *Casalvecchio atir-v-r-a bur-a* ‘atyre burrave’ në *Ginestra*. Në të dyja kontekstet rasa regjistrohet te i vetmi përcaktues ndërsa te emri del vetëm flektimi i klasës emërore /shumës. Përsa i përket strukturës së këtyre ndërtimeve, sipas Manzini e Savoia (2007), mund ta trajtojmë *a* si një kokë leksikore që mban të varur sintagmën e emrit, si në (11a).

Statusi i këtyre ndërtimeve vë në përdorim të paktën dy mekanizma të jashtëm, të natyrës pragmatike. Në radhë të parë duket e qartë se elementi *a* përkon me parafjalën që lidh dhanoren në varietetet romane të kontaktit, nga e ka huazuar. Me fjalë të tjera, këto struktura janë të ngjashme me ato të shqyrtuarat në pf. 1.4.5. që u morën në shembujt në (11b), në të cilat elementi *ðə*, i ndjekur nga forma *jo* e shquar e emrit, përkon me parafjalën *ðə* të varieteteve të kontaktit.

(11) a. *Casalvecchio*



b. *Ginestra*

<i>nə</i> bukir	<i>ðə</i>	<i>vitrə</i>
një gotë	parafjalë	qelqi
‘një gotë qelq’		

Casalvecchio

<i>ʌɛʃ-i</i>	<i>ðə</i>	<i>dɛʌɛ</i>
lesh-Em	parafjalë	dele
‘leshi i deles’		

Me fjalë të tjera, mund ta trajtojmë *a* si një huazim të specializuar për të sjellë dhanoren në kontekstet në të cilat është i pranishëm një element i pasquruar. Përfundimisht *a* leksikalizon vetitë përgjithësisht të leksikalizuara nga flektimi i dhanores; në këtë kuptim

mund ta trajtojmë si element të llojit Q. Në radhë të dytë, procesi i jashtëm që e ka sjellë në gramatikën arbëreshe të këtyre varieteteve duket se lidhet me faktin se elementët e pashquar të cilët e seleksionojnë *a* nuk e kanë morfologjinë e rasës; në fakt, në *casal-vecchio* elementi *a* mund të lidhë edhe dhanoren e vet ‘atij’ që vetë nuk e ka fleksionin e specializuar të dhanores. Natyrisht, të dyja këto mekanizma, pra huazimi dhe mungesa e një morfologjie që qartë të dhanores, paraqesin shkaqe të jashtme që mund të kenë ndikuar folësin dygjuhësh. Pika teorike është se fëmija e përvetëson gramatikën arbëreshe në të cilën dhanorja, në disa kontekste, merr këto struktura të veçanta.

1.3. *Plotësi emëror*

Një nyjë e përparme e lidh edhe gjinoren, pra sintagmën emërore që del si referim i emrit kokë; në veçanti, kemi sugjeruar se flektimi i gjinores leksikalizon denotimin e bashkësisë së përkatësisë, që specifikon vetitëreferenciale relevante për identifikimin e emrit kokë. I marrim shembujt në (12), ku (a) ilustron shembuj me plotës së shquar, (a') shembuj me plotës jo të shquar dhe (a'') shembuj në të cilët emri kokë është në të pashquarën; (b) sjell shembuj në të cilat plotësi lidhet nga një përcaktues. Të dhënat në (c) ilustronjë kontekste në të cilat gjinorja lidhet nga *jam*, e (d) ilustron kontekstet në të cilat ky ndërtim vjen si objekt i një foljeje kalimtare. Në fund janë dhënë me shembuj ndërtime në të cilat nyja që lidh gjinoren i paraprin një nyjeje të paravendosur ndaj emrit të farefisnisë në (e) ose mbiemrit të emëruar në (f).

Të dhënat në (12) tregojnë se nyja që lidh gjinoren përshtatet me klasën emërore me emrin kokë; për shembull, sikurse tregojnë kontekstet emërore *bis̄ti i Gjin* ka një nyjë mashkullore në njëjës, ndërsa *k̄mba e Gjin* ka një nyjë në femërorë njëjës në (12a) në *Vena*. Ky element i paraprin edhe dëftorit /i pashquar në gjinore që lidh një emër të varur, si në (12b). Në dialektin e *Ginestra-s* nyja që lidh plotësin

mund të mos realizohet. Megjithatë, edhe në këtë varietet duket që ajo përshtatet me vetitë e klasës emërore të emrit kokë, si në (12a). Në kontekstet në të cilat emri kokë është në kallëzore në (12d) selekcionohet një formë jo e diferencuar e njëjës së përparme, që në *Vena* alternohet mes *tə* e ε , në *Ginestra* mes *tə* e *a*, ndërsa në *Casalvecchio* elementi *tə* del në mënyrë të përgjithësuar në të gjitha kontekstet, varësisht në alternim me *a* në kontekstet që lidhen nga këpuja. Në fund, të dhënat që lidhen me emrat e farefisnisë tregojnë se nyja që lidh plotësisht emërore i paraprin njëjës së përparme të emrave të farefisnisë (krh. (6)).

(12) *Vena*

- | | | | | |
|--------------|-----------|----------------|---------------------|---------------------------------------|
| a. | bɪʃt-i | i | | matʃ-ə-sə |
| | bishti | Nyjë | | mace-fnj-Gjin |
| | 'bishti | i | | maces' |
| | kəmb-a | ε | | matʃ-ə-sə |
| | kəmba | Nyjë | | mace-fnj-Gjin |
| | 'kəmba | e | | maces' |
| | bɪʃt-ət | ε | | matʃə-vɛ |
| | bishtët | Nyjë | | mace-Gjin |
| | 'bishtët | e | | maceve' |
| a'.nə | kəmb | | | matʃ-ɛ-je |
| | një | kəmbə | | mace-fnj-Gjin |
| | 'një | kəmbə | | maceje' |
| a''.nə / ajo | kəmb tə | | | matʃ-ə-sə |
| | një / ajo | kəmbə | Nyjë | mace-fnj-Gjin |
| | 'një/ ajo | kəmbə e | | maces' |
| b. | bɪʃt-i t | asa-çə | | matʃ-ɛ / tə nɪ-çə matʃ-ɛ-je |
| | bisht | Nyjë | ajo-fs-Gjin | mace-fnj / Nyjë një-Gjin mace-fs-Gjin |
| | 'bishti i | asaj | | maceje / i një maceje' |
| c. | kjo | ɛʃt tə | nɛri- | u-tə |
| | kjo | është | Nyjë | njeri-mnj-Gjin |
| | 'kjo | është e | | njeriut' |
| | kjo | ɛʃt | nɪ-çə / ati-çə | nɛri- u-çə |
| | kjo | është një | -Gjin / ai.mnj-Gjin | njeri-mnj-Gjin |
| | 'kjo | është e | një / atij | burri' |
| d. | pɛ | bɪʃt-i-n | ε | matʃ-ə-sə |
| | pashë | bisht-mnj-Kall | Nyjëmace-fnj-Gjin | |
| | 'pashë | bishtin e | | maces' |
| | pɛ | bɪʃt-i-n | ε / tə | asa-çə matʃɛ |

- pashë bisht-mnj-Kall Nyjëajo.fnj-Gjin mace
'pashë bishtin e asaj maceje'
- e. kiə ɛʃt tə tə kuʃirir-i-tə
kjo është Nyjë Nyjë kushëri-mnj-Gjin
'kjo është e kushëririt'
mora dər-ə-nə ɛ tə mɔtr-ə-sə
mora dorën Nyjë Nyjë motër-Gjin
'mora dorën e së motrës'
- f. ki ɛʃt tə tə mað-i-tə / tə tə mað-je-sə
ky është Nyjë Nyjë madhe-mnj-Gjin /Nyjë Nyjë madhe-fnj-Gjin
'ky është i të madhit/ e të madhes'

Ginestra

- a. kjo iʃt biʃt-i i cən-ə-tə / i matʃ-ə-sə
kjo është bishti-mnj Nyjë qen-mnj-Gjin / Nyjë mace-fnj-Gjin
'ky është bishti i qenit/ i maces'
kəmb-ə-tə a matʃ-ə-tə
këmbë-t Nyjë macet-Gjin-sh
- a".nə kəmb tə cən-ə-tə
një këmbë Nyjëqenit-mnj-Gjin
- b. kəmb-a nə-i-ti matʃə/ cənə
këmbe një-Gjin mace/qen
'këmbe e një qeni/ e një maceje'
kapiλλ-i asa-j vaizə
flokū asaj.fnj-Gjin vajze
'flokū i asaj vajze'
- c. kjo iʃt i vaiz-ə-sə / i burr-ə-tə
kjo është Nyjë vajzës-fnj-Gjin /Nyjë burrit-Gjin/burrave-Gjin
'kjo është e vajzës/ e burrit/ e burrave'
ktə jan tə burr-ə-tə
këta janë Nyjë burrave-Gjin-pl
'këto janë të burrave'
- d. mora kəmb-ə-n a cən-ə-tə
mora këmbën-Kall Nyjë qenit-mnj-Gjin
'mora këmbën e qenit'
- e. mora dər-ə-n a sə mɔtr-ə-sə
mora dorën NyjëGjin motrës-fnj-Gjin
'mora dorën e motrës'

Casalvecchio


- a. kəmb-a tə cən-i-t /tə matʃ-a-s
këmbe Nyjëqenit-mnj-Gjin / Nyjëmaces-fnj-Gjin

- 'këmba e qenit/ e maces'
 bri-t tə ʎɔp-s
 brirët Nyjë lopës-Gjin
 'brirët e lopës'
- b. kəmb-a t ati-j / nə cən-i
 këmba Nyjë atij.mnj-Gjin / një qen-Gjin
 'këmba e atij/një qeni'
- c. kjo iʃt a / tə cən-i-t / matʃ-a-sə
 kjo është Nyjë qenit-mnj-Gjin / maces-fnj-Gjin
 'kjo është e qenit/e maces'
 ktɔ jan t asa-j vais
 këto janë Nyjë asaj.fnj-Gjin vajzës
 'këto janë të asaj vajzës'
- d. mɔra dor-ən tə sə mɔtr-ə-sə / t asa-j mɔtr
 mora dorën Nyjë Nyjë motrës-fnj-Gjin / Nyjë asaj-Gjin motre
 'mora dorën e motrës/ e asaj motre'
 pɛva kəmb-ən tə cən-i-t
 pashë këmbën Nyjë qenit-mnj-Gjin
 'pashë këmbën e qenit'
- e. kjo iʃt tə sə mɔtr-ə-sə
 kjo është Nyjë Nyjë motrës-fnj-Gjin
 'kjo është e motrës'


Nyja e përparme i dyfishon pra brenda sintagmës së gjinore vetitë referenciale të emrit ku gjinorja lidh përkatësinë, duke fiksuar denotimin. Do të kishim pra një strukturë të llojit në (13a), në të cilën nyja e përparme lidh një sintagmë që e përmban emrin me flektim në gjinore të shquar. Të dhënat në favor të këtij pozicioni të nyjës së përparme jepen nga kombinimet si ato në (12b), në të cilat nyja e përparme i paraprin përcaktuesit të emrit të varur, e paraqitur në (13b), si edhe nga kombinimet në (12e, 12f), në të cilat nyja që lidh gjinoren i paraprin nyjës së përparme të emrave të farefisnisë, si në (13c), ose të mbiemrit të emëruar, si në (13d); struktura e mbiemrit të emëruar do të diskutohet në 3.

(13) *Vena*


a.




b.



c.



d.



Strukturat në (13) e trajtojnë njëjën e përparme si një kokë të tipit D, pra si një lloj përcaktuesi të sintagmës emërore, vetitë referenciale të së cilës përkohjnë me ato të emrit emrit kokë ose të subjektit të ndërtimeve predikative, si në rastin e formimeve me këpujën *jam* në (12c); me fjalë të tjera, nyja e përparme përshtatet me emrin kokë/

subjekt i ndërtimeve predikative. Pra në mënyrë deskriptive i trajtojmë ndërtimet në (13) si kombinime të tipit ‘këmba e atij qeni’ etj. Për sa i përket formës së pashquar, pamë se ajo del edhe në kontekstet në të cilat emri kokë është në të pashquar (i paraprirë nga një përcaktues). Me fjalë të tjera, vendosja e *tə* ose *ε/a* jo të përshtatura lidhet me kontekstet në të cilat vetitë kuantifikuese të sintagmës janë leksikalizuar nga përcaktuesit, pavarësisht faktit nëse vendosen në D të emrit kokë ose në D të emrit të varur. Ky efekt shpjegohet me idenë që është propozuar këtu, atë që e quajmë gjinore përkon me elementin emërore që specifikon universin e referimit të emrit kokë.

Vendosja e *tə* (o *ε/a*) në këto kontekste na kujton shpërndarjen e nyjave të përparme të mbiemrit, në pg. 2 e në 2.1 do të shohim se kontekstet që lidhen nga një përcaktues seleksionojnë përgjithësisht një *tə* në vend të atyre të përshtatura. Mund të mendojmë se rastet e shqyrtuara këtu i japin një shpjegim të ngjashëm asaj që u propozua në pf. 1.3., në bazë të së cilës nyja e përparme jo e dife-rencuar del në kontekstet në të cilat vetitë referenciale të sintagmës janë fiksuar nga mekanizma të tjera. Në veçanti, e kemi lidhur vendosjen e *tə* me përmbajtjen e saj leksikore, që përkon me një ndryshore, referimi i së cilës është fiksuar nga dëftori. Në mënyrë të ngjashme mund të shpjegojmë mungesën e vendosjes së nyjës së përparme, në kontekstet predikative në (12c), në të cilat dëftori fiton vetitë e shquarsisë të të gjithë zinxhirit, dhe në kontekstet e pash-quara në (12a’), si *nə kəmb matf-ε-jε*. Në kontekstin e dytë këtu mungesa e nyjës që lidh gjinoren lidhet me interpretimin e pashquar të këtyre kombinimeve, që përjash-ton edhe vetitë referuese që sillen nga nyjat e përparme.

Nëse vetitë e shquarsisë së emrit të varur kanë vlerë interpretuese për gjithë sintagmën, mund të presim që seleksionimi i nyjës së përparme mund të regjistrojë veti të tilla, të paktën në disa kontekste. (12a’) tregon që nëse emri i gjinores është në të pashquarën, nyja e përparme nuk vendoset. Në të kundërt, një emër i varur i shquar kërkon (përveç se në *Ginestra*) njëjën edhe pse emri kokë lidhet

nëpërmjet një kuantifikuesi/ dëftori, si në (12a''). Përveç kësaj, prania e një përcaktuesi të emrit të varur mund të përjashtojë nyjën, si në kontekstet në (12b) në *Ginestra* dhe në kontekstet në (12b) në *Vena*. Formimet predikative të llojit në (12b) seleksionojnë përveç kësaj edhe një formë jo të diferencuar *tə* të nyjës. Sikurse mund ta prisnim, shpërndarja e fleksioneve të rasës në (12b) përkon me atë që pamë te dhatorja në (3iii.a-b), për shembull në *Vena*, ndërsa dëftori kombinohet me formën bazë, si në *t asa-çə matfə*.

2. Vetitë morfosintaksore të mbiemrit

Varietetet arbëreshe paraqesin lloje të ndryshme ndërtimesh mbiemërore. Ndërtimi me mbiemrin në pozicion prapaemëror të cilit i paraprin një formativ fleksiv, Nyjë, nyja e përparme, është ai që dëshmohet normalisht në varietetet arbëreshe dhe që do ta shqyrtojmë me kujdes të posaçëm. Nyja e përpërme regjistron vetitë e klasës emërore (gjininë) dhe të numrit dhe përshtatet me flektimin e mbiemrit dhe me atë të emrit (Solano 1972, Camaj 1984, Demiraj 1997, 2002). Nje grup i mbiemrave nuk e ka nyjën e përparme për të pasur mundësinë e të shfaqurit të flektimit të gjinisë e të numrit. Në fund, pranohet vendosja paraemërore e mbiemrit, i pajisur a jo me nyjën e paravendosur, përkritazi me interpretimin atributiv. Disa varietete të shqipes, si ai i *Vena-s*, nuk e pranojnë këtë pozicion, që megjithatë na del i reduktuar edhe në varietetet e tjera, përfshirë edhe standardin. Kombinimi *Nyjë - mbiemër* del në brendësi të sintagmës emërore dhe në ndërtimet predikative, si edhe në kontekstet këpujore. Paradigma e lakimit e këtyre mbiemrave leksikalizon përgjithësisht shumësin, për më tepër nëpërmjet formativit *-a* ose me alternues të specializuar (metafonetikë, të sufiksuar etj), në njëjës lakimi i klasës emërore e dallon femëroren, me flektim vokal, nga mashkullorja, duke u limituar te disa grupe. Në kombinim me një emër në varietetet e shqipes mbiemri nuk e regjistron shquarësinë dhe rasën – me fjalë të tjera, mbiemri ka lakim të pa-

shquar. Sikurse do ta shohim në pg. 3 në kontekstet e izoluarra mbiemri paraqet flektim të shquarsisë e të rasës.

Paradigma e standardit (Solano 1972) në kontekstet mbiemërore në emërore e kallëzore parasheh sistemimin si në (14). Në kombinim me një emër mbiemëror paraqet eventualisht vetëm flektim të klasës emërore e të shumësit, por jo edhe të rasës, sikurse në (14a). Në kontekstet e izoluarra (mbiemri i emëruar) mbiemri ka edhe flektimin e rasës, si në (14b). Kjo shpërndarje vlen si për mbiemrat me nyjë, ashtu edhe për ata që nuk e marrin nyjën. Rasti i fundit paraqet flektim të diferencuar për klasën emërore dhe shumësin vetëm në emërore, në (14a.i.) dhe (14a.ii.); *të* në kontekstet e pashquara në (14a.ii.) e paraqet nyjën e përparme të përshtatur me emrat neutralë. Në kallëzore, në (14a.ii.), del forma jo e diferencuar *të*. Ky kontrast karakterizon edhe kontekstet e emëruara, sikurse tregohet në (14b).

(14) nga Solano (1972)

a. kontekste me emër

- i. Emërore e shquar: emër nj – (i/e) – mbiemër pa fleksion për rasën
emër sh – (e) – mbiemër pa fleksion për rasën
Kallëzore e shquar: emër nj/sh – (e) – mbiemër pa fleksion për rasën
ii. Emërore e pashquar: emër nj – (i/e/të) – mbiemër pa fleksion për rasën
emër sh – (të) – mbiemër pa fleksion për rasën

Kallëzore e pashquar: emër nj/sh – (të) – mbiemër pa fleksion për rasën

b. Mbiemër i emëruar i shquar

Emërore: (i/e) – mbiemër me fleksion për rasën

Kallëzore (të) – mbiemër me fleksion për rasën

Si në sistemin e standardit, edhe në varietetet arbëreshe që janë shqyrtuar këtu, ka grupe mbiemrash që paraqesin flektime të specializuara për femëroren ose për shumësin, eventualishtalomorfe metafonetike ose konsonantike. Seria e nyjave të përparme përkon me atë të flektimeve emërore dhe përfshin *i* (mnj), *ε/a* (fnj), *tə* (Nyjë). Të dhënat në (15)-(17) nga dialekti i *Vena-s* përfaqësojnë shpërndarjen e tipit standrad të përshkruar në (14). Në veçanti, në kombinim me një emër mbiemri nuk e regjistron flektimin e shquarsisë e të rasës, por vetëm vetitë e klasës emërore ose të shumësit që përshtaten me

emrin. Këto kushte vlejné edhe për kont-ekstet predikative, sikurse edhe për kontekstet këpujore në (15), ku mbiemri përshtatet me një subjekt në emërore. Shembujt që vijojné tregojné edhe se si kuantifikues e mbiemrit vendosen në të majtë të nyjës së përparme.

(15) *Vena di Maida*

a.	është	i	traf	/ ε	traf
	është	mnj	trashë	/ fnj	trashë
	është	(mə)	(fum)	i	maθə / ε maðε
	është	më	shumë	mnj	madh.mnj / fnj madhe.fnj
	është	fum	mə	i	maθə
	është	shumë	më	mnj	madh.mnj
b.	jan	tə	trafa	/ təmbiðεɲ	
	janë	Nyjë	trasha/e.sh	/ Nyjë	trashë.sh

(16) sjell kontekstet emërore të sintagmës emërore në të cilat si nyja e përparme, ashtu edhe flektimi i mundshëm i klasës emërore /shumës i mbiemrit, përshtaten me emrin. Në (16a) është ilustruar kombinimi me emrin e shquar, në (16b) janë sjellë kontekstet me dëftor dhe kuantifikues të pashquar.

(16) *Vena*

a.	erθ	diał-i	i	maθ	/ vəkəçə
	erdhi	djali-Em.mnj	mnj	madh.mnj	/ vogël.mnj
	'erdhi	djali	i	madh	/i vogël'
	erθ	vazd-a	ε	maðε	/ vəgəłə
	erdhi	vajza-Em.fnj	fnj	e madhe.fnj	/ e vogel.fnj
	'erdhi	vajza		e madhe	/e vogël'
	erðə	kriatura-tə	tə	mbiðεɲə	/ vəgłə
	erdhën	fëmijët.sh-sh	Nyjë	medhenj.sh	/ vegjël.sh
	'erdhën	fëmijët		e mëdhenj	/ të vegjël'
b.	erθ	ɲə diaçə		i vəkəçə	
	erdhi	një djalë	mnj	vogël.mnj	
	erθ	ɲə vazdə	ε	vəgəłə	
	erdhi	një vajzë	fnj	vogël.fnj	
	erθ	ajovazdə	ε	vəgəłə	/ ε maðε
	erdhi	ajo vajza	fnj	vogël.fnj	/ Nyjë madhe.fnj

Në kontekstet kallëzore e në (17i.) si mbiemri ashtu edhe nyja e përparme paraqesin flektimin normal të klasës emërore; në veçanti nyja e përparme mban format *i*, *ε*, *tə* që dalin edhe në kontekstet në emërore.

(17) *Vena*

- i.a. *pε diaʎ-i-n i vɔkiçə / vazd-ə-nə ε vɔgiʎə*
 pashë djalin-mnj-Ak mnj vogël. mnj /vajzën-fnj-Kall fnj vogël.fnj
pε kriatura-t tə vɔgəʎa
 pashë fëmijët.sh-sh Nyjë vogla.sh
- b. *mɔra ɲə mbisal ε maðarεʎε*
 mora një mbulesë fnj të madhe.fnj
pε atə diaʎ i vɔkiçə / i maθə
 pashë atë djalë Nyjë vogël.mnj /Nyjë madh.mnj
- ii. a. *ja ðε diaʎ-i-t i vɔkiçə / vazd-ə-s ε vɔgiʎə*
 ia dhashë djalit-mnj-Dat mnj vogël.mnj / vajzës-fnj-Dat fnj vogël.fnj
ja ðε kriatura-ve tə vɔgəʎa
 ua dhashë fëmijëve.sh-Dhan.sh sh vegjël.pl
- b. *ja ðεɲi-çə vazde-je ε vɔgiʎə*
 ia dhashë një-Dat vajzeje.fnj-Dhan.fnj fnj vogël.fnj
ja ðε asa-çə vazdə ε maðε
 ia dhashë asaj.fnj-Dat vajze fnj vogël.fnj

Të dhënat e shqyrtuara në (15)-(17) na japin elementë për një analizë të parë të pozicionit të mbiemrit, të nyjës së përparme dhe të përshtatjes. Sikurse e kemi cekur, Manzini e Savoia (2005) pranojnë se bazat leksikore predikative, në rastin e shqyrtuar, emri dhe mbiemri, mbajnë të varur argumentin e detyrueshëm të bazës leksikore të paraqitur si N, që në varietetet arbëreshe mund të morfologjizohet nga një flektim i klasës emërore apo i shumësit. Përshtatja e flektimit të mbiemrit dhe ajo e emrit përkon me identifikimin e argumenteve N të leksikalizuara nga flektime të tilla.

Në varietetet arbëreshe përshtatja e emrit me mbiemrin përfshin vetëm një grup të vetive të leksikalizuara të flektimit emërore, duke përjashtuar rasën dhe shquarësinë. Për dallim nga gju-hët e tjera me morfologji të rasës, si në latinisht, ku përshtatja i kërkon mbiemrit tre-


guesit e rasës, në shqipe përshtatja ndan një grup vetish që përkojnë me ato të klasës emërore/shumës pikërisht si në gjuhët romane. Në të kundërt, rasa lidhet me vetitë e shquarsisë/kuantifikimit që e lidhin referimin me argumentin e vetëm të bazës predikuese. Sikurse e kemi diskutuar detajisht në pg. 1.2, nëse referimi fiksohet nga një përcaktues (dëftor/ i pashquar) flektimi i rasës leksikalizon vetëm një përcaktues dhe emri del në formë të pashquar (përveç morfologjisë të rasës së zhrëjtë). Nëse është flektimi i emrit që e fikson referimin, rasa leksikalizohet vetëm nga ky i fundit; në fund, kur është mbiemri që e fikson lidhjen, sikurse në kontekstet me izolim, flektimi i rasës del mbi vetë mbiemrin (pg. 3)

Mund ta shtrijmë edhe te kontekstet mbiemërore shpjegimin në pf. 1.2 për shpërndarjen plotësuese mes pranisë së një përcaktuesi dhe morfologjizimit të vetive të shquarsisë/rasës nga ana e flektimit të emrit. Pranojmë pra se prania e një formativi të shquarsisë është e mjaftueshme për të leksikalizuar vetitë referuese të të gjithë sintagmës emërore, përfshirë edhe ato të mbiemrit që e ka të përbashkët argumentin me emrin. Pra interpretimi i një bashkëlidhjeje *mbiemër-emër* si *vazd-a ε maðe* ‘vajza-Em.fnj Nyjë.fnj madhe.fnj’ në (16) është se kryqëzimi i vetive *vazd-* e *mað-* predikohet për të njëjtin individ, pra -a, ε, -ε. Përshtatja është pra një parakusht i këtyre vetive interpretuese, në kuptimin që regjistron veti morfosintaksore që përputhen me këtë interpretim. Kjo mënyrë e konceptimit të përshtatjes mbiemërore sugjeron që mbiemri përkon me një pikë të vendosjes emërore N, brenda sintagmës emërore. Natyrisht, sikurse e kemi sugjeruar në pg. 1, mbiemri, si edhe emri dhe folja, projekton serinë e projekteve argumentuese të treguar në (1) dhe është i analizueshëm nga aspekti i tij i brendshëm si kombinim i një rrënje predikative dhe një argumenti të detyrueshëm N.

Mund të jetë e vlefshme të konsiderojmë sërish kontekstet në të cilat mbiemri paraprihet nga një emër ferefnisnie. Marrim sekuencën *ε kuðirir-a ma ε maðe* ‘kushërira më e madhe’, e sjellë në (5a) nga

Vena. Mund ta krahasojmë me strukturën në (17), në të cilën emri është në pozicion F të sintagmës, ndërsa mbiemri është vendosur në pozicion në një pozicion të brendshëm të sintagmës. Flektimi $-\varepsilon$ i femërores njëjës të mbiemrit leksikalizon vetitë e klasës emërore që lidhen me argumentin e brendshëm të bazës leksikore, si u propozua në (7) ose si në (2), për gjuhët romane. Në (17) nyja e përparme është vendosur në brendësi të sintagmës së mbiemrit, sikurse pranohet në përgjithësi nga studimet bazuar mbi faktin se nyja e përparme nuk mund të ndahet nga mbiemri nga material tjetër leksikor (Dimitrova-Vulchanova e Giusti 1998, Turano 2002, 2003, Giusti e Turano 2007). Edhe pozicioni i kantifikesave mbiemërorë, si *mə* ‘më’, e justifikojnë këtë strukturë, duke qenë se i paraprijnë nyjës së përparme, pra ε në (17). Rendi *Q-Nyjë-Mbiemër* vërteton analizën e diskutuar përta i përket (9), ku nyja e përparme zë një vend D të ulët, që lidhet menjëherë me zonën e mbiemrit. Pra, nëse sipas asaj që trajtuam në (1), (9), elementi *mə* vendoset në Q, dalim në përfundimin se elementi kuantifikues zë një pozicion Q të projektuar në zonën më të lartë C_1 .

(17) *Vena*



Për dallim nga analiza në (17), studimet mbi emëroren me nyjën e prapavendosur të gjuhëve ballkanike shkojnë te lëvizja e emrit në një pozicion më të lartë, D ose Fokus, sikurse është propozuar veçanërisht nga Dimitrova-Vulchanova e Giusti (1998), dhe në një kornizë teorike të ndryshme nga Turano (2003, 2003). Dimitrova-

Vulchanova dhe Giusti (1998) pranojnë se pozicioni bazik i mbiemrit është paraemëror dhe që dy rendet *N-Mb* e *Mb-N* janë megjithatë rezultat i lëvizjes. Nëse emri ngjitet në një pozicion të lartë të Fokusi i sintagmës emërore krijohet rendi *N-Mb*, ndërsa mbiemri ngjitet në pozicion Spec të Focus/D, është mbiemri ai që kontrollon pjesëzat e shquarsisë së D, duke përcaktuar rendin *Mb-N*. Analogjikisht, Turano (2002, 2003), duke ndjekur Cinque (1995), pranon se mbiemri zë një pozicion specifikimi të një koke e cila e dominon sintagmën emërore, ndaj rendi emër-mbiemër vjen si rezultat i lëvizjes së N në D. Hipoteza e zhvilluar këtu pranon se rendi Emër-Mbiemër përkon me rendin bazik të strukturës, në të cilën mbiemri dhe projektimet e tij të mundshme vendosen në një zonë të ulët të emrit (Manzini e Savoia 2005).

2.1. Mbiemri në arbërishten e Ginestra-s dhe Casalvecchio-s

Në *Ginestra* e *Casalvecchio* ka një sistem që largohet pjesërisht nga ai që normalisht dëshmohet në varietetet e tjera të shqipes, përfshirë edhe të dhënat e *Vena-s* në (15)-(17). Mbiemrat me nyje të përparme paraqesin, të paktën në kontekstet këpujore, morfologji flektive, sikurse ilustron në (19) për *Casalvecchio*-n dhe në (15) në *Ginestra*. Mbiemri ka flektime të specializuara për klasën emërore në njëjës, si në (a) e (b), dhe për shumësin, në (c), respektivisht *mnj/fnj* e *sh*.

(19) Casalvecchio

- | | | | | | | | |
|----|-------------|----------|---------|------------|---------------|--------------------|-----------|
| a. | kjo sedz | ift | a | maða / | a | nɔgʎa | |
| | kjo karrige | është | fnj | madhe.fnj/ | fnj | vogël.fnj | |
| b. | ki | bukir | ift | i | maði / | i | nɔgʎi |
| | ky | gotë | është | mnj | madhi.mnj/ | mnj | vogli.mnj |
| | 'kjo | gotë | është | e | madhe/ | e | vogël |
| c. | ktɔ | sedz / | bukira | jan | tə məðɛɲəra / | tənegʎa | |
| | këto | karrige/ | gota.sh | janë | sh mədha.sh / | shvogla.sh | |
| | 'këto | karrige/ | këto | gota | janë | të mədha/të vogla' | |

Në dialektin e *Ginestra-s* përshtatja në klasën emërore të mbiemrit gjeneron morfologjinë e mashkulores edhe në kombinim me emrat femërorë. Të dhënat në (20) tregojnë kombinimin e njëjës së përparme mashkullore njëjës *i* dhe të flektimit-*i* mashkullore njëjës të mbiemrit si te emrat femërorë me flektim në emëroremë *-a*, ashtu edhe me emra mashkullorë me flektim në emërore më-*i/u*, në (b). Shumësi në (c) nuk e dallon klasën emërore. Në (d) është ilustruar rendi *Q-Nyjë-Mb*.

(20) *Ginestra*

- a. treiz-a iʃt i maði / i ʎartri /i reju
 tavolinë-Em. fnj është mnj madhe.mnj / mnj lartë.mnj / mnjri.mn
 'tavolina është e madhe/ e lartë/ e re'
- b. bukir-i iʃt i maði /i ʎartri /i reju
 gotë-Em.mnj është mnj madh.mnj / mnj larte.mnj / mnj ri.mnj
 'gota është e madhe/ e lartë / e re'
- c. jan tə mbə'ða / tə ʎertra / tə reja
 janë Nyjë mëdha.pl / Nyjë larta.pl / Nyjë reja/pl
- d. kjo bukir iʃt mə i maði
 kjo gotë është më mnj madhe.mnj


Nga ky sistem ndahen emrat e frymorëve, te të cilët nyja e përparme dhe flektimi emërore i mbiemritkanë përshtatje totale, pra përshtaten edhe në flektimin e klasës emërore, si në (21a) për mashkulloren dhe në (21b) për femëroren; (21c) ilustron shumësin.

(21) *Ginestra*

- a. bur-i iʃt i ʎartri /i maði i vɔgʎi
 burri-Em.mnj është mnj lartë.mnj / mnj madh.mnj/mnj vogël.mnj
- b. greua iʃt a ʎartra / a maða / a vɔgʎa
 gruaja.Em.fnj është fnj lartë.fnj / fnj madhe.fnj / fnj vogël.fnj
 'gruaja është e lartë/ e madhe'
- ajo greua iʃt a vɔgʎa
 ajo grua është fnj vogël.fnj
- c. jan tə ʎertra / tə mbə'ða / tə vɛgʎa
 janë Nyjë larta.sh / Nyjë mëdha.sh / Nyjëvogla.sh
 'janë të lartë/larta të mëdha të vɛgʎël/vogla'

Nyja në klasën emërore realizohet pra me emra në të cilët klasa emërore është përzgjedhur në përputhje me vetitë referenciale, si në (16a, b). Me emrat jofrymorë, si në (20), flektimi nuk leksikalizon dallimin mes klasave emërore, por leksikalizon një veti denotuese të pandryshueshme. Kjo shpërndarje vërteton analizën e propozuar, ndaj flektimi i mbiemrit në këto kontekste, më përpara leksikalizon vetitë referenciale (klasë emërore/shumës) të ngjashme me ato të gjuhëve romane, sesa vetitë që kanë të bëjnë me interpretimin e rasës. Më saktësisht, flektimi sinjalizon thjesht klasën emërore. Sikurse është propozuar në (2) për flektimin roman dhe në (6)-(7) për atë të shumësit të emrave / mbiemrave në shqipe, është e natyrshme të pranosh se në këto kontekste flektimi i mbiemrit leksikalizon pozicionin e brendshëm të fjalës N, si në (22a), dhe jo pozicionin D të emërores, si është propozuar për flektimin me interpretim emërore të emrave në (6).

Përsa i përket kontekstit në të cilin *jam* kombinohet me mbiemrin në pozicion predikativ, rimarrim analizën e ‘*jam*’ të diskutuar në pf. 1.4.3. Sipas Manzini e Savoia (2007), mbiemri vendoset në një pozicion argumentues të ulët në të djathtë të foljes kryesore, hipotetikusht pozicioni D përkon me argumentin EPP të foljes ‘*jam*’, që e kemi identifikuar me një folje që nuk merr role argumentuese, lidhet vetëm me një argument EPP. Argumenti N i mbiemrit fikson pra vetitë referenciale që lidhen me subjektin e fjalisë. Sikurse e kemi parë, përshtatja mes subjektit leksikor, IIIshnj e foljes dhe flektimi i mbiemrit, paraqesin parakushtin për identifikimin e pozicioneve D e N në (22b), që interpretohen në referim me të njëjtin individ, atë që e zëvendëson i vetmi argument i mbiemrit.



Si përfundim, në varietetet e *Ginestra-s* e *Casalvecchio -s* prania sistematike e flektimit të klasës emërore të mbiemri në kontekstet këpujore mund të trajtohet si një pajisje e gramatikës arbëreshe me sistemin e përshtatjes së tipit roman, në të cilin flektimi i mbiemrit, në kontekstet këpujore, vepron për të fiksuar vetitë e klasës emërore. Më saktësisht, flektimi i mbiemrit në kontekstet këpujore që del në këto varietete nuk i regjistron vetitë e rasës, por vetëm vetitë e klasës emërore, pikërisht si në varietetet romane.

Në brendësi të sintagmës emërore del një shpërndarje e ndryshme e morfologjisë flektive. Në *Ginestra* nëse sintagma emërore është në emërore, sikurse në rastin kur është subjekt i fjalisë, shfaqen të njëjtat kushte të mundshme që janë ilustruar në (15)-(17), me një një të përparme dhe flektim me përshtatje me emrin. Vlen e njëjta shprehje edhe mes emrave të njerëzve, me përshtatje të plotë, në (23a), dhe emrave të tjerë, me përshtatje në mashkullore, si në (23b). (23c) ilustron kontekstet në shumës.

(23) *Ginestra*

- a.
- | | | | |
|--------|--------------|-----|-----------|
| γerði | bur-i | i | λartri |
| erdhi | burri-Em.mnj | mnj | lartë.mnj |
| 'erdhi | burri | i | gjatë' |
| vaiz-a | a maða | iʃt | ktu |

- vajza-Em.fnj fnj madhe.fs është këtu
 'vajza e madhe është këtu'
- b. kə'tu iʃt məsal-a i ʎiri
 këtu është mbulesa-Em.fnjmnj pistë.mnj
 'këtu është mbulesa e pistë'
 kə'tu iʃt bukir-i i ʎiri
 këtu është gota-Em.mnj mnj pistë.ms
 'këtu është gota e pistë'
- c. ɣertən kriaturə-tə / vaʃurə-tə tə vegʎa
 erdhën fëmijët.sh-sh / vajzat.sh-sh Nyjë vegjël/ vogla.sh

Analogjikisht, në dialektin e *Casalvecchio*-s, në brendësi të sintagmës emërorja, në kombinim me emrin, përveç nyjës së përparme del edhe flektimi, të dy të përshtatur me emrin, sikurse është ilustruar në (24).

- (24) Casalvecchio
 ɣerði jaʎ-i (mə/ʃum) i noɣʎi
 erdhi djali-Em.mnj (mə/shumë) mnj vogli.mnj
 'erdhi djali më i vogli'
 mə kə-ndetməsal-a a reja
 më pëlqen mbulesa-Em. fnj fnj re.fnj
 'mbulesa e re më pëlqen'
 ɣerðənə kriaturə-tə tə məðerəra
 erdhën fëmijët-sh-sh Nyjë mëdhenj.pl
 'erdhën fëmijët e mëdhenj'

Kjo lloj përshtatjeje karakterizon edhe sintagmat në emërore që lidhen nga një kuantifikues i pashquar ose nga një dëftor, si në (25).

- (25) Ginestra
 ktu iʃt ɲə məsal i reju
 këtu është një mbulesë Nyjë re.mnj
 'këtu është një mbulesë e re'
 aɲə vaiz a maða iʃt jəmə biʎe
 ajo-Em vajzë fnj madhe.fnj është ime bijë.fnj
 ɣerði ai bur i ʎartri
 erdhi ai-Em burrë mnj i gjatë.mnj
 ɣertən di kriatura tə vegʎa

erdhën dy fëmijë.sh Nyjë vegjël.sh
 ʎertən ac bura ʃum tə mbə'ða
 erdhën aq burra shumë Nyjë mëdhenj.sh

Casalvecchio

ʎerði ɲəʃaɫ i nɔɣɫi
 erdhi një djalë mnj vogël.ms
 'erdhi një djalë i vogël
 ʎerði ɲə vaiz (ʃum) a nɔɣɫa
 erdhi një vajzë shumë fnj vogël.fnj
 'erdhi një vajzë shumë e vogël'

Për dallim nga ndërtimet në emërore, në *Ginestra* në sintagmat në kallëzore del një formë jo e eptuar e mbiemrit. Në *Ginestra* nyja e përparme është *a* (Nyjë) nëse emri ka formë të shquar, si në (26a), ndërsa nëse emri është në të pashquarën merr *tə* ose *a*, si në (26b). Në *Casalvecchio* dalin dy mundësi: ose vendoset një seri formativësh të eptuar me mbiemër të eptuar, ose vendset *tə* me një mbiemër jo të flektuar.

(26) *Ginestra*

- a. pejë vaiz-ə-nə / bur-ə-nə a/ tə ɫartrə
 pashë vajzën-Kall/ burrin-Kall Nyjë gjatë/ gjatë
 mɔra sɛdʒ-ə-n a vɔɣɫə / a maðə
 mora karrigen-Kall Nyjë vogël/Nyjë madhe
- b. pejë atə/ ɲə bur tə ɫartrə
 pashë atə/ një burrë Nyjë gjatë
 pejë atə vaiz tə mað(-ənə)
 pashë atə-Kall vajzë Nyjë madhe(-Kall)
 mɔra ɲə bukir mə tə maðə
 mora një gotë më Nyjë madhe

Casalvecchio

- a. peva kriatur-i-n mə i nɔɣɫi
 pashë fëmijën-mnj-Kall më mnj vogël.mnj
 peva trim-i-n mə tə maðə
 pashë djalin-mnj-Kall më Nyjë madh
- b. peva ɲə kriatur ʃum i nɔɣɫi
 pashë një fëmijë shumë mnj vogël.mnj
 peva atə vaiz mə tə maðə

pashë atë vajzë më Nyjë madhe

Kontekstet në dhanore paraqesin të njëjtat kushte me ato të kallëzores në (26). Në prani të formave emërore të shquara me flektim të dhanores mbiemri nuk është i flektuar dhe del nyja e përparme *a*, si në (27a). Në kombinim me një dëftor me flektim në dhanore, mbiemri nuk e ka flektimin dhe del nyja e përparme *tə*. Duke lexuar të dhënat në *Ginestra* duhet pasur parasysh se emri nuk parasheh një formë oblike në paradigmen e pashquar.

(27) *Ginestra*

- | | | | | |
|-------|--------|---|------------|-----------------|
| a. ja | ðejə | diaʎ-ə-tə/ vaiz-ə-sə | a | maðə |
| ia | dhashë | djalit-Dat/vajzës-Dat | Nyjë | madhe |
| | ‘ia | dhashë djalit të madh/ vajzës së madhe’ | | |
| b. ja | ðejə | asa-j grua tə maðə | / ate-jti | bur tə ʎartərə |
| ia | dhashë | asaj-Dat gruaje Nyjë madhe/ atij-Dat | burri Nyjë | gjatë |
| | ‘ia | dhashë asaj gruaje të madhe/ atij | | burri të gjatë’ |
| ja | ðejə | atir-v-ra bura tə ʎertra | | |
| ua | dhashë | atyre-Dat burra.sh | | Nyjë gjatë.sh |


Të dhënat e shqyrtuara në këtë pg. vërtetojnë propozimin e bërë në pg. 2, në bazë të të cilit përshtatja e mbiemrit me emrin regjistron vetëm vetitë e klasësemërore. Edhe në varietetet në *Ginestra* e *Casalvecchio* në (19)-(26) të dhënat, në fakt, e paraqesin përshtatjen të limituar të flektimi i klasës emërore/shumës. Në këto dy varietete shfaqet një kontrast mes pranisë së mbiemrit të flektuar të klasës emërore/ shumësnë kontekstet në emërore në (19)-(25), dhe futja e formave pa flektim të klasës emërore në kontekstet në kallëzore në (26) dhe të zhdrejtën në (27). Nëse analiza e deri tanishme është e saktë, mund ta lidhim këtë shkëputje me natyrën e ndryshme të flektimit të rasës të pranishëm të emri. Në kontekstet në emërore morfologjia e rasës leksikalizon argumentin e varur nga baza leksikore si në D; për dallim nga emri, mbiemri mbart veti të klasës emërore si flektimi i llojit N, që na dalin përplotësues në flektimin e emrit për të fiksuar referimin, si në (28a).

Në kontekstet në kallëzore dhe në rasën e zhdrejtë flektimi i emrit është nga njëra anë i tipit N, si tregohet në (7b) dhe (28b); në pg. 2 pamë se ky flektim merr të gjithë serinë e vetive referuese të mjaftueshme për të fiksuar referimin e argumentit të brendshëm të bazave emërore dhe mbiemërore. Nëse i japim një status flektiv vokales qendrore që varieteti i *Ginestra-s* e vendos normalisht në pozicion fundor të fjalës, mund ta identifikojmë me një flektim të tipit N që nuk i merr vetitë referenciale specifike, sikurse është sugjeruar në (28b).


Fakti se përcaktuesi nuk ka morfologji flektive të specializuara për rasën, që në fakt leksikalizon nëpërmjet alternanteve leksikore, mund të shpjegojë pse në kontekstet me dëftor /kuantifikues të pa-shquar në (26b) pranohet flektimi i rasës për mbiemrin.

(28) *Ginestra*

a.



b.



Shqyrtojmë në këtë pikë përzgjedhjen e njëjës së përparme. Në kontekstet në emërore nyja e përparme merret me përshtatje, pra *i*, *a* në kontekstet njëjës sipas klasës së emrit dhe *tə* kontekstin shumës. Në kontekstet në kallëzore e dhanore në *Ginestra* ka një shpërndarje të reduktuar, ku nëse emri ka flektim të shquar të rasës, si në (26a), vendoset një formativ zanor i klasës emërore, pra *a* ose *təsi* alternativë. Kur emri nuk ka flektim të shquar të rasës në kombinim me një

kuantifikues të pashquar si *një* ose me një element të shquarsisë si një dëftor, futet formativi *tə*. Me fjalë të tjera, përzgjedhja e *nyjës së përparme* është e ndjeshme ndaj vetive të shquarsisë e të rasës të leksikalizuara nga emri.

Përzgjedhja *etə* në kontekstet në kallëzore e dhanore në (26)-(27) mund të shpjegohet në të njëjtën mënyrë të cilën e përshtatëm për mungesën e flektimit të përshtatjes te mbiemri. Në kontekstet në kallëzore/ dhanore flektimi i rasës së emrit, kur është i tipit N, si në (28b), fiton të gjithë serinë e vetive të mjaftueshme referenciale për të fiksuar referimin e argumentit të brendshëm të bazave emërore dhe mbiemërore, duke përjashtuar, përveç flektimit emërore të mbiemrit, serinë e *nyjave të përparme* që morfologjizojnë klasën emërore. Elementi *tə*, që nuk ka përmbajtje të klasës emërore, në fakt ka efektin e mbartjes së një ndryshoreje denotimi i së cilës është fiksuar nga kuantifikuesi i pashquar *një*, nga dëftori apo nga vetitë referuese të leksikalizuara nga flektimi i emrit. Në alternativë me *tə* kontekstet me një emër të shquar në (26a) marrin *a*, duke neutralizuar interpretimin e zakonshëm të femërores *nyjës* lidhur me *a*, prandaj ky formativ ka nga ana e tij efektin konkret të mbartjes së një ndryshoreje.

Në varietetet arbëreshe, përfshirë edhe standardin, dëshmojnë edhe ndërtime me mbiemër preemërore. Të dhënat në *Ginestra* në (29) ilustrojnë këtë shpërndarje në kontekstet në emërore në (29a) dhe në ato në kallëzore në (29b).


(29) *Ginestra*

a.	γερði	ajəa	ʃkreta	greəa	/ai	i	ʃkreti	burə
	erdhi	ajəfnj	shkreta.fnj	grua	/ai	mnjshkreti.mnj		burrə
b.	pejə	atə	tə	ʃkret-ə-nə				burə
	pashə	atə	Nyjə	shkretin-Kall				burrə
	pejəmə	tə	vabək-ə-nə					burə
	pashə	mə	Nyjə	vobektin-Kall				burrə

Për dallim nga kontekstet në (26b), mbiemri preemërore paraqet flektime të kallëzores, ndërsa emri del në formë jo me flektim, duke i

dhënë vend një lloji të përshtatjes të ngjashëm me atë që karakterizon kontekstet me përcaktues preemërore, sikurse tregohet në (39). Turano (2002) e shpjegon pozicionin paraemëror të mbiemrit bazuar te lëvizja e mbiemrit në një pozicion C, të tipit përfaqësues, brenda sintagmës emërore. Dimitrova-Vulchanova e Giusti (1998), e pranojnë që mbiemri lëviz në një pozicion të lartë të sintagmës ku krijohet konteksti në të cilin mbiemri i flektuar mund të kontrollojë pjesëzat që përkojnë me D. Megjithatë (29b) tregon se edhe në prani të një përcaktuesi, mbiemri preemërore e ka flektimin e rasës, gjë që sugjeron që mekanizmi i përshtatjes është i lidhur qartë me reduktime që nuk na drejtojnë menjëherë te kontrolli i thjeshtë i pjesëzave. Nyja e përparme është *tə*, si në (29b), në vend të disa formave të nyjës së përparme të përshtatura nga flektimi emërore. Nëse do të ndjekim trajtimin e mbiemrave preemërore të gjuhëve romane me interpretim atributiv propozuar nga Manzini e Savoia (2005), mund të themi se pozicioni preemërore lidhet me një interpretim të njëhësuar (rindërtim) të strukturave të mundshme argumentuese. Prania e flektimit të shquarsisë /rasës te mbiemri edhe në kombinim me një përcaktues regjistron njëhësimin interpretues të mbiemrit dhe emrit, pavarësisht nga vetitë e shquarsisë të përcaktuesit, që i referohen sintagmës në kompleksitetin e vetë.

(30) *Ginestra*



3. Mbiemri i emërzuar

Të dhënat në (31) ilustronë kontekstet me mbiemra të emërzuar në emërore, kallëzore e dhanore në *Ginestra*, *Casalvecchio* e *Vena*. Në kontekstet në të cilat del në izolim mbiemri paraqet flektim të tipit

emërore, pra me morfologji të shquar /të rasës. Në kontekstet në emërore në (31a) nyja e përparme paraqet alternueset me flektim *i, ε/a, tə*; në kontekstet në kallëzore në (31d) nyja e përparme paraqet formën jo të diferencuar *tə*. (31b) e sjell mbiemrin të cilit i paraprin dëftori në kontekst në emërore; në (31e) është ilustruar konteksti i kallëzores me mbiemër të cilit i paraprin një dëftor; në të dyja rastet nyja e përparme paraqet, përveç (31e) në *Vena*, formën jo të diferencuar. (31c) e (31f) ilustrojnë kontekstet, në emërore, respektivisht kallëzore, me kuantifikues të pashquar. Në (31g, 31h) janë sjellë shembuj nga kontekstet në dhanore në të cilat ka një shpërndarje që përkon me atë të kallëzores.

(31) Ginestra

- a. *yerði* i maði/ a maða
erdhi mnj madhi.mnj/ fnj madhe.fnj
'erdhi i madhi/ e madhja'
- b. *yerði* ajo a maða
erdhi ajo fnj madhe.fnj
'erdhi i madhi/ e madhja'
vertəno (a'tə) tə vɛʝəλ(-tə)/ tə mbə'ða(-tə)
erdhën (ata/o) Një vegjël.sh(-sh)/ Një mëdhatë.sh(-sh)
'erdhën ata të vegjlit/ të mëdhatë'
- c. *yerði* jə i maði / jə a maða
erdhi një mnj madh.mnj / një fnj madhe.fnj
- d/e. *pejə* (a'tə)tə λartərə(-nə) /tə vɔgλə(-nə)
pashëatë Njëgjinat/ën-Kall / Një voglin/ën-Kall
- f. *pejə jə* tə λartərə / tə vɔgλə
pashë një Njëgjinatë / Një vogël
'(e) pashë një të gjatë/ të vogël'
- g. ja ðejə asa-j tə maðə
ia dhashë asaj-Dat Një madhes
'ia dhashë asaj të madhes'

Casalvecchio

- a/b. ar'ru (aji) i maði/ (a'jə) a maða
arriti (ai) mnj madh.mnj/ (ajo) fnj madhe.fnj
ar'run (a'tə) tə mə'ðejəra
arritën (ata/o) Një mëdhenj.sh
- c. *yerði* jə i maði / jə a maða
erdhi një mnj madh .mnj / një fnj madhe.fnj

- d. peva tə mað-i-n / tə mað-ə-n
pashë Nyjë madhin-mnj-Kall / Nyjë madhen-fnj-Kall
- e. peva atə tə bukr(-ə-nə)
pashë atë Nyjë bukurin/ën(Kall)
- f. peva jə i maði /jə a maða / jə tə mað
pashë një mnj madh.mnj/una fnj madhe.fnj / një Nyjë madhe
Vena di Maida
- a. erθ i vɔgəli / ε vɔgəla
erdhi mnj vogli.mnj / fnj vogla.fnj
'erdhi i vogli/ e vogla'
erðə tə vɔgla
erdhën Nyjë voglat.sh
'erdhën të vegjlit /të voglat'
- b. erθ ai i vɔkiçə / ajɔε vɔgiłə
erdhi ai mnj vogli.mnj / ajo fnj vogla.fnj
- c. erθ jə i vɔkiçə / ε vɔgiłə
erdhi një mnj vogël / fnj vogël
- d. pe tə vɔgł-i-nə / tə vɔgł-ə-nə / tə vɔgłə-tə
pashë Nyjë voglin-mnj-Kall/ Nyjë voglën-fnj-Kall/ Nyjë voglat-sh
'pashë të voglin/ të voglën/ të vegjlit/të voglat'
- e. pe a'tə i vɔkiçə.ms / ε vɔgiłə/ a'tə tə vɔgiłə
pashë atë mnj voglin/ fnjvoglën.fnj/ ata/o Nyjë vegjlit/voglat
'pashë atë të voglin/ të voglën/ ata /o vegjlit/voglat'
- f. pe jə i vɔkiçə / jə ε vɔgiłə
pashë një mnj vogël.mnj/ një fnj vogël.fnj 'pashë një të vogël/ të vogël'
- g. ja ðe tə vɔgł-i-tə / tə vɔgł-ə-sə / tə vɔgłə-ve
ia dhashë Nyjë voglit-mnj-Dat/ Nyjë voglës-fnj-Dat /Nyjë voglave-Dhan.sh
'ia dhashë të voglit/ të voglës/ të/vegjëlve/voglave'
- h. ja ðe a'ti-çə i vɔkiçə
ia dhashë atij.mnj-Dat mnj voglit.mnj
'ia dhashë atij të voglit'
ja ðe a'sa-çə ε vɔgiłə / ε maðe
ia dhashë asaj.fnj.-Dat fnj voglës.fnj / fnj madhes.fnj
'ia dhashë asaj të voglës
ja ðe a'tir-εtə vɔgłə-ve
ia dhashë atyre.sh-Dat Nyjëvoglave.sh-Dhan.sh
ja ðe jɪ-çə i vɔkiçə/ ε vɔgiłə
ia dhashë një/-Dat mnjvogli/ fnj vogle
ja ðe atirə / atirə-ve tə vɔgiłə(-ve)
ia dhashë atyre- sh-Dhan.sh Nyjëvoglave.sh(-Dhan.sh)

Sikurse duket në të dhënat në (31a,d) në të gjitha varietetet mbiemrat e emëruar në izolim veprojnë si emrat e farefisnisë në (5): në emërore përzgjedhin flektimin e shquar të emërores dhe nyjës së përparme me flektim; në kallëzore paraqesin flektimin kallëzore të specializuar, ndërsa nyja e përparme ka formën jo të shquar *tə*. Prania e dëftorit e vendos formën jo të diferencuar të nyjës së përparme si në emërore, ashtu edhe në kallëzore në *Ginestra*, ku kallëzorja mund të përjashtojë edhe flektimin e shquar të rasës të mbiemri, si në (31b, 31e). Në *Casalvecchio* dëftori përzgjedh formën jo të diferencuar të nyjës së përparme vetëm në kallëzore, si në (31e). Në kombinim me një kuantifikues të pashquar kontekstet emërore në (31c) paraqesin formën me flektim si të nyja e e përparme, ashtu edhe të mbiemri; në kallëzore në (31f) në *Ginestra*, dhe në mënyrë fakultative në *Casalvecchio*, del nyja e përparme jo e diferencuar dhe forma e mbiemrit pa flektim. Në *Vena*, përveç kontekstit në kallëzore të mbiemrit të emëruar, si në kontekstet me dëftor, ashtu në ato me kuantifikues të pashquar, leksikalizojnë nyjën e përparmedhe mbiemrin me flektim.

Tabela në (32) skematizon leksikalizime të ndryshme të mbiemrit dhe të nyjës së përparme në sintagma që nuk e kanë emrin. Në (32) të kollona në të majtë tregohen kontekstet që përkrijnë vetëm me mbiemrin (emërore (Nom) e kallëzore (Kall)), kontekstet me element dëftor dhe ato që marrin indefinitin. *Nyjë.fleks* dizajnon nyjën e përparme me flektim për klasën emërore /shumës, pra *i, ε/a, tə*; *Nyjë* dizajnon formën e paravendosur jo të diferencuar *tə*; *Mb.fleks/Mb.Kall* dizajnon mbiemrin me flektim të rasës, ndërsa *Mb* tregon mbiemrin pa flektim të shquar të rasës.

(32)	<i>Ginestra</i>	<i>Casalvecchio</i>	<i>Vena</i>
(31a)	Em	Nyjë.fleks-Mb.fleks	Nyjë.fleks-Mb.fleks
(32d)	Kall	Nyjë-Mb.Kall	Nyjë-Mb.Kall
(31b)	DëftEm	Nyjë-Mb.fleks	Nyjë.fleks-Mb.fleks
(31e)	DëftKall	Nyjë-Mb.(Kall)	Nyjë-Mb.(Kall)
(31c)	E pashquarEm	Nyjë.fleks-Mb.fleks	Nyjë.fleks-Mb.fleks
(31f)	E pashquarKall	Nyjë-Mb	Nyjë.fleks-Mb.fleks/ Nyjë-Mb

Korniza e mikrovariacionit e ilustruar në (32) na sugjeron disa përgjithësime empirike. Në fakt, ndarja mes emërores dhe kallëzores në kontekstet në të cilat mbiemri del i vetëm, në formë të emëruar, regjistrohet sistematikisht nga dy varietete, përfshirë edhe gramatikën standard (shih (14b)). Në emërore si nyja e përparme ashtu edhe mbiemri janë plotësisht të flectuar, ndërsa në kontekstet në kallëzore (dhe rasën e zhdrejtë, shih (31g)) nyja e përparme ka formën $t\theta$ jo të diferencuar edhe pse në prani të flectimit të përshtatjes e të rasës te mbiemri. Kombinimi me një dëftor ose një kuantifikues të pashquar merr njëjën e përparme jo të diferencuar në *Ginestra* dhe, të limituar në kallëzore, në *Casalvecchio*. Përveç kësaj, në *Ginestra*, dhe opsionalisht në *Casalevecchio*, kallëzorja del me formën jo të flectuar të mbiemrit; nyja e përparme ka formën jo të diferencuar $t\theta$ dhe mbiemri nuk është i flectuar. Një përgjithësim empirik që vjen nga (31) është se forma e njëjës së përparme në një kontekst të caktuar mund të dalë vetëm nëse kjo është e pranueshme në kontekstin kallëzore të izoluar, sikurse sugjerohet nga relacioni në (33). Me fjalë të tjera, ky i fundit është konteksti në të cilin normalisht gjejmë formën jo të flectuar:

(33) Nyjë-Mb.fleks në një kontekst $X \supset$ Nyjë-Mb.fleks në kontekst të izoluar në kallëzore

Relacioni i fiksuar në (33) na rishpie te kontrasti mes flectimit emërore dhe atij kallëzore në bazë të sistemit të rasës në shqipe, duke na kujtuar kushtet e ndarjes të personave të intervistuar te Manzini e Savoia (2005, 2007, 2008). Në fakt, mund ta mendojmë emërorensi leksikalizimin e subjektit nëpërmjet vetive të shquarsisë që e fiksojnë referimin, në një analizë të fundit në raport me universin e diskursit; kallëzorja leksikalizon një interpretim që lidhet me ngjarjen, gjë që kërkon pra të vendoset te roli i ngjarjes. Sipas kësaj perspektive, emërorja sjell vendosjen e formativëve parambiemërorë të specializuar për klasën emërore që bëjnë leksikalizimin e referimit.

Forma jo e diferencuar *tə* nyjës së përparme, për aq sa ka veti të tipit kuantifikues, ka edhe efektin e marrjes së një ndryshoreje në të cilën referimi është fiksuar nga fleksioni i mbiemrit dhe, even-tualisht, nga dëftori. Kallëzorja pra i lë morfologjisë së elementit leksikor detyrën për të fiksuar referimin. Kjo zgjidhje është edhe për kontekstet dëftor në emërore në *Ginestra* e *Casalvecchio*. Përveç kësaj, në *Ginestra* e pjesërisht në *Casalvecchio* kontekstet në kallëzore me dëftor të pashquar sjellin një varfëri të mëtutjeshme të morfologjisë së përshtatjes e të rasës së mbiemrit të emëruar. Në pg. 2.1. u propozua një trajtim i ngjashëm për mbiemrin jo të flektuar, që karakterizon kontekstet në kallëzore *emër-mbiemër* në varietetet e *Ginestra-s* e *Casalvecchio-s* në (26). Në prani të një emri që vjen pas një indefiniti në *Ginestra* përzgjidhet nyja e përparme jo e diferencuar *tə*. Përmbledhim, nyja e përparme jo e diferencuar ose forma jo e flektuar e mbiemrit dalin në kontekstet ku vetitë referenciale të sintagmës fiksohen nga mekanizma të tjerë, si nga dëftori, në kontekstet në emërore, ose ankorimieventiv, në kontekstet në kallëzore.

Kuantifikuesi ndajfoljor vendoset në të majtë të nyjës së përparme, si në rastin e mbiemrave në kombinim me një emër të shqyrtuar në pg. 2 e 2.1. I gjejmë pra kombinimet e tipit *Q-nyjë-mbiemër i flektuar*, të ilustruara në (34):

(34) *Ginestra*

<i>yəm</i>	<i>mə</i>	<i>tə</i>	<i>mað-ə-nə</i>
<i>ma jep</i>	<i>më</i>	<i>Nyjë</i>	<i>madhen-Kall</i>
<i>pejə</i>	<i>mə</i>	<i>tə</i>	<i>bukər-ə-nə</i>
<i>pashë</i>	<i>më</i>	<i>Nyjë</i>	<i>bukurën-Kall</i>


Casalvecchio

<i>pəva</i>	<i>(atə)</i>	<i>mə</i>	<i>tə mað-i-n</i>
<i>pashëatë</i>	<i>më</i>	<i>Nyjë</i>	<i>madhin-mnj-Kall</i>


Duke iu kthyer analizës në (6), i atribuojmë mbiemrit të emëruar strukturën në (35). Në (35a), ku leksikalizohet subjekti, mbiemri ka flektim emërore që, duke qëndruar te (6), morfologjizon

kategorinë e brendshme D të mbiemrit. (35b) përkon me leksikalizimin e objektit. Mbiemri në këtë kontekst ka flektim kallëzore, që, sipas (6b), morfologjizon kategorinë e brendshme N të fjalës.

(35) a. *Vena*



b. *Ginestra*



4. Analizë e huazimeve mbiemërore

Në këtë pikë do kthehemi te huazimet mbiemërore, të shqyrtuara në 1.3.1., me flektim *-u*, të ndryshueshëm ose pjesërisht të ndryshueshëm. Do të ndalemi në veçanti mbi statusin morfosintaksor të një flektimi të tillë dhe sjelljes së këtyre mbiemrave brenda sintagmës emërore. Në (36) janë sjellë të dhëna lidhur me kombinimin e një emri në (a), dhe në kontekstet në izolim në (b), në kombinim me një dëftor në (c) dhe një indefinit në (d). (36i.) pasqyron kontestet në emërore, ndërsa (36ii.) kontekstet në kallëzore e dhanore. Sikurse dëshmojnë disa shembuj në (36), kuantifikues ndajfoljorë vendosen normalisht në të majtë të mbiemrit.

(36)

i. Ginestra

- a. ajo iſt vaiz-a mayru
ajo është vajza-Em dobët.fleks
- b. yerdhi mə mayru
erdhi më dobëti.fleks
- c. yerdhi ai mə mayru
erdhi ai më dobët.fleks

Casalvecchio

- a. mə kəndet miſt kruðu
me pəlqen mishi-Em.nnj papjekur.fleks
'më pëlqen mishi i papjekur'
- c. yerdhi ai/ ajo mə yavtu
erdhi ai/ajomë gjatë.fleks
- d. yerdhi njə ſum yavtu
erdhi një shumë gjatë.fleks

Vena

- a. erθ grua-ja vafu
erdhi gruaja-Em.fnj shkurtër.fleks
'erdhi gruaja e shkurtër'
erðə gra:-t vafə/ vafu
erdhën gratë-sh shkurtra.fleks
'erdhën gratë e shkurtra'
- b. erθ vaf-i/ vaf-a
erdhi i/e shkurtri/a-Em.mnj/fnj
erðə vafə-tə
erdhën të shkurtrit/shkurtrat.sh-sh
- c. erð atə autə
erdhën ata/o gjatët/gjatat.fleks

ii. Ginestra

- a. pəjə njə/atə bur tsupu
pashë një/atë burrë topall.fleks
- b. pəj mə mayr-u-nə
pashë më të dobëtin-fleks-Kall
- c. pəj atə mə mayr-u(-nə)
pashë atë më të dobëtin-fleks-(-Kall)
- d. pəjnə trəpu mbunnu
pashë një shumë thellë.fleks

Casalvecchio

- a. jəmə sɛdʒ-ə-nə ɣavtu
ma jep karrigen-fnj-Kalllartë.fleks
'ma jep karrigen e lartë'
- c. pɛva atə mə avtu
pashëatë më të lartin/lartën.fleks
- d. pɛva ɲə um avtu
pashënjë shumë lartë.fleks
pɛva ac ɣavtu
pashëkaq lartë.fleks

Vena

- a. pɛ gruaj-ə-nə vaʃu
pashëgruan-fnj-Kall e shkurtër.fleks
pɛ gra:t vaʃa/vaʃu
pashëgratë-sh e shkurtra.fleks
brɛsta ɲə sɛdʒautu
bleva një karrige lartë.fleks
- b. pɛ vaʃ-ə-nə
pashë të shkurtrën-fnj-Kall
pɛ vaʃa-tə
pashë (të) shkurtërit/at.sh-sh
- c. pɛ atə vaʃu
pashëatë të shkurtërin/ën.fleks
- d. ja ðɛ vaʃ-i-t / vaʃ-ə-sə / vaʃa-vɛ ia dhashë të /shkurtërit-
mnj-Dat/ shkurtrën-fnj-Dat / shkurtrat/ep.-Dhan.sh
- e. ja ðɛ ati-çə / asa-çə /ɲi-çə vaʃu
ia dhashë atij.mnj-Dat /asaj.fnj-Dat / një-Dat të shkurtri/e.fleks

Sjellja e huazimeve mbiemërore më *-u* përkon me atë të mbiemrave pa një të përparme. Në disa varietete arbëreshe ky grupi i fundit përfshin në veçanti disa pjesore, sikurse ilustruhet në (37), në *Ginestra*.


(37) *Ginestra*

- i. c. ai ɣulur iʃt atɛjə
ai ulur ɛsh̩tɛ atjɛ
- ii. c. pɛjə atə ɣulurə
pashë atë ulur

Duke iu kthyer (36) shohim se sjellja e këtyre mbiemrave është e ngjashme me atë të mbiemrave me një të përparme në (30), për sa paraqesin flektim të rasës përgjithësisht vetëm në kontekstet të cilat dalin të izoluara, sikurse është ilustruar nga të dhënat në *Ginestra* e *Vena* në (36b). Në kontekstet në të cilat kombinohet me një emër ose me një dëftor /të pashquar, del flektimi *-u* i pandryshueshëm (në *Vena*, në alternim me *-a* shumës); në fakt vendosja e rasës nuk është e përjashtuar plotësisht, sikurse tregon e dhëna nga *Ginestra* në (36ii.c.). Të dhënat në *Vena* sjellin indikacione të mëtutjeshme mbi statusin e *-u*. Në fakt në kontekstet në (36b) në të cilat mbiemri regjistron rasën, vendoset morfologjia *-i* Em.mnj, *-a* Em. Fnj, *-i-n(ə)* Kall. mnj, *ə-n(ə)* Kall.fnj, *-i-t(ə)* Dhan.mnj, *-ə-s(ə)* Dhan.fnj, në paradigmat emërore të shquara. Kjo shpërndarje sugjeron që *-u* nuk është një flektim i rasës /shquarsisë, por një fleksion i klasës emërore.


Në diskutimin në pg. 1 e 2 pamë se ky lloj flektimi, i pranishëm edhe te emrat /mbiemrat e leksikut të shqipes, ka të njëjtën natyrë të flektimit emërore të varieteteve romane. Në bazë të këtyre konsideratave, mund ta vendosim morfologjinë e pandryshueshmë *-a* (dhe alternuesen e saj shumës *-a* në *Vena*) në pozicionin e brendshëm N të mbiemrit, në mënyrë analoge për sa u propozua për paradigma të tjera të morfologjisë së klasësemërore, si në (22) e (28a). Do të kishim pra strukturën në (38).

(38) *Ginestra*



Format me flektim të rasës kërkojnë analizën që ua kemi bërë tashmë mbiemrave me një të përparme, në (35). Në Veçanti, duhet ta lidhim flektimin e rasës emërore *-i* me kategorinë e brendshme të fjalës D, si në (39a). Kallëzorja në (39b), përkon me një leksikalizim të specializuar të N të brendshme të fjalës, që e dyfishon pozicionin N të

përzgjedhur nga rrënja, sikurse është diskutuar në pg. 1.2. për (10). Dhanorja në (39c) projekton nga ana e tij pozicionin Q që aplikohet te përbërësi i formuar nga rrënja dhe nga argumenti i tij i detyrueshëm N.



Kthehemi shkurt te kontrasti mes pranisë së flektimit të rasës kur mbiemri del i vetëm dhe mungesës së tij kur mbiemri ndjek një element leksikor (emër, dëftor, i pashquar) ilustruar në (36i, 36ii). (40) e merr sërish këtë kontrast duke krahasuar të dyja kontekstet. Në (40a) mbiemri i emëruar ka flektimin e kallëzores e të dhanores; në (40b) në prani të një dëftori me flektim mbiemri ruan formën me flektimin e klasës emërore *-u*.

(40) *Vena*

a. pε aut-i-nə

b. pε atəautu pashë (të) gjatin-Kall.mnj pashë atë gjatin.fleks
ja ðε aut-i-t ja ðε ati.ms-çəautu

ia dhashë (të) gjatit-Dhan.mnjia dhashë atij-Dat gjatit.fleks

Kontrasti në (40) përkon me situatën e mbiemrave me nyje të përparme, ku, sikurse është skematizuar në (32), në kombinim me një element leksikor me flektim mbiemri paraqet vetëm flektimin e klasës

emërore. Në këto kontekste nyja e përparme del në formën jo të diferencuar; vendosja e mbiemrit me formë jo me flektim apo me flektim jo të diferencuar reduktohet në disa kontekste në kallëzore dhe limitohet në varietetin e *Ginestra-s* e *Casalvecchio-s*. Fakti që në këto raste vetitë referuese të sintagmës janë fiksuar nga determinuesi bën të riprodhohen kushtet e nevojës së morfologjisë me veti denotuese të rasës brenda sintagmës emërore të shqyrtuara në pg. 2.1.2. Analiza e përshtatur këtu është që prania e një formativi me denotim të shquar apo të tipit kuantifikues mjafton për të leksikalizuar vetitë referuese brenda sintagmës emërore. Vetitë e rasës, që i karakterizuar sipas termave referencialë, aq sa janë të pandashëm nga ato të shquarsisë, aq janë subjekt me të njëjtën shpërndarje me këto të fundit.

5. Disa vëzhgime përmbyllëse

Dukuritë e studiuara dhe analiza e këtushme rimerr disa propozime të paradigmeve teorike (Manzini e Savoia 2007, 2012, Culicover e Jackendoff 2005, 2006, Jackendoff 2002). Qasja e ndjekur në kap 1,2,3, bën një interpretim të kornizës minimaliste që e përjashton lëvizjen dhe kategoritë abstrakte dhe bazohet në një model përfaqësues të lidhjeve sintaksore (Manzini e Savoia 2005, 2007). Analiza e propozuar në kapitullin 1 vë në pikëpyetje modelin në të cilin kategoritë funksionale nuk kanë një status teorik të ndryshëm nga ai i elementëve të tjerë leksikorë. Sipas kësaj perspektive, komputacioni sintaksor ndërtohet mbi bazën e vetive semantike të regjistruara nga elementët leksikorë dhe nuk projekton domosdoshmërisht të gjithë përbërësit e asaj që e quajmë kuptim (interpretim) i fjalisë. Në veçanti, analiza e flektimit të klasës emërore dhe e rasës e zhvilluar në këtë kapitull pranon që rasia nuk është një primitiv i gramatikës, por është pasqyrim i ndërveprimit mes vetive referuese dhe atyre argumentuese.

Analiza e sintagmës emërore dhe e mbiemrit na ka bërë të mundur të shqyrtojmë nga një perspektivë e brendshme mënyrën në të cilën veti të ndryshme leksikore u lënë vend dallimeve strukturore, pra

edhe varianteve të gramatikave të afërta. Pamë se diferencimi si shkak i mekanizmave morfosintaksorë të sintagmës emërorelidhet të paktën pjesërisht me dukuritë që kanë të bëjnë me dygjuhësinë dhe me bashkëzistencën e sistemit roman me atë të shqipes. Kjo vlen veçanërisht si në rastin e huazimeve mbiemërore, ashtu edhe në sistemin e përshtatjes së mbiemrit në varietete si *Ginestra* e *Casalvecchio*. Sistemimet e ndryshme që dalin nga krahasimi mes varieteteve të shqyrtuara na japin dëshmi në të mirë të idesë që variantiështë rezultat i ndërveprimit të vetive universale, si përmbajtja predikative e emrit, mbiemrit dhe foljes, me veti të elementëve leksikorë që e regjistrojnë në leksik dhe e bëjnë të pranueshme për sintaksën e një gjuhe.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Baldi B. e L. M. Savoia 2008, *La lingua e i parlanti. Uso del linguaggio e comunicazione*, Pisa, Pacini.
- Camaj M. (1984), *Albanian Grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden.
- Cinque G. (1995), *On the Evidence for partial N-movement in the Romance NP*, në *Italian Syntax and Universal Grammar*, Cambridge, Cambridge University Press: 287-309.
- Culicover P. e R. Jackendoff (2005), *Simpler Syntax*. Oxford, Oxford University Press
- Culicover P. e R. Jackendoff, (2006), *The simple syntax hypothesis*, in *Trends In Cognitive Sciences* 10, 9: 414-418.
- Demiraj Sh. (1997), *La lingua albanese. Origine, storia, strutture*, Centro editoriale librario, Università della Calabria.
- Demiraj Sh. (2002), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e shkencave e shqipërisë, Tiranë.
- Dimitrova-Vulchanova M. e G. Giusti (1998), *Fragments of Balkan Nominal Structure*, në A. Alexiadou, C. Wilder (nën kujdesin e) *Possessors, predicates and movement in the determiner phrase*, Amsterdam, Benjamins: 333-360.
- Giusti G. e G. Turano (2007), *Case assignment in the pseudo-partitives of Standard Albanian and Arbëresh. A case for micro-variation*, në *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze*, 17: 33-51.
- Jackendoff R. (2002), *Foundations of language*, Oxford, Oxford University Press.
- MacSwan J. (1999), *A minimalist approach to intrasentential code switching*, New York, Garland Press.
- MacSwan J. (2000), *The architecture of the bilingual language faculty: evidence from intrasentential code switching*, në *Bilingualism: language and cognition* 3, 1: 37-54.
- MacSwan J. (2005a), *Code-switching and Generative grammar: A critique of the MLF model and some remarks on "modified minimalism"*, në *Bilingualism: language and cognition* 8, 1: 1-22.
- MacSwan J. (2005b), *Précis of a Minimalist Approach to intrasentential Code Switching*, në *Italian Journal of Linguistics. Rivista di Linguistica* 17, 1: 55-92.
- Manzini, M. R. e L. M. Savoia (2004), *The nature of the agreement inflections of the verb*, në *MIT Working Papers in Linguistics* 47: 149-178
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2005), *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi Gjenerativa*, 3voll., Alessandria, Edizioni dell'Orso.

- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2007), *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian dialects*, London, Routledge.
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2008), *Worknotes on Romance morphosyntax - Appunti di morfosintassi romanza*, Alessandria, Edizioni dell'Orso.
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2012). *Non-active voice in Albanian: Implications for the theory of movement*. në Leonardo M. Savoia, *Studi sulle varietà arbëreshe*, Rende (CS): Università della Calabria: 111-149.
- Manzini M. R. e L. M. Savoia (2011), *(Bio)linguistic variation: have/ be alternations in the present perfect*, në A. M. Di Sciullo (nën kujdesin e), *Biolinguistics*, Oxford University, Press: 222-265.
- Rizzi L. (1997), *The fine structure of the left periphery*, në L. Haegeman (nën kujdesin e), *Elements of grammar*, Dordrecht, Kluwer: 281-337.
- Solano F. (1972), *Manuale di lingua albanese*, Corigliano Calabro.
- Turano G. (2002), *On modifiers preceded by the article in Albanian DPs*, në *University of Venice Working Papers in Linguistics*, 12: 169-215.
- Turano G. (2003), *Similarities and differences between standard Albanian and Arbëresh numerals. A case of micro-parametric variation*, në *University of Venice Working Papers in Linguistic*, 13: 155-177.

MORFO-SINTAKSA E PJESORES DHE E PASKAJORES NË TË FOLMEN E SHKODRËS*

LEONARDO M. SAVOIA - MARIA R. MANZINI

1. Paskajorja në të folmen e Shkodrës.

Në këtë punim do të shqyrtojmë ndërtimin sintaksor të gegërishtes të përkufizuar tradicionalisht si *paskajore* (Cordignano 1931, Demiraj 1985, 1997, Banfi 1985, Joseph 1983, Pellegrini 1995). Në fakt, në të folmet e shqipes mungon eptimi i specializuar i paskajores së tipit që hasim p.sh. në gjuhët romane. Në kontekstet e tilla si ato që do të shqyrtojmë, të folmet e shqipes përdorin ose format e eptuara të foljes në lidhore (shih edhe Graffi 1998), ose ndërtimin e shqyrtuar këtu, të formuar nga një *introduktor* (element hyrës – përkth.) dhe nga një formë foljore e pandryshuar, i cili karakterizon të folmet gege. Në këtë ndërtim, të cilin do ta përkufizojmë në mënyrë konvencionale me etiketën e ‘paskajores’, introduktori parafjalor *mε* kombinohet me një alomorf të pjesores, siç ilustron në (1) për *Shkodrën*.

- (1) *Shkodër*
mεp:rð
me ardh
vij

Në përgjithësi ky ndërtim është studiuar për cilësitë e tij përndarëse, të shqyrtuara në paragr. 3. Por ai paraqet edhe arsye të tjera me interes, si në veçanti statusi kategorial i elementeve të tij përbërëse, pra *mε* dhe përbërësi (konstituenti) foljor. Në fakt është e natyrshme të pranohet që sjellja sintaksore e këtij ndërtimi varet nga

cilësitë e tij strukturore dhe në fund të fundit nga cilësitë eptuese të elementit foljor.

1.1 *Introduktori - forma foljore e pandryshueshme.*

Të shqyrtojmë në radhë të parë elementet që mund të paraprijnë formën foljore të pandryshueshme. Përveç elementit *me* gjejmë edhe të paktën dy introduktore të tjerë, *pp* ‘pa` dhe *tu(i)* ‘duke’ për përcjelloren. Siç duket nga krahasimi ndërmjet (2a) dhe (2b) *me* dhe *pp* janë në pëndarje plotësuese.

(2) *Shkodër*

- | | | | |
|----|-----------------|-----------|---------------|
| a. | dola | <i>pp</i> | <i>hǽŋər</i> |
| | dola | <i>pa</i> | <i>ngrënë</i> |
| b. | <i>kɔ</i> fi'lu | <i>me</i> | <i>hǽŋər</i> |
| | ka filluar | | të hajë |

Formimet me vlerë përcjellore në të cilat shfaqet pjesëza *tu(i)*, mund të drejtohen nga këpuja *jam*, duke u shfaqur me ndërtime progresive, si në (3a) ose me folje të perceptimit, si në (3b).

(3) *Shkodër*

- | | | |
|----|--------------------|--|
| a. | <i>jam</i> | <i>tu e:ts</i> |
| | <i>jam</i> | <i>duke ecur</i> |
| | <i>jam</i> | <i>tu ε lɔ/ tʃu/ mlu/ ve:ʃ/ pre</i> |
| | <i>jam</i> | <i>duke e larë/zgjuar/mbuluar/veshur/prerë</i> |
| | <i>jam</i> | <i>tu j a θǽ:n</i> |
| | <i>jam</i> | <i>duke ia thënë</i> |
| b. | <i>t kam pp</i> | <i>tui ka'lu</i> |
| | <i>të kam parë</i> | <i>duke kaluar</i> |

Elementet *me* e *pp* mund të identifikohen me parafjalët përkatëse, të ilustruara nga shembujt (4).

(4) *Shkodër*

- ε kam bǝ me kry:p
 e kam bërë me kripë
 ε kam bǝ pǝ kry:p
 e kam bërë pa kripë

Një çështje e rëndësishme është ajo që ka të bëjë me vendin e klitikëve kundrinorë në ndërtimet në të cilat pjesorja e pandryshueshme paraprihet nga një element parafjalor. Në përgjithësi klitikët kundrinorë vendosen ndërmjet pjesëzës dhe pjesores, si në (5).

(5) *Shkodër*

- a. kam v:rǝ me t a ðǝ:n
 kam ardhur për të ta dhënë

Mohimi me pjesëzën *mas*, e cila paraprin *me* në (6a) dhe ndjek *tu* në (6b), ndryshon prej mohimit të zakonshëm të fjalive dëftore, me pjesëzat *nuk* ose *s* në (6d), dhe përkon me elementin mohues të specializuar që shfaqet në urdhërore, siç tregohet në (6c).

(6) *Shkodër*

- a. vʃt mǝ mir mas mεεʃkru/ mεεθi:r
 është më mirë të mos e shkruash/ e thërrasësh
- b. tu mas ε bǝ ...
 duke mos e bërë...
- c. mas εθir
 mos e thirr
- d. s/ nuk ε dʒei
 nuk e gjej

1.2 Pjesorja.

Për sa i përket elementit foljor të pandryshueshëm, i cili kombinohet me *me/pv*, vërejmë se ai shfaqet së bashku me foljet ndihmëse *kam* e *jam*. Me fjalë të tjera, shfaqet edhe në ato kontekste ku në gjuhët romane nevojitet pjesorja. Në veçanti ai kombinohet me *kam* në formimin e së kryerës

veprore, të tipit si në (7a), dhe me *jam* në form-imin e së kryerës së mesore-vetvetores ose të pësores, si në (7b).

(7) *Shkodër*

a.	<i>ε</i> kan	mlu	
	e kanë	mbuluar	
b.	jan	mlu	(p̄rei s̄ ōms)
	janë	mbuluar	(p̄rej së ëmës)
	janë	mbuluar	(vetvetore)
	ɛʃt	ve:ʃ	(p̄rei s̄ ōms)
	është	veshur	(p̄rej së ëmës)
	është	veshur	(vetvetore)

Në fakt ky element foljor normalisht trajtohet si një pjesore (Cordignano 1931, Demiraj 1985, 1997), megjithëse, siç do të shohim më hollësisht në paragr. 2, gegërishtja e Shkodrës ka një pjesore me morfologji të specializuar *-un, -m*, dhe eptim përshtatës, që mund të kombinohet me *jam* në ndërtimet pësore si në (8). Një përkim i pjesshëm morfologjik ndërmjet pjesores së eptuar dhe pjesores së pandryshueshme shfaqet së paku në klasën e foljeve të tipit *mlai* ‘mbuloj’ në (8) ose *kalai* ‘kaloj’ në (3b), duke qenë se në të dyja rastet shfaqet e njëjta zanore e temës, pra *-u*.

(8) *Shkodër*

jam	i	mlu:m
jam	m.nj.	mbuluar

Të folmet toske, duke përfshirë këtu edhe dialektet arbëreshe (Turano 1999), janë të ngjashme me ato geqe që kemi shqyrtuar këtu, sepse, siç vihet re në të folmen e Gjirokastrës në (9), në to bëhet dallimi ndërmjet pjesores së papërshtatur, si në (9a), në ndërtime me interpretim perfektiv, dhe pjesores së përshtatur në ndërtime me interpretim pësor, si në (9b). Veç kësaj pjesorja e pandryshueshme ka një element eptues pjesor të specializuar, d.m.th. *-r*, duke u dalluar në këtë mënyrë nga format e pjesores së gegërishtes.

(9) *Gjirokastër*

- a. ε kam zjuar
 e kam zgjuar
 jam zjuar
 jam zgjuar
 jan vεsur
 janë veshur
- b. jan tə zjuar/ zjuara
 janë të (sh.) zgjuar/zgjuara
 jan tə vεsur/ vεsura
 janë të (sh.) veshur/veshura

Po ashtu, edhe në të folmet e tipit toskë dëshmohen ndërtime me pjesore të pandryshuar, të paraprirë nga elemente parafjalore si *pa* dhe *pri ma* ‘për me’, si edhe nga pjesëza e përcjellores (*duke*, *ture/tura*). Në (10) po japim të dy shembuj nga e folmja e *Gjirokastrës* dhe të folmet arbëreshe të *Fermës*, *Shën Vasilit* (Altimari 1994, Turano 1999). Të dhënat në (10) tregojnë që në këto struktura shfaqet e njëjta formë me *-r* e strukturave me foljet ndihmëse *jam/kam* në (9a). Të dhënat e *Gjirokastrës* në (10) tre-gojnë edhe mundësinë që klitiku kundrinor të zërë vend në të majtë të pjesëzës *pa*.

(10) *Gjirokastër*

dola	pa ε lar
dola	pa e larë
dola ε	pa 'lar
dola	e palarë
tə patʃ	duke u lar
tə pashë	duke u larë

Ferma

ture bənur	ks'tu...
duke bërë	kəshtu...

Shën Vasili

dul pa	u λar/ λaitur
doli pa	u larë
εʃt pri ma	bən
është për	t'u bërë
tura i λaitur	ʃkava
duke i larë	shkava

2. Tipare morfologjike të pjesores së pandryshueshme dhe të eptuar.

Të shqyrtojmë cilësitë morfologjike të pjesores së pandryshueshme në të folmen e *Shkodrës*, e cila ndjek *me/pp/tu* në ndërtimin paskajor, dhe kombinohet me foljet ndihmëse *jam/kam* në formimet e së kryerës dhe të pjesores. Në përputhje me klasat e ndryshme foljore (Solano 1972, Camaj 1984) kemi grupime morfologjike të ndryshme. Në veçanti klasa e foljeve me temë më *-a/-ɔ-* paraqet një formë me zanore tematike të ndryshueshme *-u*, si në (8), ndërsa në klasat e tjera me temë më zanore pjesorja e pandryshueshme shfaq të njëjtin element zanor *-ε, -v, -i*, i cili gjendet edhe në format e shtjelluara të paradigmes, siç tregohet në (11i)-(11iv) për baza foljore të ndryshme. Në rastin e bazave më bashkëtingëllore gjejmë forma pa formativë tematike, siç tregohet në (11v)-(11viii). Në (a) po sjellim shembujt që kanë të bëjnë me ndërtimin paskajor, në (b) format që përkojnë në kontekstet me folje ndihmëse. Të vihet re se një përndarje e ngjashme dëshmohet për të folme të tjera të gegërishtes, si ato të studiuara nga Hoxha (1990).

(11) *Shkodër*

i.	a.	i kam θǃ:n	m u mlu
		i kam thënë	të mbulohet
	b.	ε/i kam	mlu
		e/i kam	mbuluar (m.f.sh.)
		ɸʃt	mlu
		është	mbuluar (m.f.)
ii.	a.	ðu	mεε lɔ
		dua	ta laj
	b.	ɸʃt	lɔ
		është (pës. vetv.)	larë (m.f.)
		ε kam	lɔ
		e kam	larë (m.f.)
iii.	a.	duhet	mεε zi
		duhet	ta ziesh
	b.	ɸʃt	zi
		është	zier (m.f.)
		ε kɔ	zi

		lo/la ha bollito/a	
iv.	a.	t kam θǿ:n	mεε pre
		të kam thënë	ta presësh
	b.	ε kam	pre
		e kam	prerë (m.f.)
		jam	pre
		jam	prerë (m.f.)
v.	a.	t kam θǿ:n	mεε ve:ʃ
		të kam thënë	ta veshësh
	b.	ε kam	ve:ʃ
		lo/la ho vestito/a	
		Ϸʃt	ve:ʃ
		është	veshur (pës.vetv.)
vi.	a.	du	mεε la:g
		dua	ta lag
	b.	ε kam	la:g
		e kam	lagur (m.f.)
		Ϸʃt	la:g
		është (pës.vetv.)	lagur (m.f.)
vii.	a.	t kam θǿ:n	mas mε u lo:ð
		të kam thënë	të mos lodhesh/lodhet
	b.	ε kam	lo:ð
		e kam	lodhur (m.f.)
		jam	lo:ð
		jam lodhur (pës.vetv.)	
viii.	a.	t kam θǿ:n	mεε kre:h
		të kam thënë	ta krehësh
	b.	Ϸʃt	kre:h
		është	krehur (m.f.)
		ε kam	kre:h
		e kam	krehur (m.f.)

Disa nënklasa foljesh kanë forma të pandryshueshme të pjesores të karakterizuara nga formativë eptues të specializuar, si *-n* në rastin e foljeve të tipit *jap* në (12a), ose *-t* në folje të tipit *mbaj* në (12b).

(12) *Shkodër*

- | | | |
|----|--------|-------------|
| a. | doin | mε j a ðǿ:n |
| | duan | t'ia japin |
| | ja kan | ðǿ:n |

- ia kanë dhënë
 b. du mεε mɔit
 dua ta mbaj
 ε kan mɔit
 e kanë mbajtur (m.f.)

Kemi parë më sipër që në të folmen e *Shkodrës* përveç pjesores së pandryshueshme ekziston edhe një pjesore e eptuar, që nuk përdoret në ndërtimet me vlerë paskajore, por pranohet në ndërtimet me folje ndihmëse. Në veçanti këtu gjejmë dy grupime morfologjike; në temat më zanore baza foljore kombinohet me formativin *-m*, si në (13a), ndërsa në temat më bashkëtingëllore baza foljore kombinohet me formativin *-un*, si në (13b). Formativi *-un* nga ana e tij mund të ndjekë formativin *-m*, duke i dhënë shkas krijimit të formave në të cilat eptimi i pjesores dyfishohet, si në (13c). Këto forma bashkëmbartin strukturën e zakonshme eptuese të mbiemrit dhe të emrit, siç tregohet nga krahasimi me paradigmën e eptimit të sjella në (14a) për mbiemrat dhe në (14b) për emrat e farefnisnës me një të para-vendosur dhe prapavendosur. Morfemat e eptimit përshtatës të paska-jores janë *-ε* për femëroren njëjës e shumës të formave më *-m*, dhe *-a* për femëroren shumës të formave më *-un*. Pjesëza e përshtatjes në pozicion proklitik është *i* për mashkulloren njëjës, *ε* për femëroren njëjës, *t* për shumësin. Formativi *i* përkon me njëjën e prapavendosur të mashkullores njëjës, ndërsa *t* i përgjigjet njëjës së prapavendosur të shumësit. Formimet në të cilat pjesorja e eptuar kombinohet me *jam*, lejojnë të bëhet një interpretim i tipit pësor, ku pranohet edhe leksikalizimi i vepruesit me anë të parafjalës *prei*.

(13) *Shkodër*

- a. jam i mlu:-m/ ε mlu-m-ε (prei s ɔms)
 jam i/e mbuluar (prej nënës)
 jan t mlu:-m/ t mlu-m-ε (prei s ɔms)
 janë të mbuluar (m.f.) (prej së ëmës)
- b. ɛʃt i veʃ-un/ ε veʃ-un (prei s ɔms)
 është i/e veshur (prej së ëmës)
 jena t veʃ-un/ t veʃ-un-a (prei s ɔms)
 jemi të veshur (m.f.) (prej nënës)

- c. *ɛʃt* i *mlu-m-un*
 është i *mbuluar*
- (14) *Shkodër*
- a. *ɛʃt* i *kutʃ/ ε kutʃε*
 është i *kuq/e kuqe*
 jan t *kutʃ/ t kutʃε*
 janë të *kuq/të kuqe*
 ɛʃt i *ɔməl/ εɔməl*
 është i/e *ëmbël*
 jan t *ɔməl/ t ɔmla*
 janë të *ëmbël/të ëmblla*
- b. *ɛʃotʃ-a/ t ʃotʃε-t*
 e shoqja/të shoqet
 i bir-i/ t bir-t
 i biri/të bijtë

Siç shihet, shembujt në (13a)-(13c) kanë të bëjnë me formime ku pjesorja e eptuar ndjek foljen ndihmëse *jam*, dhe që kanë kuptim pësor. Në të vërtetë kuptimi pësor është i mundshëm edhe në ndërtime ku këto pjesore ndjekin në formën e rasës kallëzore foljen ndihmëse *kam* të pronësisë, si në (15a). Të vihet re që *t* përfaqëson, në ndërkëmbim me *ε*, përshtatjen me klitikun kundrinor pavarësisht nga numri dhe gjinia e këtij të fundit. Elementi *t* shfaqet edhe si një e kundrinave, siç tregohet në (15b).

- (15) *Shkodër*
- a. *ε kam* t *mlu:m/ t/ε mlume*
 e kam të *mbuluar* (m.f.)
 ε kam t *veʃun*
 e kam të *veshur* (m.f.)
 i kam *kmiʃat ε/t lɔme*
 i kam *këmishat* të *lara*
- b. *pɔ t mɔtrɛn*
 pa (kr. thj. e *shoh*) të *motrën*

Format e pjesores të tipit *ðʃ:n* e *mɔit* në (12) nga ana e tyre kanë eptimin më *-un* në formimet pësore, të paraqitura në (16).

- (16) *Shkodër*
 ɛʃt i/ε *mɔitun*

është i/e mbajtur
 jan tə mɔitun/ mɔituna
 janë të mbajtur/mbajtura
 ɛʃt i/εðñun (për studim)
 është i/e dhënë (për studim)

Një tjetër tip i pjesores së eptuar shfaqet në varësi nga disa folje aspektore, si p.sh. *mbaroj*, siç tregohet në (17). Bëhet fjalë për një formë të përshkruar zakonisht si të emëruar, të paraprirë nga pjesëza proklitike *s* (gjinore) ose *t* (kallëzore). Mbaresa morfologjike emërore *-it* nga ana e saj leksikalizon referimin e shquar, si për gjinoren e paraprirë nga *s*, si për kallëzoren, të paraprirë nga *t*. Krahasimi ndërmjet *t shkruarit* dhe *t hǎǧǧǧarit* tregon që foljet më bashkëtingëllore i shtojnë bazës foljore morfemën *-n-*, ndërsa foljet më zanore i shtojnë bazës foljore formativin *-m-*, ndonjëherë të dyfishuar me formativin *-un-*.

(17) *Shkodër*

marɔva s ʃkru-m-it
 mbarova së shkruari
 t ʃkru-m-un-it
 së shkruari
 t hǎǧǧǧ-n-it
 së ngrëni
 ε marɔva s/ t ʃkru-m-un-it letren
 e mbarova së shkruari letren
 marɔi s lɔ-m-un-it
 mbaroi së lari

3. Përndarja e ndërtimit me + pjesore.

Siç dihet nga literatura (Demiraj 1985, 1997, Banfi 1985, Joseph 1993), kombinimi i *mε/pv* me formën tematike të pjesores ka një përndarje që i përgjigjet asaj të paskajores ose të lidhores në gjuhët romane. Nëse do të zhvendosim krahasimin tek të folmet toske (duke përfshirë edhe shqipen standarde dhe dialektet arbëreshe), shihet se

shfaqja e këtij ndërtimi përkon thuajse tërësisht me përndarjen e formimeve të lidhores, të përbëra prej introduktorit *të* të ndjekur nga folja e shtjelluar, të analizuara në mënyrë të veçantë nga Turano (1995). Në të vërtetë ndërtimi *mε + pjesore* shfaqet në kontekste tipikisht të lidhura me paskajoren në gjuhët si italishtja, pra kontekstet me folje modale në 18(a), shkakore në 18(b), aspektore në 18 (c), kontekste të tjera plotësuese në 18(d) dhe rrethanorë në 18(e). Në veçanti të dhënat në (d)-(e) tregojnë se nga ana e saj *mε* mund të paraprihet nga përplotësuesi (complementatore) i tipit *që*, pra *tji* ose *sε*; në kontekstet rrethanore *mε* mund të paraprihet nga parafjalë si *për* etj. Mohuesi modal *mas* i paraprin *mε* dhe ndjek përplotësues e introduktorë të tjerë parafjalorë.

(18) *Shkodër*a. **kontekste modale**

s munεm	mεε bǝ
nuk mund	ta bëj
doin	mεε bǝ
duan	ta bëjnë
na kena	me t θi:r
ne do të	të thërresim

b. **shkakore**

ε kam bǝ	m u tʃu	
e kam bërë	të zgjohet	
i kǝ vu	mε fi'et	fmi:t
i ka vënë	të flenë	fëmijët
i kǝǝ:n	mε hǝŋǝr	fmivε
u ka dhënë	të hanë	fëmijëve

c. **aspektore**

mu'nǝhen	mεε bǝ
mundohen	ta bëjnë
kam fi'ʔu	mε hǝŋǝr
kam filluar	të ha

d. **ndërtime plotësuese**

i kan θǝ:n	(tʃi) mεv:rǝ
i kanë thënë	(që) të vijë

	(tʃi) mas mɛɔ:rð
	(që) të mos vijë
	(tʃi) mɛɛ bǝ
	(që) ta bëjë
	(tʃi) mas mɛɛ bǝ
	(që) të mos e bëjë
	(mas) m u lɔ
	të mos lahet
jam i gzu:m	mɛ t pɔ mi:r
jam i gëzuar	që të shoh mirë

e. **shtesa parafjalore**

kam ɔ:rð	(tʃi) mɛɛ pɔ
kam ardhur	(që) ta shoh
	mɛ t a ðǝ:n
	që të ta jap
	pɔr mɛɛ/ t pɔ
	që të të/ta shoh
kam i:k	pɔr mas mɛɛ/ t pɔ
kam ikur	që të mos e/të shoh
	per mas mɛ t a ðǝ:n
	që të mos të ta jap
kam dɔ:l	para se mɛʃku
kam dalë	para se të shkoja

Ndërtimi *me + pjesore* veç kësaj karakterizon fjalitë pyetëse paskajore, në të cilat paraprihet nga një sintagmë *wh-*, pra pyetës, si në (19a), dhe fjalitë kushtore të paraprirra nga *bǝ*, si në (19c). Sintagma *wh-* paraprin edhe të ashtuquajturat fjali lidhore pa kokë të tipit (19b), ku pjesorja përsëri paraprihet nga *bǝ*. Vërejmë se edhe fjalia pyetëse paskajore mund të paraprihet nga përplotësuesi i shtjelluar se.

(19) *Shkodër*

a. **pyetëse paskajore**

nuk di ku	mɛʃku
nuk di ku	të shkoj
nuk di (sɛ) tʃa	mɛ bǝ
nuk di (se) çfarë	të bëj
nuk e di si	mɛ i θi:r
nuk e di si	t'i thërres

b. **lidhore pa kokë**

m bđhet tʃifi	dziθkuʃ	bđ mɛɔ:rđ
më bëhet qeʃfi	gjithkush	të vijë

c. **kushtore**

bđ mɛɔ:rđ	t pres
po të vish	të pres
bđ mas mɛɔ:rđ	s t pres
po të mos vish	nuk të pres

Së fundi, ky ndërtim që po shqyrtojmë, mund të shfaqet edhe në kontekste të pavarura, si p.sh. në (20):

(20) *Shkodër*
 mɛɔ:rđ
 të vijë!

Në rast se është i pranishëm një plotës i kryer, subjekti leksikor mund të vendoset ndërmjet tij dhe foljes, siç ilustron në (21a); veç kësaj subjekti mund të shfaqet edhe në vendosje pasfoljore, si në (21b). Krahasimi i të dhënave në (21c) tregon që subjekti leksikor paraprin elemente si sintagmat *wh-* edhe në fjalitë e zakonshme të shtjelluara.

(21) *Shkodër*

a.	du	tʃi ti	mɛɛ bđ	
	dua	që ti	ta bësh	
	du	tʃi vʔai 'jat	mɛɛ bđ	
	dua	që vëllai yt	ta bëjë	
	doin	tʃi a'ta	mɛɔ:rđ	
	duan	që ata	të vijnë	
	ε mira vʃt	tʃi (ju)	mɛɛ bđ	
	është mirë	që (ju)	ta bëni	
b.	doin	(tʃi)	mɛɔ:rđ	a'ta
	duan	(që)	të vijnë	ata
	ε mira vʃt	tʃi	mas mɛɛ bđ	(ju)
	është mirë	që	të mos e bëni	(ju)
	kam do:l	para sɛ	mɛɔ:rđ	'ti
	kam dalë para se		të vije	ti
c.	nuk ëdi	ata si θirren		
	nuk e di	si quhen ata		

Të dhënat në (22a) i tregojnë përplotësuesit *tʃi/se* si introduktorë të fjalive të shtjelluara, në veçanti të atyre dëftore. Megjithatë, siç është shtjelluar nga Turano (1995) për të folmet toske, në gjuhën shqipe një fjali mund të paraprihet nga kombinimi i përplotësuesit të shtjelluar *se* me një sintagmën *wh-*; kjo gjendje, e treguar më sipër për formimet pjesore, natyrisht gjendet në fjalitë e shtjelluara si në (22b). Plotësi *tʃi* gjithashtu paraprin fjalitë lidhore, si në (22c).

(22) *Shkodër*

a. m kan θð:n	tʃi/ se	vjen 'neser
më kanë thënë	që/se	vjen nesër
munet tʃi ai vjen		
mund qëtë vijë		
m kan θð:n	se	nuk/ s vjen
më kanë thënë	se	nuk/s' vjen
m kan θð:n	tʃi	s vjen
më kanë thënë	që	s'vjen
m kan θð:n	tʃi vʎai jð:t	kð ɒ:rð
më kanë thënë	që vëllai yt	ka ardhur
b. nuk e di	se kuʃθirri	
nuk e di	se kush thirri	
ata s di	keθrɒsin	
ata s'dinë	kë thërresin	
nuk e di	se ke kɒn θi:r a'ta	
nuk e di	se kë kanë thirrur ata	
c. eʃt a'i tʃi m θret		
është aiqë më thërret		

4. Analiza e të dhënave.

Të dhënat e përmendura deri këtu do të analizohen më poshtë në bazë të modelit të zhvilluar nga Manzini e Savoia (1999, 2002a, 2002b, 2004a, b) për sistemet e përshtatjes në të folmet dialektore të italishtes dhe gjuhëve romane dhe për strukturën e periferisë së majtë të fjalisë, sipas Rizzi-t (1997). Për sa u përket sistemeve të përshtatjes, pra të epimit të emrit dhe të foljes sipas tipareve emërore, Manzini dhe Savoia argumentojnë që asnjëra nga kategoritë tradicionale të numrit, gjinisë,

vetës dhe rasës, nuk jep në mënyrë të saktë realitetin empirik. Për shembull tipari i gjinisë është problematik, sepse i përgjigjet një kategorie që ka rëndësi interpretuese në një nënbashkësi të vogël rastesh (ku në përgjithësi i referohet seksit mashkull ose femër), ndërsa në raste të tjera ky tipar nuk përcaktohet, duke u nevojitur në këtë mënyrë një konceptualizim i ndryshëm. Për sa i përket vetës, ka arsye të mira për të menduar që bëhet fjalë për një kategori të gram-atikës; por nocioni i vetës është i përshtatshëm për të shenjuar ref-erimin ndaj folësit ose dëgjuesit ose bashkësive në të cilat përfshihen këta, pra vetës së 1-rë dhe të 2-të tradicionale, ndërsa e ashtuquajtura vetë e 3-të nuk i bindet një kategorizimi të tillë. Për sa i përket numrit dhe rasës Manzini e Savoia (2002b) vërejnë që në shumë dialekte të italishtes dhanorja përkon me kallëzoren shumë (mashkullore); kjo vlen edhe për trajtën e shkurtër *i* të shqipes. Çështja është që asnjëri nga të dy nocionet përshkruese të dhanores dhe të shumësit nuk është në gjendje të shpjegojë përse ndodh ky përkim, në ndryshim nga përkime të tjera po aq të konceptueshme, si p.sh. ndërmjet dhanores dhe femërores njëjës e kështu më tutje.

Manzini e Savoia arrijnë në përfundimin që klitikët, dhe më në përgjithësi sistemet e eptimit, megjithëse i qëndrojnë një klasifikimi sipas tipareve tradicionale ose kategorive morfologjike, mund të shqyrtohen si kategori sintaksore, të mbështetura në cilësitë shenjuese të strukturave emërore. Këto kategori janë D(eterminant) për shquarësinë, R(eferencialiteti) për referimin specifik, Q (Kuantifikues) për cilësitë kuantifikuese, P(ersona) (ose veta) për cilësitë e referimit ndaj folësit ose dëgjuesit, Loc(ativus) (vendore) për referimin ndaj koordinatave hapësinore të kontekstit të diskursit, N (omen/ emër) për cilësitë predikative të emrit; këtyre mund t'u shtojmë edhe kategorinë Op(erator), të cilën e lidhim me cilësitë intensionale. Shprehur në terma tradicionalë, N leksikalizon cilësinë e vetës së 3-të, P u përgjigjet vetës së 1-rë dhe të 2-të, Q cilësisë së shumësit. Gjinia nuk kategorizohet në mënyrë të pavarur, por reduktohet në ekzistencën e klasave emërore të ndryshme të lidhura me kategorinë N.

Një përfundim interesant është se kategoritë e sipërpërmendura përkojnë me ato që përcaktojnë nyjëtimin e brendshëm të sintagmës emërore. Mendojmë pra se, për sa i përket strukturës së brendshme të sintagmave emërore, këto kategori u përgjigjen po aq pozicioneve të renditura në mënyrë hierarkike në strukturën e fjalisë, sipas skemës themelore D - Q - P - N. Aspektet themelore të këtij rendi, të paktën për togfjalëshin emëror, mund të përftoheshin nga shqyrtimet interpretuese. Pra kuantifikuesi, i cili përmban qoftë shumësinë qoftë kuantifikimin e dobët, vepron mbi pjesën kallëzuese të emrit, d.m.th. N, e cila përfshin ndryshoren e argumentit të lidhur nga Q. Kategoria e shquarësisë D nga ana e vet vepron mbi tërë vargun, duke përfshirë emrin dhe kuantifikuesin numëror. Kategoria P konceptualizohet si leksikalizim i tipareve të referimit të lidhura me universin e diskursit, të cilët përfshijnë bashkëbiseduesit. Pra një dukuri si ajo e klitizimit, me konotacione që në pamje të parë janë thjesht morfosintaksore, shpjegohet në bazë të strukturave të renditura sipas parimeve interpretuese. Afrojmë gjithashtu vendndodhjen e Loc, pra cilësitë vendore të lidhura me universin e diskursit, me kategorinë, ndërsa R konceptohet si një pozicion i veçantë ndërmjet kategorive D dhe Q. Në brendësi të sintagmës emërore, ndërsa N lidhet me emrin gjymtyrë kryesore të sintagmës, Loc mund të lidhet me përemrin dëftor, P me pronorët, Q me kuantifikimin e papërcaktuar, R me kuantifikimin specifik, D me nyjën shquese. Do të kthehemi tek kategoria Q në shqyrtimin që vijon. Skema që përftohet së këtejmi është ajo e paraqitur në (23).



(23) [Op [D [R [Q [P [Loc [N

Sipas një tradite studimore tashmë të mirënjohur në gramatikën gjenerative, struktura e sintagmës emërore është paralele me atë të fjalisë; së këtejmi është e natyrshme të mendohet që brenda modelit tonë e njëjta vijimësi kategorish në (23) përbën në thelb skeletin themelor të vargut të pozicioneve emërore të brendshme të fjalisë. Gjithashtu supozojmë se struktura e fjalisë përfshin pozicione të ndryshme të vendosjes së foljes, sipas cilësive të saj kallëzuese V(erbum/ folje), aspekte Asp, të eptimit kohor T(ense/ kohë) dhe modale (fusha

C(omplementizer), ku CI(ntension) është Introduktori ilokutiv, si në (23'). Secili pozicion i vendosjes së foljes në (23') projekton një varg emëror, si hipotezë të formës në (23).

(23') [Op ... [C_I ... [C ... [T ... [v ... [V ...

Sipas konceptimit tonë (Manzini e Savoia 2004a, 2005) strukturat në (23)-(23') përputhen jo vetëm me fjalinë dhe sintagmën emërore, por hedhin dritë edhe mbi nyjëtimin e brendshëm të elementeve të veçanta leksikore. Ky njësim i analizës sintaksore të fjalisë dhe të sintagmës emërore me atë morfologjik të elementeve leksikore mund të shpjegohet për shembull me eptimin e foljes së shtjelluar. Qasja tradicionale ndaj eptimit foljor ilustron në teorinë e Chomsky-t (1995), në bazë të së cilës eptimi përbëhet nga një tërësi tiparesh të papërcaktuara të lidhura me foljen, vlera e të cilave përcaktohet nga tiparet përgjegjëse të kryefjalës së fjalisë. Njësimi i morfologjisë dhe i sintaksës i paraqitur këtu shpie përkundrazi në përfundimin se eptimi foljor ka brenda foljes të njëjtin status që ka kryefjala përemërore brenda fjalisë. Kështu, pranojmë që qoftë kryefjala përemërore, qoftë eptimi foljor kategorizohen si D. Dallimi ndërmjet këtyre dy elementeve qëndron në faktin se eptimi foljor, p.sh. *-in* në (24a), ndodhet në një pozicion D në brendësi të fjalës, ku *kreh-* është baza leksikore V. Ndërsa në strukturën e fjalisë së (24b) është folja e eptuar në tërësinë e saj që vendoset në F, ku ndiqet prej kryefjalës përemërore në D. Folja në (24) është njëra prej atyre të marra si shembull në (32).


(24) *Shkodër*

(P = Phrase/ sintagma)


Është e mundur ta shtrijmë njësimin e nivelit morfologjik dhe sintaksor të analizës edhe në emrin dhe sintagmën emërore (ose mbiemrin dhe sintagmën mbiemërore). Pra struktura e brendshme e një emri ose mbiemri parashikon një bazë leksikore të treguar me N/ A (Mbiemri), të ndjekur nga një element eptues N, siç në (25a) për njërin prej mbiemrave në (13). Për sa i përket foljes në (24) kemi parë që eptimi leksikalizon brenda foljes të njëjtat tipare që kryefjala leksikalizon brenda fjalisë; pra i kemi njohur eptimit të njëjtën kategori D të kryefjalës. Ndërsa në brendësi të përbërësve (konstituentëve) emërorë dhe mbiemërorë, si ai në (25), eptimin e vëmë në lidhje me kategorinë N. Në qasjen e përpunuar nga Manzini dhe Savoia (2002a, b, 2004a,b) N përkon me argumentin e brendshëm, pra me argumentin e vetëm të emër/ mbiemrit. Është e rëndësishme të vihet re që kategorizimi i ndryshëm pasqyron edhe tipare të brendshme të ndryshme të të dy tipave të elementeve, duke qenë se vetëm eptimi D ka cilësinë e vetës (folës, dëgjues), ndërsa vetëm eptimi N ka cilësinë e gjinisë (pra klasë emërore). Nga ana e vet, nyja që paraprin qoftë emrin, qoftë mbiemrin mund të trajtohet, në caqet e analizës standarde të sintagmës emërore, si një element D, duke i dhënë shkas krijimit të strukturave të tipit (25b). Përshtatja e njëjës me eptimin e emrit është e ngjashme me atë të gjuhëve romane në struktura të tipit ‘e kuqja’ etj.

(25) *Shkodër*

a.




b.



4.1. Struktura e pjesores së eptuar.

Le ta shtrijmë modelin morfosintaksor të sapohartuar në pjesoret e të folmeve geqe që po shqyrtojmë, duke filluar nga format e përbëra morfologjikisht të pjesores së eptuar. Të përcaktojmë në radhë të parë natyrën e morfologjisë *-Vm* të klasës së foljeve më zanore, si *-um* në *mlu:m*, dhe të *-un* në foljet me bazë më bashkëtingëllore. Ndërsa për elementin zanor *-u*, *-i*, *-a*, etj., kemi parë se ai shfaqet edhe pavarësisht nga prania e formativëve eptues në pjesoret e pandryshueshme të tipit *mlu*, *zi*, *lv*, *pre* etj. në (11). Këtë element mund ta lidhim me pozicionin N, si në (26), sipas hipotezës që elementet eptuese të pjesores, si ata të emrave dhe ata të mbiemrave, i referohen pozicionit N.

(26) *Shkodër*

Pjesorja e eptuar paraqet morfologjinë e përshtatjes së mbiemrave dhe të emrave (Turano e Rrokaj 2000, Turano 2001). Në veçanti morfologjia e përshtatjes së pjesores përfshin formativët eptues *ɛ*, *a* dhe nyjat parapjesore *i*, *ɛ*, *t*, të cilave u përgjigjen hyrjet leksikore në (27). Elementet


i, *ε*, *a* lidhen me karakteristika tradicionalisht të quajtura të gjinisë, pra tipare të klasës emërore; këto i përgjigjen leksikalizimit të pozicionit N të emrit. Elementi *t* lidhet me shumësin dhe rasat e zhdrejta (dhanoren e gjinoren); ia njohim këtë element kategorisë kuantifikuese Q, si në (27d). Përmendim që elementi proklitik ndryshon në varësi të rasës, në kuptimin që *i*, *ε*, *t* përfaqësojnë sistemin emëror, ndërsa në kontekstet në të cilat pjesorja përshtatet me një argument në kallëzore, si në (15), paraprihet në çdo rast nga *t*.

- (27) a. [Nⁱ]
 b. [N^ε]
 c. [N^a]
 d. [Qt]


Formativët *-m* e *-un*, që karakterizojnë pjesoret e eptuara, mund të analizohen si leksikalizim i cilësive aspektore, më saktë perfektive, të fjalisë pjesore. Duke rimarrë në shqyrtim eptimet aspektore dhe modale të propozuara për gjuhët romane nga Manzini e Savoia (2004a, 2005), dhe nga Manzini, Savoia e Franco (në shtyp) për ndërtimet me pjesore në gjuhët indiane, elementet *-m* e *-n* mund të identifkohen me kokën aspektore Asp si në (28). Baza foljore, ndonjëherë e zgjeruar me zanoren e temës si në (26), në këtë rast është plotësi i kokës T të përfaqësuar nga *-m/-n* dhe të futur si i tillë në pozicionin N në të majtë të *-m/-n*. Eptimet *ε*, *a* në (28a) e (28b) nga ana e tyre lidhen me një pozicion N brenda strukturës pjesore, në të djathtë të përbërësit (konstituentit) *mlum-* ose *vefun-*, të cilit i përcaktojnë argumentin e brendshëm. Duke qenë se klitiku parapjesor ndryshon në varësi të rasës së pjesores, mund të pranojmë se vargui, *ε*, *t* i emërores vendoset në pozicionin D të vargut klitik, që i caktohet argumentit EPP sipas Chomsky-t (1995), pra kryefjalës ose emërores tradicionale, si në (28a). Për sa i përket klitikut *t* të kallëzores, mund të mendohet që ky element leksikalizon nga ana e vet argumentin e brendshëm Q si në (28b).

(28) *Shkodër*

a.



b.



Analiza e brendshme e pjesoreve të pandryshueshme të tipit *mlu*, e paraqitur në (26), nënkupton që këto forma leksikalizojnë një element N, zanoren e temës. Në dallim nga sa ndodh me elemente N si *-a/-ε* në (28) zanorja e temës nuk ndryshon me ndryshimin e argumentit të pjesores. Elementet *-a/-ε* janë pra elemente përshtatëse në kuptimin tradicional të fjalës, d.m.th. në kuptimin që mbajnë parasysh klasën emërore dhe/ose numrin e argumentit të pjesores. Nga ana tjetër trajtimi i zanores së temës si një element N përkon me mundësinë që Manzini e Savoia (2002a, 2004a) quajnë përshtatje të pjesshme; me fjalë të tjera eptimi N nuk leksikalizon referimin ndaj tipave të ndryshëm të klasave emërore dhe/ose numrit, por thjesht referimin ndaj argumentit N.


Vërejmë që, ndërsa forma *mlu-* në (28a) përkon me pjesoren e pandryshueshme, zgjerimi *-u* i bazave bashkëtingëllore të tipit në (28b) specializohet si plotës i kokës aspektore *-n*. Pra analiza në (28) nënkupton

që formativi aspektor *-m/-n* merr si plotës jo bazën e thjeshtë foljore, por bazën që përfshin një formativ N, pra *-u*. Përmendim që pjesorja e pandryshueshme e temave më bashk-ëtingëllore karakterizohet nga një bërthamë zanore e gjatë, p.sh. *ve:f*, dhe dallohet kështu nga baza e thjeshtë foljore *vef* me bërthamë zanore të shkurtër (për zanoret e gjata të gegërishtes shih Beci 1979, 1984). Analiza e pjesores së pandryshueshme *ve:f* sugjerohet pikërisht nga krahasimi me pjesoret e tipit *mlu* të analizuara në (26). Në veçanti kemi analizuar zanoren e temës si një përbërës N të brendshëm të përbërësit (konstituentit) foljor. Mund ta shtrijmë këtë analizë në pjesoren e tipit *ve:f*, duke e parë këtë të fundit si një element leksikor të specializuar, që përfshin referimin e tipit N. Baza e thjeshtë foljore *vef* nat-yrisht nuk e ka këtë tipar shenjues.


Siç kemi parë në (17), ka edhe forma të pjesores së emëruar, me eptim *-m*, *-(u)n*, që leksikalizojnë kundrinën e foljes kryesore. Pjesorja e emëruar paraprihet nga pjesëza proklitike *s* e gjinores ose nga ajo *t* e kallëzores dhe përfshin eptimin *-it* të kundrinës së shquar, si në (29). Formativi *-it* mund të analizohet si kombinimi i argumentit N i bazës pjesore *hðŋərn-* e *shkrum-*edhe i elementit *t* Q. Është përbërësi (konstituenti) N që përcakton natyrën emërore të pjesores në tërësinë e saj. Për sa u përket pjesëzave proklitike *t* të kallëzores dhe *s* të gjinores, mund të mendojmë që *t* futet në Q, si në (29a), në përputhje me interpretimin e pjesores si argument të brendshëm. Ndërsa elementi *s* i gjinores mund të identifikohet si një element i tipit vendor Loc, si në (29b). Në mbështetje të kësaj vërejmë që edhe në gjuhët romane, në rastin tonë në italishte, gjinorja përkon me sintagmën parafjalore të paraprirë nga *di* ose nga klitiku *ne* që po ashtu mund të kenë vlerë vendore, si në *esco di lì, ne esco* ‘dal që atje, dal prej’).

(29) *Shkodër*

a.




b.




Nga krahasimi i së folmes geqe të *Shkodrës* të shqyrtuar deri tani me të dhënat nga të folme toske, si ajo e Gjirokastrës në (9)-(10), vihet në dukje që në këto të fundit pjesorja/paskajorja është gjithmonë e shoqëruar nga një eptim aspektor i specializuar, pra *-Vr*, që do ta analizojmë si kombinim të një zanoreje të temës N me kokën aspektore *-r*. Si në të folmen e *Shkodrës*, ashtu edhe në atë të *Gjirokastrës* ajo është një formë e pjesores pa eptim të bazës pjesore, pra e tipit në (30a), që në përgjithësi shfaqet në kontekste perfektive me *kam*, *jam*. Kjo formë me eptime të bazës pjesore dhe e përshtatur me një argument të fjalisë, është e kufizuar vetëm në kontekstet pjesore; siç tregohet në (30b) eptimet e rëndësishme mund të analizohen njësoj si në të folmet geqe.

(30) *Gjirokaštër*

a.



b.

**4.2. *Format e pandryshueshme.***

Mbi bazën e shqyrtimit të mësipërm, në të folmet geqe pjesoret e eptuara, të ilustruara në (28), shoqërohen me një eptim pjesor të specializuar. Në përputhje me këtë fakt, edhe kontekstet në të cilat shfaqen ato janë kontekste pjesore, pra fjali këpujore dhe pjesore. Shkurtimisht, pjesoret e eptuara janë format e pjesores në kuptimin e vërtetë të fjalës të këtyre të folmeve. Format foljore për të cilat kemi përdorur etiketën përshkruese të pjesoreve të pandryshueshme u përgjigjen bazave foljore me zanore të temës, si në (26), ose me vokalizëm të brendshëm të specializuar. Përndarja e këtyre formave foljore të pandryshueshme në shkodranishte tregon që në kontekstet në të cilat ndjekin foljen ndihmëse ato kanë vlerë perfektive, pra, shprehur me terma konvencionalë, kanë vlerë aspektore, ndërsa në kontekstet e paraprirë nga *mε* leksikalizojnë tipare të modalitetit të papërcaktuar. E

njëjta lidhje ndërmjet interpretimit modal dhe aspektor në të folmet toske paraprihet nga eptimi *-Vr*. Në fakt rikujtojmë që format e pajisura me këtë eptim shfaqen në të gjitha kontekste kryesore, si në (9), por edhe në kontekste me vlerë paskajore, pra me modalitet irreal, si në (10).

4.2.1 Bazat zanore.

Në të folmen e *Shkodrës* vlera aspektore e bazave foljore vërtetohet nga fakti që baza foljore me zanore të temës përfaqëson edhe vetën e 3-të njëjës të së kryerës në mesore-pësore, siç tregohet në (31). Pranojmë që përkimi ndërmjet (31) dhe bazave foljore që shfaqen në kontekstet pjesore/paskajore nuk është i rastësishëm, por bëhet fjalë për të njëjtat forma.

- (31) *Shkodër*
 u mlu
 u mbulua
 u lɔ
 u la
 u pre
 u pre
 u zi
 u zie

Në fakt lidhja ndërmjet modalitetit dhe aspektit foljor është e njohur pavarësisht nga literatura tipologjike dhe teorike; mjafton të mendohet për përdorimet me vlerë kundërfaktike të së pakryerës, p.sh. fjalia e italishtes *se potevo, facevo così* ‘po të mundja, do të bëja kështu’, që mbështeten në zotërimin e cilësive kuantifikuese të përcaktuara të modalitetit irreal dhe të së pakryerës. Sipas teorisë së zhvilluar nga Manzini e Savoia (2005), lidhja ndërmjet dy nocioneve tradicionale të mënyrës dhe të aspektit në thelb reduktohet në cilësinë e përcaktueshmërisë ose jopërcaktueshmërisë (së ngjarjes), që në veçanti ngërthen kontrastin themelor ndërmjet formave reale dhe irreale. Nga ana

e vet aspekti i kundruar si i kryer/i pakryer është një tjetër tipar i paraqitjes së ngjarjes dhe mund të reduktohet në cilësinë e përcaktueshmërisë/jopërcaktueshmërisë. Pra mund të mendojmë se qoftë cilësitë aspektore, qoftë ato modale të lidhura me bazat foljore me zanore të temës të shkodranishtes varen nga karakterizimi i kuantifikuar i referimit ndaj ngjarjes (eventiv). Në rastin e interpretimit pjesor dhe të aspektit të kryer kemi të bëjmë me kuantifikim të përcaktuar, në rastin e interpretimit pasakajor kemi të bëjmë me një kuantifikim modal.

Supozojmë që format në (31) kanë të njëjtën strukturë të brendshme si ajo e paraqitur në (26) për pjesoren. Sipas teorisë së parahtuar nga Manzini e Savoia (2002a, b, 2004a,b, 2005) veta e 3-të njëjës leksikalizohet nga formativë që përkojnë me elemente të klasës emërore. Mund të mendojmë që zanorja tematike *-u* në (26) është një element i këtij tipi dhe si i tillë përputhet me përkufizimin e vetës së 3-të njëjës. Fakti që format e tipit që shfaqet në (26) vlejné vetëm për referimin ndaj vetës së 3-të njëjës, mund të lidhet me dallimin ndërmjet interpretimit të vetës së 1-rë/2-të dhe asaj të 3-të. Veçanërisht referimi ndaj vetës së 1-rë/2-të, prandaj folësit dhe dëgjuesit, mund të përftohet drejtpërdrejt në përpjesëtim me universin e diskursit. Përkundrazi, interpretimi i vetës së 3-të karakterizohet nga të qenët domosdoshmërisht i lidhur me një rol eventiv. Ky dallim ndërmjet vetës së 1-rë/2-të dhe asaj të 3-të duket se qëndron në bazë të faktit që argumenti N i kokës kallëzu-esore të foljes përjashton çdo tip leksikalizimi të specializuar për referimin ndaj vetës së 1-rë/2-të. Në format në (31) elementi tematik në N, si p.sh. *-u*, në brendësi të përbërësit (konstituentit) foljor, mund të kufizohet pra vetëm në interpretimin e vetës së 3-të njëjës, nëse pranojmë që shumësi nga ana e vet rrjedh nga prania e elementeve Q të specializuara.

Në shqyrtimin e mësipërm N është lidhur me argumentin e brendshëm të emrit dhe të foljes dhe D me argumentin EPP të foljes, pra me kryefjalën. Mund të mendojmë nga ana tjetër që zanorja e temës N brenda përbërësit (konstituentit) foljor ndihmon për të përcaktuar cilë-

sitë përkufizuese të lidhura me argumentin EPP, duke bërë të mundur referimin e vetës së 3-të njëjës për kryefjalën e foljes në (31).

Vërejmë që interpretimi mesor-vetvetor në (31) leksikalizohet pavarësisht nga klitiku i specializuar *u*, i krahasueshëm me pjesëzën vetvetore *si* të italishtes (Manzini e Savoia 1999). I njëjti leksikalizim haset në interpretimin mesor-vetvetor të bazave foljore në kontekstet paskajore (përcjellore etj.). siç tregohet p.sh. në (18), si edhe në kontekstet urdhërore që shqyrtohen në vijim, në paragr. 4.2.3. Mbi mundësinë e leksikalizimit të interpretimit mesor-vetvetor përmes eptimit të specializuar të foljes së shtjelluar, si alternativë ndaj klitikut *u*, të shihet shqyrtimi i të folmeve të tipit toskë *te* Manzini e Savoia (1999). Këtu do të mjaftohemi me vërejtjen që ky i fundit haset në kontekstet ku interpretimi mesor-vetvetor lidhet me bazën e thjeshtë foljore, me përjashtim të konteksteve pjesore me *jam*; është e qartë se në këtë rast përzgjedhja e foljes ndihmëse në vetvete është e mjaftueshme për të përcaktuar interpretimin mesor-vetvetor.

4.2.2. *Bazat bashkëtingëllore.*

Format pjesore/paskajore jotematike me zanore të gjatë të tipit *ve:f*, *lo:ðetj.* nga ana e tyre përkojnë me format e vetës së 2-të/3-të njëjës të dëftores së tashme. Në (32) po japim paradigmat e dëftores së tashme të foljeve më bashkëtingëllore. Një çështje të rëndësishme përbën fakti që në klasën e foljeve më bashkëtingëllore dallimi ndërmjet vetës së 2-të/3-të njëjës, që nuk eptohen, dhe vetës së 1-rë njëjës e vetave të shumësit, të cilat kanë eptim të specializuar, krijon një lloj ‘çarjeje’ (split) të vetës.

(32) *Shkodër*

ε *ve:fi*, *ve:f*, *ve:f*, *ve:fi*, *ve:fi*, *ve:fi*

e *vesh*, etj.

ε *lagu*, *la:g*, *la:g*, *lagu*, *lagu*, *lagu*

e *lag*, etj.

ε *lo:ði*, *lo:ð*, *lo:ð*, *lo:ði*, *lo:ði*

e lodh, etj.
 ε kreh, kre:h, kre:h, krehim, krehni, krehin
 e kreh, etj.

Kemi parë që format me bazë zanore në (31) vërtetojnë përputhjen ndërmjet interpretimit aspektor të pjesores dhe të së kryerës së dëftores, dhe natyrisht përputhjen e këtyre dy interpretimeve me interpretimin modal të paskajores. Në rastet e temave bashkëtingëllore, vlera modale e paskajores dhe ajo aspekte e pjesores përkojnë me referimin ndaj së tashmes. Në lidhje me (31) kemi sugjeruar që qoftë modaliteti, qoftë aspekti shpjegohen me cilësinë e përcaktueshmërisë/papërcaktueshmërisë së ngjarjes. Edhe për format me bazë bashkëtingëllore në (32) interpretimi paskajor lidhet me kuantifikimin modal të ngjarjes, ndërsa interpretimi pjesor, perfektiv, nënkupton një kuantifikim të përcaktuar. I njëjti trajtim mund të propozohet për interpretimin e së tashmes. Në fakt mund të pranojmë që format foljore të shtjelluara janë ato në të cilat koha e foljes i referohet një pike ose një tërësie të përcaktuar pikash kohore. Këto përfshijnë të tashmen e dëftores, sepse në shqipe, ashtu si edhe në italishte, ajo mund t'i referohet një pike të përcaktuar në çastin e thënies.

Po ashtu kemi parashtruar mendimin që bazat pjesore/paskajore të tipit *ve:/etj.* janë forma të specializuara për leksikalizimin e referimit ndaj një elementi N; pra duhet të arrijmë në përfundimin se një morfologji e tipit N është e përshtatshme me përkufizimin e vetës së 2-të njëjës dhe të 3-të njëjës në të njëjtën kohë. Ky përfundim vërtetohet nga ekzistenca e kushteve të krahasueshme në gjuhë të tjera. Veçanërisht në Manzini e Savoia (2004a, 2005) analizohen disa dialekte të italishtes veriore, ku referimi ndaj vetës së 2-të njëjës dhe të 3-të në të tashmen e dëftores leksikalizohet nga baza e thjeshtë e foljes, ose nga baza e foljes e ndjekur nga një eptim i tipit N. P.sh. në të folmen e tipit lombard të *Soacës (Soazza)* paradigma e klasës së parë për njëjësin është *lavi, tu lava, əl/lalava*, ndërsa në klasën e dytë gjejmë *dərm, tu dərm, əl/la dərm*. Në rastin e parë pra vetat e 2-të/3-të njëjës shfaqin të njëjtin eptim *-a* që përkon me përcaktime të qarta të klasës emërore; në rastin e

dytë vetat e 2-të/3-të njëjës përkojnë me bazën e foljes.

Të shqyrtojmë pra se cilat janë cilësitë interpretuese të brendshme të referimit ndaj vetës së 2-të e të 3-të njëjës që e bëjnë të përputhshme me të njëjtën morfologji, siç e gjejmë në të folmet romane të sapocituara dhe në format në (32) që po shqyrtojmë. Në fakt përkufizimi i vetës së 3-të njëjës, i lidhur vetëm me strukturën e ngjarjes, ndryshon nga ai i vetës së 2-të njëjës, pra i dëgjuesit, i lidhur në mënyrë të brendshme me universin e diskursit. Megjithatë mund të mendojmë që leksikalizimi që i përgjigjet klasës emërore, pikërisht sepse nuk është i specializuar më tej, mund të përputhet qoftë me përkufizimin e lidhur me universin e diskursit, qoftë me atë të lidhur me ngjarjen.

4.2.3. Parametrizimi në lidhje me bazat bashkëtingëllore.

Në disa të folme geqe, si ajo e *Mirditës* në (33), e njëjta formë që përkon me bazën foljore, leksikalizon pjesoren e pandryshueshme në (33a), vetën e 1-rë/2-të/3-të njëjës të dëftores së tashme veprare në (33b) dhe vetën e 3-të njëjës të së kryerës së mesore-pësore në (33c). Në disa klasa, si ajo e paraqitur në (33)(i), forma e urdhërores së vetës së 2-të njëjës në (d) dallohet nga baza e thjeshtë foljore, sepse ka një bërthamë zanore të specializuar. Në klasa të tjera, si ajo në (33)(ii), edhe urdhërorja e vetës së 2-të njëjës përfaqësohet nga baza e thjeshtë e foljes.

(33) *Mirditë*

- i. a. du m(ε) u kɾɛf
dua të krihem
ɛʃt kɾɛf
është krehur (m.f.)
ε kam kɾɛf
e kam krehur (m.f.)
- b. ε kɾɛf
e kreh (veta e 1-rë/2-të/3-të)
- c. u kɾɛf
u kreh
- d. m krif

- më krih!
- ii. a. t kam θan mɔs mɛɛ lɔð
 të kam thënë të mos e lodhësh
 ε kam lɔð
 e kam lodhur (m.f.)
 ɛʃtlɔð
 është lodhur (m.f.)
- b. ε lɔð
 e lodh (veta e 1-rë/2-të/3-të)
- c. u lɔð
 u lodh
- d. mɔs ε lɔð
 mos e lodh


Në shkodranishte tiparet e gjatësisë dhe të cilësisë së zanores së theksuar dallojnë format e vetës së 2-të/3-të njëjës në (32) nga format e urdhërores së vetës së 2-të njëjës në (34b) dhe të vetës së 3-të njëjës të së kryerës së mesore-pësores në (34a), të cilat kanë një bërthamë zanore më të shkurtër, më të hapur dhe më qendrore. Kështu *ve:f* me kuptim pjesor/paskajor ose në vetën e 2-të/3-të njëjës të dëftores së tashme dallohet nga urdhërorja *m ve:f* 'më vish' dhe nga e kryera e thjeshtë e mesore-pësores *u ve:f* 'u vesh'.

- (34) *Shkodër*
- a. u veʃ
 u vesh
 u lɔð
 u lodh
 u θir
 u thirr
 u kreɥ
 u kreh
- b. m/ na veʃ
 më/na vish!
 veʃɛ/i
 vishe/i!
 veʃ u
 vishu!
 mas m/ na/ ε/ i/ u veʃ
 mos më/ na/e/i/u vish!
 m kreɥ

më krih!
 mas u loð
 mos u lodh!
 mas εθir
 mos e (m.f.) thirr!

Kontrasti ndërmjet zanores së gjatë dhe zanores së shkurtër, thjesht si shembull për këtë rast, është ilustruar nëpërmjet spektrogramave në (34'), që krahasojnë formën e pjesores së shkurtuar [mε ve:ɟ] 'me vesh', e gjatë 181ms, me urdhëroren [veɟ] 'vesh!', e gjatë 117 ms. (Për realizimin e analizës akustike është përdorur *software Praat*)³.

(34') *Shkodër*



m ε v e: ɟ v e ɟ

Të dhënat që kanë të bëjnë me klasat foljore me temë më zanore të sjella për krahasim në (35) tregojnë që në dëftoren e tashme bazës së foljes me zanoren e temës i shtohen formativë eptues në tri vetat e njëjësit. Megjithatë përsëri veta e 2-të dhe e 3-të kanë të njëjtin eptim, pra *-n*, si në (a). Edhe format urdhërore të vetës së 2-të njëjës të klasave me temë më zanore kanë tipare eptuese të specializuara, siç duket në (35b). Në veçanti në disa tipa, p.sh. (35ii), gjejmë eptimin *-i*, ndërsa në rastin e bazave më *-a/-o* gjejmë zanoren e temës *-a*, si në (35i).

³ Falenderojmë informatoret tona, Alma Hafizin dhe Eliana Laçejn.

(35) *Shkodër*

- i. a. emlai, mla:n, mla:n, mloim, mloni, mloin
e mbuloj, etj.
- b. m mla
më mbulo!
- ii. a. ε prei, pre:n, pre:n, preim, preni, prein
e pres, etj.
- b. mas u prei
mos u pri!

Të shqyrtojmë pra të folmen e *Mirditës*; në klasën foljore në (33) (ii) pjesorja/paskajorja përputhen me të kryerën e mesore-pësore dhe me të tashmen; me fjalë të tjera këtu kombinohen të dy përkimet e mundshme, të cilat i kemi studiuar në lidhje me (31) dhe (32). Kështu mund ta shtrijmë edhe në (33)(i) trajtimin e parashtruar për (31) e (32), sipas të cilit baza leksikore lejon të bëhet një interpretim i kuantifikuar, qoftë i papërcaktuar (paskajore), qoftë i përcaktuar (pjesore, e kryer e thjeshtë, e tashme). Po ashtu në të tashmen e dëftores në (b) referimi ndaj bazës foljore shtrihet në të gjitha vetat e njëjësit. Kjo mënyrë e leksikalizimit të të trija vetave të njëjësit me anë të bazës së thjeshtë foljore dëshmohet gjerësisht edhe në të folmet romane, p.sh. *a dɔ:rem, at dɔ:rem, al/la dɔ:rem* në dialektin e *Modenës*, të cilat dallohen nga shumësi *a durmam, a durmi, i/ al dɔ:rmen*.

Në rastin e paradigmave në (33)(ii), tërësisë së interpretimeve të lidhura me bazën e thjeshtë të foljes u shtohet ajo e urdhërores së vetës së 2-të njëjës. Duke qenë se kemi pranuar që bazat e thjeshta foljore janë të pajtueshme me një kuptim të kuantifikuar të referimit të tyre eventiv, interpretimi i urdhërores, si edhe ai i paskajores, mund të lidhet me një kuantifikim modal. Referimi ndaj vetës së 2-të njëjës, në mungesë të eptimeve të specializuara, mund të shpjegohet me spikatjen që bën dëgjuesi në kontekstet urdhërore.

Duke u kthyer në të folmen e *Shkodrës*, leksikalizimi i së kryerës së mesore-pësore të vetës së 3-të njëjës dhe të urdhërores së vetës së 2-të njëjës nga ana e bazës së thjeshtë foljore, si në (34), bie në kundërshtim

me leksikalizimin e pjesores/paskajores dhe të së tashmes së vetës së 2-të e të 3-të nga ana e bazës foljore me bërthamë zanore të gjatë që e kemi karakterizuar si një formë që përfshin morfologjinë N. Në fakt, mungesa e morfologjisë së specializuar të tipit kohor/aspektor në të gjitha këto forma të ndryshme, shpjegohet brenda caqeve të shqyrtimit që ka të bëjë me të folmen e *Mirditës*, pra si mundësi për ta lidhur bazën foljore me një kuantifikim eventiv të llojit të përcaktuar/të papërcaktuar. Përkundrazi, e folmja e *Shkodrës* leksikalizon tipare të tipit N në përputhje me interpretimin pjesor/paskajor dhe të së tashmes së vetës së 2-të e të 3-të njëjës, ndërsa nuk i leksikalizon ato në përputhje me urdhëroren e vetës së 2-të njëjës dhe me të kryerën e vetës së 3-të njëjës.

Në përfundim të këtij shqyrtimi është me dobi të hartohen skemat e formave të ndryshme të leksikalizuara në dialektet gege të studiuara këtu, pra të *Shkodrës* dhe *Mirditës*, nga baza e thjeshtë foljore ose nga baza e thjeshtë foljore e kombinuar me një tipar N, të leksikalizuar me anë të zanores së temës ose të zgjatjes së bërthamës zanore të bazës foljore. Pasqyra përmbledhëse në (36) vë në dukje se këto forma gjithsesi leksikalizojnë një interpretim modal (paskajore, urdhërore), ose aspektor (pjesore, e kryer, e tashme). Gjithashtu qoftë morfologjia N, qoftë mungesa e çdo tipi morfologjie emërore janë në pajtim me një numër të kufizuar përkufizimesh emërore, të cilat përfshijnë njëjësën dhe në veçanti vetën e 2-të dhe të 3-të njëjës. Këto kufizime interpretuese vërtetojnë qasjen tonë, të mbështetur në idenë se të folmet në (36) nuk paraqesin një përkim të rastit ndërmjet formave të ndryshme të paradigëm foljore, por më tepër janë forma leksikore unike të pajtueshme me një mjedis të kufizuar interpretimesh.

(36)	<i>Shkodër</i>	
i)	baza zanore bazë foljore + zanore e temës N:	pjesore/paskajore veta e 3-të nj. e kryer mesore-vetvetore
ii)	baza bashkëtingëllore bazë foljore	veta e 3-të nj. e kryer mesore-vetvetore

bazë foljore + zanore e gjatë (=N)	veta e 2-të nj. urdhërore pjesore/paskajore veta e 2-të/3-të nj. e tashme dëftore
------------------------------------	--

Mirditë

- | | |
|--|---|
| i) baza bashkëtingëllore e tipit <i>krɛf</i>
bazë foljore | pjesore/paskajore
veta e 3-të nj. e kryer
mesore-vetvetore veta e
1-rë/2-të/3-të nj. tashme
dëftore pjesore/paskajore |
| ii) baza bashkëtingëllore e tipit <i>lɔð</i> | veta e 3-të nj. e kryer
mesore-vetvetore
veta e 1-rë/2-të/3-të nj. e tashme
dëftore veta e 2-të nj. urdhërore |


Pasi kemi parë në (9)-(10) që të folmet toske, duke përfshirë edhe ato arbëreshe, leksikalizojnë pjesoren/paskajoren me anë të një eptimi të specializuar -*V-r*, ia vlen të vihet në dukje që edhe në këto të folme shfaqen forma foljore që përkojnë me bazën foljore, e cila nganjëherë përfshin edhe zanoren tematike. P.sh. në të folmen e *Gjirokastrës* bazat foljore më zanore shfaqen si vetë e 3-të njëjës e së kryerës së pësore-mesores dhe si vetë e 2-të njëjës e urdhërores; e njëjta përndarje karakterizon të paktën disa prej bazave më bashkëtingëllore, edhe pse me të tjera syresh veta e 2-të njëjës e urdhërores paraqet një bërthamë zanore të modifikuar.

4.3. Fjalitë me *mɛ* dhe pjesore të pandryshuar.

Analiza e formimeve me pjesore të pandryshuar kërkon një shqyrtim të natyrës së introduktorëve parafjalorë si *mɛ*. Në shqyrtimin klasik të parafjalëve në kontekstet në të cilat këto “mbërthejnë” emrat, si p.sh. në (4), parashikohet që këto të jenë koka autonome, në të cilat sintagma emërore përfaqëson plotësin. Është e mundur që ky trajtim të shtrihet edhe tek parafjalët që paraprijnë ndërtime me pjesore të pandryshueshme: në këtë rast zbatojmë propozimin e sjellë në Manzini e


Savoia (2007) që identifikojnë pjesëzën *mε* me leksikalizimin e një koke D në fushën C, që fut ndryshoren që i përket argumentit D të pjesores, siç tregohet në (37). Fakti që një kundrinor klitik paraprin formën e pjesores së pandryshueshme lë të kuptohet që kjo e fundit zë një pozicion të ulët në brendësi të fjalisë, pra pozicionin normal v të foljes. Natyrisht kundrinën klitike *ε* në (37) e trajtojmë si leksikalizim të argumentit N të vargut emëror të projektuar nga F.

(37) *Shkodër*



Fakti që introduktorët parafjalorë *mε/ pa* kufizohen në ndërtime pjesore të kujton kufizimin e ngjashëm në gjuhët romane, ku p.sh. parafjalët *di, a, senza* etj. të italishtes marrin si plotësja fjali paskajore. Për sa u përket gjuhëve romane, si italishtja, në Manzini e Savoia (2005) kemi hedhur idenë që introduktori parafjalor shfaqet kur fjalia e varur nuk është e shtjelluar; në fakt fjalitë paskajore romane nuk kanë leksikalizim të argumentit D as nga ana e eptimit të foljes, as nga ana e një sintagme emërore të vendosur në domenin e tij të eptimit T. Po kështu edhe në gjuhën shqipe fjalia kryesore e paraprirë nga parafjala nuk shfaq leksikalizimin e argumentit D nga ana e eptimit të foljes dhe nuk pranon subjekte leksikore parafoljore. Përkundrazi, si në gjuhët romane, ashtu edhe në shkodranishte, shfaqen së bashku paskajorja dhe pjesorja e pandryshueshme përkatësisht me një subjekt pasfoljor. Në këtë rast subjekti zë një pozicion të ulët, të krahasueshëm me atë të plotësave të tjerë brenda strukturës së fjalisë.


Ndryshe nga introduktorët parafjalorë si *mε*, elementet si *tʃi* apo *se* që paraprijnë fjalitë e shtjelluara, pra një argument D të leksikalizuar, mund të trajtohen si kuantifikuesetë specializuar për një ndryshore fjalie, dhe si të tillë e lidhin me pozicionin Op të domenit më të lartë të fushës C të fjalisë, siç tregohet në (38) (Manzini e Savoia 2003, 2005).



Është interesante të vihet re, siç tregohet në (18) që vargu *mε - klitik – pjesore* mund të paraprihet nga një plotësues *tʃi* apo *se*, duke u dalluar në këtë mënyrë nga gjendja e gjuhëve romane, në të cilat përplotësuesit si *che* e përjashtojnë paskajoren (të paraprirë ose jo nga parafjala). Mund të mendojmë se ky dallim është i bashkëlidhur me tiparet e ndryshme të ndërtimit pjesor në krahasim me ndërtimin paskajor roman; paskajorja romane parashikon një formativ modal, *-re* në italishte, i cili nga ana e vet nuk eptohet as në tiparin D, as në tiparin N. Përkundrazi pjesorja në caqet e paraqitura këtu është një formë e eptuar, edhe pse eptimi i saj është i një tipi emëror, pra N; mund të mendojmë se kombinimi i *tʃi/se* me pjesoren e pandryshueshme është në radhë të parë pasojë e këtyre tipareve të eptimit. Nga ana tjetër *tʃi* e *se* nuk kombinohen drejtpërdrejt me pjesoren e pandryshueshme, por vetëm me pjesoren e paraprirë nga një parafjalë; një gjë e tillë lë të kuptohet se parafjala ndihmon për leksikalizimin e modalitetit, i nevojshëm për përcaktimin e një ndryshoreje fjalie. Nga këndvështrimi strukturor duhet të pranojmë që përplotësuesi vendoset në një pozicion Op


brenda përbërësit (konstituentit) parafjalor, duke krijuar struktura si (39).

(39) *Shkodër*




Në ndërtimet e tipit në (39), ku pjesorja e paraprirë nga *mɛ* udhëhiqet nga një përplotësues i shtjelluar, pranohet leksikalizimi i argumentit D, pra i kryefjalës, ndërmjet përplotësuesit në Op dhe kokës parafjalore *mɛ*. Siç tregohet në (40), pranojmë që kryefjala vendoset në një pozicion të topikalizuar, të lidhur nga ana e vet me një domen të lartë C. Kjo mundësi vërteton idenë që në gjuhën shqipe si në gjuhët romane përplotësuesi *tʃi/sɛ* lidh një ndryshore që i përgjigjet një fjalie, që përfshin interpretimin e argumentit D.

(40) *Shkodër*




Togu *me* - *pjesore e pandryshueshme* mund të paraprihet edhe nga fjali të tjera, të cilat ashtu si *pər* në (41) nga ana e tyre janë koka të një ndërtimi parafjalor.

(41) *Shkodër*




Mohimi *mas*, i cili i papraprin *mε* dhe pjesores, përkon me një element të specializuar për kontekstet modale, duke qenë se shfaqet në formimet me vlerë urdhërore dhe kombinohet me pjesëzën e përcjellores *tu*, siç tregohet në (6), por jo në ndërtimet me vlerë dëftore. Sipas propozimit të parashtruar nga Manzini e Savoia (1999, 2005) mund të mendohet që klitiku mohues në përgjithësi leksikalizon një pozicion emëror Q që i përket të njëjtit varg ku ndodhen klitikët e argumentit. Në veçanti *mas*, duke qenë formë modale dhe jo dëftore, zë vend në brendësi të fushës C të kokës që i jep tipare modale ndërtimit, pra *mε*, siç tregohet në (42).

(42) *Shkodër*



Introduktori *mε*, së fundi, mund të paraprihet edhe nga elementi *wh-* në ndërtimet pyetëse të zhdrejta. Manzini e Savoia (2003, 2005) theksojnë se domeni i rëndësishëm i sintagmave *wh-* është C_I , pra domeni i lidhur me tipare të fokalizimit. Natyrisht në shembujt si (43) përfshihet domeni C_I i kokës parafjalore; në veçanti *tfa* leksikalizon pozicionin N që i përgjigjet argumentit të brendshëm. Pozicioni brenda domenit C_I sqaron edhe faktin që elementi *wh-* ndjek plotësuesin *sε* në Op. Ky rend mund të vërehet në fjalitë e zakonshme pyetëse të zhdrejta me folje të shtjelluar, siç tregohet në (22b) dhe siç ka vënë në dukje Turano (1995) për të folmet toske.

(43) *Shkodër*




Shkodranishtja parashikon një introduktor kushtor *bǃ* për ndërtimet *mε - pjesore e pandryshueshme*, përveç introduktorit *po t* për fjalitë e shtjelluara, si *po t mas m θrpsin s vi* ‘po të mos më thërresin nuk vij’. Si *bǃ* ashtu edhe *po*, si introduktorë kushtorë mund të karakterizohen si elemente që paraprijnë një kuantifikim të fjalisë. Në këtë kuptim ata mund të njëjtësohen me përplotësuesit. Në veçanti elementi *bǃ* dallohet prej elementit *po*, duke qenë se është i specializuar për tipin e ndërtimeve me pjesore të pandryshueshme, pra pa leksikalizim të argumentit D.


Pjesorja e pandryshueshme mund të kombinohet drejtpërdrejt, përveç pjesëzës *mε* edhe me pjesëzën *tu*, duke sjellë një kuptim përcjellor, pra progresiv, si në lidhjen me foljen *jam*, ashtu edhe në fjali rrethore. Përndarja e introduktorit *tu* ndryshon nga ajo e *mε* në

aspekte të ndryshme; nga njëra anë, nuk ka asnjë dëshmi të pavarur që *tu* të jetë një element parafjalor, duke qenë se nuk lidhet me sintagmat emërore. Nga ana tjetër, *tu* ndiqet nga ndërtime mohore, ndërsa parafjala *më*paraprihet prej tyre. Nga të dyja këndvështrimet *tu* është më i ngjashëm me plotësit. Pra mund të mendojmë se bëhet fjalë për një element Op si në (44); fakti që mund të paraprijë vetëm një tërësi të kufizuar elementesh, pra me mohimin modal, përveç klitikëve, duket se tregon një pozicion të ulët për këtë plotës, pra Op të domenit C.

(44) *Shkodër*



Urdhërorja e vetës së 2-të njëjës, edhe pse mund të përkojë me bazën foljore, nga këndvështrimi i vendit që zë në varësi të klitikëve, paraqitet e ndryshme nga pjesorja e pandryshueshme. Në fakt klitiku i vetës së 3-të dhe klitiku mesor-vetvetor *u* ndjekin bazën foljore me vlerë urdhërore, ndërsa klitiku i vetës së parë e paraprin atë. Gjithashtu, kur baza foljore paraprihet nga mohimi modal, pra pjesëza *mas*, të gjithë klitikët shfaqen në pozicion proklitik, siç duket nga të dhënat në 34(b). Nëse pranojmë, si në rastin e strukturave me interpretim pjesor/paskajor, që pozicioni proklitik përkon me pozicionin e bazës foljore në V, urdhërorja mohuese do të ketë strukturën e paraqitur në (45), paralele me atë të parashtruar në (42) për paskajoren mohuese.

(45) *Shkodër*


4.4. Urdhërorja.

Në njërën nga të folmet e shqyrtuara, në atë të Mirditës, kemi parë në paragr. 4.2.3. që të paktën për disa prej foljeve më bashkëtingëllore pjesorja e pandryshueshme përkon me bazën foljore, e cila nga ana e vet leksikalizon urdhëroren e vetës së 2-të njëjës. Në të folmen e Shkodrës të shqyrtuar më hollësisht këtu, qëndron fakti që veta e 2-të njëjës e urdhërores përkon me bazën foljore të foljeve më bashkëtingëllore.


Ndërkëmbimi ndërmjet pozicionit proklitik të klitikëve të vetës së 3-të dhe pjesëzës *u* në urdhëroren mohore, lë të kuptohet që në rastin e dytë baza foljore ka një pozicion më të lartë. Gjithashtu klitikët e vetës së 1-rë paraprijnë bazën foljore edhe në urdhëroren pohuese; kjo përndarje e ndryshme e klitikëve është pasqyrim i faktit që ata vendosen në domene të ndryshme, në të djathtë dhe në të majtë të foljes. Për sa i përket kësaj të fundit, mendojmë që të jetë në C, si në (46), mbi bazën e krahasimit me të folmet e italishtes ku klitikët shkëputen prej njëri-tjetrit në mënyrë të ngjashme me atë që sapo kemi përshkruar. Manzini e Savoia (2004a, 2005) mendojnë që klitiku P ndodhet brenda domenit C, ndërsa klitiku N brenda domenit F; kjo do të thotë që koka foljore ndodhet në C.

(46) *Shkodër*

a.



b.



Në shqyrtimin e mësipërm kemi përmendur faktin që përkufizimi i vetës së 3-të ndryshon nga ai i vetës së 1-rë dhe të 2-të, sepse veta e 3-të interpretohet në lidhje me strukturën e ngjarjes, ndërsa ai i vetës së 1-rë/2-të, pra folës/dëgjues lidhet me universin e diskursit. Në vazhden e Manzinit dhe Savoies (1999), të cilët kanë përvijuar një përndarje të ngjashme me atë të (46) për të folmet arbëreshe, mendojmë që në bazë të pozicionit të ndryshën të dy vargjeve klitike në (46a) e (46b) qëndron kjo shkëputje ndërmjet vetës së 3-të dhe vetës së 1-rë/2-të. Mund të mendojmë pra se elementet e lidhura me universin e diskursit, si klitiku *m* i vetës së 1-rë, mund të vendosen në një domen modal si C, pa paragjykuar interpretimin e tyre. Përkundrazi, elemente si *ε* e kallëzores ose *u* e mesore-vetvetores, të cilat kanë nevojë të lidhen me ngjarjen, shfaqen në domene emërore të tipit eptues, pra F.

4.5 Elementi pjesor në ndërtimet me folje ndihmëse.

Të shqyrtojmë formimet në të cilat pjesorja ‘ngulitet’ nën një folje ndihmëse, *jam* apo *kam*, duke filluar me pjesoret e pandryshueshme. Siç tregohet në (47a) gjejmë *kam* me të gjitha klasat foljore, pra si me folje kalimtare *mlu* ‘mbuluar’, ashtu edhe me folje jokallëzore,

vrð‘ardhur’, dhe me folje joergative *fol* ‘folur’. Folja ndihmëse *jam* leksikalizon kuptimin mesor-vetvetor dhe pësor, si në (47b).

- (47) a. kam v:rð
 kam ardhur
 kɔ fo:l
 ka folur
 ε/i kam mlu
 e/ikam mbuluar (m.f.sh.)
- b. vʃt mlu
 është mbuluar (m.f.)

Prej diskutimit në paragr. 4.1. rrjedh që pjesorja është një strukturë fjalie e pavarur. Nga ana tjetër kontekstet *folje ndihmëse* – *pjesore* tradicionalisht trajtohen si një formë foljore e bashkuar. Duke shqyrtur gjuhët romane Manzini e Savoia (2005) mendojnë se jo vetëm pjesorja i përgjigjet një fjalie, por që edhe të ashtuquajturat folje ndihmëse *jam* e *kam* kanë vlerën e foljeve të zakonshme me tipare leksikore të veçanta. Përkimi i pikave të ngjarjes së fjalisë pjesore me ato të fjalisë në zanafillë varet nga fakti që pjesorja lidhet me një argument eventiv të ngopur jo në brendësi të fjalisë së vet, por nga të njëjtat tipare kohore F që ngopin ndryshoren eventive të foljes kryesore. Rrjedhoja e këtij identifikimi të argumenteve eventive është identifikimi i të tërë strukturës së argumentit.

Përndarja e foljeve ndihmëse *jam* dhe *kam* në gjuhët romane si italishtja të kujton atë të shqipes në një rast si *ho bruciato il quaderno* ‘kam djegur fletoren’ kundrejt *il quaderno è bruciato* ‘fletorja digjet; fletorja është e djegur’. Në fakt zgjedhja e foljes ndihmëse *jam* u përgjigjet interpretimeve të ndryshme, ndër të cilat ai pësor (*fletorja digjet nga dikush*) dhe ai mesor-vetvetor (*fletorja digjet vetë*). Në fjalitë pjesore të ndërtuara duke u nisur nga një folje kalimtare si *djeg*, ka dy pika eventive që u përgjigjen argumenteve të dallueshme nga pikëpamja interpretuese. Nëse një fjali pjesore e tipit *djegur* lidhet me *kam*, që nga ana e vet është folje kalimtare, përftojmë kuptimin kalim-

tar të të gjithë ndërtimit. Nëse e njëjta pjesore lidhet me *jam*, ka rëndësi vendimtare fakti që kjo folje ka vetëm një argument, i cili i përgjigjet kryefjalës. Njësimi i strukturave eventive të të dyja fjalive çon në identifikimin e argumentit të detyrueshëm të *jam*, pra të kryefjalës D, me argumentin e detyrueshëm të foljes leksikore, pra argumentin e brendshëm. Ky identifikim sjell kuptimin pasiv në rastin kur argumenti pjesor D interpretohet në mënyrë të pavarur, p.sh. si i përgjithshëm (*fletorja digjet prej dikujt*). Nga ana tjetër mund të shkaktojë një interpretim mesor, si në *fletorja digjet (vetë)*. Por nuk mund ta shtrijmë në mënyrë automatike analizën e italishtes në gjendjen e shkodranishtes, sepse kjo e fundit nuk shfaq ndërkëmbimin ndërmjet *jam* ose *kam* sipas klasës foljore. Në fakt në italisht *ho bruciato* ‘kam djegur’/ *ho dormito* ‘kam fjetur’ dallohet nga *sono andato* ‘kam shkuar’.

Të pranojmë që *jam* e *kam* janë folje të zakonshme leksikore që marrin si përplotësues një fjali pjesore; në mënyrë të veçantë *kam* lidhet me një strukturë eventive të tipit kalimtar që përfshin një argument të brendshëm, ndërsa *jam* është një folje pa strukturë eventive, pra e lidhur vetëm me pozicionin EPP në kuptimin e Chomsky-t (1995), pra me kryefjalën tradicionale. Futja e foljes ndihmëse *jam* i përgjigjet një strukture në të cilën argumenti i brendshëm i foljes leksikore, si rrjedhojë e njësimimit eventiv ndërmjet fjalisë së foljes ndihmëse dhe fjalisë pjesore, identifikohet me pozicionin D të foljes ndihmëse. Më saktë, ndërtimi *jam – pjesore* nënkupton identifikimin e pikës eventive të leksikalizuar nga D e foljes ndihmëse me pikën eventive të brendshme të pjesores. Mendimi ynë është se interpretimet e ndryshme të ndërtimit *jam – pjesore* nuk zgjidhen në nivel sintaksor nga rrjedhoja të ndryshme; përkundrazi, formës sintaksore të përbashkët i përgjigjet një strukturë e vetme, e tipit që parashtruam më lart. Pra e ashtuquajtura pjesore-vetvetore dhe e ashtuquajtura pjesore dallohen prej njëra-tjetrës në nivelin interpretues.

Veçanërisht mendojmë që interpretimi pjesor përftohet kur pika e dytë eventive e pjesores, që i përgjigjet argumentit D, interpretohet si

një element i përgjithshëm ose lidhet me argumentin e leksikalizuar me anë të introduktorit *prei* (i ashtuquajtur plotës vepruesi). Përkundrazi, interpretimi vetvetor dhe mesor (jokallëzor) rrjedhin nga veprimi i identifikimit të argumentit të brendshëm dhe të jashtëm të pjesores sipas skemës së Chierchia-s (1989), Reinhardt-it (1997). Ky veprim identifikon të dy argumentet në vetvetore, dhe, sipas Chierchia-s, identifikon argumentin e brendshëm me një tipar të argumentit të jashtëm në rastin e mesores (jokallëzores). Në fakt është me vend të përmendim që edhe në gjuhët romane ka ndërtime në të cilat bashkëzistojnë të tre interpretimet, pësor, vetvetor dhe mesor, pra ndërtimet me *si* të italishtes të tipit *i bambini si lavano* 'fëmijët lahen'; këto ndërtime në italishte kërkojnë foljen ndihmëse *jam*. Shkurt, folja *jam* vendoset në kontekstet në të cilat argumenti D i foljes ndihmëse identifikohet me pikën eventive të një pjesoreje, e cila nga ana tjetër dallon dy pika eventive; pika e dytë eventive e pjesores interpretohet si e përgjithshme në kuptimin pësor ose identifikohet me argumentin e brendshëm në kuptimin mesor-vetvetor.

Përdorimi i foljes *kam* karakterizon në mënyrë të qartë kontekstet në të cilat struktura pjesore nuk nënkupton veprimet interpretuese të identifikimit të dy argumenteve pjesore (mesor-vetvetor) ose të interpretimit të përgjithshëm të argumentit subjekt (pësor). Pra gjejmë *kam* kur të dy argumentet e një pjesoreje kalimtare leksikalizohen në mënyrë të pavarur, duke përkuar me argumentin D dhe vetë argumentin N të foljes *kam*, ose me foljet jokallëzore, duke qenë se lidhen nga ana leksikore me një pikë të vetme eventive. Pikërisht në lidhje me këto folje shkodranishtja dallohet nga një gjuhë si italishtja, e cila ka foljen *jam* edhe me foljet leksikore jokallëzore. Është e qartë se për italishten është vendimtar fakti që, në prani të një argumenti të vetëm, N-ja pjesore duhet identifikuar me argumentin EPP, pra D, të foljes ndihmëse. Në këto kushte sintaksore italishtja përdor foljen ndihmëse *jam*. Përkundrazi, për përdorimin e ndihmëses *jam* në shkodranishte është me rëndësi prania e një veprimi interpretues (identi-

fikimi) që prek argu-mentin D të foljes ndihmëse. Përndryshe përdoret ndihmësja *kam*, pavarësisht nga numri i argumenteve të përfaqësuar.

Mbeten për t'u shqyrtuar ndërtimet me pjesore të eptuar dhe përshtatje; këto përdorin ndihmësen *jam* nëse pjesorja i referohet kryefjalës, dhe ndihmësen *kam* nëse pjesorja i referohet kundrinës, si në (15). Kushtet e shfaqjes së pjesores së eptuar me foljen ndihmëse janë tejet të lehta për t'u përshkruar. Në thelb, në shkodranishte pjesorja e eptuar kufizohet vetëm në kontekstet ku pjesorja ka interpretim pësor. Ky i fundit, siç kemi parë, nënkupton interpretimin e pavarur të pikës së dytë eventive të vetë pjesores. Ndërkaq pika eventive e brendshme N leksikalizohet qartësisht nga eptimi pjesor dhe në rastin e *jam* identifikohet me subjektin e foljes ndihmëse. Të dhënat e tipit (48) vënë në dukje interpretimin pësor (stativ) të pjesores së përshtatur; vetëm pjesorja e pandryshueshme me *kam* i jep shkas interpretimit eventiv (perfektiv).

- (48) *Shkodër*
 kɔrɔ/ ni:s
 ka rënë/nisur
 ɛʃt i rɔ:m/ i nisun
 është i rënë/ i nisur

*Falenderojmë informatorët tanë, ndërmjet të cilëve përmendim me shumë kënaqësi kolegët e Universitetit të Shkodrës Alma Hafizi, Artan Haxhi dhe Eliana Laçej si dhe studentët Esmeralda Ademi, Klodian Kovaçi nga Shkodra dhe Gent Tusha nga Mirdita; gatishmëria, gjykimet e tyre si folës amtarë dhe vërejtjet e tyre kanë qenë shumë të vlefshme për këtë punim. Kërkimi i paraqitur në këtë artikull u financua nga Programet Kërkimore me bashkëfinancim të MIUR ‘*La cartografia strutturale delle configurazioni sintattiche e le sue interfacce con la fonologia e la semantica*’ për vitet 1999-2001 dhe ‘*Categorie linguistiche: dalla mappatura strutturale all-architettura delle rappresentazioni mentali*’ për vitet 2001-2003.

Përktheu: Genc Lafa.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Altamari F. 1994, Shënim në N. Frashëri, *Baqëti e bujqësija*, përgatitur nga F. Altamari, Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria: 83-84.
- Banfi E. 1985, *Linguistica balcanica*, Zanichelli, Bologna.
- Beci B. 1979, *Vlera funksionale e gjatësisësë zanoreve të theksuara në shqipen*, në *Studime filologjike* 3: 89-133.
- Beci B. 1984, *Sistemi i zanoreve hundore në të folmen e Shkodrës*, në *Studime filologjike* 2: 45-73
- Camaj M. 1984, *Albanian grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden.
- Chierchia, G. 1989, *A semantics for unaccusatives and its syntactic consequences*, ms., Cornell University.
- Chomsky N. 1995, *The Minimalist Program*, The MIT Press, Cambridge Mass.
- Cordignano F. 1931, *Lingua albanese (dialetto ghego)*, Hoepli, Milano.
- Demiraj Sh. 1985, *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe*, 8 Nëntori, Tiranë.
- Demiraj Sh. 1997, *La lingua albanese. Origine, storia, strutture*, Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria.
- Graffi G. 1998, "Sulla struttura di un balcanismo sintattico", në G. Bernini, P. Cuzzolin, P. Mulinello (nën kujdesin e) *Ars linguistica*, Bulzoni, Roma: 247-262.
- Hoxha Sh. 1990, *E folmja e Arnit*, në *Dialektologjia Shqiptare VI*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: 57-188.
- Joseph B. D. 1993, *The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive*, Cambridge University Press, Cambridge.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 1999, *The syntax of middle-reflexive and object clitics: a case of parametrization in arbëresh dialects*, në M. Mandalà (nën kujdesin e) *Studi in onore di Luigi Marlekaj*, Adriatica, Bari: 283-328.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2002a, *Parameters of Subject Inflection*, në P. Svenonius (nën kujdesin e) *Subjects, Expletives and the EPP*, Oxford University Press, Oxford: 157-199.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2002b, *Clitics: Lexicalization patterns of the so-called 3rd person dative*, në *Catalan Journal of Linguistics* 1: 117-155
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2003, *The nature of complementizers*, në *Proceedings of IGG XXIX, Rivista di Grammatica Generativa*, 28: 87-110,
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2004a, *The nature of the agreement inflections of the verb*, në A. Castro, M. Ferreira, V. Hacquard, A. Salanova (nën kujdesin e), *Collected Papers on Romance Syntax* (47): 149-178, MIT Working papers in Linguistics

- M. R. Manzini e L. Savoia 2004b, *Clitics, Cooccurrence and mutual exclusion patterns*, në L. Rizzi (nën kujdesin e), *The structure of CP and IP*: 211-250, Oxford University Press, New York.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2005, *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi generativa*, Edizioni dell'Orso, Alessandria.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia 2007, *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian dialects*, Routledge, London.
- Manzini M.R., L.M. Savoia e L. Franco (në shtyp), *Oblique subjects in ergativity splits*, në *Revue Roumaine de Linguistique*.
- Pellegrini G.B. 1995, *Avviamento alla linguistica albanese*, Università di Palermo.
- Reinhart T. 1997, *Syntactic effects of lexical operations: Reflexives and unaccusatives*, në *OTSWorking Papers in Linguistics*, University of Utrecht.
- Rizzi L. 1997, *The fine structure of the left periphery*, në L. Haegeman (nën kujdesin e) *Elements of grammar*, Dordrecht, Kluwer: 281-337.
- Solano F. 1988, *Manuale di lingua albanese*, Cosenza.
- Turano G. 1995, *Dipendenze sintattiche in albanese*, Unipress, Padova.
- Turano G. 1999, *Il costruito 'pa + participio' nella varietà arbëreshe di S. Nicola dell'Alto (KR)*, në M. Mandalà (nën kujdesin e) *Studi in onore di L. Marlekaj*, Adriatica, Bari: 564-578.
- Turano G. 2001, *Albanian noun phrase domain*, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica Serie Albanistica 3*, Università della Calabria.
- Turano G. e Sh. Rrokaj 2000, *A proposito del sintagma nominale in albanese*, *Lingua e Stile XXXV*, 1: 95-128.

NDARJA E VETËS NË SISTEMET E RASËS TË GEGËRISHTES (SHKODËR) DHE ARBËRISHTES (GRECI)

Maria Rita Manzini - Leonardo M. Savoia

1. Disa çështje teorike

Debati i fundit teorik mbi nocionet e aftësisë së të folurit(AF) dhe gramatikës universale (GU) (Hauser, Chomsky and Fitch 2002) ngre çështje të rëndësishme mbi statusin e kategorive gramatikore të pranuar në analizën gjuhësore. Nëse ne e pranojmë se aftësia gjuhësore e njerëzve ka një bazë gjenetike, AL, mbetet të shohim se çfarë do të thotë nocioni GU. Përmbajtja e GU dhe përshtatshmëria e ndarjeve tradicionale të kategorive paraqet dy anë të së njëjtës medalje, që ne mund ta mendojmë si një ‘sintezë gjenerative ortodokse’. Çështja kyçe është se më vonë kategoritë do të përkojnë me objekte reale Platonike, tërësisht të renditura në GU. Culicover e Jackendoff (2005: 6) karakterizojnë qartë një konceptim popullor të veçantë mbi lidhjen mes semantikës dhe sintaksës si ‘Uniformizëm Ndërfaqësor’ (Interface Uniformity-përk). Me fjalë të tjera, teoritë më të fundit japin një kuadër ku sintaksa përfshin interpretimin dhe gjithë informacioni semantik i nevojshëm e gjen veten te struktura sintaksore. Shumë autorë, nga perspektiva të ndryshme, e konsiderojnë të papërshtatshme zgjidhjen për zgjerimin e variacionit gjuhësor, duke u munduar t’i japin nocionit të GU një karakterizim më mbrojtës për kategoritë universale. Evans e Levinson (2009) këmbëngulin se diversiteti gjuhësor krijon universalet gjuhësore dhe, në veçanti, e shohin nocionin e GU si një mit pa fuqi shpjeguese. Ne mendojmë se ky përfundim është

tërësisht ideologjik. Përkundrazi, ne pajtohemi me Culicover e Jackendoff (2006: 416) në idenë se interpretimi është ‘produkt i një kapaciteti autonom kombinator i një sintakse më të pasur’ ‘që përkon më tepër me mendimin’, sintaksa (dhe kategoritë sintaksore) e të cilit thjesht kufizohet në disa mënyra thelbësore.

Na lejoni t’i përmbledhim këtu disa koncepte kyçe. Sipas Chomsky-t (2000: 119), ‘aftësia njerëzore e të folurit dhe gjuhët LI, të cilat janë manifestim i asaj aftësie, kualifikohen si objekte natyrore’. Kjo qasje – që ‘e shikon aftësinë e të foluritsi një “organ të trupit”’ - është etiketuar si një ‘perspektivë biolinguistike’ nga Chomsky (2005: 1). Hauser, Chomsky e Fitch (2002: 1570) e mbështesin diskutimin e tyre në çështjen kyç të biologjisë mbi evolucionin të përdorimi i ‘bazës biologjike dhe individuale’ të termit gjuhësor ‘të referosh të një përbërës i brendshëm i mendjes/trurit (ndonjëherë i quajtur gjuhë e brendshme)’ ose “gjuhë IL”. Ata dallojnë dy përbërës të aftësisë së të folurit, një më të gjerë (ALGJ, ‘FLB’ ang) dhe një më të ngushtë (ALN, ‘FLN’ angl):

FLB includes FLN combined with at least two other organism-internal systems, which we call “sensory-motor” and “conceptual-intentional”... A key component of FLN is a computational system (narrow syntax) that generates internal representations and maps them into the sensory-motor interface by the phonological system and into the conceptual-intentional interface by the (formal) semantics system ... Most, if not all, of FLB is based on mechanisms shared with nonhuman animals ... (Hauser, Chomsky e Fitch 2002: 1571).

Ne mund të pyesim pra si ALN dhe ALGJ ndërveprojnë në fusha të tilla si evolucionin gjuhësor, gjenetika, neurologjia, veçanërisht përsa u përket çështjeve të variacionit gjuhësor, duke u nisur nga idea se:

It may be that the computational system itself is (virtually) invariant, fixed by innate biological endowment, variation among languages and language types being limited to certain options in the lexicon; quite restricted options. (Chomsky 2000:79)

Ne e dime se egzistojnë gjuhë që duket sikur i lënë në hije parimet më kyçe të AL/GU, si rekursion/ngulitje (Evans e Levinson 2009, Pinker e Jackendoff 2009, Everett 2005) ose ndarjen themelore të kategorive si emër dhe folje (Jelinek 1995). Kjo na sugjeron se nocioni tradicional se GU është një mbajtëse e një liste të kategorive të fiksuara, duhet riparë; ne mund të mendojmë se GU thjesht përmban një hapësirë konceptuale (dhe fonetike) e cila fikson kufijtë e variacionit gjuhësor. Në këtë studim ne shtrojmë çështjen se si hapësirat konceptuale relevante gjuhësore prodhojnë gjuhë të ndryshme përtej aspektit të “arbitraritetit Saussurian”.

Të supozojmë se leksiku është vendi i variacionit gjuhësor – në praninë e një repertori të pandryshueshëm të primitiveve ndërfaqësore, fonologjike dhe konceptuale. Këtu na dalin pyetje jo të parëndësishme: si mund të ndryshojë leksiku në bazë të një inventari vetish universale? Dhe si ndodh që variacioni në leksik të ketë për rrjedhojë variacionin sipas rendit, përshtatjen, përzgjedhjen dhelidhjet e tjera sintaksore relevante? Një përgjigje e mundshme që jepet nga studiues të ndryshëm është se ka një ndarje thelbësore mes elementëve funksionalë dhe jofunksionalë. Prandaj në Morfologjinë Shpërndarëse, Embick (2000:187), bëhet një ‘ndarje mes fjalorit *funksional* dhe *leksikor* të një gjuhe... kategoritë funksionale vetëm sa dëshmojnë seri abstrakte të tipareve sintaksore-semantike’, mbi të cilat veprojnë përbërësit e derivuar. Variacioni është rezultat i mënyrave të ndryshme për të leksikalizuar këto kategori abstrakte primitive – të cilat nga ana e tyre formojnë një repertor universal (potencialisht).

Te Manzini e Savoia (2005, 2007, 2008, 2011a,b) ne ndjekim një rrugë tjetër, ku e gjithë struktura morfosintaksore projektohet nga nyjat leksikore të fundit. Egziston një hapësirë konceptuale dhe gramatikore për t’u leksikalizuar dhe variacioni rrjedh nga ndarje të ndryshme të asaj zone. Nuk ka leksik funksional të fiksuar i cili ndryshon vetëm përgjatërrugës së tij të leksikalizimit (i hapur kundrejt jo i hapur, autonom kundrejt sinkretik, etj.) – e ashtuquajtura hapësira funksionale është pikërisht si gjithë hapësira

tjetër konceptuale, të gjitha trajtat leksikore janë të hapura. Prandaj ndarja midis funksionale, psh gramatikore, përmbajthesore dhe konceptuale është e jashtme; si e tillë, në rastin më të mirë është e papërdorshme, ndërsa në rastin më të keq ajo errëson përgjithësimet e vërteta gjuhësore. Thënë shkurt, leksikët e gjuhëve të ndryshme formohen mbi një bazë konceptuale universale, duke mbuluar lehtë zgjerime të ndryshme të saj dhe në rrugë paksa të ndryshme. Variacioni gjuhësor varet nga ato pjesë të hapësirës konceptuale universale ku leksiku gjuhësor-specifik mund të zgjerohet. Procesi i ‘zgjerimit (Berwick e Chomsky 2011) krijon hapësirën e variacionit.

Në këtë rrugë arsyetimi, krahasimi mes dy varieteteve të shqipes, i paraqitur në këtë punim, është bërë për të ndihmuar të kuptuarit e primitiveve (kategorive parësore) dhe për të pasuruar për-bërësin morfo-sintaksor të AL/GU. Ne do të shqyrtojmë shpërndarjen e morfologjisë së rasës në dy varietete të shqipes, gegërishten e folur në *Shkodër* dhe arbërishten e folur në *Greci* (Campania). Në veçanti ne hulumtojmë dallimet mes paradigmave të rasës të cilat karakterizojnë përemrat e vetës së I dhe të II dhe përemrin e vetës së III ose emrat. Dallimet që dalin në sistemin përemëror veçmas te dukuritë si Dallimi i Objekteve të Markuara (DOM- Differential Object marking) dhe gjithashtu do të analizohet Reduktimi i Rasës (Person Case Constraint (PCC)).⁴

⁴ Të dhënat e analizuara këtu janë mbledhur nga kërkimet dhe intervistat me folës të lindur (native) në Shkodër dhe Greci; i falenderojmë informatorët tanë për durimin dhe bashkëpunimin. Ky studim është mbështetur nga PRIN *Morfosintassi e lessico: Categorie della flessione nominale e verbale* (2007-2009), nga MIUR.

2. Të dhënat.

Sikurse në përgjithësi në shqipe (Camaj 1984, Beci 2004), në varietetin gegë të Shkodrës emrat e pashquar e dallojnë rasën e drejtë (emërore-kallëzore) nga rasa e zhdrejtë, dhe, në shumës, gjithashtu nga një rrjedhore-vendore. Emrat e shquar dallojnë emëroren nga kallëzorja të paktën në njëjës. I njëjti flektim rasa e zhdrejtë mbulon dhanoren dhe gjinoren; gjinorja ndërtohet nga një nyjë e specializuar (Manzini e Savoia 2011a,b). Ky sistem është ilustruar skematikisht në (1), ku çdo shembull paraqet fillimisht formën e pashquar e në fund formën e shquar. Për secilën rasë në (1) ka të paktën një eksponent josinkretik, veçanërisht *-n* për formën e shquar tëkallëzores njëjës dhe *-s* për rasën e zhdrejtë e shquar në femërore në njëjës. Rrjedhorja dallohet nga fakti se *-t* del në femërore të shquar njëjës (duke e dalluar atë veçanërisht nga rasa e zhdrejtë) në një seri të ngushtë të emrave në vendore, ilustruar me *spinë* 2. Rrjedhorja në (2) është dhënë në kontekst parafjalor.

(1)

- | | | |
|--|--|---|
| a. <i>Emërore</i> | | <i>Shkodër</i> |
| i. <i>nj.</i> erði | ni vajz/ vajz-a / | ni burr / burr-i |
| | ‘erdhi | një vajzë/ vajza / |
| | | një burrë / burri’ |
| ii. <i>sh.</i> erðən | sum vajz-a/ vajz-a-t / | sum burr-a / burr-a-t |
| | ‘erdhën | shumë vajza.sh / vajzat / |
| | | shumë burra / burrat’ |
| b. <i>Kallëzore</i> | | |
| i. <i>nj.</i> pa:ʃ | ni vajz/ vajz-ε-n / ni burr / burr-i-n | |
| | ‘pashë | një vajzë/vajzën/ një burrë / burrin’ |
| ii. <i>sh.</i> pa:ʃ | sum vajz-a/ vajz-a-t / sum burr-a / burr-a-t | |
| | ‘pashë | shumë vajza.sh / vajzat /shumë burra.sh / burrat’ |
| c. <i>Rasë e zhdrejtë Rasa dhanore</i> | | |
| i. <i>nj.</i> j-a ða:ʃ | ni vajz-ε/ vajz-s / ni burri / burr-i-t | |
| | ‘ia dhashë | njëvajze/vajzës / një burri / burrit’ |
| ii. <i>sh.</i> j-a ða:ʃ | sum vajz-a-ve/ vajz-a-ve / sum burr-a-ve / burr-a-ve | |
| | ‘ia dhashë | shumë vajzave /vajzave / shumë burrave / burrave’ |
| d. <i>Rasa gjinore</i> | | |
| | mɔtra ε kuʃrin-i-t | |
| | ‘motra e kushërit’ | |

- (2) *Parafjalë - rrjedhore njëjës* Shkodër
 prej/ mas/ para ʃpi-ε-t
 'prej/ mbas/ para shtëpisë'
 'from/ behind/ before the house'
Parafjalë - rrjedhore shumës
 pun prej gra:-ʃ
 'punë prej grash'

VetaIIIe përemrave tonikë paraqet të njëjtin sistem si leksiku N(P)s, si në (3).

- (3) *Emërore* *Kallëzore* *R. e zhdrejtë* *Shkodër*
- i. *nj.* a-i/a'j-a a't-ε a't-i-i / a-'s-a-i
 ai/ ajo atë/atë atij/ asaj
- ii. *sh.* a't-a a't-a a't-y-ne
 ato/a ato/a atyre
- iii. *Rasa gjinore*
 mɔtra ε at-i-i
 'motra e atij'

Përemrat e vetës së I/II në(4), e njëjta rasë (të cilën ne e quajmë rasë e zhdrejtë, për arsye që do t'i shpjegojmë më vonë) mbulon kallëzoren, e ilustruar në (5i), dhe dhanoren, e ilustruar në (5ii), duke përfshirë njëgrup të konteksteve parafjalore (p.sh *mε*) sikurse është ilustruar në (6ii). Rasa e zhdrejtë ndryshon nga rrjedhorja, gjithashtu në lidhje me kontekste parafjalore, sikurse në (6iii).

- (4) *Emërore* *R. e zhdrejtë* *Rrjedhore* *Shkodër*
- i. 1*nj.* un m-u mej-ε-t
 2*nj.* t-i t-y tej-ε-t
- ii. 1*sh.* n-a n-e ne-ʃ
 2*sh.* ju ju ju-ʃ
- (5) i. ε / mə / na ʃɔfin a't-ε / m-u / ne *Shkodër*
 ii. j / m / n a japinat-i-i / m-u / ne
- (6) i. *Parafjalë - Emërore* *Shkodër*
 te un / ti / ai
 ii. *Parafjalë - 1/2 R. e zhdrejtë/ 3Kallëzore*

mɛm-u / ty / at-ɛ

- iii. *Parafjalë – 1/2 Rrjedhore /3R. e zhdrejtë*
prei/ pošt/ paramej-ɛ-t/ nɛ-ʃ / at-i-i

Një shpërndarje pakëz më e ndryshme del në varietetet arbëreshe, si ai i *Greci-t* (Camaj 1971), ku përemrat e vetës së I dhe II sërish e njëhësojnë kallëzoren me dhanoren në një formë të vetme të rasës së zhdrejtë, por gjithashtu e lënërrjedhoren në kontrast me të tri rasat e sistemit të emrave. Sikurse ilustrohet në (7), në varietetin e *Greci-t* emrat e dallojnë rasën e zhdrejtë nga format emërore-kallëzore në formën e pashquar; emrat e shquardallojnë tri forma të rasave në njëjës (emërore, rasë e zhdrejtë dhe kallëzore) dhe dy forma në shumës (emërore-kallëzore kundrejt rasës së zhdrejtë) (Manzini e Sa-voia 2011a,b, 2012). Sikurse është ilustruar në (1), lakimi irasës së zhdrejtë përfshin edhe kontekstet e gjinore.

(7)

a. *Emërore* *Greci*

- i. *nj.* ɛrθ nə vaz/ vaz-a /nə burr / burr-i
 ‘erdhi një vajzë/ vajza / një burrë / burri’
ii. *sh.* ɛrðən ʃum vars-a/ vars-a-t / ʃum burr-a / burr-a-t
 ‘erdhën shumë vajza.sh / vajzat /shumë burra / burrat’

b. *Kallëzore*

- i. *nj.* pɛ nə vaz/ vaz-a-n / nə burr / burr-i-n
 ‘pashë një vajzë/vajzën/ një burrë / burrin’
ii. *sh.* pɛ ʃum vars-a/ vars-a-t / ʃum burr-a / burr-a-t
 ‘pashë shumë vajza.sh / vajzat /shumë burra.sh / burrat’

c. *Rasë e zhdrejtë (kontekst dhanore)*

- i. *nj.* j-a ðɛ nəja vaz-ja/ vaz-ə-s / nəja burri / burr-i-t
 ‘ia dhashë një vajze/vajzës / një burri / burrit’
ii. *sh.* j-a ðɛ ʃum vars-ui / vars-ui-t / ʃum burr-ui / burr-ui-t
 ‘ia dhashë shumë vajzave /vajzave / shumë burrave / burrave’

d. *Rasa e zhdrejtë (kontekst gjinore)*

libr-i (t) trim-i-t
‘libri i trimit’

- (8) *Emërore* *Kallëzore* *Rasë e zhdrejtë* *Greci*
 i. 3nj a-i/a^lj-ə at-ə a^lt-i-a / a-^lsa-i-t-a
 ii. 3sh a^lt-a a^lt-a a^lt-i-r-u-a / a^lt-i-r-(v)ui
 iii. asë e zhdrejtë (kontekst gjinore)
- libr-i t at-i-a / t asa-i-t-a/ t atir-u-a
 libr-i iatij/ i asaj/ i atyre
- (9) *Emërore* *Rasë e zhdrejtë* *Greci*
 i. 1nj u m-ua
 2sh t-i t-i
- Emërore* *Kallëzore* *Rasë e zhdrejtë*
 ii. 1sh n-a n-e ^lne-ui
 2sh ju ju ^lju-v-ui
- (10)
 i. fəhan atə / m-ua / ju-vui *Greci*
 ‘ai shikon atë / mua / juve’
- ii. j / m / va jepanat-i-a / m-ua / ju-vui
- (11)
 i. *Parafjalë – Emërore* *Greci*
 ka a-i / u / ju
 ii. *Parafjalë – 3Kallëzore / 1/2nj Rasë e zhdrejtë*
 maat-ə / m-ua / ne
- iii. *Parafjalë – 3Rasë e zhdrejtë / 1/2nj Rasë e zhdrejtë*
 para at-i-a / m-ua / ne-ui

3. Nocioni i rasës.

Sikurse është diskutuar te Manzini e Savoia (2010, 2011a,b, 2012), nocioni i rasës ka një status jo aq të qartë në teorinë e sotme gjenerative. Në qasjen minimaliste të Chomsky-t (1995 ff.), strukturat sinkretike janë projektuar nga specifikimet leksikore – dhe më vonë përkojnë me vetitë e brendshme të njëjësive leksikore. Për shembull, numri dhe veta janë tipare

(phi-features), derisa ato përkojnë me vetitë denotacionale të shprehjeve argumentuese. Megjithatë rolet-theta, duke qenë relacionare, nuk janë aspak tipare, por perceptohen si konfigurime. Prandaj, është potencialisht problematike për ta asimiluar rasën, e cila është konceptuar tradicionalisht si një nocion i lidhur me një tipar. Fakti se rasa është i vetmi tipar në Chomsky (1995) i cili është absolutisht i paimterpretueshëm (dmth nuk e ka një kundërvënës të interpretueshme), është refleksi njëvështirësie më të madhe për të lidhur thelbin e saj relational me statusin e saj të tiparit. Zgjidhja e problemit sipas Chomsky-t është që të mohojë se rasa ka një status të tiparit primitiv. Teknikisht rasa nuk hyn te asnjë funksion i kontrollit. Ne jo domosdoshmërisht nuk pajtohemi me idenë se rasa nuk është parësor i gramatikës. Megjithatë, nëse rasa reduktohet te primitivët e tjerë, pse paskemi nevojë ta mbajmë etiketën e rasës te të gjitha? Me fjalë të tjera: cili është dallimi mes një gjuhe që ka vetëm përshtatjen (italishtja të themi) dhe një gjuhe si latinishtja, e cila ka refleksin e ‘rasës’ apo të përshtatjes?

Studime si i Chomsky-t ose Pesetsky and Torrego (2007) konsiderojnë të ashtuquajtur rasë ‘abstrakte’ një rasë të pavarur vetish nga realizimi morfologjik, ashtu sikurse u gjet (hipotetikisht) në të gjitha gjuhët e tjera. Nga ana tjetër, flektimet e rasës kanë qenë në qendër të debatit morfologjik, në veçanti në lidhje me morfologjinë sinkretike. Nëse ne mbajmë një nivel sintaksor ku përfshijmë tiparet abstrakte të rasës, efekti i formave sinkretike është vetëm për të fshehur vetitë semantike të cilat do të duhej të shpreheshin nëpërmjet tyre. Në implementimin standard morfologjik të sintaksës minimaliste, e quajtur Morfologji Shpërndarëse (Distributed Morphology) (Halle e Marantz 1993, 1994, Calabrese 1998), rasa dhe tipare-phi (phi-features) janë veti funksionale, ndaj grupet abstrakte të tipareve me të cilat Insertimi në Fjalor lidh nyjat e fundit leksikore, pra ‘eksponentët’, pasi janë aplikuar rregullat morfologjike (insertim i vonshëm). Një nga rezultatet e këtyre veprimeve morfologjike është krijimi i formave sinkretike sipërfaqësore.

Një ilustrim i mirë vjen nga analizat e sistemit dyrasor (emëroreja kundrejt objektivit) te frëngjishtja e vjetër te Calabrese (1998). Flektimi i

rasës së emrave mashkullorë që rrjedh nga klasa emërore e dytë e latinishtes paraqet një shpërndarje të kryqëzuar, ndërsa i njëjti lakim *-s* bën bashkë njëjësën e emërores dhe shumësin e kallëzores, p.sh. *mur-s* (mur/mure), si kundërvënëse të \emptyset të emërores shumës dhe kallëzores njëjës, p.sh. *mur* \emptyset . Sipas Calabrese (1998) paraqitja sintaksore e formave *-s* përfshin një specifikim rase të plotë, p.sh. [+subjekt,+direkt] për emëroren dhe [-subjekt,+direkt] për kallëzoren, por fjalori regjistron vetëm dallimin [+/-shumës].

Ne dallojmë nga Morfologjia Shpërndarëse duke pranuar një përbërës të unifikuar morfosintaksor, struktura e të cilit projektohet nga njësitë leksikore. Në një model të tillë nuk ka vend për insertim të vonshëm, ndaj rregullat morfologjike aplikohen te nyjat abstrakte të fundit. Ne e kemi argumentuar më parë (Manzini e Savoia 2005, 2007, 2008a, 2009) se arsyet për thjeshtimin dhe reduktimin e teorisë na e sugjerojnë këtë lëvizje. Përbërësi i rregullit morfologjik (të paktën rregulli i Merge) është redundant te përbërësi sintaksor – ndërsa ky e pasuron mjaft atë duke sjellë rregulla, si Varfërimi, i cili shumëfishon në një mënyrë të konsiderueshme grupime të mundshme bazike të tipareve sintaksore për leksikon/ eksponentët morfemikë.

Propozimet tona paraqesin një shembull të veçantë brenda një perspektive të përgjithshme që ne e mendojmësi strukturë minimaliste. Sipas kësaj perspektive, modelet aktuale janë reduktuar duke i refuzuar nyjat abstrakte më të fundit në të mirë të projektimit nga leksiku. Analizat e dukurive në shqipe në këtë artikull synojnë të tregojnë se ndarja e fortë mes leksikut substantiv dhe funksional qëstudimet gjenerative aktuale shpesh e pranojnë si të dhënë të gatshmenuk ka ndonjë motivim empirik. Më saktë, komputacioni sintaksor ngrihet mbi vetitë e nyjave abstrakte fundore – dhe nuk regjistron me çdo kusht çdo përbërës të asaj që ne e quajmë kuptim i fjalisë (Culicover e Jackendoff 2005).

Objektivi primar i punës sonë është që në një mënyrë të zbatojë zhdukjen e rasës, meqënëse supozojmëqënë programin minimalist tiparet e njësisive leksikore duhet të jenë të vërteta, jo mekanizma të fshehta që do

rindërtonin primitive relacionare. Ne e kapim problemin nga ndërfaqja PF, me një studim të morfologjisë së rasës në gegërishte dhe arbërishte, sikurse është ilustruar në (1)-(11). Argumentojmë se etiketa tradicionale e rasës lidhet te trajtat morfologjike që në të vërtetë përkojnë me kategoritë primitive denotuese si klasa emërore (gjinia), shquarësia, cilësueshmëria, predikativiteti. Sikurke dihet, morfologjia në fjalë është marrë si ajo që përkon me leksikalizimin e një relacioni të specializuar të rasës si në traditën historike/tipologjike, ashtu dhe në traditën gjenerative duke përshtatur ‘rasën abstrakte’ (Vergnaud 2008 [1977], Chomsky 1981). Nëse ne e pranojmë se rasia përbëhet tërësisht nga shumë veti primitive, përfshirë klasën emërore, shquarësinë, predikativitetin dhe kuantifikimin, janë po këto veti që hyjnë në projektimin e pemës sintaksore. Nocioni tradicional i rasës mund të rindërtohet po të nisemi nga fakti se seri të ndryshme të këtyre vetive primitive kënaqin kontekste të ndryshme sintaksore, të përcaktuara nga përshtatja, ‘theta-assignment’ (atribuimi i roleve tematikë) dhe në përgjithësi relacionet primitive të teorisë minimaliste. Rasia është thjesht emri i pranuar për të respektuar traditën. Nëse ne jemi në rrugën e duhur, duke mënjanuar shumëkoncepte abstrakte (përfshirë edhe mbikategorinë ‘rasë’), qasja jonë bëhet më e thjeshta nga zgjidhjet e tjera të mundshme dhe një problem më i perceptueshëm, përfshirë reduktimin e ‘rasës’ për të kontrolluar tiparet e përshtatjes te Chomsky (20001, 20008):

Të dhënat në (1)-(11) paraqesin shpërndarjen e rasës morfologjike në sistemin emërore në *Shkodër* dhe *Greci*. Në veçanti, ato ilustrojnë ekzistencën e mbaresave të flektimit që sjellin shembuj të të ashtuquajturit sinkretizëm – ose, sikur se do ta përmbledhim këtu, janë të paqarta pra lidhen me dy ose më shumë interpretime. Në shembujt tanë ne gjejmë dy lloje të sikretizmit: (i) disa lakime përkojnë me dy (ose më shumë) rasia; (ii) disa lakime përkojnë me interpretimin e të dyjave, interpretimin e rasës dhe interpretimin e klasës emërore (gjinia) dhe numri. Për shembull lakimi më *-a* leksikalizon emëroren e shquar (për femëroren njëjës) dhe emëroren shumës (eventualisht të ndjekur nga mbaresat rasore) në (1) dhe (7). Kështu *vajz-a/ vaz-a* mbart dy kuptimësinë

mes ‘vajza (Emërore e shquar)’ dhe ‘vajza (Em/Kall e pashquar)’. Njëkohësisht morfologjia *-a* duket si një fle-ktim i klasës emërore në formacionet shumë të përfshin mbaresat e specializuara të rasave më bashkëtingëllore / rrokje, për shembull rasat e zhdrejtja (e shquar dhe e pashquar) në (1c.ii) dhe emëroreja / kallëzorja e shquar në (1a. ii, b.ii) / (7a.ii, b.ii).

Në mënyrë të ngjashme, lakimi më *-i*, që përkon me flektimin e klasës emërore për mashkulloren njëjës, vetëm leksikalizonrasën e zhdrejtë e pashquar në (1c.i) / (7c.i) dhe emëroren e shquar në (1a.i) / (7a.i). Lakimi më *-t* lidhet me rasën e zhdrejtë (mashkullore njëjës) në (1c.i) / (7c.i), me emëroren / kallëzoren (shumës) në (1a.ii, b.ii) / (7a.ii, b.ii) dhe me rrjedhoren (femërore njëjës) në (2), (4). Lakimi më *-vε/ ui* është i lidhur në mënyrë unike me shumësin e zhdrejtë në (1c.ii) / (7c.ii). EkspONENTI -exponent *-vei* përfshin të dyja interpretimet, të shquar dhe të pashquar, si në (1c.ii). Në varietetin e *Greci-t* lakimi më *-ui* vetëm paraqet interpretimin e pashquar, (Manzini dhe Savoia 2011a, b, 2012), ndërsa format e shquara kërkojnë lakimin e shquar me *-t*, si ilustron në (7c.ii). Flektimi *-ui* ndodh gjithashtu në vetën I dhe II shumë në (911), si te *neui*, dhe alternohet me *-ua*, në vetën e tretë shumë.

Krahasimi mes sistemit të *Shkodrës* dhe *Greci-t* tregon disa dallime të vogla. Për shembull, në varietetin e *Greci-t* në (7b.i) morfema *-ua*, në vetën e tretë del mes bazës dhe flektimit të shquar të kallëzores *-n*. Përveç kësaj, nyja e pashquar paraqet një flektim të specializuar *ɲə-ja* në rasën e zhdrejtë, duke përfshirë edhe flektimin *-(j)a*, i cili karakterizon femëroren e pashquar njëjës në rasë e zhdrejtë në (7c.i) dhe rasën e zhdrejtë njëjës në vetën e tretë në (8i). Dalja e *-a* në shumë karakterizon rasën e zhdrejtë të përemrave/dëftorëve të vetës së tretë shumë, si *atir-u-a* në (8ii). Së fundi, baza për ‘vajzë’ alternohet mes një forme njëjës *vaz* dhe një forme shumë *vars-a*; ky lloj alternimi burimor sigurisht që është gjetur te varietetet e shqipes në mënyrë të pavarur.

Nëse marrim parasysh leksikun me të cilin përfundon modeli i Morfologjisë Shpërndarëse, logjika e tij është se në qoftë se një njësi e fjalorit hyn tenyjatë ndryshme fundore, me veti të papajtueshme mes tyre, atëherë njësitë e fjalorit nuk mund të specifikohen për asnjë nga këto veti. Me fjalë të tjera, një element leksikor i dhënë është në gjendje që të dalë në disa mjedise (duke përkuar me një sinkretizëm tradicional) deri në atë masë sa ajo nuk ka veti të papajtueshme me to. Maksimumi, njësia leksikore mund të jetë e pavlefshme (dmth një default). Leksiku ynë dallon nga ai i Morfologjisë Shpërndarëse në aspekte të rëndësishme. Derisa struktura është projektuar nga trajtat leksikore aktuale, këto të fundit vështirë se mund të jenë të çliruara nga vetitë; për më tepër ato duhet të kenë informacionin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të përcaktuar strukturën sintaksore. Prandaj në rastet kur një element i dhënë leksikor mund të shfaqet në mjedise të ndryshme sintaksore, si në të gjitha rastet e sapopërmendura, ne duhet të kuptojmë se ato ambiente kanë të njëjtat veti themelore të përbashkëta - që do të formojnë bërthamën e specifikuar pozitivisht të elementit leksikor.

3.1. DOM dhe vetitë lidhëse të diskursit.

Le të përqëndrohemi tani në ndarjen mes sistemeve të rasave të vetës I / II të përemrave dhe të emrave / veta III. Në veçanti, ne kemi parë se paradigmat (4) dhe (9) janë të njëjta si për rasën kallëzore ashtu dhe për atë të zhdrejtë, pasi veta e pare dhe e dytë e përemrit me vlerën e kundrinorit të drejtë nuk kanë dallim nga ato të rasës dhanore, pra të kundrinorit të zhdrejtë. Kjo ndarje në fakt mund të mendohet se lidhet me ekzistencën e dy sistemeve të ndryshme të rasave, e shquar dhe e pashquar, ku paradigma e pashquar zakonisht është më pak e diferencuar. Ndarja tjetër, për shembull, në gjuhën shqipe, ndodh kur emëroreja dhe kallëzorja mund të diferencohen në paradigmen e shquar, por jo në të pashquarën (Manzini dhe Savoia 2011a, b, 2012). Me fjalë të tjera dallimi midis sistemeve të rasave të përemrave të vetës I / II në (4) / (9) dhe i emrave / përemrave të vetës III / dëftorëve në (3) / (8) -

dhe me dallimi në mes lakimit të shquar dhe të pashquar - mund të konceptohet si një ndarje e cilakundërvë shquarësisë dhe emrat e frymorëve, duke e përfshirë atë brenda përemrave vetorë te referimi i pashquar / jofrymor.

Në literaturën tipologjike kjo shpërndarje, përsa u përket kundrinave, njihet si Differential Object Marking (DOM, kundrinat e markuara diferencialisht: shënim i përkth) (Aissen 2003). Sipas Manzini dhe Savoia, thelbi i DOM-it është se disa lloje të referuesëve, pjesëmarrësit nëdiskurstëtë cilëve janë nëngrupethemelore, nuk mund të inkorporohen si temat e V (dmth 'kallëzore'), por duhet të inkorporohen ose me rolin e vepruesit (dmth 'emërore'), ose me rolin e poseduesit (dmth 'dhanore' ose 'rasë e zhdrejtë'). Për shembull, në varietete të shqipës veta I/ II nuk mund të jetë kallëzore (theme embedding), pasi ato kërkojnë formën e zhdrejtë - e cila lidhet me një rol të ndryshëm, përkatësisht rolin e posedimit.

Deskriptivisht, është mjaft e qartë se si funksionon hierarkia pjesëmarrës / frymorë/ shquarësi. Morfosintaksa e DOM-it mund të lidhet me 'referuesin / vetën / hierarkinë e frymorëve' (Nichols 2001): veta I > veta II > veta III e frymorëve > veta III e jofrymorëve. Për më tepër, në shumë gjuhë Objekti nuk mund t'ia kalojë Subjektit në hierarki, në kuptimin që, për shembull, një sekuençë Subjekt veta III - Objekt veta I, ose është e papranueshme, ose është e markuar morfologjikisht. Prandaj të dhënat tona, në veçanti zgjerimi i vetës I / II si dhanore / rasë e zhdrejtë, gjithashtu mund të lidhen me hipotezën që dhanorja është zgjedhja e fundit që bëhet me qëllim për të shmangur konfiguriminku një vetë I / II e objektit kombinohet me një vetë III (ose një renditje të njëjtë) të subjektit (Nichols 2001 te Kashmiri).

Sa për statusin teorik të hierarkisë, është e qartë se referuesit e vetës I dhe II (dhënësi dhe marrësi) janë të ndarë nga referuesit e tjerë në universin e diskursit ku ata janë vendosur drejtpërdrejt, ndërsa referuesit e vetës III (dhe ndoshta edhe veta I/II shumë gjithashtu, të cilët përfshijnë referuespër 'të tjerët' përveç të 'dhënësit' dhe 'marrësit')

nuk janë. Referuesit e frymorëve janë gjithashtu edhe një grup potencial i dhënësve (folësve) dhe marrësve (dëgjuesëve) - dmth i pjesë marrësve potencialë në diskurs. Në kushte të tilla, dominimi i frymorëve nuk ka të bëjë me potencialin e tyre si veprues (agjentë) (pace Dixon 1979), por me rëndësinë e tyre referuese, apo kontrollin e tyre të mundshëm mbi diskursin / rrjedhën e informacionit (shih DeLancey 1981). Shquarësia dhe joshquarësia ngrenë një shkallë të ndryshme të referimit. Referuesit më pak të spikatur janë në gjendje të kënaqin shtojcën e fjalisë duke inkorporuar në strukturën e ngjarjes një plotësim të thjeshtë - referuesit më të spikatur kërkojnë një strukturë më komplekse të shtojcës që vjen nga rasa e zhdrejtë.

Problemi i parashtruar në të dhënat në seksionin 2 nuk është vetëm pse referuesit e vetës I/II njëjës ndahen nga të tjerët, por edhe pse ndarja e tyre paraqet format e veçanta që ata kanë. Pyetja më e rëndësishme që del nga shembujt në (1) - (11) është pse referuesit e vetës I/II (folës, dëgjues) janë të lidhur me një grup të specializuar të 'rasave' përkundrejt referuesëve të tjerë (veta III). Në veçanti, ne kemi parë se paradigmat (4) dhe (9) e njëhësojnë kallëzoren me dhanoren. Nëse e mendojmë këtë shpërndarje si një shfaqje të ndarjes klasikeveta I/II kundrejt vetës III, tri llojet kryesore të ndarjes tregojnë: veta III (përfshirë edhe emrat) kundrejt vetës I/II; veta I/II njëjës kundrejtvetës I/II shumë (Greci); veta I kundrejt II (Greci). Në përgjithësi, përemrat e vetës I/II i njëhësojnë të gjitha llojet e objekteve verbale (argumentet e para të kalimtareve dhe qëllimet e jokalimtareve), si dhe argumentet e parafjalëve.

Siç kuptohet nga glosat tona, ne arrijmë në përfundimin se nuk ka një eksponent morfologjik të specializuar për kallëzoren e vetës I/II; përkundrazi argumenti i parë i një kalimtareje është markuar si një plotës i dhanores, si një shembull i DOM-it. Me fjalë të tjera, DP më të larta në shkallën referuese kërkojnë një mënyrë të specializuar për t'u futur në strukturat argumentuese, duke i bërë ato zotëruese dhe jo tema të thjeshta. Pavarësisht ndarjes mes vetës III dhe I/II njëjës që

e vërejmë në *Greco*, vetat I/II shumë të paktën pjesërisht përkojnë me vetën III. Kjo mund të rrjedhë nga fakti se veta I/II shumë, sikurse veta III, referojnë te persona të cilët janë të ndryshëm nga folësi dhe dëgjuesi ('folësi dhe të tjerët', 'dëgjuesi dhe të tjerët'). Në anën tjetër përkimi i vetës I/II shumë me sistemin e emrit në vetën III është vetëm në dukje, derisa format e zhdrejta në (6iii) dalin edhe si argumente të brendshme të kalimtareve, në këtë mënyrë ato u kundërvihen emrave/përemrave të vetës III, të cilat zgjedhin kallëzoren e specializuar në këtë kontekst.

Me pak fjalë, morfosintaksa e DOM-it duket të jetë një pasqyrim i forcës së brendshme denotuese të argumenteve. Referenca e elementëve leksikorë të vetës III (ose elementëve të vetës III më pak referues, dmth të pashquara, jofrymorë) vetëm sa është inkorporuar dobët në universin e diskursit dhe është ndërmjetësuar nëpërmjet futjes në strukturën e ngjarjes (Manzini e Savoia 2005, 2007 2008 , 2010, 2011a). Në të kundërt, denotimi i vetës I/II (dhe nga zgjerimi i argumenteve referuese të spikatura, dmth njerëzit, e shquar) është ngulitur mirë në universin e diskursit (në të cilin folësi dhe dëgjuesi janë dy koordinatat), pa iu referuar domosdoshmërisht strukturës së ngjarjes.

Në varietetet romane që kanë 'kallëzore të parafjalëve', si në spanjisht, rumanisht dhe në dialektet italiane të jugut, DOM-i është zgjeruar me anë të një parafjale në dhanore *a/pe*. Këto gjithashtu paraqesin një formë të zhdrejtë që katë bëjë me 'zotërimin' apo 'përfshirjen' sikurse është diskutuar te Manzini e Savoia (2011, 2001a, b). Në veçanti, Manzini e Savoia (2011a,b) pranojnë se të gjitha llojet e zotërimit, përfshirë zotërimin e patjetërsueshëm dhe posedimin e gjendjes psikike, kanë të njëjtën lidhje bazike. Propozimi i tyre ashtu si dhe natyra e kësaj lidhje është e afërt me atë të Belvin e den Dikken (1997: 170), sipas të cilëve 'entitetet kanë zona të ndryshme që lidhen me to, të tilla që një objekt apo një ngjarje mund të përfshihet në një zonë të lidhur me një entitet pa u përfshirë fizikisht në atë entitet ... Lloji i zonave të cilat mund të lidhen me një entitet do të ndryshojnë me entitetin'. Prandaj zotërimi është përfshirje 'zonale'.

Si përfundim, një veti e vetme, përkatësisht përfshirje / bashkësi-përfshirëse, të cilën ne e formalizojmë këtu si Q (\subseteq), lidhet me një grup konceptual që sapo e pamë. Me fjalë të tjera, veta I/II në thelb janë burime/agjentë të ngjarjes ('emërore') ose 'posesivë' 'që përfshijnë' (një pjesë nga) ngjarja ('rasë e zhdrejtë').


4. Çfarë projekton fleksioni në modelin leksikor

Në qasjen e këtushme, përmbajtja sintaksore dhe semantike hyjnë direkt te të dhënat morfologjike. Ato specifikojnë një hartë në mes tingullit dhe kuptimit (shih Jackendoff 2002), pa rendur drejt një ndarjeje morfologjike (si në DM) mes sintaksës dhe eksponentëve që e manifestojnë konkretisht atë. Njësitë leksikore emërore (përemrat, përcaktuesit dhe kuantifikuesit e emrave, vetë emrat) janë të lidhur me leksikon vetëm me vetitë denotuese që i karakterizojnë ato pavarësisht nga pozita ku vendosen. Vetitë të cilat janë teorikisht relevante për rasën përfshijnë të paktën N (fleksionin/klasën emërore), Q (kuantifikimin), D (shquarësinë). Fleksionet Q (\subseteq) janë përgjegjëse për të ashtuquajturën rasë e zhdrejtë - faktikisht një operator divalent vendoset në një 'përfshirje zonale' (posedim) mes elementit të i cili është lidhur dhe argumentit të brendshëm të foljes (dhanore) ose kokës së një fraze emërore (gjinore). Fleksionet Q janë edhe përgjegjëse për shumësinë (Numri), ndërsa fleksionet N (klasa emërore) mund të jenë të mjaftueshme për të kënaqur kontekstet e drejtpërdrejta të përplotësimit (kallëzore) dhe D karakterizon kontekstet EPP sipas Chomsky-t (1995) (emërore).

Në një gjuhë pa 'rasa' të emrave, si italishtja, një emër me të ashtuquajturin fleksion të përshtatjes mund të analizohet si një strukturë në të cilën baza leksikore, e shënuar si $\sqrt{\quad}$ (rrënjë), duke shprehur përmbajtje predikative, kombinohet me flektimin N të klasës emërore (gjinia), që lidhet me argumentin e brendshëm të bazës predikative, si në $[[\text{macchin}\sqrt{\quad}]aN]$. Gjuhët si latinishtja apo shqipja / arbërishtja nuk

janë sisteme të cilësisht të ndryshme në lidhje me italishten, por janë vetëm pak më të pasura. Më saktësisht, i ashtuquajtur iflektim i rasave është një flektim me përmbajtje më të artikuluar denotuese (klasa emërore, kuantifikimi etj) e specializuar për të kënaqur lidhjet e veçanta sintaksore (përshtatjen, theta-konfigurimin, ose të tjerat). Rasa nuk është veçse një emër që merr njësi të flektimit që në bazë të vetive të caktuara denotuese specializohet për të kënaqur mjedise të caktuara sintaksore.

Le të fillojmë me *-i* dhe *-a* të shqipes si mbaresa tëemërores të shquar njëjës në mashkullore dhe femërore, në (1) dhe (7). Ne supozojmë se fleksioni fundor i një foljeje nuk paraqet një grup me veti të pashpjegueshme (Chomsky 1995), por ngjason me një përemërbrenda foljes me të cilin në lidhimkategorinë e shënuar me D. Ky supozim krijon struktura të tilla si në (12) të fjalës *erđvajza* ilustruar në (1), ku emri (frazë) është ngulitur si argumenti i vetëm i foljes jokallëzore *erđ* ‘(ajo)’. Struktura e fundit është analizuar si e përbërë nga një bazë predikative *erđ* dhe një *-i* e flektimit foljor që leksikalizon arg-umentin (D) të predikatit.




Kur themi se në (12) fleksioni verbal *-i* përshtatet me klasën emërore *-a* është njësoj si të thuhet se ato bashkëveprojnë për të kënaqur pozicionin e argumentit të foljes, të shënuar me (x). Me fjalë të tjera, pozicioni argumentues i shënuar nga ndryshorja x në (12) plotësohet nga çifti (*-i*, *-a*) (ndërtim i ngjashëm me atë të zinxhirit). Kështu *-a* plotëson rolin e brendshëm të bazës së sajemërore (sh. diskutimin e [[*macchin*√]aN] në fund të seksionit të mëparshëm) dhe në të njëjtën kohë bashkëvepron për të kënaqur rolin e argumentit të foljes. Kur themi se *-a* e shqipes është një emërore kjo kuptohet nga fakti se morfologjia e klasës emërore *-a* përkon me flektimin e foljes,

në pajtim me Chomsky-n (1995) EPP, pra na e jep përshtatjen si efekt sipërfaqësor. Flektimet e klases emërore janë të mjaftueshme për të kënaqur këtë kontekst në njëjës; përveç se në të pashquar $-ε$ nuk mund të dalë me një interpretim të shquar. Prandaj vetëm $-i$ (mash-kullore njëjës) dhe $-a$ (femërore njëjës) mund të shfaqet si shquarësi.

Të shqyrtojmë tani kallëzoren. Për shumësin, ne mund të supozojmë se mbaresa $-t$ duke iu shtuar morfologjisë së klasës emërore është një specifikim Q që interpreton numrin, që gjendet gjithashtu edhe në emërore. Kështu është kryesisht morfologjia e klasës emërore (N) që kënaq të ashtuquajturat kontekste nëkallëzore dhe në emërore shumë. Duke u nisur nga diskutimi në $[[macc-hin\sqrt{ }]aN]$ në fund të seksionit të mëparshëm, ne supozojmë se morfologjia e klasës emërore leksikalizon argumentin e brendshëm të emrit (ose bazën e tij predikative). Prandaj ne nuk befashohemikur gjejmë se e njëjta morfologji mund të kënaqë edhe argumentin e brendshëm të foljes.

Nëse do të zbatojmë këto përfundime të morfologjia $-n$ e formave të shquara njëjës të emrave, ne shkojmë drejt përfundimit tjetër se mbaresa $-n$ thjesht ka veti N. Me fjalë të tjera, ky është një flektim i klasës emërore, i specializuar më tutje edhe për shquarësinë, siç ilustruhet në (13). Në këto kushte $-n$ paraqet referim të një klasë emërore e specializuar—të dyja të specializuara në atë që është e shquar dhe në atë që është kontekstualisht e kufizuar në klasën e temave të ngjarjes. Me pak fjalë, kallëzorja nuk është tjetër veçse emri tradicional i dhënë për të kënaqur e një argument të brendshëm duke specializuar morfologjinë emërore N.




Rasa e zhdrejtë në paradigmën emërore (1c.i) / (7c.i) ngre çështjen e sinkretizmit mes të të ashtuquajturës dhanore (argumentin e dytë të dy-tranzitives) dhe gjinore. Sinkretizmi mes dhanores dhe gjinore është dëshmuar edhe në përemrat e vetës së tretë *at-i-i* / *as-a-i* / *at-y-nëin* (3) në *Shkodër* dhe *at-i-a* / *asa-i-ta* / *at-i-r-u-a* in (8) në *Greci*. Manzini e Savoia (2011a, b) e shpjegojnë atë duke supozuar se e njëjta përmbajtje, e shënuar përfshirje/bashkësi-përfshirëse $Q(\subseteq)$, sipas Belvin e den Dikken (1997:170), lidhet me kontekste të ndryshme sintaksore.

Në veçanti, ne mund t'i marrim të gjitha llojet e posedimit, përfshirë edhe posedimin e pandryshueshëm dhe atë të gjendjes psikologjike, nën këtë lidhje. Nga ana tjetër, afërsia konceptuale e nocioneve të poseduesit për 'dhanoren' dhe 'vendoren' është e njohur në literaturën tipologjike. Kjo afërsi konceptuale, e pasqyruar nga 'rasa e zhdrejtë' sinkretik, përkon, sipas termave të këtushëm, me $Q(\subseteq)$. Prandaj, sinkretizmi i dhanores dhe gjinore, parë te rasa e zhdrejtë i shqipes, tregon për një karakterizimin përfshirës të morfologjisë përkatëse, në veçanti për *-t* te emrat. Kjo duket të jetë në përputhje me karakterizimin kuantifikues Q që ne e kemi supozuar për *-t* si shumës të shquar. Në këtë perspektivë, ne propozojmë që nuk ka asnjë rasë primitive të zhdrejtë, sepse në të vërtetë nuk ka rasë primitive kallëzore dhe emërore. Gjithçka që është, është një element $Q(\subseteq)$ -t që denoton një bashkësipërfshirëse/ relacion të përfshirjes (zakonisht një posesiv) në mes të argumentit ku ai lidhet dhe ca argumenteve të tjera. Sinkretizmi i fleksionit tërasës së zhdrejtë *-t* me *-t* (emërore /kallëzore) shumës është dëshmuar i pavarur në sistemin përemëror ro-man, ku *-i* është flektimi i italishtes *gl-i* 'atij' dhe *l-i* 'ata' (Manzini dhe Savoia 2014). Neve përkimi i rasës së zhdrejtë njëjës me jo-rasën e zhdrejtë shumës në shqipe më *-t* na del nga natyra e tij kuantifikuese. Kur *-t* paraqitet si shumës, ajo merr në zonën e saj specifikimet e klasës emërore të emrit, pra *-a* në shumës. Kur paraqitet si bashkësi-përfshirëse/ poseduese, zona e së cilës është fjalia, që aplikohet te argumentet e brendshme të foljes, ose, në gjinore, DP-e brendshme.

Në shumës, të gjitha klasat emërore dhe të dyja kategoritë, shquarësia dhe joshquarësia, lidhen merasën e zhdrejtë-*vε* të varietetit të *Shkodrës*. Në varietetin e *Greci-t* flektimi *-ui* leksikalizon interpretimin e rasës së zhdrejtë, ndërsa shquarësia kërkon *-t* dhe *-ui-t* për rasën e zhdrejtë në shumës të shquar si në (7c.ii). Që kur kemi propozuar se rasa e zhdrejtë në njëjës tëshquar (mashkullorë) *-t* është në gjendje të leksikalizojë argumentin e dytë të dytranzitives etj. në bazë të denotimit të bashkësipërfshirësetë tij / Q (\subseteq), atëherë *-vε/-ui* karakterizohen kryesisht nga i njëjti denotim, duke projektuar gjith-ashtu kategorinë Q. E njëjta gjë do të jetë edhe për *-s* e specializuar të rasës së zhdrejtë në femërore njëjës. Forma *at-ir-u-a* në *Greci* në (8ii) kombinon morfemën *-u-* të rasës së zhdrejtë, që del te emrat, me flektimin *-a* të shumësit; interpretimi i shquar paraqitet kryesisht nga mbartja leksikore *at-* e dëftorit. Te për-emrat sinkretizmi mes shumësit dhe rasës e zhdrejtë nuk është i pranishëm. Megjithatë ata riprodhojnë të njëjtën shpërndarje të flektimit të rasave si emrat. Ka edhe përkimetë tjera morfologjike ndërmjet për-emrave vetorë të vetës III ku gjejmë elementin *-t-* për shquarësinë, flektimin shumës më *-a*, morfologjinë njëjës mashkullorë *-i* dhe morfologjinë femërore njëjës të rasës e zhdrejtë *-s-*.

Në varietetin e *Shkodrës*, flektimi sinkretik më-*i-i* i për-emrave në njëjës leksikalizon rasën e zhdrejtë, siç ilustruhet në (3i), domethënë një bashkësi-përfshirëse që përkon me rasa të ndryshme konvencionale në përputhje me kontekstin e insertimit. Ne shohim në këtë sekuencë formuesin e klasës emërore-*i*, i cili del edhe te morfologjia e emrave (mashkullorë), si dhe te një kopje *-i* e tij. Si e pamë në (14), ne sugjerojmë, në analogji me strukturat si *burr-i-t*, se *-i* më e jashtme konkretizon Q (\subseteq). Një morfologjitjetër karakterizon vetën III njëjës të rasës e zhdrejtë te për-emrat në *Greci*, ku është inkorporuar një element zanor *-a*, si në *at-i-a*-njëjtësi elementi i klasës emërore *-ai* shumësit femëror të shquar. Ne duhet të konkludojmë se te *at-i-a* / *asa-i-t-a* ajo leksikalizon pozicionin e kuantifikimit, siç sugjerohet në (14).



Në interpretimin e dhanores, ne e marrim *-ie* bashkësisë-përfshirëse të varur nga qëllimi i fjalisë $Q(\subseteq)$. Te gjinorja, i ilustruar në (1d)/(3111) dhe (7d)/ (8iii), specifikimet $Q(\subseteq)$ të-*i* vendosen në kokën e frazës emërore. Te përemrat mund të shihet qartë se rasa e zhdrejtë përfshin gjithashtu edhe vendoren (rrjedhoren tradicional), i cili ka një leksikalizim të ndryshëm në vetën I/II, të paktën në *Shkodër*. Ne e marrim atë si një interpretimin vendor të zonës së $Q(\subseteq)$ është nënngjarja ‘sub-event’ (e gjendjes) që paraqitet nga parafjala. Përkatesisht një ‘rrjedhore’ është një flektim i specializuar $Q(\subseteq)$ për kontekstin e vendores P të insertimit.

Si përfundim, nocioni i rasës futet te nocionet më primitive (veta, klasa emërore, shquarësia, sasia), në përjasje me të dhënat leksikore relevante në përputhje me teorinë e përgjithshmetë leksikut në një model të projektuar (projektimi i sintaksës nga njësitë leksikore). Vetë të ndryshme denotuese kënaqin mjedise të ndryshme, duke dhënë interpretime të ndryshme. Elementet leksikore nuk trajtohen si vetë emergjente të shpërndarjeve themelore abstrakte - në të kundërt, çfarë do rregullsie distribucionale që vërehet trajtohet si një vetë emergjente e leksikut në bashkëveprim me sistemin komputacional.

4.1. *Rasa dhe denotimi (DOM sërish).*


Duke pasur në mend analizën e përgjithshme në pjesën e mësipërme, ne do të zgjatemi disi më tepër tekundërvënja mes kallëzores dhe rasës së zhdrejtë, qëkarakterizojnë DOM. Për hir të prezantimit, ne i përsërisim këtu shembujt duke ilustruar shpërndarjen e flektimit të rasës emrat / përemrat e vetës III dhe të vetës I/II. (15a) përfshin format e specializuara të kallëzores të emrave dhe të përemrave të vetës III. (15b)

tregon daljen e flektimit të rasës së zhdrejtë te objekti i zhdrejtë i foljeve dytranzitive. Së fundi, (15c) tregon daljen e formave të zhdrejta të përemrave të vetës I/II si objekte të drejta të kalimtareve, pra në të njëjtin kontekst ku emrat dhe përemrat e vetës III për-zgjedhin kallëzoren në (15a).

- (15) a. *kallëzore – objekt i drejtë*
- | | |
|----------------------|----------------|
| pa:ʃburr-i-n | <i>Shkodër</i> |
| ‘pashë burrin’ | |
| ɛʃɔfin a't-ɛ | |
| ‘e shohin atë’ | |
| ʃɛhan trim-i-n/ at-ə | <i>Greci</i> |
| ‘sheh djalin / atë’ | |
- b. *Rasë e zhdrejtë – objekt i zhdrejtë (veta III)*
- | | |
|---|----------------|
| j a ða:ʃ at-i-i / burr-i-t | <i>Shkodër</i> |
| ‘ja dhashë atij / burrit’ | |
| j / m / n a japin at-i-i / m-u / ne | |
| ‘j/ m/ na e japin atij/ mua/ neve’ | |
| j/ m / v a jëpan trim-i-t/ at-i-a / m-ua / ju-vui | |
| ‘j/ m/ ju e japin djalit/ atij mua/ jua japin juve’ | <i>Greci</i> |
| ‘j/ m / ju e japin djalit/ atij/ mua/ jua japin juve’ | |
- c. *veta I/II objekti i drejtë*
- | | |
|---------------------|----------------|
| məʃikoin m-u | <i>Shkodër</i> |
| ‘më shikoin mua’ | |
| ʃɛhan m-ua / ju-vui | <i>Greci</i> |
| ‘shohin mua/ ju’ | |

Le të marrim fillimisht kontekstet me frazëemërore si një dhanore tradicional, si në fjalinë në (15b). Ne supozojmë se klitikët ilustrojnë konkretisht brenda domenit tëflektimit tëfjalisë të njëjtin lloj specifikimi që kanë marrë nga flektimi brenda emrit. Kështu klitiku i dhanores përkon me një pozicion Q dhe klitiku i kallëzores me një pozicion N. Në diskutimin në pikën 3 dhe 4, ne kemi propozuar që i ashtuquajhuri interpretim i dhanoresqë rrjedh nga*trimit* është një bashkësi-përfshirëse e interpretimit (zakonisht një posedues) që varet nga flektimi më *-t* i Q (\subseteq). Në mënyrë më të specifikuar ky interpretim del kur *-t* merr zonën e fjalisë, duke përcaktuar një lidhje mes argumentit ku ai lidhet dhe


argumentit të brendshëm të predikatit, dmth çiftet (y, z) në (16), në mënyrë që (z) e përparme të përfshijë të prapmen (y) , në rrugën e përfshirjes 'zonale'. Duke pasur parasysh këtë fakt, në vend që të flitet për 'zonën e fjalisë' të operatorit $Q(\subseteq)$, është më e përshtatshme të karakterizohet $Q(\subseteq)$ duke e marrë zonën mbi VP (sikurse kundërshtohet te Chomsky (1995) vP), dmth mbi ngjarjen elementare që rrjedh nga kombinimi i predikatit me argumentin/et e tij të brendshëm, para kompozitës me argumentin e jashtëm.




Në diskutimin e interpretimit të kallëzores, ne propozuam se në shumësin e shquar, i njëjti operator $Q(\subseteq)$ përgjegjës për përfshirjen (zonale), dmth rasa e zhdrejtë, kur merr zonën e fjalisë, përkon me interpretimin e shumësit kur merr vetëm bazën emërore në zonën e tij. Në shëmbullin e mëvonshëm operatori $Q(\subseteq)$ përzgjedh një nën grup nga zinxhiri (grup i grupeve) i denotuar nga predikati. Në sugjerojmë gjithashtu se flektimi më $-n$ i njëjësit të shquar është një morfologji e specializuar e klasës emërore e cila leksikalizon argumentin e brendshëm të ngjarjes, si në (17a); flektimi përemëror është edhe më i thjeshtë (morfologjia e klasës emërore- \emptyset) derisa shquarësia bartet në mënyrë të pavarur nga baza përemërore $at-$.

(17) a.

Greci




b.



Dalja e formave të rasës e zhdrejtëtë vetës I/II në të dy kontekstet në (16)-(17) mbetet për t’u shqyrtuar. Natyrisht, format e rasës së zhdrejtë në kontekstet e dhanores në (18) mund të mendohen si leksikalizim i të njëjtave veti interpretuese të emrat dhe të elementët e vetës III në (16). Sikurse sugjeruam në diskutimin në (16), në (18) flektimi i rasës së zhdrejtë–*u(a)*e merr zonën mbi VP, dmth ngjarja elementare që del nga kombinimi i predikatit me argumentin/et e brendshëm, para kompozimit me argumentin e jashtëm. Nga pozicioni i zonës së tij ai përfaqëson një përfshirje mes denotimit të bazës të e cila është lidhur (‘folësi’) dhe përemrit që e posedon ‘atë’ (i përfaqësuar nga klitiku N a)

(18)


Shkodër/ Greci



Të shqyrtojmë tani kontekstet ku format e rasës së zhdrejtëtë vetës I/IIe projektojnë argumentin e brendshëm të një klauzole kalimtare, si në (19). Ideja jonë është se bazat leksikore që denotojnë elementë të universit të diskursit marrin pjesë në ngjarje vetëm si veprues (emërore) ose si posedues/vendi (morfologjia e rasës së zhdrejtë). Në shembullin e fundit një pjesëmarrës në diskurs paraqitet si të përfshinte edhe një tjetër DP (një posedim, si në struktura dytranzitive) ose në mungesë të së mëvonshmes duke përfshirë (nën) ngjarjen VP. Në të vërtetë vetitë morpho-sintaksore të*mu/ mua, ty/ ti* tregojnë se format e vetës I dhe II

kërkojnë praninë e operatorit të përfshirjes Q (\subseteq), i projektuar nga morfologjia e rasës së zhdrejtë. Semantikisht propozimi ynë duhet të kuptohet në aspektin e literaturës së konsiderueshme formale, përfshirë edhe Chomsky-n(1995), që i trajton predikatët kalimtarësi të përbërë nga një shtresë e dyfishtë strukturore, si në qoftë se ‘shikoj’ në (19) me të vërtetë ka qenë ‘të marrë një sy’ ose ‘hedh një sy’. Në perifrazime të tilla edhe anglishtja përdor dhanoren ‘Ata hodhën/ morën një shikim te unë’. Ne mendojmë se kjo është pikërisht ajo që ndodh detyrimisht në gjuhën shqipe me argumentin e brendshëm të vetës I/II, siëshhtë skematizuar në (20).

(19)



(20) ARGUMENTI-I-JASHTËM [KAUZATIV/v [fikoin [Q(\subseteq) mua/ ty]]]

Me pak fjalë, ndarja në mes përemrave të vetës I/II dhe të III mund të lidhet me mënyra të ndryshme të vendosjes së pjesëmarrësve në ngjarje. Vendosja e pjesëmarrësve të vetës I/II kërkon ndarjen e predikatit në nën ngjarje; vendosja e vetës III përfshin një trajtim të strukturës së kauzativit predikat + ngjarje e gjendjes (‘hedh një sy’) si një tërësi e in-korporuar. (19b), pra, është thelbi i DOM-it i vendosur sipas qasjes aktuale - ne tashmë diskutuam në seksionet e mëparshme çfarë marrim si thelb të hierarkisë themelore që rregullon in-korporimin e DOM-it.

5. Ndërtimet parafjalore dhe rrjedhore.

Kontekstet parafjalore, jo më pak se ato verbale, nuk janë të kufizuara në një rasë të vetme, si për shembull në gjuhën gjermane, ku

parafjalët zgjedhin ose kallëzoren ose dhanoren, edhe në latinisht ato zgjedhin kallëzoren ose rrjedhoren. Në fakt, parafjalët në shqipe përzgjedhin të gjitha rasat që gjenden në mënyrë të pavarur në kon-tekste të fjalive, siç detajohet në shembujt në (21) - (25), që zgjeron dhe qartëson të dhënat në (2), (6), (11). Kështu ka parafjalë si *ka*, *te*, që përzgjedhin emëroren, si në (21). Të dhënat në (22) ilustrojnë parafjalët duke përzgjedhur kallëzoren me emrat dhe elementet e vetës III. Fleksioni i zhdrejtë i emrave dhe elementët e vetës III përzgjidhen nga një nëngrup i parafjalëve, siç ilustron në (23).

Të njëjtat parafjalë që kërkojnë kallëzoren për elementin e vetës III në (22) shoqërohen nga rasa e zhdrejtë sinkretik i përemrave të vetës I/II. Më në fund, në (25) paraqesim të dhënat në *Shkodër* që kanë të bëjnë me parafjalët që përzgjedhin rrjedhoren në një nëngrup kontekstesh edhe në varietete të tjera- sikurse ato në *Greci*- që përzgjedhin rasën e zhdrejtë. Në njëjësën e shquar mbaresa e rrjedhores-*t* për femëroren reduktohet te një grup emrash që tregojnë vendndodhje, përveç përemrave të vetës I dhe II, si në (25a). Në mënyrë të ngjashme në shumës mbaresa e rrjedhores të specializuar -*ɟ* del vetëm në vetën I dhe II në (25b) ose në të pashquarën në kontekste semantikisht të reduktuara, si në (5 b’).

(21) *Parafjalët - Emërore*

ai	ɟkan	te	vajz-a/ dial-i	<i>Shkodër</i>
‘ai	shkon	te	vajza / djali’	
ai	vien	te	un/ ti/ a-i	
‘ai	vjen	te	unë / ti / ai’	
kje	i	bën	ka trim-i/ u/ ti/ a-i/ na	<i>Greci</i>
‘qe	NYJË	bërë	nga djali /unë / ti / ai/ ne’	
ai	vjen	ka u		
‘ai	vjen	te unë’		
u	veta	ka a-i		
‘unë	vajta	te ai’		

(22) *Parafjalë – Kallëzore (emra/ elemente të vetës III)*

ε	vuna	mi/ nen	miɟ-ε-n/ kmiɟ-a-t / at-a	<i>Shkodër</i>
‘e	vura	mbi/nën	këmishën / këmishat / ato’	

kam	a:rð	mε	vajz-ε-n / dial-i-n	
'kam	ardh	me	vajzën / djalin'	
ε	bena	pər	at-ε	
'e	bëra	për	atë'	
ai	erða	ma	vaz-a-n/ at-ə	<i>Greci</i>
'ai	erdhi	me	vajzën/ atë'	

- (23) *Parafjala – Rasë e zhdrejtë (emra/ elemente të vetës III)*
- | | | | | |
|------|-------|------|---|----------------|
| εft | bε: | prej | dial-i-t/ diem-vε | <i>Shkodër</i> |
| 'ajo | është | bërë | prej djalit/ djemve' | |
| ε | kam | vu: | para/ poft/ sipər libr-i-t/ karig-ε-s / ati-i-i | |
| 'e | kam | vënë | para/ poshtë/ sipër librit / karriges / atij' | |
| a | vura | para | trim-i-t / trim-ui-t / at-i-a/ atir-vui | <i>Greci</i> |
| 'e | vura | para | djalit / djemve / atij / atyre' | |

(24) *Parafjala– Rasë e zhdrejtë (përemrat vetorë I/II)*


ai	vien	mε	m-u /ty / at-ε	<i>Shkodër</i>
'ai	vjen	me	mua /ty / atë'	
ai	vjen	ma	m-ua/ nε	<i>Greci</i>
'ai	vjen	me	mua / ne'	

(25) *Parafjalë – Rrjedhore*

prei/ poft/ para	ʃpi-ε-t/ðom-ε-t / mε-jε-t / tε-jε-t	<i>Shkodër</i>
'prej/ poshtë/ para	shtëpisë / dhomës / meje/teje'	
b.prei/ poft/ para	nε-ʃ	
'prej/ poshtë/ para	nesh'	
b'.pun	prej gra:-ʃ	
'punë	prej grash'	


Fakti se frazat parafjalore i lejojnë të gjitha rasat që dalin në fjali, do të dukej të ishte në kundërshtim me idenë e Chomsky-t (1995) që parafjalët përcaktojnë një rasë e zhdrejtëtë specializuar. Në të kundërtën, nëse ne supozojmë se parafjalët nuk janë të lidhura në mënyrë unike me rasën e zhdrejtë, shtrohet pyetja se cilat veti drejtojnë përzgjedhjen e rasave nga parafjalët e ndryshme. Pesetsky dhe Torrego (2004), sugjerojnë se përzgjedhja e rasave të veçanta nga një grup i caktuar parafjalësh duhet të ketë të bëjë me karakteristika të veçanta

që lidhen me vetitë ndryshme të ngjarjes, në strukturën e tipit në (26). Në (26) parafjala T_{prfl} , e pajisur me një tipar iT të inter-pretueshëm kontrollon tiparin e pakontrolueshëm uT që lidhet me kokën D të një fraze emërore.



Dikush mund të kundërshtojë se papajtueshmëria e të dhënave të tilla si në (21) - (25) me rasëne zhdrejtë e propozuar nga Chomsky (1995) zhduket nëse merret në konsideratë përbërësi morfologjik. Në kuadër të Morfologjisë Distributive mund të supozohet për shembull se futja e të paktën disa prej rasave, të cilat përzgjidhen nga parafjalët, ndodh për shkak të varfërimit të rregullave. Kështu ne mund të supozojmë se një varfërim i rregullave ifshin specifikimet e rasës obike nga objekti i parafjalëve, *sinen*, *mi*, të cilat marrin kallëzore, si në (27a). Supozoni se ajo që deskriptivisht quhet morfologjia e specializuar e kallëzores për njëjësin, dmth *-n*, të vërtetë është vetëm një njëjës i shquar, dmth *N* si në diskutimin në seksionin 4. Nëse është kështu, *-n* përputhet me insertimin në kontekstet e varfëra parafjalore, si në (27b); në fakt futja e mbaresave të tjera të specifikuar nga rasa (p.sh. rasa e zhdrejtë) nuk është e mundur.

(27) a. [r. e zhdrejtë] → ∅ / [p nen, mi] ____

b. [njëjës, i shquar] → V-n /  ____

Tani, parafjalët në gjuhën shqipe mund të përzgjedhnin gjithashtu dy rasa të ndryshme të zhdrejta përemëroren. Për kontekstin në emërore, ne mund të formulojmë një rregull të varfërimit të rasës së zhdrejtë paralelisht me atë të formuluar në (27a). Ne mund t'i atribuojnë më tej morfologjisë emërore një mbartje të specifikuar e cila e lejon atë që të futet nën një nyje të varfëruar. Por problemi është se sistemi tani ka dy mbartje të ndryshme tëspecifikuara (në emërore dhe kallëzore) shpërndarja e të cilave në kontekste parafjalore nuk mund të përshkruhet. Fakti se emëroreja është përzgjedhur nga parafjalët është po aq problematik për modelet sintaksore që e ndërtojnë emëroren si një refleks të përshtatjes me foljen flektive, si te Chomsky (2001, 2008), ose Pesetsky e Torrego (2004, 2007). Sa për këtë të fundit, nuk është shumë e qartë se T_{prfl} , si në (26), mund të ilustrojë veti paralele me ato të T së fjalisë, pasi që kushtëzimi për këtë qëllim do të kundërshtonte faktet evidente semantike.

Trajtimet morfologjike si (27), bazuar te Varfërimi, kanë një pasojë interesante nga këndvështrimi i këtushëm - dmth se ekzistenca e morfemave që lidhen me më shumë se një kontekst rasor (dmth i morfemavesinkretike rasore) kërkon që ato të trajtohen si elementë të privuar nga vetitë rasore, dhe për këtë arsye janë pajisur vetëm me veti referuese, të tilla si numri ose gjinia (klasa emërore). Kjo është pika në të cilën propozimet tona vijnë, derisa ne kombinojmë të njëjtat përfundime në lidhje me përmbajtjen aktuale të njësisve leksikore me postulatit minimalist të projektimit nga leksiku. Kjo do të thotë se vetitë që mundësohen nga leksiku duhet të jenë të mjaftueshme për të projektuar struktura sintaksore, pa ndërhyrjen e strukturave abstrakte funksionale që do të varfëroheshin nga rregullat morfologjike.

Le të merremi pak me atë çka mund të thuhet në lidhje me rasat që përzgjidhen nga parafjalët brenda qasjes së këtushme. Parafjalët janë predikatë me dy pozita, argumenti i brendshëm i të cilave është leksikalizuar në mënyrë të pavarur, ndërsa argumenti i jashtëm është i kontrolluar nga disa argumente të predikatit tëmatrices. Për shembull

argumenti i jashtëm i ‘mni’/’nën’ te ε vuna *mi/nën kmi.f- ε -n/kmi.f-a-t* në (20) në *Shkodër*, kontrollohet nga klitiku i matricës kallëzore ε . Ajo çka ‘mbi’ / ‘nën’ denoton është një lidhje hapësinore midis ‘atë’ dhe ‘këmishë (s)’. Kështu, parafjalët që përcaktojnë kontekstet që kërkojnë të ashtuquajturin kallëzore, si në (22), sillen si folje kalimtare aktive. Argumenti i tyre i brendshëm kënaqet, nëse është në të shquarën, nga morfologjia e specializuar *-n* e klasës emërore, në njëjës, dhe nga flektimi-(*V*)*t* klasa emërore+numri, në shumës

Sipas mendimit tonë, parafjalët që kërkojnë të ashtuquajturin emërore në (21) zënë një nyjë ku në të vërtetë fleksioni i rasave nuk konceptohet si realizim i tiparave primitive të rasave, por vetëm si veti denotuese të aftapër të kënaqur referencën argumentuese në kontekste të caktuara sintaksore - dmth, si ‘rasa’ të gjendjesqë qëndrojnë në kryqëzimin e tipareve primitive denotuese (referuese, predikative) dhe konteksteve sintaksore të insertimit. Ndryshe nga Chomsky (1995 ff.) ne nuk e lidhin të kënaqurit e EPP me kontrollin e tiparevetë painterpretueshme të kokës së predikativit nga tiparet korresponduese të painterpretueshme të subjektit. Përkundrazi, ne konsiderojmë se përmbajtja referuese (veta dhe numri) i flektimit të foljeve flektive përcakton një element D që kënaq EPP (Manzini dhe Savoia 2005, 2007). Të ashtuquajturit argumente emërore lidhen me kontekstet ku ato janë në zonën e argumentit D (EPP) të fjalisë (flektimi i foljeve flektive). Përkitasi me këtë ne nuk kemi nevojë të formulojmë veti-boshe të përshtatjes për parafjalët, që sistematikisht mungojnë në morfologjinë e hapur të shqipes, për të justifikuar rasën emërore për objektet P. Përfundojmë me faktet se të njëjtat veti denotuese që kënaqin subjektin, dmth kontekstet D/EPP, gjithashtu kënaqin nënngjarjen e sjellë nga parafjalët si *ka/ tənë* (21) - pa lënë të kuptohet senë lojë është një nocion primitiv i rasës emërore në të dyja kontekstet. Në veçanti, në vetën I/II, format ‘e zhveshura’ (pra jo të flektuara) përemërore si *u(n), ti, ju, na*, na shfaqen, duke sugjeruar se vetëm vetitë e tyre deiktike janë në gjendje t’i leksikalizojnë këto kontekste. Përemrat e veës III dhe emrat kërkojnë flektime të specializuara në të shquar.

Sa për kontekstet parafjalore që përzgjedhin rasën e zhdrejtë, në (23), në këtëstudim ato kërkojnë të kënaqin argumentin e tyre të brendshëm me morfologji me specifikime Q (\subseteq). Sipas analizës në seksionet 3-4, këto specifikime Q (\subseteq) përkohjnë me një interpretim bashkësi-përfshirëse. Në të vërtetë ka fakte të konsiderueshme të pavarura që parafjalët ndër-gjuhësore (zgjedhin specifikabashkësi-për-fshirëse (posedues, veçues). Kështu në italisht (dhe në shumë gjuhë-ëromane) disa parafjalë ndiqen detyrimisht nga *di* ‘e’, p.sh. *prima di* ‘përpara / para se’. Kujtojmë se përemrat e vetës I/II në njëjës në anën tjetër karakterizohen nga morfologjia DOM (dmth rasa e zhdrejtë) edhe kur dalin në kontekste të thjeshta kalimtare, dmth ku argumentet e vetës III shfaqin morfologji kallëzore (dmth N). Insertimi i formave të zhdrejtë në këto kontekste, ilustruar në (24), projekton predikatin parafjalor siç u ‘posedua’ / ‘përfshi’ nga veta I/II. Vini re se në termat tradicionalëshumësi i vetës II në të tashme paraqet një emërore – sinkretizmin kallëzore, në kushte të tjera forma *ju* thjesht leksikalizon një rasë të drejtë (jo të zhdrejtë).

5.1. Rrjedhja

Mbërritëm te kontekstet parafjalore që zgjedhin rrjedhoren (25). Sikurse u vërejt kur sollëm këto të dhëna, morfologjia e specializuar e rrjedhores *-t* për njëjësin e shquar në varietetin e Shkodrës gjendet vetëm një nëngrup i emrave që denotojnë vendin. Në (25a) ne morën shembullin ‘shtëpi’, ‘dhomë’; emra të tjerë të rëndësishëm si ‘derë’, ‘karrige’ etj. E njëjta morfologji e specializuar shfaqet te përemrat e vetës I dhe II njëjës, sikurse është ilustruar në (25a). Pyetja e parë që na del këtu është: çfarë kanë të përbashkët referuesit e vetave I dhe II njëjës, dmth ‘folësi’ me ‘dëgjuesin’, me bazat emërore që denotojnë vendin? Sikurse e kemi diskutuar deri tani, folësi dhe dëgjuesi janë dy koordinata të rëndësishme të universit të diskursit. Një specifikë e vendit, zakonisht ‘këtu’ duhet të jetë domosdoshmërisht mes këtyre koordinatave, në mënyrë që të lejojë fiksimin e denotimit të dëftorëve.

Ne propozojmë, pra, se veta I dhe II me vendoren kanë të përbashkët, në mënyrë specifike me vendoren e shquar, pikërisht këtë lidhje me universin e diskursit.

Duhet të theksohet se pothuajse i njëjtë grup i emrave leksikorë që janë relevantë për rrjedhoren e specializuar në shqipe ka kuptim ndërgjuhësor. Për shembull, numërorët njëjës në italisht duhet të paraprihennë përgjithësi nga përcaktuesit (si në anglisht). Kjo nuk vlen për emrat që denotojnë vende (përafërsisht i njëjti nëngrups i në gjuhën shqipe), që lidhen nga parafjalët e vendit, të cilat mund të paraqiten pa përcaktues, si në (28). Mungesa e përcaktuesë vepërkon me faktin se specifikimi për vendin është ngulitur në universin e diskursit. Në veçanti në (28a) ‘shtëpi’ ose ‘çantë’ priren që të interpretohen si të poseduar nga matrica e vepruesit, ndërsa në (28b) në varësi të kontekstit ‘shtëpi’ mund të interpretohet si i poseduar nga argumenti i brendshëm i matricës. Vini re megjithatë se ‘tokë’ në (28a) interpretohet si thjesht të qenit ‘afër me’ vepruesin - dmth në kuptimin e ‘përfshirjes’ më të afërt. 5

- (28) a. L' ha messo in casa/ borsa/ terra
 e ai. vuri në shtëpi/ çantë/ tokë
 b. L' ha portata a casa
 e/atë ai. solli në shtëpi

Ne propozojmë që morfologjia *-t* në (25a) projekton specifikimet e bashkësisë-përfshirëse Q (\subseteq) –pikërisht ashtu siç bën njëjësi mashkullore në rasën e zhdrejtë (dhanore / gjinore). Tani, afërsia konceptuale e nocioneve të posedimit dhe vendit është e njohur në literaturën tipologjike. Kështu ndërtimet posesive ndër-gjuhësore mund të përfshijnë një gjinore deskriptiv ose një dhanore deskriptiv, ose një vendore deskriptiv (Freeze 1992). Në kushtet e tanishme kjo afërsi

⁵ Përderisa mund të themi, nuk ka literature formale për këtë çështje, ndoshta me përjashtim të Longobardi-t (2001) puna në veti të veçanta që lidhen me shpërndarjen e determinuesëve të jë emri si ‘shtëpi’

konceptuale, dhe gjithashtu sinkretizimet drejt të cilave ajo mund të çojë, përkohë krejtësisht me vetitë e bashkësisë përfshirëse, të cilat, kur janë të përcaktuara në hapësirë, na shpiten te interpretimi vendor. Kjo e fundit është ajo që ne e gjejmë të projektuar nga morfologjia e specializuar në (25A).

Ja ku vijmë teflektimi *-ʃ*, i cili është i specializuar për të ashtuquajturin rrjedhore, në veçanti për shumësin. Nëse qasja jonë në përgjithësi është e saktë, *-ʃ* do të ketë vetitë e brendshme referenciale të cilat reduktojnë kontekstet e saj të shfaqjes. Nga ana tjetër, kjo e fundit jep provat themelore në bazë të të cilave ne fiksojmë kontekstin denotues të e *-ʃ*. Tani, shembujt në (25b) tregojnë se *-ʃ* lidhet me të ashtuquajturat veta I dhe II shumë, pra me elemente leksikore që denotojnë grupe gjithëpërfshirëse për folësit dhe dëgjuesit. Nga ana tjetër, e njëjta morfologji është e pranishme në kontekste parafjalore të tipit në (25b'). Esencialisht, kur thuhet se 'një punë për gratë' në shqipe (25b') arrin të sjellë një veti të 'punës', si në gjuhën angleze 'a women's job, a womanly job'. Prandaj referimi te 'gra' në shmës të pashquar është i përgjithshëm, dmth afërsisht një universale, thuajse 'një punë për çdo grua / të gjitha gratë'. Në bazë të këtyre vëzhgimeve, ne paraprkisht interpretojmë *-ʃ* si një element kuantifikues Q. Në mënyrë të veçantë vetitë kuantifikuese me të cilat ai lidhet, kënaqen nga mbyllje të përgjithshme, të cilat ne sugjerojmë se paraqesin thelbin e interpretimit të *-ʃ* në shembujt si (25b').

Mund të duket problematike që *-ʃ* kombinon gjithashtu edhe bazat e vetës I dhe II për 'ne' dhe 'ju' (shumës). Në realitet, përdorimet gjenerike për të paktën të 'ne' janë vërtetuar në mënyrë të parvarur si në '*we are on earth for a brief time*' (ne jemi në tokë për një kohë të shkurtër) (që i referohet species njerëzore ku folësi bën pjesë) dhe nëshprehje të ngjashme. Me fjalë të tjera, për aq sa i përket 'ne', interpretimi gjenerik bashkëjeton në gjuhët natyrore me interpretimin deiktik ('këtu dhe tani'). Kjo merr ca kohë për të shpjeguar se pse të dyja trajtat e shumësit të pashquar dhe 'ne' kombinohen me të njëjtin

specifikim kuantifikues -*f*. Chierchia (1995), Manzini dhe Savoia (2005, 2007) diskutojnë në detaje përkimin e dy vlerave referuese të ndryshme në klitikun e italishtes *si* - domethënë gjenerike (pothuaj universale) dhe ajo çfarë Chierchia e quan episodike (dmth e reduktuar nga universi i diskursit). Në të njëjtën linjë, ne mund të marrim me mend se të njëjtat tipare të numrit që na lejojnë leximin gjenerik të bazave emërore, lejojnë gjithashtu edhe leximin thelbësor deiktik të vetës II shumës. Dalja në të ashtuquajturat ndërtime rrjedhore varet nga një reduktim i morfologjisë relevante për kontekstet e vendores.

Forma e veçantë që ndarja e vetës merr në të dhënat tona ka specifika të ndryshme të rasave që lidhen me bazat leksikore që denotojnë elemente të universit të diskursit (p.sh. ‘dëgjuesi’ dhe ‘folësi’) dhe bazave të tjera leksikore. Një pikë e fundit që duhet të theksohet është dallimi në mes varietetit si Shkodra, që karakterizohet nga ndarja rasë e zhdrejtë / rrjedhore, dhe varietetit arbëresh si *Greci* që nuk e ka rrjedhoren. Ky ndryshim përkon me dy mënyra të ndryshme për të futur DOM. Kujtojnë se veta I/II njëjës leksikalizon një formë të palakueshme për ‘emëroren’ dhe një ose dy forma Q (\subseteq) për ‘dhanoren’, ‘kallëzorja’ dhe ‘vendorja’ i DOM. Të dy varietetet i zgjerojnë argumentet e brendshme të vetës I/II nga morfologjia e rasës së zhdrejtë (19) dhe i paraqesin ato si përfshirëse të nën-ngjarjes elementare.

Varieteti i Shkodrës paraqet një ndarje të dytë, duke dalluar interpretimine përfshirjes së vendores, izgjeruar nga rrjedhorja, nga interpretimet e tjera të përfshirjes, të shprehura nga rasa e zhdrejtë. Në përgjithësi, ka një lidhje të ngushtë mes kontekstit referencial të bazave leksikore dhe rangut të të ashtuquajturave rasa me të cilat ato lidhen – të cilat përputhen jo drejtpërdrejt me rindërtimin tonë të rasës, nga aspekti i vetive denotuese elementare që kënaqin kontekste me insertim leksikor.

6. Dukuria e reduktimit të rasës (Person Case Constraint (PCC))

Sinkretizimi i rasës mes kallëzores dhe dhanores te përemrat në vetën I dhe II, ilustruar në (24), jep Reduktimin e Rasave. Reduktimi zakonisht nëpër studime kufizohet te klitikës ose te elementët e laki-mit dhe pengon kallëzoren e vetës I/II që të kombinohet me vetën e III tëdhanores (Bejar e Rezac 2003, 2009, Adger e Harbour 2007). PCC funksionon gjithashtu për shqipen, si në shembujt (29i)-(29ii). Në varietetin e Shkodrës, klitikët e vetës I/II njëjës kanë një formë sinkterike kallëzore/dhanore *mə/tə*, ndërsa klitikët e vetës III dallojnë formën e kallëzores njëjës *ε/a* nga dhanorja dhe kallëzorja shumë *i*. Bashkekzistenca e klitikëve të vetës I/II me dhanoren e vetës III ose një klitik tjetër të vetës I/II përjashtohet. Një përjashtim i tillë ndodh edhe në *Greci*, ku forma sinkretike kallëzore/dhanore *mə/tə* dallon nga format e vetës III njëjës *a* për kallëzoren dhe *i* për dhanoren.

- (29) i. *ai m i ka prezan'tu: *Shkodër*
 *ai m i prəzəntuacən *Greci*
 ii. *m tə ka prezan'tu: *Shkodër*

Lidhur me këtë ne mund të marrim të dhënat mes dialektit gegë dhe arbërishtes. Në *Shkodër* kombinimi mes përemrave të plotë I/II është i mundshëm vetëm marginalisht, si në (30i). Sekuenca e përemrave I/II në dhanore përjashtohet gjithashtu nga përemrat e plotë, si në (30ii).

- (30) *Shkodër*
 i. ai m/ t ka prezan'tu: ?mu ty / ?? ty mu
 ii. ai ka prezan'tu:*mu/ ty atii /asai

Normalisht argumentet objektive të vetës I/II pranohen vetëm nëse qëllimi i argumentit paraqitet nga një element vendor, si në (31i). E njëjta gjë është në (31ii) nga kombinimi i përemrit të vetës I/II me përemrin e vetës III.

- (31) *Shkodër*
 i. m/ t kan prezan'tu: mu te ti / ty te un
 ii. m/ t kan prezan'tu: mu/ ty te ai

Insertimi i përemrave të vetës I/II lejohet në kontekstin e argumentit të brendshëm të vetës III, si në (32), ku vendorja gjithashtu përjashtohet.

- (32) *Shkodër*
 m/t a kan prezan'tu: a'te mu/ ty /*te un/ ti

Në (32) prania e klitikëve të vetës I/II lidhet me argumentin qëllim/posedim që kërkon rasën e zhdrejtë të përemrave. Nëse nuk përdoret klitiku i vetës I/II, vendorja realizohet si në (33). Kjo përkon me faktin se vendorja del në (31), ku grupi i klitikëve I/II/III *Dhan-I/II Kall* nuk është i mundshëm.

- (33) *Shkodër*
 ε kan prezan'tu: a'te te un/ ti

Në të kundërt, në *Greci*, kombinimi mes përemrave të fortë, si në (34i, ii), është normalisht i pranueshëm.

- (34) *Greci*
 i. mə prəzəntəci mua ti
 ii. mə / a prəzəntəci mua atirui / atə mua


Dukuria e hierarkisë referenciale dhe reduktimet e shpërndarjes së morfologjisë së rasës (PCC) lidhur me hierarkinë referenciale na shpjen te vetitë e brendshme denotuese të elementëve që marrin pjesë (përemra, morfema të përshtatjes). Në literaturë, PCC merret si një efekt i konkurimit mes dy formave që kontrollojnë tiparet e funksionit të vetës. Adger e Harbour (2007) supozojnë se në pozicionin e argumentit të brendshëm të një foljeje dytranzitive, vetëm veta e tretë mund të dalë, për shkak se nuk i merr tiparet [e pjesëmarrësit] –

ndërsa përemrat e vetës I/II, të cilat i kanë këto tipare përjashtohen. Kjo ndodh për shkak se dhanorja gjithmonë ka një tipar [të pjesëmarrësit] (përfshirë edhe vetën e tretë), duke përcaktuar një konkurrencë që vetëm mund tëdështojë. Që ta përsërisim, PCC referon te vetitë e brendshme denotuese të elementëve pjesëmarrëse (përemrat, morfemat e përshtatjes), ndërsa nocioni i rasës nuk përfshihet aty.


Sikurse e vërejtëm, ka një lidhje mes dukurive të hierarkisë referenciale dhe sinkretizmit të flektimit të rësës. Sikurse e pamë, përemrat e vetës I/II e përjashtojnë strukturën kanonike të ngjarjes tranzitive që përmban një agjent dhe një temë dhe, në vend të kësaj, kërkon rasën e zhdrejtë duke krijuar shpërndarjen DOM. Vetëm elem-entete vetës së tretë, si në (1) - (3), (7) - (8), japin një strukturë kanoniketë ngjarjes kalimtare përfshirë një agjent dhe një temë. Në përgjithësi, ne kemi parë se veta I/II njëjës dhe veta III kanë mënyrë tjetër për të leksikalizuar kontekste të ndryshme argumentuese (subjekt kundrejt objekt kundrejt argumentin e parafjalëve). Ne kemi argumentuar se këto dallime morfologjike nuk janë etiketa fonetike sipërfaqësore të kategorive abstrakte identike. Në të kundërtën, ato përkojnë me lloje vërtetë të ndryshme të konceptimit brenda së njëjtës hapësirë universale të primitiveve ndërfaqësore. Ne e kemi interpretuar ndarjen në mes të përemrave të vetës I/II dhe vetës III si një mënyrë të ndryshme të leksikalizimit të pjesëmarrësvetë ngjarjes. Në veçanti, bazat leksikore që denotojnë elemente të universit të diskutit marrin pjesë në ngjarje si agjentë apo posedues/vende (që përkojnë me morfologjinë e emërores ose tërasës së zhdrejtë/ vendores). Ngulitja e tyre brenda predikatit kërkon praninë e operatorit Q (\subseteq) për përfshirje, të zgjeruar gjithashtu nga morfologjia e rasës së zhdrejtë të vetës së tretë, si në (2) dhe (6i), por vetëm për qëllimet e vetave.

Në këtë këndvështrim, ne mund të ndjekim edhe një shpjegim për PCC, siç shihet në kombinimet e klitikëve në (29) - (34). Klitikët e vetës I/II e bëjnë operatorin e bashkësisë-përfshirëse Q (\subseteq) të pavlefshëm për klitikun e vetës së tretë, siç sugjerohet në (35) për *Greci* - në


mungesë të të cilit ngjarja nuk mund të merret si ta kishte përfshirë qëllimin e vetës III. Kjo është për shkak se veta I/II, në bazë të denotimeve të tyre tëbrendshme për folës/dëgjues, merr përparësi për ngjijtjen e Q (\subseteq), duke privuar një referent të vetës së tretë nga mjetet e nevojshme për t'u vendosur në ngjarje.



Ndryshe papajtueshmëriames vetës I/II dhe klitikut të vetës së tretë të dhanores, në arbërishtekombinimi i formave të forta të për-emrave me vetitë kualifikuese (\subseteq) dhe të dhanores të për-emrave vetës së tretë, është e interpretueshme, si në (36). Ne e marrim atë si të mundshme të zgjerimi që dy elementët Q (\subseteq) kanë dy qëllime logjikisht të ndryshme. Q (\subseteq) më e ulët, dmth ajo që i bashkëngjitet qëllimit *at-*, paraqet një relacion përfshirës mes argumentit të vetës së tretë ('poseduesi' abstrakt) dhe argumenti i vetës I dhe II. Q (\subseteq) më e lartë, dmth ajo që është bashkëlidhur së brendshmi me folësin jo-subjekt *m-* ka si qëllim paraqitjen e nën ngjarjes. Kujtojmë se 'ai më njohu me ta' është thujse parafrazore si të 'Ai më prezantoi mu ata' - dhe kjo është pikërisht se si FL ose (36) është interpretuar. Me fjalë të tjera në *Greci*, vetëm në domenin e klitikut hierarkia referuese ndërvepron me argumentin e bashkëngjitur duke imponuar të vetmen lidhje të Q (\subseteq) me referentin e vetës I/II (thujse asnjë referent i vetës III nuk mund të lidhet me Q (\subseteq) në qoftë se përreth ka një referent të vetës III).



Mundësia strukturore që ilustron në (36) kundërvë arbërishten me të folmen e Shkodrës, ku një kombinim ekuivalent normalisht refuzohet. Natyrisht, ne mund të presim që në *Shkodër* dy forma objektive të përemrave të vetës I/II janë të papajtueshme; në të vërtetë, nuk shfaqet asnjë nga sekuencat *mu ty/ ty mu/ mu atii/ ty atii*. Prandaj, në *Shkodër* te trajtat e forta të përemrave gjenden të njëjtat parime kryesore si te klitikët në (35). Nga ana tjetër me përemrat e fortë Shkodra zgjidh papajtueshmërinë që buron nga PCC duke futur një vendore, i cili lejon vetën I/II, si elementët Q (\subseteq), të kombinohet me zonën e një vete të tretë, të zgjerua nga vendorja, si në (37).



Ndryshimi mes sjelljes morfosintaksore në Greci dhe Shkodër mund të merret duke supozuar se në gramatikën e Shkodrës elementet e vetës I dhe IIe privojnë argumentin tjetër nga interpretimi i bashkësisë-përfshirëse Q (\subseteq) në bazë të një efekti hierarkik referencial i cili nuk i lejon asnjë argumenti (në një domen të dhënë) që të lidhet me Q (\subseteq), nëse një element referencialisht më i lartë është i pranishëm (në të njëjtën domen).

8. Përfundime.

Ky artikull paraqet një trajtim të morfologjisë së rasës në varietetet e shqipes, duke propozuar në mënyrë të veçantë se DOM rrjedh

nga vetitë më të thella referuese, domethënë se vetëm emrat dhe përemrat e vetës së tretë japin një strukturë kanonike të ngjarjes kalimtare që përmban një agjent dhe një temë. Referentët deiktikë janë futur jo si tema, por si posedues / vendore. Kjo përkon me faktin se denotimi i vetës së parë dhe të dytë caktohet në bazë të faktit se ato janë koordinata të universit të diskursit, pa iu referuar domosdoshmërisht strukturës së ngjarjes. Në përgjithësi, ne kemi shqyrtuar dukuritë e rasave nga një këndvështrim leksikor, ku secila e dhënë leksikore është një funksion i lidhjes tingull: interpretimin (dhe anasjelltas).

Nocioni i rasës reduktonnë primitive denotuese (vetën, klasën emërore, shquarësinë, sasinë), që lidhet me të dhënat përkatëse të flektimit - ku veti të ndryshme denotuese kënaqin mjedise të ndryshme sintaksore. Në këtë këndvështrim, ne mund t'i mendojmë dallimet morfologjike si konceptime autentikisht të ndryshme, brenda një hapësire të vetme universale të primitiveve ndërfaqësore. Në të njëjtin kuadër, ne gjithashtu propozojmë një qasje të PCC, duke theksuar edhe një herë lidhjen e saj të fortë për vetitë referuese të njësisve leksikore të përfshira.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Adger D. e D. Harbour (2007), *The Syntax and Syncretisms of the Person Case Constraint*, në *Syntax* 10: 2–37
- Aissen J. (2003), *Differential object marking: iconicity vs. economy*, në *Natural Language e Linguistic Theory* 21: 435-483.
- Beci B. (2004), *Gramatika e Gjuhës Shqipe për të gjithë*, EDFA, Tiranë.
- Bejar S. e M. Rezac (2003), *Person licencing and the derivation of PCC effects*, në A.-T. Pérez-Leroux e Y. Roberge (nën kujdesin e), *Romance linguistics: Theory and acquisition*, Amsterdam, Benjamins:49-62.
- Bejar S. e M. Rezac, (2009), *Cyclic Agree*, në *Linguistic Inquiry* 40: 35–73
- Belvin R. e M. Den Dikken (1997), *There, happens, to, be, have*, në *Lingua* 101: 151-183.
- Berwick R.C. e N. Chomsky (2011), *The biolinguistic program: The current state of its evolution and development*, në A.M. Di Sciullo e C. Boeckx (nën kujdesin e), *The Biolinguistic Enterprise*, Oxford, Oxford University Press: 19-41.
- Calabrese A. (1998), *Some remarks on the Latin case system and its development in Romance*, në J. Lema e E. Trevino (nën kujdesin e), *Theoretical Advances on Romance Languages*, Amsterdam, Benjamins: 71-126.
- Camaj M. (1971), *La parlata Albanese di Greci in provincia di Avellino*, Firenze, Olshki.
- Camaj M. (1984), *Albanian Grammar*, Wiesbaden, Harrassowitz.
- Chierchia G. (1995), *Impersonal Subjects*, në E. Bach, E. Jelinek, A. Kratz e B. H. Partee (nën kujdesin e), *Quantification in natural languages*, Dordrecht, Kluwer: 107-143.
- Chomsky N. (1981), *Lectures on Government and Binding*, Dordrecht, Foris.
- Chomsky N. (1995), *The Minimalist Program*, Cambridge Mass., The MIT Press.
- Chomsky N. (2000), *New horizons in the study of language and mind*, Cambridge, Cambridge University Press
- Chomsky N. (2002), *On Nature and Language*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Chomsky N. (2005), *Three factors in language design*, në *Linguistic Inquiry* 36: 1-22.
- Chomsky N. (2008), *On Phases*, në R. Freidin, C. Otero e M.-L. Zubizarreta (nën kujdesin e), *Foundational Issues in Linguistic Theory. Essays in Honour of Jean-Roger Vergnaud*, Cambridge, Mass., The MIT Press.
- Culicover P. e R. Jackendoff (2006), *The simpler syntax hypothesis*, në *Trends in Cognitive Sciences* 10: 413-418.

- DeLancey S. (1981), *An interpretation of split ergativity and related patterns*, në *Language* 57: 626-657.
- Dixon R.M.W. (1994), *Ergativity*, Cambridge, Cambridge University Press.
- Embick D. (2000), *Features, syntax and categories in the Latin perfect*, në *Linguistic Inquiry* 31: 185-230.
- Evans N. e S. Levinson (2009), *The myth of language universals: language diversity and its importance for cognitive science*, në *Behavioral and Brain Sciences*, 32: 429-448
- Everett D.L. (2005), *Cultural Constraints on Grammar and Cognition in Pirahã*, në *Current Anthropology*, 46, 4: 621-646.
- Freeze R. (1992), *Existentials and other locatives*, në *Language* 68: 553-595.
- Halle M. e A. Marantz (1993), *Distributed morphology and the pieces of inflection*, në K. Hale e S. J. Keyser (nën kujdesin e) *The view from Building 20*, Cambridge, Mass., The MIT Press: 111-176.
- Halle M. e A. Marantz (1994), *Some key features of Distributed Morphology*, në A. Carney, H. Harley e T. Bures (nën kujdesin e), *Papers on Phonology and Morphology, MIT Working Papers in Linguistics* 21: 275-288.
- Hauser M., N. Chomsky e W. T. Fitch (2002), *The faculty of language: what is it, who has it and how did it evolve?*, në *Science* 298: 1569-1579.
- Jackendoff R. (2002), *Foundations of Language*, Oxford, Oxford University Press.
- Jelinek E. (1995), *Quantification in Straits Salish*, në E. Bach, E. Jelinek, A. Kratzer e B. Partee (nën kujdesin e), *Quantification in natural languages*, Dordrecht, Kluwer: 487-540.
- Longobardi G. (2001), *Formal Syntax, Diachronic Minimalism and Etymology: the history of Frenchchez'*, në *Linguistic Inquiry* 32: 275-302.
- Manzini M.R. e Savoia (2005), *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi generativa*. Alessandria, Edizioni dell'Orso, 3 vols.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2007), *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian varieties*, London, Routledge.
- Manzini M. R. e L.M. Savoia (2008), *Worknotes on Romance morphosyntax – Appunti di morfosintassi romanza*, Alessandria, Edizioni dell'Orso.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2010), *Case as denotation: variation in Romance*, në *Studi Italiani di Linguistica Teorica e Applicata*, 39, 3: 409-438
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2011a), *Grammatical Categories*. Cambridge, Cambridge University Press
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2011b), *Reducing 'case' to 'agreement': Nominal inflections in the Geg Albanian variety of Shkodër*, në *Linguistic Variation Yearbook* 11, 1: 76-120.

- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2012), 'Case' categories in the Geg Albanian variety of Shkodër, në *Res Albanicae* 1: 23-42.
- Manzini M.R. e L.M. Savoia (2014), *From Latin to Romance: case loss and preservation in pronominal systems*, në *Probus*, 26, 2: 217-248.
- Nichols L. (2001), *The syntactic basis of referential hierarchy phenomena: clues from languages with and without morphological case*, në *Lingua* 111: 515-537
- Pesetsky D. e Torrego E. (2004), *Tense, Case and the Nature of Syntactic Categories*, in: J. Guéron e J. Lecarme (nën kujdesin e), *The Syntax of Time*, Cambridge, Mass., The MIT Press.
- Pesetsky D. e E. Torrego (2007), *The Syntax of Valuation and the Interpretability of Features*, në S. Karimi, V. Samiian e W. Wilkins (nën kujdesin e), *Phrasal and Clausal Architecture*. Amsterdam, Benjamins.
- Pinker S. e R. Jackendoff (2009), *The reality of universal language faculty*, në *Behavioral and Brain Sciences*, 32: 465-466.
- Vergnaud J.-R. (2008 [1977]), *Letter to Noam Chomsky and Howard Lasnik on "Filters and Control", April 17, 1977*, në R. Freidin, C. P. Otero e M. L. Zubizarreta (nën kujdesin e), *Foundational Issues in Linguistic Theory*, Cambridge, Mass., The MIT Press: 3-15.

ETIMOLOGJI DHE GJUHË KOMBËTARE. SHËNIME MBI NJË ASPEKT TË GJUHËSISË SË EQREM ÇABEJT

1. Në periudhën që shtrihet afërsisht ndërmjet fundit të shekullit të 18-të dhe botimit të *Deutsche Grammatik* (1819, 1822) të Jakob Grimmit studimet gjuhësore pësojnë një periudhë shndërrimi të thellë. Në veçanti komparativizmi i fillimit të shekullit vijon në kushtet e kërkimeve gjuhësore, teknikat e analizës dhe pikat teorike thelbësore të gjuhësisë iluministe, duke pranuar në përgjithësi edhe fushat kërkimore dhe terminologjinë e saj (Diderichsen 1974, Savoia 1981, Aarslef 1984 [1982], Morpurgo Davis 1994). Në *Conjugationssystem*-in (1816) e Franz Boppit, si edhe në *Undersøgelse*-n (1818) e Rasmus Raskut në fakt gjenden skemat interpretuese të ‘gramatikës së përgjithshme’ dhe të krahasimit të dokumentuar, të cilat gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 18-të qëndronin në bazë të kërkimeve mbi gjuhën parake, gjuhët mëmë dhe afërsitë gjuhësore. Në mënyrë të veçantë, tek De Broses, Turgot, Beauzée, Court de Gébelin përshkrimi gjuhësor synon drejt teorizimit, pra drejt kërkimit të ligjeve dhe të parimeve racionale që drejtojnë gjuhët.

Morpurgo Davis 1994:46-47 nënvizon që kërkimet etimologjike kanë luajtur një rol themelor “për teorinë e përgjithshme të gjuhës dhe për rindërtimin e historisë filozofike të njeriut”, pra që në gjuhësinë e shekullit të 18-të. Për shembull De Broses mendon që etimologjia mund të shërbejë për “*recouvrer en partie les anciennes langues, en écomposan les langues moderne*” (për të zbuluar pjesërisht gjuhët e lashta duke zbërthyer gjuhët moderne; De Broses 1765:94). Turgot e bën të qartë raportin ndërmjet etimologjisë dhe teorisë së përgjithshme

të gjuhës në artikullin e tij të rëndësishëm *Étymologie* (1756) në vëllimin VI të *Enciklopedisë*. Atje ai përcakton lidhjen që ekziston ndërmjet etimologjisë, prejardhjes së një gjuhe të caktuar dhe teorisë së gjuhës, duke pohuar se: *“L’application la plus immédiate de l’art étymologique est la recherche des origines d’une langue en particulier: le résultat de ce travail... est une partie essentielle... de la connaissance complète du système de cette langue... ces préliminaires sont indispensables pour saisir... la théorie générale de la parole et la marche de l’esprit humaine dans la formation et les progrès du langage... Cette théorie est la source d’où découlent les règles de cette grammaire générale qui gouverne toutes les langues”* (f. 99). (Zbatimi më i drejtpërdrejtë i artit të etimologjisë është studimi i prejardhjes së një gjuhe të veçantë: përfundimi i kësaj pune... është një pjesë thelbësore... e njohjes së tërësishme të sistemit të kësaj gjuhe... këto kërkime paraprake janë të domosdoshme për të kuptuar... teorinë e përgjithshme të të folurit dhe rrugën e shpirtit njerëzor në formimin dhe ecurinë e të folurit... Kjo teori është burimi prej të cilit rrjedhin rregullat e kësaj gramatike të përgjithshme, e cila është në bazë të të gjitha gjuhëve).

Pra etimologjia që në shekullin e 18-të i drejtohet “kërkimit të prejardhjes së një gjuhe të veçantë“ si parakusht për teorinë e përgjithshme të të folurit dhe të ecurisë së shpirtit njerëzor (Formigari 1972 :140). Në thelb, në këndvështrimet e ndryshme që shfaqen në fund të shekullit të 18-të përvijohet një sërë njohurish dhe vijash teorike që vijnë në mënyrë të natyrshme në interesat e llojit krahasues e historik-gjuhësor të fillimit të shekullit të 19-të. Madje, fuqia shpjeguese e përbërësve teorikë të gjuhësisë së shekullit të 18-të ruan, së paku tek autorët, si Bopp dhe Rask, një rol kërkimor thelbësor. Një gjë e tillë nuk ka të bëjë vetëm me veprat e Boppit, Schlegelit dhe Raskut, por duket se ka vlerë të përgjithshme për gjuhësinë e fillimit të shekullit të 19-të. Gjatë periudhës kalimtare deri në afirmimin e gjuhësisë historike-krahasuese, në mungesë të një modeli përshkrues të frytshëm përshkrimi gjuhësor gjen shprehje tipike në përmbledhje

të mëdha të dhënash dhe tekstesh. Në këtë periudhë botohen vepra që ofrojnë gjedhe të gjuhëve të ndryshme mbi bazën e një komparativizmi të thjeshtëzuar, si *Catalogo delle lingue conosciute e notizia della loro affinità et diversità* (1784) dhe *Saggio pratico delle lingue* (1787) të jezunitit spanjoll Lorenzo Hervas y Panduro (1735-1809), përmbledhja e dëshiruar nga Katerina II dhe e hartuar nën kujdesin e natyralistit gjerman Peter Simon Pallas (1741-1811) *Linguarum totius orbis vocabularia comparativa Augustissimae cura collecta* (1786-1789), *Mithridates oder allgemeine Sprachenkunde* (Mitridati ose gjuhësia e përgjithshme 1806-1817) filluar nga Johann Christoph Adelung (1732-1806) dhe përfunduar nga Vater, *Atlas ethnographique du globe* (1826) i Balbit.

Me *Deutsche Grammatik-ën* (1819 e 1822) e Jakob Grimmit afirmohet një metodologji që përdor krahasimin sistematik të formave gjuhësore si parim studimi dhe njëkohësisht si mjet për rindërtimin historik të marrëdhënieve ndërmjet gjuhëve. Në këtë kuptim këndvështrimi i Grimmit përcakton një ndryshim të rëndësishëm ndaj karakterit universal dhe teorik të gjuhësisë së mëparshme dhe përfaqëson modelin e veprave të mëdha rindërtuese të studimeve të shekullit të 19-të. Nga ky këndvështrim vepra *Grammatik der romanischen Sprachen* (1836-1843) e gjuhëtarit Friedrich Diez bën që të mbizotërojë edhe në lëmin roman dhe atë dialektologjik një model analize i bazuar në krahasimin sistematik të të dhënave dhe të përkimeve, si edhe në rindërtimin induktiv të afërsive dhe zhvillimeve gjuhësore.

Megjithatë, nevojat e një krahasimi të mbështetur në procedura empirike dhe përkime sistematike të përcaktuara historikisht gjatë shekullit të 19-të bëhen gjithnjë e më të qarta. Prirjet me karakter pozitivist në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të bëhen mbizotëruese dhe vënë në diskutim trashëgiminë iluministe që kishte depërtuar në gjuhësinë europiane gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli (Kuke-nheim 1962, Timpanaro 1973, Aarslef 1984 [1982]). Për shembull,

njëra prej çështjeve themelore me të cilën ishin ndeshur kërkimet dialektore në fund të shekullit të 19-të kishte të bënte me unitetin e dialektit dhe të kufijve dialektorë. Këndvështrimi gjenealogjik, i gërshtuar me tezën e “paqortueshmërisë së ligjeve fonetike” të teorizuar nga Osthoff dhe Brugmann 1878, sjell idenë se çdo gjuhë është një objekt homogjen, i përcaktuar në kohë dhe në hapësirë. Në të vërtetë një konceptim i tillë vihet në dyshim në mjedise të tjera shkencore europiane.

Për këtë ndryshim metodologjik dha një ndihmesë themelore afirmimi i gjeografisë gjuhësore, pra i studimit të shpërndarjes gjeografike të fenomeneve gjuhësore, në fund të shekullit të 19-të. Është i njohur fakti që përpjekja e parë për një studim gjeografik-gjuhësor, *Sprachatlas von Nord- und Mitteldeutschland* (Atlas gjuhësor i Gjermanisë Veriore dhe të Mesme, një botim me vetëm gjashtë harta, në vitin 1881) përgatitur nga Georg Wenker kishte për qëllim të përcaktonte kufirin ndërmjet bashkëtingëlloreve të spirantizuara të dialekteve të gjermanishtes së sipërme dhe bashkëtingëlloreve mbylltore të gjermanishtes së poshtme. Rregullsia e këtij zhvillimi fonetik duhej të vërtetohej nga ekzistenca e një vije ndarëse të qartë ndërmjet këtyre dy dialekteve. Por përfundimet vunë në dukje për herë të parë kushtet tipike të heterogjenitetit dhe të parregullsisë që normalisht karakterizojnë ligjërimin e grupeve të folësve të studiuar në një kohë dhe në një territor të caktuar. Në këtë mënyrë lind një këndvështrim metodologjik i ri, i cili do të ketë ndikim të rëndësishëm në rrafshin e interpretimit të fakteve gjuhësore. Në veçanti *Atlas linguistique de la France* (1902-1912), konceptuar dhe nën kujdesin e Jules Gilliéron. Gilliéroni i shndërroi në mënyrë thelbësore metodat e kërkimeve dialektologjike. Tagliavini 1970:259 vëren që botimi i *Atlasit* “shkaktoi pështjellim në shumë prej teorive të përgjithshme të gjuhësisë (dhe veçanërisht në ato rreptësisht neogramatike)”. Hartat e tij në fakt vërtetuan përfundimet e sugjeruara nga atlasit i Wenkerit, pra që shpërndarja në territor e tipareve fonetike nuk duket aspak e rregullt dhe homogjene dhe shpeshherë sjellja e fjalëve e të veçanta diktohet nga

faktorë të ndryshëm. Në studimet dialektore Gilliéroni vuri në dukje që faktorë me karakter semantik (etimologjia popullore dhe homofonia) e kulturor ndikojnë në ndryshimin gjuhësor.

Me ndërrimin e shekujve, në shkencat e të folurit shfaqen ndryshime të thella në mendim. Nga njëra anë orientimi rindërtues dhe metoda krahasuese theksojnë karakterin johistorik dhe teknik të gjuhësisë indeuropiane (Meillet) dhe të gjuhësisë romane (Meyer-Lübke) (khs. Terracini 1949, Malkiel 1953), nga ana tjetër idetë saussuriane, teorizimet e Baudouin de Courtenay-së (Baudouin de Courtenay 1895) mbi marrëdhëniet ndërmjet kuptimit dhe shprehjes gjuhësore, afirmimi i këndvështrimeve teorike në gjuhësinë përshkruese amerikane dhe në Shkollën e Pragës i japin teorisë gjuhësore një vend gjithnjë e më autonom dhe qendror në kuadrin e shkencave humane. Hapen kështu rrugëdalje të reja teorike, të cilat pasqyrojnë një konceptim ‘të brendshëm’ të funksionimit të gjuhëve natyrore.

2. Është i njohur fakti se afirmimi i këndvështrimeve metodologjike dhe i mjeteve të analizës bëhet, të paktën pjesërisht, në funksion të dinamikave kulturore që karakterizojnë një shoqëri në momente të caktuara historike. Një gjë e tillë duket se ka vlerë të përgjithshme për idetë dhe skemat interpretuese të shkencës dhe shtrihet edhe në paradigmat interpretuese që zbatohen në fenomenet natyrore. Lidhjes ndërmjet skemave të analizës shkencore dhe orientimeve ideologjike nuk i shpëton dot as formimi i procedurave etimologjike dhe rindërtimit gjuhësor, që karakterizojnë studimet gjuhësore në Europën e shekujve të 19-të e të 20-të; këto procedura nuk janë të huaja për qëndrimet romantike dhe trashëgojnë prej tyre elementë të qartë ideologjikë.

Për shembull Rotsaert 1979 vë në dukje se studimet etimologjike gjermane paraqesin të paktën dy orientime të njëpasnjëshme, në funksion të prirjeve të ndryshme kulturore të zhvilluara në shoqërinë gjermane. Punimet etimologjike të pjesës së parë të shekullit të 19-të në fakt lidhen me ‘rehabilitimin’ e gjermanishtes, të kryer për-

mes rindërtimit të indeuropianishtes, duke zbatuar në lëmin leksikografik një metodologji të mbështetur në krahasimin indeuropian. Në rastin e *Althochdeutscher Sprachschatz oder Wörterbuch der althochdeutschen Sprache* (1834-46) të Graffit (Rotsaert 1979:310) rindërtimi etimologjik nënkupton krahasimin me varietetet e tjera të indeuropianishtes, të cilat po përvijoheshin nga rindërtimi i saj, dhe jo vetëm me ato gjermanike. Një ndër pasojat tipike të këtij përcaktimi të procedurës është lematizimi në bazë të rrënjëve, në mënyrë që të vihet në dukje afërsia e gjermanishtes me gjuhët e tjera indeuropiane. Siç nënvizon Rotsaert 1979, ‘zbulimi i etimologjisë së fjalëve për Graffin në fakt do të thotë gjetja e shprehjes origjinale të shpirtit të popullit gjerman [‘Der Geist des Volkes’]’. Më pas u afirmua një këndvështrim i mirëfilltë historik, i cili synonte rindërtimin e brendshëm të leksikut të gjermanishtes, çka gjeti shprehje, për shembull në *Etymologisches Wörterbuch der deutschen Sprache* të Kluges (1883, 1899), ku pasqyrohen interesa të reja të llojit purist, që synonin rindërtimin dhe rivlerësimin e leksikut të gjermanishtes.

Konceptimet e ndryshme të etimologjisë, të vëna në dukje nga Rotsaert 1979, lidhen kështu me aspektet e ndryshme ideologjike që shoqërojnë procesin kulturor dhe politik të formimit të gjuhëve kombëtare (Hobsbawm 1991 [1990]). Në mënyrë të veçantë procesi i njësimiit gjuhësor përputhej me interesat e pushtetit ekonomik dhe më në përgjithësi me kushtet e organizimit të shoqërive kombëtare e të teknologjive të komunikimit (Anderson 2000 [1991]). Në këtë mënyrë përcaktimi i ‘gjuhës kombëtare’ duhet parë i lidhur me përpjekjet intelektualëve, të cilët, përmes rindërtimit dhe etimologjisë, përcaktojnë cilësitë historike dhe formale të qenies së saj.

3. Mund të përpiqemi ta vendosim formimin e gjuhësisë shqiptare e në veçanti studimet etimologjike në brendësi të këtij kuadri. Ato pasqyrojnë shtresëzimin kompleks të metodave të analizës, të konceptimeve dhe të interesave që shoqërojnë zhvillimin e gjuhësisë historike-krahasuese dhe rindërtimit gjuhësor. Veçanërisht kërkesa për ri-

ndërtimin e prejardhjes dhe afërsia ndërmjet gjuhëve nënë dhe gjuhëve moderne lidhet me skemat ideologjike dhe kulturore të nacionalizmit. Në mënyrë të ngjashme me ç'kemi parë më sipër në lidhje me gjuhën letrare, përcaktimi i gjuhës letrare dhe i shqipes së përbashkët lidhen me procesin e Rilindjes Kombëtare (khs. Camaj 1984, Qosja 1985, Demiraj 1997). Ajo përfaqëson përfundimin e procesit të përpunimit historiko-kulturor të kombit shqiptar, në të njëjtat caqe në të cilat ky proces kryhet në pjesën tjetër të Europës dhe lidhet me një organizim të ri të shoqërisë europiane. Hobsbawm 1996 [1987] vë në dukje në mënyrë të veçantë se arsimimi masiv, me rëndësi themelore për afirmimin e idesë kombëtare, nënkupton përdorimin e një gjuhe të folur prej pjesës më të madhe të njerëzve dhe jo të gjuhës së një elite. Edukimi dhe arsimimi bëhen çështje kombëtare mbizotëruese që me fillimin e krijimit të shteteve kombëtare. Është me interes të vihet re se Qosja 1985 shquan pikërisht këtë aspekt në qëndrimin e romantikëve ndaj gjuhës: "*Traitant de la langue comme une émanation de l'esprit national, les romantiques albanais la considèrent aussi comme un facteur de l'enseignement, du savoir...*" (duke e trajtuar gjuhën si një rrezatim të shpirtit kombëtar, romantikët shqiptarë e konsiderojnë atë gjithashtu si një faktor arsimimi, diturie, f. 88). Në fakt përcaktimi i normave leksikore e gramatikore dhe sistemit të shkrimit është në funksion të krijimit të organizmave kolektive të administrimit të pushtetit, siç është shteti kombëtar.

Siç vë në dukje Qosja (1985), çështja e gjuhës shqipe gjatë romantizmit shqiptar zë një vend qendror, së cilës i kushtojnë vëmendjen e tyre shkrimtarët dhe intelektualët si Jeronim De Rada ose Naum Veqilharxhi. Ajo përbën 'çështjen kombëtare', madje një 'mit kombëtar', motivimet kulturore të së cilës gërshetohen me ato politike e historike, në kuptimin që "... *les peu d'intellectuels ne peuvent considérer et traiter la question de la langue que comme un facteur essentiel qui témoigne de l'existence d'une nation autochtone, respectivement comme une émanation nationale.*" (Qosja 1985: 85). Në këtë kuadër figura e De Radës është emblematike për rolin e letrarëve

arbëreshë në lëvizjen romantike; ata, veçanërisht pas krijimit të Lidhjes së Prizrenit më 1878 mbështetën Rilindjen e Shqipërisë dhe kërkuan autonominë politike të saj (Altimari 1986). Me *Këngët e Milosaut* (1836) dhe *Rapsodi të një poeme arbëreshe* (1866) De Rada nxit një letërsi shqiptare të vëmendshme ndaj modeleve letrare medietuese dhe rrymave europiane (Altimari 1986). Edhe dy gramatikat e tij të arbërishtes, dhe në përgjithësi interesat e tij gjuhësore pasqyrojnë kërkesat kulturore të lidhura me përcaktimin e shqipes dhe të prejardhjes së saj, në përputhje pra me çështjen kombëtare (khs. Altimari 1982).

Studimet e gjuhësisë shqiptare të shekullit të 19-të marrin një rrjedhë ideologjike të veçantë. Të shqyrtojmë veprën e Xylanderit *Die Sprache der Albanesen oder Schkiptaren* (1835). Ai i interpreton mbi bazën e substratit tiparet gramatikore të përbashkëta të shqipes, rumanishtes dhe bullgarishtes, siç është prapavendosja e nyjës shquese, duke sugjeruar një rindërtim të gjuhës nënë të shqipes: “kjo karakteristikë [prapavendosja e nyjes] nuk përfshin vetëm gjuhën shqipe, por si një afërsi e qartë gjuhësore shtrihet mbi krejt zonën e gjuhëve vllahe e bullgare... së këtejmi rrjedh që këto tre gjuhë të popujve të shpërndarë në pjesën më të madhe të zonës ku jetonin trakasit e lashtë mund të kenë gjetur një substrat të përbashkët [Unterlage] në një gjuhë të veçantë të banorëve të mëparshëm të vendit, e cila bie në sy me më shumë forcë e qartësi në gjuhën shqipe“ (Xylander 1835: 314-315, *përkth. i autorit*).

Në të vërtetë hipoteza e ndikimit të gjuhëve të mëparshme mbi latinishten përbën një nga mjetet kryesore interpretuese të gjuhësisë së fundit të shekullit të 18-të. Në bazë të kësaj hipoteze ndryshimet dialektore pasqyronin gjuhët e lashta. Biondelli 1839 do t'i bëjë të vetat idetë e Xylanderit 1835 e veçanërisht substratin si mjet zbulimi. Në lidhje me tiparet gramatikore të rumanishtes (“valacco”), si prapavendosja e nyjës shquese dhe lakimi emëror, ai mbështet pikëpamjen se shkaku i tyre është mënyra e të folurit latinisht e një popullsie që si gjuhë të mëparshme kishte shqipen: “...troviamo generalmente che,

quando una nazione soggiogata da un'altra fu costretta colla violenza ad adottare... la lingua del vincitore..adattò più o meno il nuovo lessico al genio ed alla grammatica della lingua nativa..." (...në përgjithësi vërejmë se kur një komb i nënshtruar nga një tjetër detyrohet me forcë të marrë... gjuhën e ...pushtuesit, atëherë, ai rreket t'ia përshtasë njëfarësoj leksikun e ri, shpirtit dhe gramatikës së gjuhës amtare... Biondelli 1839:168).

Te Dorsa 1862¹ referimet ndaj literaturës shkencore mbi shqipen (citohen Hahn, Bopp, Fallermayer, Stier) vënë në dukje vazhdimësinë në kulturën e Italisë së Jugut të trashëgimisë së Vikos (G.B. Vico) dhe të autorëve të tjerë të shekullit të 18-të, që e lidhin në mënyrë më të qartë gjuhën me zhvillimin e mendimit dhe të kulturës njerëzore “...*far risaltare l'antichità antiomerica dell'idioma albanese, mettendolo in comparazione principalmente col greco e latino primitivi. Le autorità dei dotti e in special modo di Malte-Brun, Court de Gébelin, Mazocchi, ci guideranno per seguire alcun altro punto di affinità con gli altri idiomi indoeuropei, e anche semitici derivati pure in origine da una madre comune. Seguiremo lo svolgimento delle parole guidati dalle stesse leggi onde si svolgono le idee, e invocando a maestro il Vico... forse ci sarà dato di tracciare in qualche modo una storia ideale della lingua albanese...*” (... të vihet në dukje lashtësia parahomerike e gjuhës shqipe, duke e krahasuar atë në radhë të parë me greqishten dhe latinishten parake. Autoriteti i dijetarëve, e në radhë të parë i Malte-Brunit, Court de Gébelinit, Mazocchit, do të na udhëheqin për të ndjekur ndonjë pikë tjetër afërsie me gjuhët e tjera indeuropiane dhe ato semite, të prejardhura nga një nënë e përbashkët. Do të ndjekim zhvillimin e fjalëve të udhëhequr prej të njëjtave ligje nga të cilat

¹ Idetë themelore të Dorsës nuk dallohen shumë prej atyre të Kamardës: edhe Dorsa 1862 përpiket të gjejë një lidhje gjenealogjike të veçantë ndërmjet greqishtes dhe shqipes me anë të një gjuhe “pellazge”. Teoria pellazge u përgjigjej qëndrimeve të caktuara kombëtare, duke kënaqur edhe kërkesën për një lashtësi fisnike dhe një lidhje mbizotëruese me greqishten e vjetër dhe gjuhët e lashta italiane. Edhe autorë të tjerë arbëreshë e mbështetën këtë lidhje, p.sh. De Rada 1893.

zhvillohen idetë dhe duke thirrur në ndihmë mësuesin Vico... ndoshta do të na lejohet të përvijojmë në një farë mënyre një histori ideale të gjuhës shqipe..., fq. 8-9-10). Trysnia e idealeve kombëtare dhe paraqitja e veçantisë gjuhësore e kulturore mbizotëron në *Sugli albanesi. Ricerche e pensieri* dhe në *Studi etimologici della lingua albanese* të Dorsës (Dorsa 1847 e 1862). Pasiguria e theksuar metodologjike dhe anakronizmi i procedurave etimologjike të llojit të Vicos dhe të Gébelinit nxjerrin në pah qëllimin historiko-kulturor, i cili megjithatë nuk është larg gjuhësisë romantike bashkëkohore.

I njëjti qëndrim metodologjik karakterizon në përgjithësi veprën e Dhimitër Kamardës *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* (Camarda 1864), të recensuar hollësisht nga Ascoli 1877. Te Kamarda 1864 (khs. Camaj 1973, Guzzetta 1983) metoda krahasuese, e vërtetuar nga njohja e literaturës gjermane (Bopp, Schleicher, Curtius) jepet përpara nevojave të një skeme të paracaktuar: vërtetimit të marrëdhënieve të afërsisë ndërmjet shqipes dhe greqishtes përmes krahasimit gramatikor dhe rindërtimit etimologjik. Siç nënvizon Guzzetta 1989, vepra e Kamardës ka në të vërtetë qëllim politik, duke qenë se "pasi të vërtetohet natyra trako-pellazge, ose greko-italike, sipas dëshirës, e gjuhës së folur që nga lashtësia në kontinentin e vjetër dhe në Epirin e Ri, do të arrihet në përfundimin jo të padobishëm që e gjithë Europa Jugore banohet nga raca e quajtur zakonisht greko-latine.. Për ata që e kanë për zemër fatin e ardhshëm të Greqisë do të jetë lehtësisht e kuptueshme sa rëndësi ka që të dihet... që dy degë etnike të të njëjtit trung pellazg, në brendësi jo të ndryshme ndërmjet tyre, janë prej kohësh shumë të lashta banorë vendas të gadishullit lindor... f. iii). Mundësia e përcaktimit të një lidhjeje të ngushtë gjenealogjike ndërmjet shqipes, greqishtes dhe latinishtes do të thotë të përligjësh karakterin autonom të gjuhës kombëtare shqipe dhe për pasojë edhe të drejtën e shqiptarëve për të pasur kombin e tyre.

4. Në përgjithësi, ende deri në fund të shekullit të 19-të ky qëndrim përshkrues dhe historik-etimologjik synon qartësisht të përcaktojë karakteristikat e shqipes, lashtësinë dhe prejardhjen e saj, por gjithmonë në lidhje me një kuadër krahasues më të gjerë, pra me atë të gjuhëve indeuropiane, të greqishtes e të gjuhëve të tjera ballkanike. Njohja e marrëdhënieve më të lashta dhe përcaktimi i prejardhjes së shqipes nga një gjuhë mëmë e mundshme ende përfaqësojnë përligjen themelore të gjuhës kombëtare.

Hipoteza e Xylanderit 1835 mbi një substrat iliro-trak, i cili është në bazë të ballkanizmave rimerret edhe nga Miklosich 1861 (khs. Banfi 1985, Demiraj 1988) dhe përvijon pikat themelore të një diskutimi mbi prejardhjen e shqipes me rëndësi ideologjike të drejt-përdrejtë. Në fund të fundit çështja e substratit ka karakterizuar në përgjithësi gjuhësinë romantike. Për shembull në Itali nocioni i substratit është i përpunuar tërësisht te Biondelli 1839, që e përdor atë për të përcaktuar fisnikërinë e prejardhjes së dialekteve të italishtes (në krahasim me toskanishten letrare): *“Su questa base, viene ancora mirabilmente risolto il cèlebre problema sulla causa della varietà dei nostri dialetti, la quale evidentemente risulta dalla originaria varietà delle nazioni che li parlano; e di più ne viene precisata l'origine, la quale daterebbe dall'epoca in cui la lingua latina fu introdotta nelle rispettive provincie.”* (Mbi këtë bazë edhe një herë zgjidhet mrekullisht çështja e njohur e shkakut të shumëllojshmërisë së dialekteve tona, i cili qartësisht rrjedh nga shumëllojshmëria në zanafillë e kom-beve që i flasin; e për më tepër përcaktohet prejardhja e tyre, i cila fillon me kohën kur gjuha latine u vendos në provincat përkatëse. Biondelli 1839:170). Në Italinë e periudhës së krijimit të shtetit kombëtar koncepti i substratit nxit kundërvënien ndërmjet mbështetësve të toskanishtes letrare dhe të traditave të tjera gjuhësore, si rrymat lombarde antitokane, të përfaqësuara për shembull po nga Biondelli dhe Monti.

Në fakt, të pohosh, siç bën Xylanderi, se shqipja ruan me ‘forcë dhe qartësi’ gjuhën e lashtë të substratit do të thotë të hamendësosh edhe një vazhdimësi të atdheut të parë të shqiptarëve, të territorit të formimit etnik dhe gjuhësor të tyre. Kjo zgjidhje që sot zakonisht pranohet, u pohua edhe nga Meyer 1888, sipas të cilit shqipja duhet vështruar ‘si një fazë e re e ilirishtes së lashtë’ (Demiraj 1988: 149). Siç vëren Banfi 1985, teza e substratit pati ndikim të veçantë mbi studuesit e mjedisit vienez, Miklosich, Meyer, Papahagi e këtë tezë e bëri të vetën Schuchardti. Pikërisht me këtë mjedis lidhet veprimtaria e Joklit dhe në veçanti analiza etimologjike e tij, e cila, siç dihet, përcaktoi si të fondit indeuropian të shqipes fjalë që deri atëherë kundroheshin si huazime nga gjuhët fqinje. Tagliavini 1965:34 e çmon *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen* (Jokl 1923) si “një model për studimin e historisë së fjalëve të lidhur me atë të sendeve dhe të institucioneve“. Siç vë në dukje Tagliavini 1970, zhvillimi i kërkimeve onomasiologjike është i lidhur me gjeografinë gjuhësore, që siç kemi parë, përcakton një rishqyrtim të thellë të marrëdhënive ndërmjet gjuhës dhe folësit. Skema *Wörter und Sachen*, në veçanti në veprën e Schuchardtit, nxori në pah mundësinë për ta trajtuar leksikon e një gjuhe në lidhje me jetën dhe kulturën e një bashkësie. Këto skema interpretuese nga njëra anë hidhnin poshtë konceptimin neogramatik të gjuhës si një sistem homogjen, nga ana tjetër ishin në funksion të karakterizimit të thesarit leksikor të një gjuhe kombëtare pavarësisht nga prejardha e saj e lashtë, por në lidhje me përdorimin e vet dhe kushtet historikokulturore të folësve.

Është interesante të vërehet që kërkimet onomasiologjike përputhen me vizionin historicist të zhvillimit të shoqërisë dhe të fakteve kulturore dhe ekonomike. Ky vizion ka karakterizuar shumë prej modeleve interpretuese të llojit idealist apo marksist, për të cilat gjuha njësohet me historinë e vet, e më saktë me kulturën dhe mundësisht me strukturën shoqërore dhe ekonomike të bashkësisë. Për shembull nga këndvështrimi idealist aftësia e të shprehurit përmes gjuhës dhe vetë ‘liria’ gjuhësore tradicionalisht konceptohen si prirje stilistike ose

letrare, të cilat përkojnë me prodhimin historik të veprimtarisë shprehëse të subjektit folës. Kuadrin tipik të këtij shqyrtimi na e ofron Croce 1902: 174, i cili vë në lidhje natyrën e gjuhës me shprehjen e thjeshtë: *“Fuori dell'Estetica, che dà la conoscenza della natura del linguaggio, e della Grammatica empirica, ch'è un espediente pedagogico, non resta altro che la Storia delle lingue nella loro realtà vivente, cioè la storia dei prodotti letterari concreti, sostanzialmente identica con la Storia della Letteratura”* (Veç Estetikës, e cila jep njohuritë mbi natyrën e gjuhës, dhe Gramatikës Empirike, e cila është një mjet pedagogjik, nuk mbetet gjë tjetër pos Historisë së gjuhëve në realitetin e tyre jetësor, pra historia e prodhimeve letrare konkrete, të njëjta në thelb me Historinë e Letërsisë).

Në *Ideologjinë gjermane* Marksia dhe Engelsia shohin tek gjuha ‘ndërgjegjen reale, praktike’, të kuptuar si ‘produkt shoqëror’. Gjuha pra vihet në lidhje me prodhimin e jetës materiale, të kuptuar si një nivel organizimi vijues dhe i dalluar nga baza natyrore. ‘Skema materialiste’ u zbatua ‘mekanikisht’ për gjuhën nga Nikollaj Marr, i cili e identifikoi gjuhën si një ‘superstrukturë’ ndaj strukturës ekonomike, në të njëjtën mënyrë si konceptet dhe institucionet juridike, politike dhe ideologjike. Në të vërtetë interpretimi marksist i gjuhës edhe jashtë skematizmit të Marrit, nuk mund të mos shohë në gjuhët e ndryshme një prodhim të veprimtarisë njerëzore, dhe në analizë të fundit edhe të historisë së tij (Rosiello 1974). Një shpjegim të këtij lloji e gjejmë për shembull tek Kostallari 1973 në lidhje me aspektet e ndryshme të njësimin gjuhësor dhe të formimit të gjuhëve kombëtare. Në veçanti ndryshimi i strukturave shoqërore i përcaktuar nga ‘triumfi i revolucionit popullor’ *“... ne pouvait ne pas donner les jours à des conditions qualitativement nouvelles aussi pour la vie et le développement de la langue littéraires, de ce trait fondamental de l'unité de la nation et... de notre culture nationale.”* (nuk mund të mos krijojë kushte cilësisht të reja edhe për jetën dhe zhvillimin e gjuhës letrare, të këtij tipari themelor të unitetit të kombit dhe... të kulturës sonë kombëtare, f. 48).

Kostallari 1964 e lidh zhvillimin e studimeve albanologjike me historinë e shoqërisë shqiptare, me përfundime herë-herë interesante. Në veçanti ai i lidh studimet etimologjike të leksikut të shqipes me punimet e Meyerit, Miklosichit, Joklit dhe kryesisht të Schuchardtit. Por Kostallari vëren që albanologjia e përpunuar nga studiuesit e huaj ka një këndvështrim ‘të jashtëm’, duke u mbështetur kryesisht mbi marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, ndërsa i mungon në përgjithësi këndvështrimi i brendshëm, i orientuar drejt strukturave të shqipes. Por veprat e Çabejt do të karakterizohen “... *par l’historisme, par la liaison organique de l’évolution de la langue avec la culture matérielle et spirituelle du peuple albanais, ... par l’objectif de rendre et d’analyser les faits et les phénomènes linguistiques dans leur extension non seulement dans le temps, mais aussi en espace...* (nga historicizmi, nga lidhja organike e evolucionit të gjuhës me kulturën materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar, ... duke synuar të japin dhe të analizojnë faktet dhe fenomenet gjuhësore në shtrirjen e tyre jo vetëm në kohë por edhe në hapësirë... Kostallari, Mansaku 1988: 16, etj). Studimet e Çabejt nxjerrin në pah virtytet dhe veçoritë origjinale të shqipes “*son individualité, l’unité de la langue albanaise et de la culture populaire*” (individualitetin e saj, unitetin e gjuhës shqipe dhe të kulturës popullore).

Çështjet e gjuhës shqipe në veprat e shumta të Çabejt shqyrtohen, siç pohojnë Kostallari dhe Mansaku 1988, nga këndvështrimi i brendshëm, pra në lidhje me vetë historinë e shqipes. Etimologjia në veprën e Çabejt nuk është rindërtimi i thjeshtë i fjalës, ose gjetja e bazës së prejardhjes së saj. Ajo synon, siç thotë Turgot, të zbulojë prejardhjen e gjuhës dhe në të njëjtën kohë të njohë sistemin e saj. Në fakt, siç duket qartë në *Studime etimologjike*, etimologjia e Çabejt ka një ecuri komplekse të shumanshme, e cila përfshin historinë e fjalës në aspektet e ndryshme të saj dhe mban parasysh kushtet e përdorimit, të shpërndarjes gjeografike, të ndryshimeve shoqërore të cilat kanë ndikuar mbi kuptimin dhe formën e vetë fjalës. Që në tezën e tij vieneze të vitit 1933 nën drejtimin e Joklit, *Italoalbanische Studien*, ai

tregonte një vëmendje të hollësishme për të dhënat gjuhësore dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, e cila në studimet etimologjike bëhet një përbërëse themelore e metodës së llojit “fjalë dhe sende”. Në këtë kuptim puna etimologjike e Çabejt vërtet “fit de l’*étymologies de l’albanais une partie intégrante et centrale de l’histoire de cette langue, une incarnation entière de son système*” (i bëri etimologjitë e shqipes një pjesë përbërëse dhe qendrore të historisë së kësaj gjuhe, një mi-shërim të tërësishëm të sistemit të saj. Kostallari e Mansaku 1988: 21).

Një prej përfundimeve më të rëndësishme të studimeve etimologjike të Çabejt është shpjegimi prej bazave të qarta të shqipes i fjalëve të cilat më parë kundroheshin si huazime, ose kishin mbetur pa shpjegim, si në *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache* (1891) të Meyerit. Metoda etimologjike, siç thotë Çabej në hyrjen e veprës *Studime etimologjike* të vitit 1982, mbështetet në një “*comparaison ... soit à l’intérieur de la langue, soit avec un mot d’une autre langue, et, à l’intérieur de la langue, soit dans le sens géographique et territorial, soit dans celui historique... pour celui qui étudie l’origine d’un mot, il s’impose de constater avant tout ... l’emploi, les embranchements, l’extension géographique, le milieu et l’histoire de ce mot, quand il est possible de sa première documentation dans l’écriture*” (krahasim... qoftë brenda gjuhës, qoftë me një fjalë të një gjuhe tjetër, dhe, brenda gjuhës, si në kuptimin gjeografik dhe territorial, si në atë historik... për atë që studion prejardhjen e një fjale është e nevojshme të vërejë para së gjithash... përdorimin, degëzimet, shtrirjen gjeografike, mjedisin dhe historinë e kësaj fjale, kur është e mundur dokumentimin e parë të saj me shkrim. f. 192-193). Përsa i përket karakterit të brendshëm të këndvështrimit, Çabej vëren që “*la comparaison intérieure et celle extérieure représentent des opérations également nécessaires et également justifiées de l’analyse historique de la langue, qui coopèrent et se complètent mutuellement...*” (krahasimi i gjuhës jo vetëm së brendshme, por edhe së jashtme ka të njëjtën rëndësi dhe të dy kahet janë njëlloj të përligjura për analizën historike të gjuhës, duke qenë se bashkëveprojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin, f. 193).

Krahasimi brendagjuhësor i zbatuar nga Çabej mbështetet mbi një njohje të gjerë e të saktë të thesarit leksikor të të folmeve të shqipes. Ndryshimi leksikor analizohet në lidhje me mekanizmat e ndryshme të vëna në dukje nga kërkimet gjuhësore moderne, si rregullat fonetike, marrëdhëniet semantike, kufizimet shoqërore-stilistike, ekzistenca e nënbashkësive leksikore të përcaktuara. Gjerësia e dokumentimit paraqet pikën e forcës të trajtimit etimologjik dhe karakterizon në fakt atë që Çabej e quan metodë ‘brenda-gjuhësore’, të brendshme pra në sistemin gjuhësor të kuptuar si një bashkësi (e strukturuar) elementesh. Në të kundërt mungon çdo lloj interesi për një kuadër teorik referimi. Edhe parakushtet për rindërtimin fonetik e morfosintaksor janë të ngjashme dhe përvijojnë një qasje të pastër empirike ndaj të dhënave gjuhësore. Për shembull Çabej 1976 : 80, e shpjegon prejardhjen e nyjes së prapavendosur duke pohuar se ajo është struktura më e hershme dhe që nyja e paravendosur rrjedh nga një segmentim i gabuar i togfjalëshave emër + mbiemër nga ana e folësve; rindërtimi i hollësishtëm etimologjik i mbaresës së kallëzores së nyjës është një kalim i domosdoshëm.

Në zbatimin e këtij lloji të hulumtimit etimologjik mbështetet përfundimi i karakterit autokton të shqipes, duke qenë se, siç thotë Çabej, “*La question du lieu de formation... étant... aussi une question concernant l’histoire de la langue*” (Çështja e vendit të formimit... duke qenë... po ashtu një çështje që ka të bëjë me historinë e gjuhës, Çabej 1972: 129). Në fakt pesha kryesore e provës duket se qëndron në materialin gjuhësor (toponime, leksikë të veçantë), siç sugjerojnë kërkimet pioniere të Xyalnderit e më pas të Hahnit. Hahni 1854 (211 etj.), duke u mbështetur në toponime si *Delmatia*, *Dardania*, arriti në përfundimin që vendi i formimit të shqipes duhet të ishte pikërisht territori ende (pjesërisht) i banuar nga popullsi shqipfolëse. Kjo është vija e ndjekur nga Çabej 1972 ; ai vërteton që edhe toponimet më të diskutueshme pasqyrojnë një zhvillim fonetik normal, së paku në krahasim me kohë më të lashta. Edhe çështja e nomenklaturës detare bëhet e parëndësishme kur mbahet parasysh fakti që në çdo lëmë leks-

ikor gjejmë kushte në të cilat huazimet triumfojnë mbi fjalët vendase. Veç kësaj, elementi latin i shqipes paraqet karakteristika më arkaike se ai i rumanishtes, duke sugjeruar një romanizim më të lashtë se ai i Dakisë dhe duke i ndarë të dyja fazat e romanizimit.

Etimologjia paraqet një metodë kërkimore me vlerë të përgjithshme, që ka për qëllim interpretimin e historisë së përgjithshme të një populli. Ajo nuk heq dorë nga funksionet e saj origjinale ideologjike, të përcaktimit të gjuhës (dhe të kulturës) kombëtare. Edhe kur metoda është bindëse dhe përfundimet shkencërisht të sakta, roli i gjuhëtarit mbetet i ndjeshëm ndaj kërkesave të historisë kombëtare. Vetë krahasimi i brendshëm, si metodë njohëse dhe mekanizëm i zbulimit të lidhjeve ndërmjet elementëve leksikorë, e thekson karakterin tashmë dytësor të kohës së lindjes së gjuhësisë shqiptare e më gjerësisht asaj europiane, pra atëherë kur çështja parësore ishte përligjja e gjuhëve kombëtare në sajë të lashtësisë së tyre. Asokohe krahasimi i jashtëm ishte i nevojshëm për ta njohur shqipen si një gjuhë të familjes indeuropiane. Punimet e Çabejt, që gjithsesi u takojnë kohëve të fundit, tashmë kanë si qëllim njohjen e plotë të autonomisë së sistemit gjuhësor të shqipes ndaj kërkimet etimologjike bëhen mjete kryesor për këtë. Edhe metodat e përdorura, që nga “fjalë dhe sende” deri tek hulumtimet etnografike, semantike, letrare, etj. i bëjnë jehonë një interesi qartësisht të drejtuar kah historia gjuhësore, e konceptuar si pikëmbërritja e një hulumtimi të plotë gjuhësor e në funksion të historisë kombëtare.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Aarslef H. 1984 [1982], *Da Locke a Saussure. Saggi sullo studio del linguaggio e la storia delle idee*, Bologna, Il Mulino.
- Adelung J. Ch. 1806-17, *Mithridates oder allgemeine Sprachenkunde mit dem Vater Unser als Sprachprobe in bey nahe fünfhundert Sprachen und Mundarten* (fortgesetzt und bearbeitet von J.S. Vater), 4vv., Berlin, Vossische Buchhandlung.
- Altimari F. 1986, *Profili storico-letterari*, në *Altimari et alii L'esilio della parola*, Pisa, ETS:1-31.
- Altimari F. 1992, *Per una storia della dialettologia arbëreshe*, Quaderni di Ziarri.
- Anderson B. 1996 [1991], *Comunità immaginate. Origini e fortuna dei nazionalismi*. Roma, Manifestolibri.
- Balbi A. 1826, *Introduction à l'Atlas ethnographique du globe*, v. I, Parigi.
- Banfi E. 1985, *Linguistica balcanica*, Bologna, Zanichelli.
- Baudouin de Courtenay J. A. 1895, *Versuch einer Theorie phonetischer Alternationen. Ein Capitel aus der Psychophonetik*, Strassburg, Trübner.
- Beauzée N. 1767, *Grammaire générale ou exposition raisonnée des élémens nécessaire du langage, pour servir de fondement à l'étude de toutes les langues*, Paris.
- Biondelli B. 1839, *Sullo studio comparativo delle lingue - Osservazioni generali di B. Biondelli*, në *Politecnico*, anno primo, II:161-184.
- Bopp F. 1816, *Über das Conjugationsystem der Sanskritsprache in Vergleichung mit jenem der griechischen, lateinischen, persischen und germanischen Sprache*, Frankfurt.
- Bopp F. 1854, *Ueber das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, Berlin
- Camaj M. 1984, *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*, në A. Guzzetta (nën kujdesin e), *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*, Università di Palermo: 85-93.
- Camaj M. 1984b, *Albanian Grammar*, Wiesbaden, Harrassowitz.
- Camarda D. 1864, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno.
- Court de Gébelin 1773-1789, *Monde primitif analysé et comparé avec le monde moderne*, 9 vv., Paris.
- Court de Gébelin 1776, *Histoire naturelle de la parole*, Paris.
- Croce B. 1902, *Estetica*, Milano-Palermo-Napoli, Sandron.
- Çabej E. 1972, *Le problème du territoire de la formation de la langue albanaise*, në *Studia albanica*, IX, 2: 125-151.
- Çabej E. 1976, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, Rilindja.
- Çabej E. 1980, *Sur les principes et la méthode des études étymologiques*, në *Studia albanica* XVII, 2: 7-40.

- Çabej E. 1982, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* – I, Akademia e Shkencave, Tiranë.
- De Brosses Ch. 1765, *Traité de la formation mécanique des langues, et des principes physiques de l'étymologie*, Paris.
- Demiraj Sh. 1988, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.
- Diderichsen P. 1974, *The Foundation of Comparative Linguistics: Revolution or Continuation*, në D. Hymes (nën kujdesin e) *Studies in the History of Linguistics*, Indiana University Press, Bloomington: 277-306
- Diez R. 1836-43, *Grammatik der romanischen Sprachen*, 3vv., Bonn.
- Dorsa V. 1847, *Sugli albanesi. Ricerche e pensieri*, Napoli.
- Dorsa V. 1862, *Studi etimologici della lingua albanese*, Cosenza.
- Formigari L. 1972, *Linguistica e antropologia nel secondo settecento*, Messina. La Libra.
- Grimm J. 1822², *Deutsche Grammatik*, Göttingen.
- Guzzetta A. 1984, *Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista*, në A. Guzzetta (nën kujdesin e), *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*, Università di Palermo: 9-21.
- Guzzetta A. 1989, *Presentazione*, në D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese*, ribotim i botimit të vitit 1864, Palermo.
- Hahn J.G. 1854, *Albanische Studien*, Jena.
- Hervas y Panduro L. 1784, *Catalogo delle lingue conosciute e notizia della loro affinità e diversità*, Cesena
- Hervas y Panduro L. 1787, *Saggio pratico delle lingue*, Cesena.
- Hobsbawm E. J. 1991 [1990], *Nazioni e nazionalismi dal 1780*, Torino, Einaudi.
- Hobsbawm E. J. 1996 [1987], *L'età degli imperi 1875-1914*, Milano, Mondadori.
- Jokl N. 1923, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, Berlin-Leipzig.
- Kostallari A. 1964, *Le développement des études albanologiques en Albanie. Problèmes nouveaux et taches nouvelles*, në *Studia albanica* 1: 5-46.
- Kostallari A. 1973, *La langue littéraire albanaise contemporaine et les problèmes fondamentaux de son orthographe*, në *Studia Albanica* X, 1: 33-89
- Kostallari A. e S. Mansaku 1988, *L'oeuvre du prof. Eqrem Çabej dans le domaine de la science et de la culture albanaises*, në *Studia albanica* XXV, 2: 13-25.
- Kukenheim L. 1962, *Esquisse historique de la linguistique française et de ses rapports avec la linguistique générale*, Leiden, Universitaire Pers.
- Malkiel Y. 1953, *Language History and Historical Linguistics*, në *Romance Philology* VII, 1: 65-76

- Mayer G. 1891, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg.
- Miklosich F. 1861, *Die slavischen Elemente in Rumunischen*, në *Denkschriften der Akademie der Wissenschaften*, 12, Wien
- Morpurgo Davis A. 1994, *La linguistica dell'ottocento*, në G.C. Lepschy (nën kujdesin e), *Storia della linguistica*, III v., Il Mulino, Bologna:11-399
- Osthoff H. e Brugman K. 1878, *Vorwort*, në *Morphologische Untersuchungen*, 1, iii-xx, Leipzig.
- Pallas P.S. 1786-89, *Linguarum totius orbis vocabularia comparativa. Augustissimae cura collecta*, 4 vv., Pietroburgo.
- Rask R. 1818, *Undersøgelse om det gamle Nordiske eller Islandske Sprogs Oprindelse*, in R. Rask 1932, *Ausgewählte Abhandlungen*, Levin og Munksgaard, Copenhagen.
- Rotsaert M.-L. 1979, *Étymologie et idéologie. Des reflets du nationalisme sur la lexicologie allemande, 1830-1914*, në *Historiographia Linguistica* VI-3: 309-338.
- Savoia L.M. 1981, *Appunti per la storia della linguistica tra '700 e '800*, në *Studi di Linguistica Italiana per Giovanni Nencioni*, Firenze: 351-420.
- Schuchardt H. 1874, *Phonétique comparée. I les modifications syntactiques de la consonne initiale dans les dialectes de la Sardaigne, du centre et du sud de l'Italie*, në *Romania* 3:1-30.
- Schuchardt H. 1885, *Ueber die Lautgesetze. Gegen die Junggrammatiker*, Berlin.
- Tagliavini C. 1965, *La stratificazione del lessico albanese*, Bologna, Pàtron.
- Tagliavini C. 1970³, *Panorama di storia della linguistica*, Bologna, Patron.
- Terracini B. 1949, *Guida allo studio della linguistica storica. I profilo storico-critico*, Roma, Edizioni dell'Ateneo.
- Timpanaro S. 1973, *Il contrasto tra i fratelli Schlegel e Franz Bopp sulla struttura e la genesi delle lingue indeuropee*, në *Critica storica*, 4: 553-590.
- Timpanaro S. 1979, *Giacomo Lignana e i rapporti tra filologia, filosofia, linguistica e darwinismo nell'Italia del secondo ottocento*, në *Critica storica*, XVI-3:406-503.
- Turgot A.R.J. 1756, *Étymologie*, në *Encyclopédie*, tomo VI.
- Xylander J. von 1835, *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*, Frankfurt am Main.

GJUHA NË SHOQËRITË E PËRZIERA: IDENTITETE DHE VARIACIONE GJUHËSORE¹

1. Diversiteti kulturor brenda shoqërisë sot shfaqet mjaft i dukshëm dhe kompleks. Mekanizmat identitarë, lidhjet mes roleve dhe llojet e ndërveprimit udhëhiqen nga komutacioni sistematik, situatat komunikuese e sistemet socio-kulturore, duke i dhënë rol fluiditetit, i cili karakterizon shoqërinë globale (Bauman 2005, 2005a). Në të vërtetë, nocioni i multikulturalizmit është diskutuar nga perspektiva të ndryshme për një ambiguitet esencial që ekziston midis shumës së kulturave të ndryshme të paintegruara dhe bashkekzistencës harmonike dhe aktive të kulturave. Përveç kësaj, termi i multi-kulturalizmit shpesh lidhet me atë të pluralizmit aq sa i konsiderojmë sinonime. Santori 2000 thekson se dallimi mes dy koncepteve në momentin që multikulturalizmi kuptohet si vlerë dhe jo si bashkekzistim i kulturave:

Nëse multikulturalizmi kuptohet si status real, si një gjendje, që thjesht regjistron ekzistencën e një shumësie kulturash [...], në këtë rast një multikulturalizëm nuk paraqet probleme për një konceptim pluralist të botës. Në këtë rast multikulturalizmi është vetëm një nga konfigurimet e mundshme historike të pluralizmit. Por, nëse multikulturalizmi deklarohet si vlerë, madje një vlerë parësore, atëherë gjërat ndërrojnë, pasi aty paraqitet një problem. Sepse në këtë rast pluralizmi dhe multikulturalizmi përplasen. (Santori, 2000:55)

¹ Studim i përbashkët: Benedetta Baldi e Leonardo M. Savoia (2006), *Perché bar-bari? Lingua, comunicazione e identità nella società globale*, Roma Bulzoni, ff. 67-94. Përkthyer shqip nga Majlinda Bregasi.

1. Shoqëria multikulturore, procesi migrues.

Takimi mes kulturave të ndryshme, raporti mes identitetit dhe tjetërsimit, shpesh shquhet nga ambivalenca; nëse është e vërtetë që çdo grup social e ndjen nevojën e afirmimit të identitetit të vetë, është e vërtetë se i njëjti grup ka vullnetin ta mohojë atë, në të njëjtën kohë, duke dëshiruar tjetërsimin, duke fshirë kufijtë e vetë me qëllim që më vonë t'i ripërcaktojë ata. Çështja e identitetit, qoftë ajo individuale ose kolektive, paraqitet si temë qendrore në debatin e sotëm për shumë motive; i pari prej këtyre është fakti se shoqëria bashkëkohore, para së gjithash, është një shoqëri “multikulturore”. Nevoja për të menduar hollësisht mbi identitetin individual përforcohet nga shqetësimi që rrjedh nga prishja e kundërvënieve ideologjike, nga perëndimi i pasionit politik dhe nga konfuzioni mes sferës publike dhe asaj private. Ndjenja e të përkulturit dhe e të vlerësuarit të përkatësisë individuale i përgjigjet një tregu të globalizuar dhe modeleve homologe që ato u imponojnë individëve që rezistojnë të heqin dorë nga përvojat e tyre të jetës, nga origjinaliteti, unikaliteti, identiteti. Në veçanti, një pikë e diskutuar në raportin e formësimit të një shoqërie multikulturore ka të bëjë me mundësinë që kompetenca e kulturave dhe gjuhëve të ndryshme duhet të jetë e rregulluar nga toleranca, për të mos e zhdukur diversitetin, sikurse është vënë në pah nga autorë të ndryshëm si për shembull në Zanfarino 1985:

përkufizimi i pluralizmit implikon dallime dhe ndarje, por nuk është braktisje pasive e heterogjenitetit dhe shmangie e prirjeve që kërkojnë bashkim. (Zanfarino 1985:175)

Më saktësisht, nocioni i pluralizmit vë në lojë idenë e shtetit të së drejtës dhe të të drejtave qytetare të nënkuptuara si karakteristika të shteteve perëndimore. Me këtë rast, Sartori 2000 ndërlihd mundësinë e një pluralizmi efektiv me një kulturë të shekullarizuar dhe me ekzistencën në brendi të shoqërisë të përkatësive shumëfishë që nënkupton, megjithatë, një parim të tolerancës:

[...] rrjedhja e “pluralizmit” nga “shumësi” [...] është vetëm shprehje e varfërisë dhe e mediokritetit intelektual. Për të kuptuar pluralizmin [...], do ta dalloj nga tri nivele të analizës, pra nga 1) pluralizmi si besim, 2) pluralizmi social dhe 3) pluralizmi politik. Në lidhje me sistemet e besimit mund të flitet për një kulturë pluraliste me të njëjtin kuptim sikurse flitet për një kulturë të shekullarizuar. [...] nëse një kulturë është e shekullarizuar, nuk mund të jetë moniste. Anasjelltas, nëse është pluraliste, duhet të jetë patjetër e shekullarizuar (besimet e shfaqura nuk tolerojnë kundër-besime) [...] varietetet dhe jo uniformitetet, të menduarit ndryshe dhe jo unanimitet, ndryshimi dhe jo palëvizshmëria, janë “gjëra të mira”, këto janë besimet e veshme që dalin nga toleranca, që përbëjnë kontekstin kulturor të pluralizmit dhe që duhet të shprehen nga një kulturë pluraliste që nuk abuzon me emrin që i jepet. [...] këto janë tiparet në bazë të të cilave duhet të vlerësojmë të ashtuquajturin “multi-kulturalizëm” në ditën tona. [...] niveli i dytë i analizës [...] pluralizmi social [të mos ngatërrohet] me çdo lloj diferencimi social. Meqënëse nuk ekzistojnë shoqëri të të barabartëve [...] të gjitha shoqëritë janë të dallueshme në mënyra të ndryshme. Nga kjo nuk rrjedh që të gjitha janë të dallueshme “pluralisht”. [...] niveli i tretë i analizës, pluralizmi politik, i ringre palët në parti. [...] pluralizmi [...] lind pjesërisht nga toleranca [...] dhe toleranca nuk e vë në dukje tjetrin dhe tjetërsimin, por i pranon. Gjë që do të thotë se pluralizmi e mbron, por edhe e frenon diversitetin. (Sartori, 2000: 28-56).

Në momentin kur një individ, i cili i përket një kulture çfarëdo, vihet në kontakt me një kulturë “tjetër” mund të vazhdojë të ruajë kulturën e tij ose mund të parapëlqejë tjetrën. Natyrisht që preferenca ndaj një kulture tjetër është e rrallë, por gjithmonë është e mundur, të paktën për botën perëndimore. Prirja drejt identifikimit me përkatësi të ndryshme kulturore – nga ajo e familjes, qytetit, kombit... - për botën perëndimore paraqet një mundësi ndryshe, edhe pse të largët, nga ajo që ndodh jashtë kufijve të Perëndimit. Si një lloj autokritike mbi kulturën e vetë, theksohet, si kundërpeshë, një kulturë ‘tjetër’ së cilës i argumentohet superioriteti. Nga ana tjetër, autokritika dhe auto-

ekzaltimi janë dy faqe të të njëjtës medalje dhe shërbejnë për të paguar heshtjen e një të vërtete jo të këndshme që i përket universalitetit të konfliktit që strukturon përkatësitë tona kolektive dhe identitetet tona individuale. Nga ky këndvështrim janë të nevojshme konsiderimet e Sartorit 2000, përse i përket kontrastit ndërmjet një shoqërie pluraliste tolerante dhe një shoqërie multikulturore të bazuar mbi fragmentarizmin:

[...] pluralizmi nuk rihforcon, përkundrazi i fashit identitetet me të cilat ndeshet, ndërsa multikulturalizmi krijon 'identitete të rihforcuara', të rihforcuara pikërisht nga të përkiturit dhe të mbivendosurit – për shembull të gjuhës, besimit, etnisë dhe ideologjisë. [...] pluralizmi shpjegohet gjerësisht si një shoqëri e përbërë e hapur ndaj përkatësive të shumëllojshme, ndërsa multikulturalizmi paraqet fragmentarizmin e komunitetit pluralist në bashkësi të komuniteteve të mbyllura dhe homogjene. [...] multikulturalizmi paraqitet si një thyerje historike me konsekuenca shumë më të rënda sesa ajo që duket sikur paralajmërojnë çirakët e shtriganëve. (Sartori 2000, 110:111)

Çështja në fakt është komplikuar nga shumë elementë praktikë dhe ideorë. Pizzorusso 1993 vë në pah kontrastin ndërmjet të drejtave themelore të lirisë dhe barazisë, që kanë karakter universal, dhe të drejtave kolektive të grupeve minoritare, që megjithatë nënkuptojnë të parat. Lanzillo 2005 thekson faktin se demokracitë liberale tentojnë t'iu përgjigjen kushteve të shoqërive multikulturore nëpërmjet mbrojtjes së kulturave minoritare si mjet njohjeje të të drejtave kolektive. Ky drejtim synon pra të tejkalojë 'ideologjinë universalizuese' të barazisë dhe vetemancipuese të modernitetit [...] të paaftë për t'iu përgjigjur sfidave që vijnë [...] nga ridalja në pah e fundamentalizmit' (Lanzillo 2005:8). Multikulturalizmi do të përfaqësojë pra 'rizbulimin' e kulturave të veçanta dhe të komuniteteve minoritare brenda një themeli të bazuar mbi parimet e shtetit - komb, të identitetit kulturor dhe religjionit. Veçanërisht sjelljet e grupeve minoritare apo të kulturave a gjuhëve të ndryshme brenda një shoqërie multikulturore

propozojnë sërish aspekte të procesit të formimit të shtetit komb dhe të gjuhëve kombëtare të nënkuptuara si faktorë identiteti të individëve (Hobsbawm 1991).

Ideja e Sartorit 2000 është që pluralizmi nuk njihet si me prejardhje nga multikulturalizmi, por ndoshta nga 'interkulturalizmi' (fq.112). Shoqëritë moderne kanë paraqitur një tip të fragmentarizmit që lidhet me ndarjen në klasa apo në grupe: klasa dhe gjinia ishin mjedisi brenda të cilit realizoheshin zgjedhjet e personave, të cilëve u ishte kërkuar të zinin pozicionin dhe një rolin që u ishte caktuar. Në manifestin e Partisë Komuniste Marx-i dhe Engels-i nxitnin të shkri- nin trupat solidë të strukturave të rendit kapitalist; revolucioni proletar në fakt mund të kontribuonte në një mënyrë më vendimtare në ndër- timin e një shoqërie të transformuar. Sot, në bazë të analizës së propo- zuar nga Bauman 2005, po përballemi me një rend të ri social ' të lëngshëm', pa spiranca, pa pika fikse, brenda të cilave vlerat, insti- tucionet dhe sjelljet janë janë të rrjedhshme. Pa rendin e diktuar nga klasat, çdo individ është vetë përgjegjës, përta i përket ndërtimit të jetës së tij politike, të ndjenjës së vetë të përkatësisë, të identitetit të vetë ose, të paktën, të identitetit mbizotërues. Grupet në brendi të sho- qërisë aktuale tentojnë të formohen mbi bazën e përkatësisë së rastit që lidhet me ngjarje ose aktivitete individuale, të cilat Bauman 2005 i etiketon si komunitete estetike.

Për aq sa vihen në diskutim rrjetet dhe vlerat tradicionale brenda shoqërive të përbëra e të diferencuara përta i përket profilit kulturor, etnik e social, identitetet vazhdojnë të thellojnë rrënjët e tyre mbi vlera të tilla edhe pse në rërërat e lëvizshme të një tradite të minuar. Në fakt lidhjet mes individëve janë të ndjeshme ndaj faktorëve të mbrojtur tradicionalisht nga shteti komb, si siguria, respekti për kulturat dhe gjuhët e pranuar, etj. Brenda shoqërive të përbëra, si këto aktualet, grupet e ndryshme tentojnë të gjejnë një ekuilibër që mund të ndërrojë në raport me mundësinë për t'u integruar në trupin social. Fragm-

entarizmi i shoqërisë në identitete të ndara grupore është i shoqëruar me vështirësi në integrim:

[...] sa më shumë që emigrantët ndiejnë që tradita e tyre kulturore e origjinës respektohet në vendin e ri të rezidencës e sa më pak e vërejnë që janë të mbajtur peng, të refuzuar, të kërcënuar a diskriminuar për shkak të identitetit të tyre të ndryshëm, aq më e pritshme do të jetë hapja e tyre ndaj ofertave kulturore në vendin e ri dhe aq më pak do të mbeten të kapur fort pas mënyrës së tyre të jetesës. [...] pasiguria (mes popullsisë së imigruar aq sa asaj indigjene) tenton të transformojë multi-kulturalizmin në 'multikomunitarizëm'. [...] siguria është kushti i nevojshëm për dialogun mes kulturave. (Bauman 2005:136-138)

Karakterit multikulturor dhe i përbërë i shoqërive moderne përkon, në një anë, me kompleksitetin dhe artikulumin e mekanizmave socio-ekonomike e komunikuese, të cilat organizojnë raportet sociale, nga ana tjetër me rezultatin e dukurive migruese. Dukuria e migrimit paraqet pasojën e rritjes demografike që nuk përkon me kapacitetin e popullsisë në një vend ose me burimet që ai ofron. Duhet dalluar dukuritë e masave – zakonisht të përcaktuara – nga ato që u përkasin një numri të caktuar njerëzish dhe përfaqësojnë një dukuri infiltrimi që nuk tjetërson strukturën identitare të vendit të destinimit. Spostimi dhe vendosja e grupeve të ndryshme njerëzore në mjedise të largëta nga ato të origjinës kanë përcaktuar formimin e shoqërive dhe kulturave më komplekse. Për më shumë, migrimet kanë shoqëruar që përherë jetën e njerëzve, që nga grupet njerëzore primitive deri te spostimet e ditëve të sotme, si rezultat i vullnetit për të pushtuar apo për të kërkuar kushte të tjera për jetë. Në këtë kuptim, dukuria migrim, për aq sa është një nga proceset më të dukshme që karakterizojnë shoqëritë bashkëkohore, nuk mund të konsiderohet një faktor tipik i globalizimit, edhe pse me tezën e tij, Giddens 1994, lidh ngushtë globalizimin me modernitetin.

Në Itali dukuria e emigrimit masiv filloi rreth vitit 1860 dhe gjatë njëzet vjeçarit 1890-1910 paraqiti një tërheqje të fortë për krahun

e punës pa mundësi punësimi në vendet e origjinës; është ky njëzet-vjeçar që arrin pikët maksimale. Franca, Austria dhe Gjermania, pataj Zvicra ishin vendet më të kërkuara në Europë në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë, edhe pse destinacionet më të parapëlqyera mbeten gjithmonë Shtetet e Bashkuara, Brazili dhe Argjentina. Lëvizja e migrimit vazhdoi deri në fillim të Luftës së Parë Botërore, për t'u rimarrë, me ritëm më të ngadalshëm, pas LIIB, e cila mundësoi lindjen e dukurisë së shkëmbimit social e kulturor që u reflektua si në shoqëritë vendase, ashtu edhe në ato origjinës. Shkaqet kryesore që e ngadalësuan dukurinë e migrimit i takojnë, nga njëra anë, gjendjes së luftës dhe, nga ana tjetër, faktit se Shtetet e Bashkuara, të cilat me vite kishin qenë destinacioni kryesor i migrimit, promovuan, për arsye të ekonomisë së brendshme, një politikë armiqësore ndaj imigrimit. Pas përfundimit të konfliktit të dytë botëror, çekuilibri i fortë i brendshëm mes popullsisë dhe kapacitetit prodhues (i përcaktuar nga kriza ekonomike, nga prania e madhe e refugjatëve dhe e vështirësuar edhe më tepër nga hendeku mes rajoneve) solli flukse të reja migrimi që vazhduan me intensitet herë më të ulët e herë më të lartë deri në fillim të viteve të gjashtëdhjeta. Në fakt, përkitazi me krizën e Suezit, që solli si pasojë rënien ekonomike të vendeve të industrializuara, pritëse të emigranëve, dukuria e migrimit pësoi një ndërprerje të fortë. Pezullimi i emigracionit përkoi për më tepër me rritjen e riatdhësimeve.

Vitet	Emigrante	Burra	Gra	Të riadhesuar	Shuma +o-
1861-1870	1.210.000	1.008.000	202.000	E panjohur	- 1.210.000
1871-1875	585.000	525.000	60.000	E panjohur	- 585.000
1876-1880	544.000	464.000	80.000	E panjohur	- 544.000
1881-1885	771.000	654.000	117.000	E panjohur	- 771.000
1886-1890	1.110.000	871.000	239.000	E panjohur	- 1.110.000
1891-1895	1.283.000	989.000	294.000	E panjohur	- 1.283.000
1896-1900	1.552.000	1.240.000	312.000	E panjohur	- 1.552.000
1901-1905	2.770.000	2.287.000	473.000	544.000	- 2.226.000
1906-1910	3.256.000	2.658.000	598.000	1.000.000	- 2.256.000
1911-1915	2.743.000	2.198.000	545.000	976.000	- 1.766.000
1916-1920	1.085.000	718.000	367.000	233.000	- 852.000
1921-1925	1.516.000	1.076.000	440.000	137.000	- 1.379.000
1926-1930	1.061.000	776.000	285.000	685.000	- 376.000
1931-1935	458.000	278.000	180.000	535.000	+ 77.000
1936-1940	421.000	314.000	107.000	535.000	+ 114.000
1941-1945	250.000	242.000	8.000	230.000	- 20.000
1946-1950	1.128.000	713.000	415.000	455.000	- 673.000
1951-1955	1.366.000	927.000	439.000	660.000	- 706.000
1956-1960	1.739.000	1.275.000	464.000	917.000	- 822.000
1961-1965	1.556.000	1.221.000	335.000	1.043.000	- 513.000
1965-1970	1.078.000	747.000	329.000	820.000	- 258.000
1971-1975	637.000	439.000	198.000	600.000	- 37.000
1976-1980	502.000	346.000	155.000	490.000	- 12.000
1981-1985	415.000	287.000	128.000	415.000	00
SHUMA	29.036.000	22.253.000	6.780.000	10.275.000	18.761.000

Analizat vënë në pah një grup faktorësh që ndikojnë te shoqëritë pritëse sikurse edhe te ato të origjinës. Një nga tiparet karakteristike është përbërja anagrafike që tregon një superioritet të dallueshëm të meshkujve të ardhur në moshë për punë nga zonat e mesdheut, të paktën në dhjetëvjeçarët e parë të analizuar. Kjo tregon faktin se në komunitetin e origjinës familjet ndahen, ridimensionohen raportet sociale dhe pakësohet forca e punës dhe kompetencat profesionale. Kjo dukuri rikompensohet nga të hyrat në para dhe me riadhesimet në moshë të shtyrë. Edhe analfabetizmi që përfshinte thuajse shumicën e emigrantëve në veçanti në periudhën e parë karakterizonte në aspektin

social e kulturor këto masa punëtorësh dhe kufizonte integrimin e tyre dhe hyrjen në shërbimet e shoqërisë pritëse.

Këto vështirësi për integrim u shfaqën në sjelljet e tipit racist të pranishme gjerësisht në literaturën e viteve të para të shekullit XIX, sikurse këto të sjella nga Gumina, 1973:

Përqindja e të huajëve me një moshë mendore më të ulët se ajo e një njëmbëdhjetë vjeçari është 45,6%. [...] Imigrim nga Europa lindore dhe mesdhetare është ai më pak i dëshiruari nga pjesët e tjera të kontinentit. [...] Nuk mund t'u kundërvihemi seriozisht imigrantëve nga Britania e Madhe, Holanda, Kanadaja, Gjermania, Danimarka e Skandinavia, ku përqindja e grupeve me kualitet e kalon 4% dhe arrin pikun me 19% e Anglisë. Ndërkohë që të ardhurit nga Italia, ku 63,4 % të imigrantëve klasifikohen në shkalën më të ulët. [...] Derisa kjo ardhje e padëshirueshme të vazhdojë në vendin tonë shpresa për të rritur standardin e silësisë së jetës për qytetarët tanë do të jetë gjithmonë e më e vogël. Nuk ka rëndësi se sa të mira janë shkollat tona, kur grupet më të ulëta nuk mund të alfabetizohen. Nuk kemi vend në këtë shtet për 'njeriun me shat', të pistë nga toka që punon dhe të udhëhequr nga një mendje pakës më superiore sesa ajo e një bualli, të cilin e ka vëlla. (Sweeny 1992 në La Gumina 1973:137)

Italianët gjenden në nivelin më të ulët në sindikata, përse u përket aftësisë së tyre për të folur anglisht, përshtatjes me ambientin edhe pas dhjetë vjetë rezidence, për numrin e fëmijëve që ndjekin shkollat dhe janë në vend të parë për minorenët që punojnë. (Ross 1914 në La Gumina 1973:137).

[...] një burrë [italian] mund të jetë shumë imoral dhe shumë besimtar në të njëjtën kohë. Fjala besim nun nënupton tjetër gjë përveç ceremonive dhe ritualeve. [...] Shkurt, besimi është për ta pjesërisht zakon e pjesërisht një ligj të cilit i nënshtrohen me çdo kusht. (Pecorino 1903 në La Gumina 1973: 175, 176)

Gjendja aktuale e italo-amerikanëve lidhet me zhvillimin e procesit të globalizimit në kuptimin që italo-amerikanët janë integruar në brumin e shoqërisë dhe ekonomisë duke zënë pozita të reja brenda një ekonomie moderne. Kjo sjell, domosdoshmërisht, braktisjen e aspekteve më të theksuara të kulturës së tyre tradicionale edhe pse mbeten ca stereotipe që propozohen sërish, përse u tha për shoqëritë e përbëra bashkëkohore në të cilat etniciteti dhe vlerat tradicionale bashkëjetojnë me formësimin e një shoqërie të re globale.

Në fillim të mijëvjeçarit të ri, cili është pra statusi i italo-amerikanëve në USA dhe cilat janë perspektivat e etnicitetit italo-amerikan? Sociologu Richard Alba krijoi shprehjen ‘vagëllim i etnicitetit’ për të përshkruar kushtet e asimilimit në të cilat ata ndodhen tashmë, duke nënkuptuar që për ta toka e origjinës nuk ka më një kuptim autentik në jetën e amerikanëve me origjinë italiane. [...] një shekull pasi emigrantët filluan të vinin në ishullin Ellis, shumë prej pasardhësve të tyre mbetën një grup etnik i dallueshëm dhe i vetëdijshëm, të përfshirë më shumë se kurrë në kulturën dhe në politikën e USA-s. Për mendimin tim, ajo që ka ndodhur është një tranzicion nga një formë primitive e etnicitetit – e bazuar në lidhjet e farefnisës dhe bashkëvendasve, që mishëronte një kulturë katundi - te një formë moderne, të institucionalizuar, transnacionale dhe plotësisht e shfrytëzueshme për integrimin në shoqërinë amerikane dhe që përfaqëson të gjitha shtresat socio-ekonomike të popullsisë italo-amerikane. [...] Sikurse ka vënë në dukje kohët e fundit Maddalena Tirabassi, jemi përpara një enigme: dallimi mes kushteve reale dhe statusit të italo-amerikanëve dhe imazhit të tyre kolektiv të dhënë nga mediat dhe të rrënjësuar në imagjinatën e bashkëkombësve të tyre amerikanë. (Vecoli 2005: 141, 142)

Migrimet e tanishme i përgjigjen një zhvillimi të ndryshëm mes vendeve të nisjes dhe atyre të destinimit, edhe pse mbipopullimi vetëm nuk përbën faktor determinant për dukuritë e migrimit, nga njëra anë; ato rezultojnë interesante, nga njëra anë, nga shtytja përse i

përket vendit të nisjes dhe, nga ana tjetër, kapacitetit atraktiv të vendit të destinuar. Faktorit shtytës mund t'i atribuohen motive që u përkasin fatkeqësive natyrore, problemeve sociale, konflikteve etnike, religjioze ose politike. Ndërkohë që faktori atraktiv ka të bëjë me atë që ofron zgjidhje më të mirë për këto probleme. Zgjedhja do të varet, pra, nga vendi i cili është në gjendje të ofrojë mikpritjen më të favorshme dhe më stabile: në këtë perspektivë, një nga elementet vendimtare përfaqësohet nga lidhjet familjare ose miqësore prezente në ato vende që shërbejnë si një lloj grepi për një lidhje më të mirë.

Në fund të mileniumit të dytë, rreth 120 milion njerëz jetonin në vende të ndryshme nga ato të origjinës ose si refugjatë ose si emigrantë për motive pune apo të tjera. Flitet për 2% të popullsisë botërore. (Macioti, Pugliese 2003:3)

Numrat, në këtë rast, meqënëse përfaqësojnë një informacion të çmuar, nuk e llogarisin nivelin social të një dukurie që nuk u takon vetëm aktorëve të migrimit, por i përfshin gjithë ata njerëz që do të jenë në kontakt me ta, gjithë kontekstin social që do të modifikohet. Sikurse vë në dukje Sartori (2000), prania e një migrimi të fortë alternon identitetin e njerëzve që vihen në kontakt me migruesit.

Në Shtetet e Bashkuara identitetet që mbijetojnë janë ato që mban brenda kjo tenxhere me presion – klithen – të mbytur. Në Europë, nëse identitetet e mysafirëve mbeten të paprekura, atëherë identitetet që do të shpëtojnë mbeten, ose do të mbeten, ajo të mikpritësve. (Sartori 2000:113)

Në realitet, dukuria ka një ngjyrim reciprok për të dyja shoqëritë, pasi që lëvizjet përcaktojnë ndryshime edhe mbi shoqërinë e nisjes, e cila hyn, megjithatë, në kontakt me indentitete të ndryshme. Ky mekanizëm përforcohet nga dukuritë e kthimit, të cilat ndodhin si shkak i qëndrimit të kufizuar në kohë për disa migrues, duke u shfaqur veçanërisht në dukuritë e kontaminimit gjuhësor. Për shembull, emigrimi italian në Amerikë ka sjellë edhe shpërndarjen e italianizmave

në vendet pritëse, edhe përhapjen e huazimeve nga anglishtja apo spanjishtja në rajonet italiane më të prekura nga lëvizjet migruese (Menarini 1939, Pellegrini 1944-45, De Muro 1976).

Në dhjetëvjeçarët e fundit, alternimi i flukseve migruese, të kompensuara pak a shumë me kthimet e emigrantëve, ka përcaktuar lindjen e kolektivitetëve të reja në vende të ndryshme të destinimit dhe rritjen ekonomike si të vendeve të pritjes, ashtu edhe të atyre të nisjes. Në fakt fuqia punëtore që shfrytëzohet në vendet e huaja ka kontribuar, pa dyshim, në zhvillimin ekonomik të vendit pritës, por edhe të atij të origjinës, qoftë nëpërmjet dërgimit të parave, ashtu edhe përsa i përket kthimit të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të specializuar. Është gjithashtu e vërtetë se, me gjithë përparësinë që ka fakti i lehtësimit të rritjes së fuqisë punëtore në vendet e origjinës dhe mundësisë së investimit të të ardhurave të emigrantëve nga jashtë, emigrimi i punëtorëve të kualifikuar paraqet një humbje të pakompensuar ‘të kapitalit human’ (Macioti, Pugliese 2003:21). Nga ana tjetër një humbje të madhe paraqet fakti i papunësisë së njerëzve të kualifikuar në vendin e tyre. Megjithatë kjo situatë nuk i përket dhe nuk mund t’i përkasë shumicës së njerëzve të përfshirë në këtë dukuri në momentin që, sot më shumë se më parë,

[...] është e pamundur që e gjithë popullata aktive e një ekonomie të jetë shumë mirë e kualifikuar dhe rritja e një ekonomie që vepron në një sistem global të hapur nuk do të mund të mbijetonte kurrë duke u bazuar ekskluzivisht mbi punëtorët e mbikualifikuar [...] një ushtri e përbërë nga oficerë nuk mund të luftojë. Përkundrazi, sa më shumë që kualifikohet forca e punës e vendeve të industrializuara, aq më shumë rritet nevoja për punëtorë të përgjithshëm; në një ekonomi të hapur, shumë prej tyre do të vijnë në mënyrë ligjore ose jo nga vende në zhvillim e sipër. (Harris 2001:42-43)

Përparësitë ekonomike për më tepër, shërbjenë si kundërpeshë e problemeve si integrimi me popullatat dhe me ligjet lokale me të cilat emigrantët do të duhet të ndeshen: që nga shtëpia, deri te ndihma shën-

detësore dhe shoqërore, nga shkollimi deri te të drejtat politike dhe ajo e votës, kompetenca gjuhësore etj. Në veçanti, prania e të huajve në vendet e tjera me kohë ka njohur ndryshime përsa i përket përbërjes së moshës dhe gjinisë. Në fakt, superioriteti tradicional i burrave është zvogëluar shumë në tridhjetë vitet e fundit, për shkak të pranisë gjithnjë e më të madhe të grave në punë dhe i bashkimit fam-iljar që prekin edhe të moshuarit e fëmijët.

Duke u nisur nga vitet '60, zuri fill një dukuri, fillimisht margjinale, që u përkiste spostimeve të mëdha nga vendet e prapambetura ose të pazhvilluara me rritje të lartë demografike drejt vendeve të industrializuara me rritje demografike të ulët. Në këto vende, përveçse USA, Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania (pjesa e ish-Republikës federale) bën pjesë edhe Italia, që, për më tepër, për shumë aspekte përbën një rast të vërtetë duke marrë parasysh që ka qenë tradicionalisht një vend emigrantësh. Lëvizja e parë imigruese e rëndësishme u regjistrua në Itali në vitin 1968 nga ana e tunizianëve që mbërritën në Sicili për të mbushur zbrazëtinë që ndodhi nga eksodi rural pas tërmetit në Valle del Belice.

Në histori kemi parë dukuri masive të migrimin – mes të tjerave, emigrimi ndëroqeanik i europianëve drejt Amerikës mes shek. XIX dhe XX dhe ai ndëroqeanik në vitet '60 e '70 – por sot, për dallim nga e kaluara, shihen lëvizje migruese globale, që karakterizohen nga spostimet e përkohshme dhe në drejtimet nga më të ndryshmet të popujve anemabanë botës. Shumë migrime u përkasin edhe refugjatëve dhe, në këtë rast, duke qenë se dukuria ndodh si shkak i motiveve politike përveç atyre ekonomike, nuk është e mundur që të bëhen parashikime.

[...] ka një globalizim të migrimeve ndërkombëtare, që shprehet nëpërmjet rritjes progresive të numrit të vendeve që u takojnë [...] sot flukset migruese përbëhen mbi të gjitha nga burra dhe gra që vijnë nga Bota e Tretë [...] përsa u përket vendeve pritëse në Europë, risia e madhe – një risi tashmë e konsoliduar që tridhjetë vjetë – përfaqësohet nga prania e

Greqisë, Italisë, Portugalisë, Spanjës [...] si vende të fluksit migrues. Në të shkuarën ato kanë qenë vende emigrantësh [...] Pastaj ka – sipas Castles e Miller – një përshpejtim të migrimeve, pra një tendencë në rritje të lëvizjeve ndërkombëtare, që për më tepër lidhet edhe [...] me rritjen e pikëtakimeve të refugjatëve [...] Italia është sërish një rast sinjifikativ dhe përfaqësues i kësaj tendence [...] një aspekt i tretë i theksuar nga Castles e Miller [...] është një diferencim i migrimeve, vlen të thuhet një përbërje gjithnjë e më shumë komplekse e flukseve nga këndvështrimi demografik e social, nga këndvështrimi i motiveve dhe [...] tendenca e katërt është ajo që dy autorët e përkufizojnë si feminizimin e migrimeve, që ka të bëjë me rritjen e përbërësit grua në këto migrime [...] aspekti i fundit që theksohet nga Casler e Miller është ai që ata e përkufizojnë si politizimin e migrimeve, vlen të theksohet fakti që flukset migruese tentojnë të regullohen progresivisht edhe nga politikat e migrimit të vendeve të pritjes. (Macioti, Pugliese 2003:4-5)

Ekzistojnë migrime të vullnetshme dhe të sforcuara, permanente dhe të përkohshme, ligjore dhe joligjore, të brendshme dhe ndërkombëtare që nuk mund të klasifikohen në kategori të përkufizuara për aq sa mjaft shpesh nuk parashikohen as nga vetë aktorët e migrimit. Në fakt, nuk është gjithnjë e mundshme të vendosësh paraprakisht nëse migrimet do të jenë definitive apo të përkohshme dhe, në rastin e këtyre të fundit, për sa kohë do të zgjasin. Edhe përsa u përket migrimeve të brendshme a të jashtme është e nevojshme të përcaktohen parametra referues për aq sa, për shembull, migrimi nga Italia drejt Francës do të përkohë me një migrim të brendshëm apo ndërkombëtar, në bazë të kornizës referuese që lidhet me shtetin apo me Bashkimit European, etj. Migrimet kryesore kanë, sot, si destinim Amerikën e Veriut, me flukse që vijnë nga vendet më të ndryshme të botës, dhe Europa, me flukse që vijnë kryesisht nga jugu i Mesdheut dhe nga Europa e Lindjes (dukuri që ndodhi pas rënies së murit të Berlinit në 1989).

Migrimet përcaktojnë takime mes kulturave dhe komuniteteve të ndryshme. Kjo reflektohet te bashkëjetesa e gjuhëve të ndryshme brenda shoqërisë dhe te dukuritë e përzierjes gjuhësore që lindin nga kjo. Krijohen pra skenare tipike të studiuara nga sociolinguistët që lidhen me shoqëritë dy/shumëgjuhëshe, në të cilat gjuhë të ndryshme kanë një status funksional dhe socio-stilistik të ndryshëm. Varietetet e ndryshme gjuhësore që lidhen me kontekste sociale që i drejtojnë formojnë atë që sociolinguistët e quajnë repertor linguistik të një komuniteti. (Berruto 1987, 1995).

Prania e migriimeve të reja gjuhësore dhe nevojat e komunikimit në një shoqëri thellësisht të internacionalizuar paralajmërojnë nevojën e mbrojtjes (pardonimit) së më shumë gjuhëve edhe si përgjigje ndaj kompleksitetit kulturor, edhe si instrument komunikimi me botën. Sikurse mund të paramendohet me lehtësi, është e vështirë për imigrantët që të ballafaqohen me mbrojtjen e një gjuhe të huaj për ta, në atë masë sa do t'i bëjë të ndihen mirë duke e përdorur sikurse të vetën, që do t'i lejojë ata të mendojnë, ëndërrojnë, komunikojnë ndjenjat në një gjuhë tjetër. Mbrojtja e gjuhës ndihet pra si një instrument thelbësor në procesin e integritit të individëve brenda një komuniteti. Natyrisht edhe përdorimi i një gjuhe është objekt i të njëjtit lloj ndërtimi që përcakton formimin e identitetit dhe të njohjes së për-katësisë etnike.

[...] A është e drejtë që imigrantët duhet të kalojnë provimin e ndërgjegjes gjuhësore [...]? [...] *Për fat të keq mjaft shpesh ideja që duhet të kalohet një provë, të mësuarit e një gjuhe, para se të konsiderohesh qytetar i një shteti perceptohet si një padrejtësi, sepse duket sikur duhet të zhvishet një njeri nga gjuha dhe kultura e vetë. Mospranimi i një gjuhe tjetër në universin e vetë gjuhësor dhe kulturor, dhe mohimi i mundësisë që kjo gjuhë ia jep për të transformuar të vetën, konsiderohet si provinciale, e limituar, ngurtësi.* (Homi K. Bhabha, *Il Corriere della Sera*, 27/05/'05 p. 14)

Kjo ndjenjë e shqetësimit, që rritet nga ndjesia që shumë fjalë fshehin kuptime të ndryshme dhe shprehin vlera të ndryshme, përcakton një ndjesi përjashtuese, ose, edhe më keq, izoluese.

2. Identiteti gjuhësor si pasojë e raporteve sociale.

Marrëdhëniet mes individëve përbrenda shoqërisë varen nga pozicioni reciprok i atyre që ndërveprojnë dhe riprodhojnë norma, rregulla dhe vlera që lidhen me aspekte të ndryshme të të jetuarit në një bashkësi, zakoneve, besimeve etj. Norma të tilla janë pranuar te anëtarët e grupeve dhe bashkëveprojnë për të formuar atë që quhet identitet dhe të paktën disa aspekte të personalitetit. Identiteti i individëve përbëhet pra nga një tërësi karakteristikash që fiksojnë përkatësinë e tyre te një grup social. Kjo tërësi përfshin si karakteristikat e pandryshueshme, si moshë, gjinia, etnia, gjuha, ashtu edhe ato të përfutuara, si niveli i shkollimit, besimi, bindjet morale, idetë politike etj. E rëndësishme është që kjo tërësi karakteristikash ndryshon në bazë të kushteve materiale të jetës apo psikologjisë dhe eksperiencës së individëve. Paraqet një proces të ndërtimit që Tabouret-Keller 1998 e karakterizon në këtë mënyrë:

Në çdo moment të dhënë identiteti i një personi është një heterogjen i formuar nga të gjithë emrat ose identitetet, të dhëna e të pranuar. Por gjatë jetës identiteti ndërtohet vazhdimisht në bazë të kushteve të ndryshme sociale (historike, institucionale, ekonomike etj), ndërveprimeve sociale, takimeve dhe dëshirave që mund të jenë vërtetë subjektive dhe unike. (Tabouret-Keller 1998: 316)

Proceset e identifikimit përfshijnë si përbërësit gjuhësorë, ashtu edhe mjetet simbolike verbale që luajnë rol jo dytësor në këto procese si faktorë pragmatikë të rëndësishëm për interpretimin. Këta faktorë parajjuhësorë janë objekte të dukurive të homogjenizimit në mënyrë analoge me atë që u takon gjuhëve. Roli i gjuhës në fiksimin e identitetit të individëve është esencial pasi ‘shpreh’ dhe ‘ofron mjetin’

që krijon lidhjen mes identiteteve individuale e sociale (Tabouret-Keller 1998). Përvetësimi i gjuhës së parë (L1) përbën në fakt bërthamën e procesit të përfshirjes në grupin social dhe bazohet në zhvillimin e një vetëdijeje gjuhësore të paktën sipërfaqësisht identike me atë të adultëve që ofrojnë thëniet me të cilat fëmija krijon gramatikën e vetë mentale dhe atë që Hymes 1974 e quan kompetencë komunikuese, pra tërësinë e aspekteve paragjuhësore e komunikative që i përgatisin terrenin komunikimit gjuhësor.

Gjuha e veçantë mund të evokojë gjithashtu edhe një organizim social të veçantë, juridik a ekonomik me të cilin lidhen folësit. Është e njohur që përkatësia e pranuar përgjithësisht mes entiteteve shtetërore dhe gjuhës është një konstrukt që lidhet me krijimin e shtetit nacional (Hobsbawm 1996, Anderson 2000) që shpreh formimin e asaj ‘bashkësie imagjinare’ që ndodhet në bazë të ideologjisë nacionale e etnike (Anderson 2000). Pontiggia 2000 e sintetizon kështu kuptimin socio-kulturor të gjuhës:

Mbrojtja e gjuhës nga pushtimet barbare ushqehet, nga fillimi i shekullit XX, nga pikëtakimi i dy idealeve, ai klasik e ai ai nacional, të bashkuar në një martesë, një dëshmi e tmerrshme e së cilës është himni i Mameli-t (Pontiggia 2000:218)

Gjuha përveç se është vetvetja, për aq sa përdoret, një shenjë identiteti për grupin social, furnizon edhe dallimet (leksikore, morfo-sintaksore e fonologjike) që shërbejnë për të fiksuar identifikimet e ndryshme, si në rastet e fundit në formimin e nacioneve të reja për të cilat njohja e një gjuhe autonome ka përfaqësuar një legjitimitet të fortë. Në këtë kornizë, Gumperz 2000 flet për ‘besnikërinë gjuhësore’ përballë një varieteti që ndihet si simbol i një grupi të veçantë apo të një ‘lëvizjeje të veçantë sociale’. Besnikëria gjuhësore përfaqëson një lidhje të shkëlqyer për ‘klasat sociale dhe grupet e ndryshme lokale, anëtarët e të cilëve mund të vazhdojnë të përdorin vernakularët e tyre në mjediset familjare dhe ‘mund’ të kthehet në një problem politik në një shoqëri në rrugën e modernizimit kur minoritetet e izoluar sociale

mobilizohen'. Mjaft shpesh pas kërkesave për reforma gjuhësore me qëllim për nevojat komunikuese, lindin kundërvënie socioekonomike mes minorancave të ndryshme.

Hindi e urdu, gjuhët standarde që konkurojnë njëra-tjetrën në Indinë e Veriut, apo serbishtja e kroatishtja në Jugosllavi, janë thuar identike nga këndvështrimi gramatikor. Ato dallojnë vetëm në sistemin e shkrimit, në leksik dhe në aspekte minore të sintaksës. Megjithatë mbështetësit e tyre i konsiderojnë gjuhë të ndryshme. (Gumperz 2000:180)

Në realitet na duket e nevojshme t'i rishqyrtojmë disa kategori, duke u ndalur te nocioni i identitetit e te lidhja mes identitetit e etnisë, që përbën një qështje kyçe në sociologjinë e globalizimit. Huntington 2005 i sintetizon kështu mekanizmat e ndryshme që e përcaktojnë identitetin:

Pika e parë: si individët ashtu edhe grupet kanë identitete. Individët, megjithatë, i gjejnë e i ridefinojnë identitetet e tyre në grupe. [...] pika e dytë: identitetet janë të ndërtuara. Personat e ndërtojnë identitetin e tyre nën presione e lajka të ndryshme, por edhe me një lloj shkalle të lirisë [...] Pika e tretë: individët dhe, në masë më të vogël, grupet kanë disa identitete. Mund të jenë territoriale, ekonomike, kulturore, politike, sociale e nacionale. Vlera që individit ose grupi u jep këtyre identiteteve mund të ndryshojë nga momenti në moment apo nga një situatë në tjetrën, kështu sikurse mund të modifikohet shkalla e integritimit apo e konfliktit mes këtyre identiteteve. [...] pika e katërt: identitetet nuk përcaktohen vetë, por janë prodhim i ndërveprimit mes vetvetes dhe të tjerëve. Mënyra në të cilën të tjerët perceptojnë individin ose një grup tregues të autopërcaktimit të atij individit a të atij grupi. [...] Pika e pestë: vlera relative e identiteteve të mundshme është situacionale për çdo individ ose grup. Në disa rrethana, njerëzit theksojnë aspektin e identitetit të vetë që i afrojnë me ata me të cilët ndërveprojnë. [...] (Huntington 2005:36-39).

Epoka jonë shquhet nga dialektika mbi identitetin. Zhvillimi ekonomik dhe globalizimi i kanë drejtuar njerëzit drejt reflektimit mbi identitetet e tyre në aspektin intim e të përbashkët me të tjerët. Identiteti nacional bije një hap nga një perspektivë më e qëndryeshme rajonale brenda së cilës njerëzit duket se kanë të përbashkëta të njëjtat tradita e perspektiva. Në të njëjtën kohë, të njëjtët individë të mbyllur në një identitet gjithnjë e më lokal, hapen, edhe falë teknologjive të reja informative të komunikimit, ndaj banorëve të vendeve të largëta me të cilët ndjejnë se kanë të përbashkët gjuhën, kulturën, besimin. Dikotomia mes identiteteve nënacionale dhe identiteteve mbinacionale shprehet, për shembull, në faktin se katalanët po ndihen gjithnjë e më shumë katalanë se spanjollë ndërkohë që mund të luftojnë për një identitet europian në vend të atij spanjoll.

Procesi i globalizimit duke i homogjenizuar mënyrat e jetesës, të të menduarit e të të prodhuarit e bën gjithnjë e më komplekse identifikimin e tjetrit e mbi të gjitha dallimin, mes përkatësive të shumta, të identitetit që e dallon nga të tjerët. Nëse identiteti është ai që e bën çdo individ të jetë unik, megjithatë, elementët që e përshkruajnë, si gjuha, besimi, kushtet sociale, etnia, kombi, mund të përkojnë me disa përkatësi, duke i lënë vend variacionit social-kulturor dhe gjuhësor që karakterizon çdo komunitet, me pasojat që shpesh identiteti që çmohet shkel – negativisht- atë të tjetrit. (Maalouf 1999:21). Përkatësitë e shumta nuk kanë te individët të njëjtat vlera dhe jo në të njëjtën kohë; përveç kësaj, gjuha, kombësia, besimi, kushtet shoqërore, ngjyra e lëkurës shihen nga njerëzit si një identitet i vetëm. Në këtë kuptim, të njohësh diversitetin tënd krahas një përkatësie tjetër, ka si efekt të konsideruarit e identitetit të vetë në konflikt me çka është e ndryshme, si-kurse thekson Maalouf 1999:

Në të gjitha epokat kanë qenë persona që kanë menduar se ekziston vetëm një përkatësi themelore, aq superiore nga të tjerat në çdo situatë sa mund të quhej 'identitet'. Për disa, kombi, për disa besimi ose klasa sociale. [...] nëse ekziston, në çdo moment, mes elementëve

që ndërtojnë identitetin e çdonjërit, një hierarki që nuk është e pandryshueshme, ndërron me kohën dhe modifikon në thellësi sjelljet. (Maa-louf 1999:20)

Në një kohë që dallohet nga komunikimi i shpejtë, nga zgjerimi i informacioneve, nga ndryshimet e modeleve të konsumit dhe nga rritja e lëvizjes së njerëzve e njëkohësisht shenjohe edhe nga dobësimi i raporteve sociale, nga zbehja e vijave kufitare dhe nga rënia e referuesve të vlerave dhe strukturave institucionale, qytetari bindet e përballet me një dimension kognitiv dhe emotiv të pasigurisë (Bauman 2000, 2004). Identiteti, shqetësimet personale, rrjedhin si pasojë e një prodhimi social; emancipimi i individit nga përcaktueshmëria e lindur apo që i atribuohet trashëgimisë së tij sociale e sposton identitetin njerëzor nga gjendja e një të dhëne fikse, të pandryshueshme, në atë të detyrës e të objektivit. Në fakt, shumësia e përkatësive në botën globale e bën të mundshme pranimin e përmbytjeve të caktuara identitare sikurse e kujton Sartori 2000:

[...] saktësimi i Wohlin, për të cilin pluralizmi vepron mbi lidhje të vullnetshme që 'nuk na obligojnë', ndërsa neo-pluralizmi (lexo: multikulturalizmi) vepron mbi lidhje të pavullnetshme – specie të gjinisë e të racës – që përkundrazi na detyrojnë duke qenë se kemi lindur me to e që i mbajmë me vete. [...] është e vërtetë që në ato identitete jemi lindur; por nuk është e thënë që të na mbeten me çdo kusht të ngjitura pas trupit. Për shembull, nga gjuha dilet duke u bërë biling (pra pa humbje e përkundrazi duke u pasuruar). Mund edhe të dalim shumë thjesht, nëse duam, nga besimi në të cilin jemi lindur. (Sartori 2000:108)

Ndërkohë, në shoqëritë aktuale çështja e identitetit është bërë problematike si nga karakteri multikulturor, ashtu edhe nga proceset kulturore (mjetet e komunikimit, çterritorializimi socio-ekonomik, përdorimi i gjuhëve transportuese) që tentojnë t'i shtypin e uniformojnë diversitetet origjinare/ të lindura të njerëzve. Në radhë të parë, karakteri multikulturor i shoqërive tona ka vënë menjëherë në dyshim perceptimin e vetë të përkatësisë të vetëm një grupi social, që

në shoqëritë tradicionale bazohet pikërisht në vlerat dhe dijet e përbashkëta. Efekti i traditës për të organizuar, stabilizuar e kontrolluar sjelljet në sektorë të ndryshëm të jetës sonë përbëhet nga 'kontrolli reflektiv' i veprimit nga ana e individit dhe nga fakti se identiteti merr një natyrë refleksive, si realizim të një projekti indi-vidual (Giddens 1994). Giddens 2000 e lidh rënien e traditës me fragmentimin e identitetit të individit brenda shoqërisë së globalizuar: *për shkak të globalizimit [...] në vendet perëndimore, jo vetëm institucionet publike, por edhe jeta e përditshme po lirohen nga pesha e traditës [...] Në situata më tradicionale perceptimi i vetvetes mbështetet mbi të gjitha nga stabiliteti i pozicioneve sociale të individëve në komunitet; identitetet duhen krijuar e rikrijuar në mënyrë shumë më aktive se më përpara. (Giddens 2000:59,60).*

Përdorimi më i pakët i mekanizmave të vendosjes së rregullave sociale, të normave kulturore dhe të vlerave të shoqërive tradicionale, pra të integritit (Beck 2000), do t'i bënte antarët e shoqërisë moderne më të lirë ndaj rregullave të imponuara nga sistemi social, dhe në të njëjtën kohë, më të varura nga nevoja e të marrit vendime individuale (Giddens 2000). Në një situatë në të cilën 'as fakti që fliten gjuhë të ndryshme, nuk mund ta ndalë rrjedhën e ideve dhe kulturave që sot po përshkon bota' (Held e McGrew 2003:40), identitetet e ndryshme shkëputen nga traditat [...] dhe krijohet një efekt pluralizues mbi formimin e identiteteve. Na lind një varietet identitetesh të pjesshme [...] (Held e McGrew 2003:41). Në mënyrë më specifike del mundësia që kultura e prodhuar dhe ndjesia e përkatësisë së saj shfaqet në vende të dallueshme. Në këtë kuptim, identiteti si identifikim kulturor i jep një lloj jopërcaktueshmërie të mëtutjeshme sistemit kompleks të referimit të përcaktuar nga globalizimi i sinjifikuesve kulturorë (Zamagni 2002).

Kjo analizë në të vërtetë nuk e zgjidh përfundimisht çështjen. Mbetet fakti që baza e identitetit përfaqësohet megjithatë nga një proces i lidhjes me grupet sociale dhe/ose me sistemet e vlerave, pra të mekanizmit të zakonshëm të identifikimit mbi bazën e kombësisë apo

të etnisë. Kushtet multikulturore të shoqërive perëndimore në fakt implikojnë nga njëra anë bashkekzistencën e kulturave të ndryshme dhe të identiteteve të ndryshme, nga ana tjetër fluiditetin e përkatësisë kulturore (Lanzillo 2005). Përveç kësaj, sikurse sugjeron Beck 2000, derisa çdo identitet del nga lidhja me tjetrin, një identitet pa të tjerët është një realitet i papjekur i dominuar nga rreziku. Një pikë shfuqizuese që ka të bëjë me gjendje multikulturore të së shkuarës është që distancimi kohor-vendor i lidhjeve sociale dhe të ndërtimit të ngjarjeve (Giddens 1994) sjell një ndërtim më kompleks ose konservativ të identitetit personal, përfshirë edhe përbërësin gjuhësor. Në fakt strukturimi i kohës dhe i vendit nga ana e mediave e bën të mundshme bashkekzistencën e të ndryshmeve, përkohësisht të ndryshmeve dhe të ndarë në hapësirë, me rezultat që traditat e ndryshme kulturore dhe gjuhësore të jenë objekt i një sistemi të përshtatjes me dukuritë globale, në kuptimin e theksuar nga Fabietti 2000:

Dialektika e lokales dhe globales [...] konfigurohet [...] si një proces i gërshetimit të daljeve të paparashikueshme në të shumtën e rasteve. Në një proces të tillë, një kulturë sheh t'i transformohen vlerat e veta (lokale) në raport me atë që shtohet nga jashtë. Megjithatë kjo 'jashtë' nuk konfigurohet si një kulturë tjetër [...] por si një bashkësi dukurish që u përkasin pandashëm të gjitha (ose pothuajse) kulturave. [...] dukuri të tilla, që i quajmë globale, kur përqafohen nga kultura pranuese, nuk ndihen më si 'të huaja' në të, por bëhen pjesë e asaj kulture, që vazhdon t'i formulojë vlerat e veta sipas nevojave lokale, që duhet gjithashtu t'i mbajnë parasysh [...] forcat globale [...] Kështu pra, në vend që ta mendojmë botën si një entitet që shkon vetëm drejt homogjenizimit [...] apo si të karakterizuar nga 'përballja e civilizimeve' [...] duhet te sforcohemi ta kuptojmë si një skenar të gjerë brenda të cilit traditat e ndryshme kulturore përvetësojnë logjika globale që, duke pasur origjina të tjetra, janë të dyshimta, por kur asimilohen, riformulojnë logjika të tjera të nivelit lokal, në një proces virtualisht të pandalshëm (Fabietti 2000:168-169 in Giaccardi 2005:142)

Raporti mes identitetit dhe faktorëve socio-kulturorë e gjuhësorë vendoset tani në kornizën e proceseve të globalizimit që kanë rrjedhur nga zgjedhjet politiko ekonomike dhe mekanizmat e komunikimit në shoqërinë bashkëkohore. Sikurse e kemi parë në pg. 1, diferencimi i burimeve të informacionit, të gjuhëve sektoriale, të kushteve socio-ekonomike, të kulturave dhe gjuhëve i lë vend një lloji çrregullimi të sjelljeve dhe pritjeve, duke shkaktuar variacione dhe pasiguri në identitetin e individëve. Në të vërtetë radikalizmi i njerëzve në një traditë kulturore e gjuhësore nuk mund të fshihet, sikurse tentojnë ta paraqesin disa qasje në procesin e globalizimit (shih Giddens 2000). Edhe identiteti, për aq sa paraqet botën së cilës i përket dhe lidhjen me një gjuhë, me një besim, me një rit social, me një territor dhe me një traditë, shihet si një rezultat i një projekti identitar, individual apo kolektiv, pra i historisë dhe i dinamikave të saj. Identiteti është gjurmë pra si një e dhënë që nuk varet nga lidhja me një traditë, por si diçka që përkufizohet në brendësi në momentin në të cilin je i shtyrë që ta bësh. Në përputhje me këtë na duken të vlefshme konsiderimet e Goody 2005, për të cilin ideja që ‘ne modernët mund t’ a dalim edhe pa traditën’ nuk mbështetet:

[...] i vetmi pozicion i arsyeshëm është që jemi (ose mund të jemi) më pak të lidhur me atë që e kemi trashëguar [...] nuk mund t’ia bëjmë ndryshe. [...] mjete ynë kryesor i komunikimit – gjuha në formën orale apo të shkruar – sjell pikërisht lidhjen tonë me normat e së shkruarës që e bëjnë të mundshëm komunikimin (Goody 2005:7).

Mund të mendojmë përkundrazi që nuk ka një censurë mes organizimit aktual të shoqërisë, veçanërisht si rezultat i procesit të modernizimit, dhe shoqërive të së kaluarës. Goody 2005 argumenton kundër hipotezës për të cilën moderniteti, i parë si prodhim i kulturës kapitaliste, do të sillte një grup ‘ndryshimesh rrënjësore’ brenda sistemit të raporteve sociale. Në realitet, modernizimi mund të përkojë me ‘variacione të shkallëve’ më shumë sesa me ndryshimet e vërteta në vetë natyrën e shoqërisë njerëzore. Të dhënat etno- dhe socio-an-

tropologjike tregojnë që edhe bazat e ekonomisë së tregut, si të ndër-tuarit e një force pune pa të mira materiale vjen nga epoka e bronxit, kur përdorimi i parmendës dhe i tërheqjes së kafshëve favorizoi një shpërndarje të pabarabartë të tokave dhe formimi i një klase sociale të gatshme për t'u shpërngulur.

Gjuha, ashtu si besimi, është një nga përkatësitë më përcaktuese (të identitetit); historia na mëson që gjuha ka qenë për shumë arsye antagonistja më e madhe e religjionit, e ndonjëherë edhe aleatja e tij. Në momentin kur dy komunitete flasin gjuhë të ndryshme, religjioni nuk është i mjaftueshëm për t'i bashkuar (p.sh. flaminget katolikë dhe valonët) dhe as përkatësia e njëjtë gjuhësore (Bosnja) nuk gatanton sot bashkjetesën mes serbëve ortodoksë, katolikëve kroatë dhe myslimanëve. Njihen, nga ana tjetër, edhe shembuj të aleancave mes islamit dhe arabishtes, mes Kishës katolike dhe latinishtes, mes Biblës së Luterit dhe gjermanishtes. Religjioni tenton të jetë përjashtues, gjuha jo; gjuha është faktori i identitetit dhe instrumenti i komunikimit – Franca, në Algjeri, nuk kërkoi që të konvertonte myslimanët në kristianë, por imponoi frëngjishten. Lidhja mes gjuhës dhe identiteteve të ndryshme sforcon edhe politikat e bilinguizmit, që në disa shtete si Kanadaja, Belgjika ose Zvicra kanë propozuar, sikurse nxjerr në pah Huntington 2005:

Vendet në të cilat të gjithë banorët flasin të njëjtën gjuhë, si Franca, Gjermania dhe Japonia, ndryshojnë thelbësisht nga vendet në të cilat bashkekzistojnë dy ose më shumë bashkësi gjuhësore, si Zvicra, Belgjika dhe Kanadaja. Në këto vende, ndarja e brendshme është gjithmonë e mundur dhe historikisht, faktori i unifikimit nacional ka qenë gjithmonë frika nga fqinjët më të fuqishëm. Tentativat për të krijuar një bilinguizëm të vërtetë me vështirësi janë kurorëzuar me sukses. Mjaft pak kanadezë të gjuhës angleze flasin me korrektësi frëngjisht. Mjaft pak flamingë ndihen komod kur flasin gjuhën valone dhe e kundërta, zvicranët e gjuhës gjermane dhe zvicranët e gjuhës franceze flasin mes tyre anglisht. (Huntington 2005:191)

Kontrasti i madh identitar që mund të krijohet përsa u përket situatave të bilinguizmit përshkruhet kështu në një artikull të javores *Internazionale*, i cili trajton një fakt nga kronika ditore që zë fil nga lidhja afektive e dy parlamentarëve Sophie Péciaux, francofone valone, dhe Rik Daems, separatist flaming:

Kufiri gjuhësor mes Flandrës dhe Valonisë përfundimisht u vendos në fillim të viteve të gjashtëdhjeta; një kufi i cili u kthye në politikë me federalizimin. Tashmë gati çdo gjë është ndarë: gjuha (gjithnjë e më pak fiamingë flasin frëngjisht, ndërsa valonët e sno-bojnë neerlandezen), partitë politike, gjykatat, televizionet dhe radiot, mësimdhënia, hulumtimet e kështu me radhë. Dy kështjellat e fundit të ‘Belgo di papà’ bien njëra pas tjetrës. [...] në Flandër tashmë është e pamundur të shohësh televizionet franceze, përfshirë edhe rrjetet franceze; bibliotekat publike duhet të kenë së paku 75% të librave në neerlandese për të pasur subvencione nga regjioni dhe është e nevojshme të fitet gjuha fiamange për të fituar një vendbanim social e kështu me radhë. Fiandra subvencionon deri edhe prezencën e fiamingëve në Bruksel me qëllim të zvogëlimit të dominancës frankofone. (nga *Internazionale*, 10/16 mars 2006, n.632:48-50)

Rasti i gjuhës moldave, diskutuar te Lorinczi 2005, tregon që zgjedhjet e politikës gjuhësore kanë përmbajtje socio-ekonomike dhe politike. Njohja e një gjuhe moldave lidhet me një ekulibër kompleks të forcave dhe interesave politike, duke marrë parasysh qëllimet territoriale të Rusisë, vullnetin për pavarësi të republikës së Moldovisë dhe aspiratat e rumenëve për një Rumani të madhe. Në Moldavi, republika aktuale e Moldovës, është, për më shumë se një shekull një çështje gjuhësore dhe nacionale e ushqyer nga ‘moldovët’, pra nga inspiruesit e ideologjisë historike, politike e gjuhësore të shfrytëzuar për të ngritur themelin ‘objektiv’ të nevojës për të mbajtur të ndara dhe për të vazhduar me mbajtjen e dallimit mes gjuhës rumene nga ajo moldave e Besarabisë, historisë së Rumanisë nga ajo e Besarabisë [...]’ (Lorinczi 2005:1800). Është kjo korniza kulturore, kur në 2003

Vasil Stati publikoi fjalorin moldoven-rumanisht, përgjithësisht një përmbledhje e varianteve dialektore/rumene regjionale, tepër i kritikuar nga bota shkencore. Për më tepër, edhe pse dy vjet pas botimit të tij, ngre ‘një kuriozitet historik’, ka pasur një vlerë të madhe simbolike dhe një sukses të madh shitjesh. Stati e shpjegon kështu pozicionin e tij:

Gjuha rumune dhe gjuha moldave nuk janë dy gjuhë të ndara; ato kanë dy glotonime, të dyja nacionet [...] të dyja gjuhët nacionale ruajnë dy glotonime, të clat shërbejnë për të identifikuar dy kombet. Unë nuk e di rumanishten, por flas moldavisht dhe rumunët më kuptojnë. (Lorinczi 2005: 180-1; intervista e Statit për agjencinë e lajmeve moldave BASA-Press, 26.8.2004)

Emri i ndryshëm legjitimon pra dallimin mes dy gjuhëve dhe dinjitetin e tyre të barabartë që u takon dy shoqërive të ndryshme nacionale. Në një kornizë etnologjike (Canut 2000), procesi i emërtimit të një gjuhe është trajtuar si një ndërtim social që lind nga ‘vullneti i homogjenizimit’ i drejtuar nga institucionet dhe nga gjuhëtarët. Sikurse e kemi parë, në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë, ndarja e asaj që konsiderohej vetëm një gjuhë, serbo-kroatishtja, në tri gjuhë, serbishte, kroatishte e boshnjakishte, pranimi i emrit përkon me njohjen e tyre si gjuhë e nënës e qytetarëve të entiteteve të reja shtetërore (Canut). Atribuimi i emrave që identifikojnë gjuhët dhe kulturat është pra një instrument i fuqisë, që interpreton barazvlerësinë mes një gjuhe, një kombi dhe një komuniteti etnik.

Një shembull tjetër është nxjerrë nga çështja e gjuhës në rajonin e Kosovës, që paraqet mirë dinamikën që ka të bëjë me vendosjen e një gjuhe standard në procesin e formimit të një shteti komb. Dëshmia e gjuhëtarit Rexhep Ismajli (2005) thekson kontrastin mes aspiratës më të fshehtë të elitës intelektuale, të mbajtjes së karakteristikave rajonale (pra gegë), me interesa të karakterit më të përgjithshëm, që kanë përcaktuar pjesërisht pranimin e standardit të shqipes, pra shqipen e unifikuar. Ndryshimi mes pritjeve të intelektualëve dhe për-

dorimet më të shpeshta në media dhe në institucionet shkollore shfaqet në kushtet e variacionit dhe përzierjes gjuhësore të ndjeshme ndaj ndryshoreve socio-stilistike tipike të proceseve të këmbimit kulturor. Sistemet që hyjnë në lojë janë të folmet kosovare, gegërishtja e standardizuar, shqipja standarde dhe format hibride mes gegërishtes letrare dhe shqipes standarde. Ismajli, autor i një studimi mbi gjuhën standarde dhe identitetet, (Ismajli 2005), e përshkruan situatën duke iu përgjigjur kështu pyetjeve tona:

1) Përdoret në Kosovë shqipja standarde? Në mjetet e komunikimit, në TV, radio, gazeta? Si gjuhë e shkruar?

Në 3 TV kombëtare, në mjaft nga ato lokale, në radio, në 8-9 të përditshme dhe në gazeta të tjera, në të gjitha nivelet e gjuhës së shkruar.

Si gjuhë e ligjeve dhe e proceseve gjuhësore?

Po, si gjuhë e ligjeve dhe e proceseve gjuhësore; ligjet janë të shkruara edhe në serbisht e anglisht.

Në shkolla? Në manuale?

Po, në shkolla dhe në universitet në të gjitha nivelet, edhe në mësimdhënie gjatë pushtimit serb në vitet '90; manualët janë shkruar apo përkthyer në shqipen standarde; më herët ishin përkthyer nga serbo-kroatishtja, tani përgjithësisht nga anglishtja dhe nga gjuhët e tjera europiane; ka edhe manuale të përbashkëta për gjithë zonën albanofone.

Në gjuhën e folur?

Në shkolla e universitete, përdoret në klasa, përgjithësisht, shqipja standarde, edhe pse në nivele përvetësimi e zotërimi të ndryshme; ka një continuum mes formave të shqipes standarde dhe formave të gegërishtes letrare, varet nga shkalla e njohjes së shqipes standarde; ndërhyjnë edhe format dialektore; studentët përdorin edhe një formë rajonale të gegërishtes, veçanërisht në situata më pak formale dhe ato familjare.

2) në kontekstet që numëruat në (1) a përdoret edhe varieteti geg i Kosovës?

Në transmetimet e përgatitura nga redaksia, nuk përdoret; ka transmetime ku përdoret edhe varieteti gegë i kultivuar ose dialekti. Megjithatë gegërishtja e kultivuar dhe dialekti ndikojnë shumë në përdorimin e rëndomtë të shqipes standarde. Varieteti gegë përdoret edhe në transmetimet humoristike dhe në ato të drejtpërdrejta të të rinjve, veçanërisht në televizionet jopublike. Përgjithësisht në gazeta përdoret shqipja standarde, por është edhe një gazetë (Java, e përjavshme) që shkruan vetëm në gegërishte.

3) *Perdorimi i shqipes standarde varet nga klasa sociale e folësit, nga niveli i tij i shkollimit?*

Shtresimi social në Kosovë nuk është studiuar mirë; ka vështirësi për ta përshkruar. Është një shoqëri në transformim të madh nga një shoqëri me shumë elemente koloniale brenda ish-Jugosllavisë, në një pavarësi totale dhe nga një shoqëri komuniste në një shoqëri liberale.

Kontaktet me Shqipërinë dhe shqiptarët e diasporës që më herët ishin të vështira, tashmë janë normale; ka edhe gjurmë të përdorimit të varietetit kosovar kryesisht te të rinjtë në Prishtinë dhe në qytete; për të tjerët, mund të thuhet se fshatarët përdorin dialektin; intelektualët përdorin në situata formale shqipen standarde, edhe pse jo në mënyrë të shkëlqyer; në disa situata përdoret ky continuum meshqipe standarde-gegërishte standarde, pra forma letrare që përdorej më herët, që përdoret edhe në situata jo formale. Në familjen time nuk përdoret dialekti lokal, por një lloj i shqipes së kultivuar që bazohet në gegërishten letrare me mjaft interferenca të shqipes standarde në leksik e në sintaksë.

4) *A perceptohet përdorimi i standardit si mjet emancipimi dhe zhvillimi social?*

Po, përdorimi i standardit të shqipes ndihet si mjet emancipimi dhe përparimi social, çmohet mjaft në jetën publike; megjithatë në disa situata ndihet si artificial.

A lidhet përdorimi i standardit me mjedise apo përdorime të veçanta?

Më shumë në situata formale, mësimdhënie, radio-tv, etj.

5) Varieteti gegë i Kosovës si ndihet nga folësit? Si një lloj dialekti i standardit apo si gjuhë autonome, e ndryshme?

Më tepër si një lloj dialekti i standardit, një varietet, jo si një gjuhë autonome, e ndryshme.

Si një gjuhë minoritare a më pak e rëndësishme?

Të flasësh 'kosovarisht' është ulje në krahasim me përdorimin e standardit, edhe pse është e vështirë të gjesh një limit të saktë në këtë continuum. Çështja e varietetit kosovar nuk shtrohet aq si një çështje e një 'gjuhe minoritare', edhe pse ndihet si më pak e rëndësishme sesa standardi.

A i janë kosovarët besnikë varietetit të tyre të lindur? A ndihet ai si pjesë e identitetit të tyre kulturor e gjuhësor?

Ka edhe kosovarë që po flasin për një identitet kulturor e gjuhësor, por kjo nuk është sjellje e përgjithshme; tendencat integruese me shqipen standarde janë dominuese.

Gegërishtja e standardizuar a flitet tashmë? A shkruhet?

Gegërishtja e standardizuar e përdorur në të kaluarën dhe gegërishtja dialektore fliten vazhdimisht në situatat e përshkruara; në të përjavshmen *Java* shkruhet një dialekt gegë me mjaft elemente të 'gegërishtes standarde', me ndikime edhe nga qarku i Shkodrës; në situata të tjera nuk shkruhet.

6) Tashmë që parashihet një shtet i Kosovës, a ka edhe një politikë gjuhësore?

Për momentin nuk ka një planifikim gjuhësor; bashkë me Akademien e Shqipërisë, Akademia jonë ka krijuar një Këshill Ndërkademik për gjuhën; ky Këshill duhet të diskutojë problemet e gjuhës standarde për të gjitha zonat albanofone dhe të propozojë zgjidhje ku është e nevojshme.

A ka një projekt planifikimi gjuhësor?

Ka një projekt planifikimi që parasheh vetëm një standard me Shqipërinë.

Do të vendoset një standard zyrtar/ letrar? Mbi cilin dialekt do të bazohet? Projekti eventual a e parasheh respektimin e standardit të Shqipërisë apo dallimet gramatikore (psh përdorimi i infinitit etj) dhe ato grafike?

Të gjitha dallimet e mundshme diskutohen bashkë me specialistët nga Shqipëria dhe Maqedonia; nuk ka projekte për varietet të ndryshëm, por vetëm projekte të integritit në standard të elementëve të shfaqur në dhjetëvjeçarët e fundit në të gjitha mjediset albanofone. Dallimet dialektore nuk e veçojnë Kosovën; në fakt, gegërishtja e vjetër letrare përfshinte edhe Shqipërinë e Veriut; në dhjetëvjeçarët e fundit shqipja standarde është pasuruar shumë në përdorimin e saj publik dhe kulturor, kështu që gegërishtja letrare nuk është më e mjaftueshme; tendencat për një gjuhë të vetme të integruar janë të forta. Nuk janë paraparë dallime grafike.

7) Cili është qëndrimi i intelektualëve?

Intelektualët janë të shqetësuar më shumë për çështje të tjera të jetës publike në frymën e integritit kombëtar, edhe sipas një perspektive mbishtetërore; mendohet në përgjithësi që një shqipe standarde e vetme është e mjaftueshme, por që duhet të integrojë gjithë çka mund të jetë e integrueshme; ka edhe kritika nga kundërshtarët e risive apo ndryshimeve në standardin e shqipes. Ka edhe një grup intelektualësh që janë për forcimin e gegërishtes, por është një pozi-

cion jetëshkurtër. Nuk ka studime sociolinguistike për këtë dukuri; në përgjithësi intelektualët përkrahin standardin aktual të shqipes.

8) *Vërejtje të tjera?*

Në vitet '90 të shekullit të kaluar, nën pushtimin serb, të përdorje shqipen në shkolla e universitet, në jetën e përditshme i përgjigjej një kauze, 'une cause à défendre'; ndaj nuk ishte e rëndësishme cila shqipe përdorej, mjaft që të ishte shqipe; kjo dhe liberalizimi i kushteve të jetës, lëvizja e të rinjve etj, kanë përgatitur një situatë në të cilën të gjitha varietetet mund të përdoren normalisht; na shfaqet një gjendje dinamike tranzicioni.

Mendimet e Ismajlit vënë theksin mbi atë se sa është delikat raporti mes gjendjes gjuhësore reale, historike dhe formimit të sjelljes së folësit. Përkatesia në një varietet gjuhësor ndihet si pjesë e përkatesisë së një grupi social dhe të kulturës së tij.

Lidhja mes vlerave morale të përbashkëta dhe gjuhës bën të manifestohet një sjellje e njohur mjaft mirë nga antropologët. Kjo lidhje ka një ndikim të drejtpërdrejtë në lidhjen e emrit të gjuhës metribute të tilla si 'i shenjtë' dhe me nocione si 'e shpirtit'. Kështu për shembull brenda vetë komunitetit të referimit bjellorusishtja është etiketuar si 'themeli i jetës shpirtërore', irlandishtja si 'bartës i një jete plotësisht kristiane', frëngjishtja në Quebec si 'intimisht e lidhur me besimin... me çdo gjë të shenjtë, me çdo gjë të çmuar', mayat kaq chikel si 'gjuhë që na e ka dhënë Zoti' (Fishman 1998:331). Aspekti tjetër që lidhet me shenjtërimin e gjuhës është moralizmi, pra gjuha lidhet me moralin, traditat e zakonet e përvetësuara nga komuniteti, ndaj rendja drejt një gjuhe tjetër të ndryshme nga ajo e grupit sjell mosmirënjohje për stërgjyshërit tanë (Fishman 1998:(332). Lidhja mes gjuhës dhe moralit paraqet pra një mekanizëm psikologjik që pikërisht për aq sa shfaqet në traditat më të ndryshme kulturore, kujton atë që mund ta quajmë në përgjithësi një prirje instiktive. Më saktësisht, duket sikur ka të bëjë me vetitë kognitive që lidhen me sjellje kom-

plekse sikurse është propozuar nga Fodor 1983, Atran 2002, Sperber 2005, që i lidhin përbërësit kulturorë të jetës njerëzore me organizimin modular të mendjes/ trurit. Në veçanti, Sperber (2005:16) karakterizon mendimin si një ‘grup parakushtesh kognitive të specializuara në trajtimin e llojeve të ndryshme të imputit’.

Është interesante të vërehet se në realitet përfshirja e një grupi emigrantësh brenda një komuniteti sjell megjithatë lindjen e ndjenjave të pasigurisë edhe kur ekziston një identitet i njëjtë kulturor, gjuhësor dhe etnik, si në rastin e studiuar nga Giacomarra 1994 lidhur me vësh-tirësitë e integritit në komunitetet arbëreshe të Italisë mesdhetare të shqiptarëve të emigruar në Itali në vitet ’90. Giacomara 1994 del me rezultatin se ‘[...] identitetet e popujve nuk janë të përcaktuar një herë e përgjithmonë, por ndërtohen’. Edhe pse afërsia gjuhësore dhe kuj-tesa historike pjesërisht e përbashkët, ‘Identiteti arbëresh i ndërtuar në vazhdimësi gjatë pesë shekujve [në Itali] mund të mos ketë shumë të përbashkëta me atë të shqiptarit të Shqipërisë’.

REFERIME BIBLIOGRAFIKE

- Anderson B. 2000, *Comunità immaginate. Origini e fortuna dei nazionalismi*. Manifestolibri, Roma
- Baldi B. 2002, *Ai confini della comunicazione. I linguaggi economici tra conoscenza e autopromozione*, TTS, Torino.
- Baldi B. e L. M. Savoia 2005, *Mezzi di comunicazione di massa e scuola: conflitto d'interessi? Media, informazione e educazione linguistica in Italia*, në *Lingua italiana d'oggi*2: 215-268
- Baldi B. e L. M. Savoia 2005a, *I media e la formazione dell'opinione pubblica. Alcune riflessioni sul rapporto tra informazione e globalizzazione*, në *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Firenze*, 15:255-279.
- Bauman Z. 2004, *Voglia di comunità*, Bari-Roma, Laterza.
- Bauman Z. 2005, *La società sotto assedio*, Bari-Roma, Laterza.
- Bauman Z. 2005a, *Dentro la globalizzazione*, Bari-Roma, Laterza.
- Berruto G. 1987, *Sociolinguistica dell'italiano contemporaneo*, Roma, NIS.
- Berruto G. 1990, *Italiano regionale, commutazione di codice e enunciati mistilingui*, në M. A. Cortelazzo e A. M. Mioni (nën kujdesin e), *L'italiano regionale*, Roma, Bulzoni: 105-130.
- Berruto G. 1995, *Fondamenti di sociolinguistica*, Roma-Bari, Laterza.
- Berruto G. 1997, *Code-switching and code-mixing*, në M. Maiden e M. Parry (nën kujdesin e), *The dialects of Italy*, London, Routledge: 394-400.
- Castles S., M.J. Miller 1998, *The Age of Migration. International Population Movements in the Modern World*. Second edition. New York, The Guilford Press.
- Castells M. 1996, *The Rise of the Network Society*, Oxford, Blackwell (përkth. it. *La nascita della società in rete*, Milano, Università Bocconi-Egea, 2002).
- Castells M. 2002, *Galassia Internet*, Milano, Feltrinelli.
- Fabietti U. 2000, *Dal tribale al globale*, Milano, Mondadori.
- Fabietti U. 2005, *L'identità etnica*, Roma, Carocci.
- Fishman J. A. 1998, *Language and ethnicity: the view from within*, në F. Coulmas (nën kujdesin e), *The Handbook of Sociolinguistics*, Oxford, Blackwell: 327-343.
- Giacomarra M. 1994, *Immigrati e minoranze*, Palermo, La Zisa.
- Giddens A. 1994, *Le conseguenze della modernità*, Bologna, Il Mulino.
- Giddens A. 2000, *Il mondo che cambia*, Bologna, Il Mulino.
- Goody J. 2005, *Capitalismo e modernità*, Milano, Cortina.
- Goody J. 2005a, *Oralità, scrittura, globalizzazione e nuove tecnologie*, Intervistë e

- A. Lanni në *Rivista di filologia cognitiva in rete* uniroma1.it/cogfil/goody.html
- Harris N. 2001, *I nuovi intoccabili*, Milano, Il Saggiatore.
- Huntington S.P. 1997, *Lo scontro delle civiltà e il nuovo ordine mondiale*, Milano, Garzanti.
- Huntington S.P. 2005, *La nuova America*, Milano, Garzanti.
- Hymes D. 1974, *Foundations in Sociolinguistics. An Ethnographic Approach*, London, Tavistock.
- Ismajli R. 2005, *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë.
- La Gumina S. 1973, *'Wop!' A Documentary History of Anti Italian Discrimination in U.S.*, San Francisco, Straight Arrow Books.
- Lanzillo M.L. 2005, *Il multiculturalismo*, Roma-Bari, Laterza.
- Lörinczi M. 2005, *La sconfitta del buon senso linguistico: il primo dizionario moldavo-romeno, a oltre un anno dalla sua pubblicazione*, në C.Guardiano., E.Calaresu, C. Robustelli, A. Carli (nën kujdesin e) *Lingue, istituzioni, territori*, Atti del XXXVIII Congresso internazionale di studi della Società di Linguistica Italiana, Roma, Bulzoni: 175-191.
- Maalouf A. 1999, *L'identità*, Milano, Bompiani.
- Macioti M.I., E. Pugliese 2003, *L'esperienza migratoria. Immigrati e rifugiati in Italia*, Bari-Roma, Laterza.
- Menarini A. 1939, *L'italo-americano degli Stati Uniti*, në *Lingua Nostra*, 1: 152-160.
- Pizzorusso A. 1993, *Minoranze e maggioranze*, Torino, Einaudi
- Pontiggia G. 2000, *Come salvare i segreti della parola*, në Moussanet M., *Verso una società aperta*, Milano, Il Sole 24 ore: 218-222.
- Sartori G. 2000, *Pluralismo multiculturalismo e estranei*, Milano, Rizzoli.
- Savoia L. M. 2001, *La legge 482 sulle minoranze linguistiche storiche. Le lingue di minoranza e le varietà non standard in Italia*, in *Rivista Italiana di Dialettologia*, XXV: 7-50.
- Savoia L.M.2002, *Componenti ideologiche nel dibattito sulle leggi di tutela linguistica*, në *Plurilinguismo. Contatti di lingue e culture*, 9: 85-114.
- Tabouret-Keller A. 1998, *Language and identity*, in F. Coulmas (nën kujdesin e), *The Handbook of Sociolinguistics*, Oxford, Blackwell: 315-326.
- Vecoli R.J. 2005, *L'arrivo negli Stati Uniti*, in *Verso l'America*, Roma, Donzelli Editore: 109-143.

Leonardo M. Savoia
STUDIME NË GJUHËSINË SHQIPTARE
2015

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Ganimet Klaiqi

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 18.75 tabakë shtypi
Tirazhi: 200 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18-26
811.18'282.4(450)-26

Savoia, Leonardo M.

Studime në gjuhësinë shqiptare / Leonardo M. Savoia, në bashkëpunim me M. Rita Manzini e Bendetta Baldi. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2015. – 238 f. ; 24 cm. - (ASHAK : Botime të Veçanta ; CXLVIII : Seksioni i Shkencave i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ; Libri 53)

Burimet : f. 6. – Referime bibliografike : f. 237-238

1. Manini, M. Rita 2. Baldi, Bendetta

ISBN 978-9951-615-47-1